# RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
# MBI
# (Auditim Përputhshmërie)

# "ALBCONTROL SH.A"

**TIRANË, JANAR 2022**

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|---|---|---|
| **I.** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | 5 |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit ..... | 5 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve ..... | 6 |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit ..... | 11 |
| **II.** | **HYRJA** ..... | 13 |
| 1. | Objekti i auditimit ..... | 13 |
| 2. | Qëllimi i auditimit ..... | 13 |
| 3. | Identifikimi i çështhes ..... | 14 |
| 4. | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese ..... | 14 |
| 5. | Përgjegjësitë e audituesve ..... | 14 |
| 6. | Kriteret e vlerësimit ..... | 15 |
| 7. | Standardet e auditimit ..... | 15 |
| 8. | Metodat e auditimit ..... | 16 |
| 9. | Dokumentimi i auditimit ..... | 16 |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | **18** |
| a. | Informacion i përgjithshëm ..... | 18 |
| b. | Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit..... | 18 |
| **1.** | Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm..... | 18-22 |
| **2.** | Mbi ligjshmërinë e emërimit dhe funksionimit të organeve drejtuese, vendimet e marra si dhe zbatimi i tyre..... | 23-42 |
| 3. | Mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit ekonomiko ï financiar strategjik dhe atij vjetor të shoqërisë si dhe realizimi i tij..... | 43-55 |
| 4. | Auditim mbi shërbimet e kryera nga shoqëria si dhe zbatimi i sistemit të taksave mbi korridoret ajrore referuar dispozitave ligjore në fuqi..... | 56-60 |
| **5.** | Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli.....<br>- Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna.<br>- Respektimi i dispozitave ligjore për për pagat dhe shpërblimet e punonjësve.<br>- Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin.<br>- Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre. | 61-65 |
| 6. | Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit.....<br>- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogë.<br>- Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.<br>- Inventarizimi i pasurisë së institucionit. | 66-67 |
| 7. | Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.<br>- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik.<br>- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve. | 68-180 |
| 8. | Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....<br>- Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit.<br>- Vlerësimi i Menaxhimit të Riskut. | 181-183 |

| | | |
|---|---|---|
| | - Vlerësimi i Aktivitetit të Kontrollit.<br>- Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. | |
| 9. | Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm të Njësisë..... | 184 |
| 10. | Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit..... | 185 |
| **IV.** | **GJETJET DHE REKOMANDIMET** ..... | **186-204** |
| **V.** | Anekset ..... | 205 |
| **VI.** | Lista e dokumenteve të auditimit ..... | 2018-220 |

# SHKURTIME

| | |
|---|---|
| **KLSH** | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| **SHA** | Shoqëri Aksionere |
| **MFK** | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| **NA** | Nëpunës Autorizues |
| **NZ** | Nëpunës Zbatues |
| **GSM** | Grupi i Menaxhimit Strategjik. |
| **NJAB** | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| **AB** | Auditi i Brendshëm |
| **MAB** | Manuali i Auditimit të Brendshëm. |
| **AQT** | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| **UMF** | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| **VKM** | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| **ISSAI** | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| **INOTSAI** | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| **ISA** | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| **IFAC** | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| **IPSAS** | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| **NJA** | Njësi Administrative. |
| **AK** | Autoriteti Kontraktor |
| **SHA** | Shoqëri Anonimë. |
| **BOE** | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| **OE** | Operator Ekonomik |
| **NjP** | Njësia e Prokurimit |
| **KVO** | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| **KSHA** | Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave |
| **MFE** | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtësr i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 445/1 prot., datë 12.05.2021, i ndryshuar, me nr. 445/2 prot., datë 30.06.2021, i ndryshuar me nr. 445/3 prot., datë 29.07.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.05.2021 deri më datë 30.09.2021, në subjektin ñAlbcontrolò SHA për periudhën nga 01.09.2018 deri më 31.03.2021 u krye auditimi ñMbi përputhshmërinëò nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S. M., Përgjegjës i grupit të auditimit
2. A. K., Auditues
3. E. G., Auditues
4. S. B., Audituese
5. E. H., Audituese

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua rregjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave për punë publike, shërbime dhe mallra, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit.
Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 32 akte konstatimi dhe 2 akt verifikime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit ñAlbcontrolò SHA, brenda afatit të periudhës së auditimit.
Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin e auditimi dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.
Mbështetur në punën audituesve në terren, në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituesve, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituesve përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë.

**2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA për periudhën objekt auditimi, konstatohet se për propozimet dhe vendimmarrjet e ndryshimeve në Programin e Zhvillimit Ekonomik nuk janë relatuar me detaje arsyet mbi këto ndryshime.<br>Materialet argumentuese relatuese mbi këto vendimmarrje, i janë vënë në dispozicion këtij organi vetëm një ditë përpara miratimit duke mos marrë kohë të mjaftueshme për njohjen dhe vlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë këto ndryshime janë miratuar brenda ditës, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*sipas të cilit Raportet dhe materialet e përgatitura për tâu paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë para mbledhjes. | 24 | E Lartë | Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, të marrë masa që të relatojë dhe të argumentojë në procesverbalet dhe mbledhjet e tij, çdo vendimmarrje sipas afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator të funksionimit të shoqërisë |
| 2 | Nga auditimi konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA ka marrë vendimin nr. 2, datë 25.02.2021 ñPër një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontrolò sha të vitit 2021.<br>Nga relacioni bashkëlidhur këtij vendimi argumentohet se shtohet nënzëri ñAsistencë ligjore për çështjen e ngrirjes së llogarive bankare në ñEurocontrolò në vlerën 12,500,000 lekë, vlerë e cila programohet të mbulohet nga zbritja e zërit ñamortizimò, në kuadër të lëshimit të një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg me objekt ñBllokimin/ngrirjen e llogarive të Shqipërisë në Eurocontrol.<br>Pasi pala shqiptare si palë e paditur ka humbur çështjen, pala paditëse i është drejtuar gjykatës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata dhe si rrjedhojë është lëshuar një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg për bllokimin e llogarive të Albcontrol. Për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Belge është angazhuar Eurocontrol, Avokatura e shtetit dhe një studio ligjore Belge e kontraktuar nga Albcontrol për asistencë ligjore.<br>Konstatohet se vendimi nr.2 datë 25.02.2021 i Këshillit Mbikëqyrës për kontraktimin e studios ligjore belge është jo në përputhje me pikën 1, | 44 | E lartë | Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, në lidhje me mbrojtjen për kundërshtimin e vendimit të gjykatës belge dhe angazhimin në këtë proces të një studio ligjore nga ana e Albcontrol SHA, të sigurohet koordinimi i mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit duke garantuar eficencën maksimale në strategjinë e mbrojtjes, si dhe në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të saj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | nenin 9 ñZyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtarò të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 ñPër avokaturën e shtetitò sipas të cilit; Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar | | | |
| **3** | Nga auditimi mbi hartimin e specifikimeve teknike u konstatua se, në 9 raste hartimi i tyre është bërë, jo në përputhje me kërkesat e nenit **23**, pika **3**, shkronja **b)** dhe pika **4** të Ligjit **nr. 9643**, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe jo sipas kërkesave të nenit 61, pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikôi ndryshuar | 37-38 | I mesëm | Nga titullari i shoqërisë Albcontrol SHA, të merren masa, që në zhvillimin e Proçedurave të Prokurimit Publik, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, për çdo kriter të kërkuar në DST, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një proçesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, me qëllim të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale |
| **4** | Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.<br>Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat | 86-101 | I lartë | Këshilli Mbikqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar.<br>Drejtori i Përgjithshëm (Administratori) dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb.<br>Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjt nr. 9901, date 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë ñALBCONTROLò SHA, nenit 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të ñALBCONTROLò SHA, miratuar me vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV ñFunksionimi i shoqërisëò, nenet 21, 37, 38, 39 | | | shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare |
| **5** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò Albcontrol SHA, fituar nga BOE fitues ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCuò SHPK, me vlerë 94,918,419.60 lekë me TVSH, rezultuan zëra punime, konkretisht: *"Shtrim dysheme me Rezinë EPOXY Autoniveluese 3-5 mm (Rezistente ndaj kalimit të mjeteve të magazinës)", "F.V Porte metalike dekorative rrëshqitëse", "Pajisje të brendshme kasetë AUXA54GALH, marka General Fujitsu, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw"* të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën **2,401,029 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 732/4 prot datë 21.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe BOE fitues ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCuò SHPK. | 78-80 | E lartë | Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave. |
| **6** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò | 81-82 | E lartë | Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Albcontrol SHA, fituar nga BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr Enò SHPK, me vlerë vlerë 46,507,991 lekë me TVSH, rezultuan në objekt zëra të punimeve, respektivisht: ñF.V bolier 80 litër, ujë të ngrohtëò dhe zëri ñShtresë termoizoluese me lesh guriò, të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën në vlerën **923,494 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2255/5 prot, datë 27.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr Enò SHPK. | | | bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave. |
| **7** | Mos realizim i detyrimeve kontraktuale me pasojë dëmtimin e fondeve publike në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** për procedurën e prokurimit *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019.* Nisur nga konstatimet e kryera në terren nga grupi i auditimit është konstatuar se në zbatim të kontratës së lidhur për procedurën e sipërpërmendur, nuk është realizuar njëra nga komponentët e zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, konkretisht komponentja óintegrimi i sistemit të akses control me Rostering Systemò. | 9 | E lartë | Administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të marrë masa për ngritjen e grupi pune të përbërë nga specialistë të fushës, i cili të analizojë situatën e realizimit të pjesshëm të zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, zë i cili është faturuar në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** dhe të hartojë një raport ku të përcaktohet vlera financiare përsa i përket ñIntegrimit me Rostering Systemò. Të merren masa që vlera financiare e mos realizimit të integrimit me Rostering System që do të nxirret nga ky raport të arkëtohet pranë shoqërisë nga ana e OE ñR.ò sh.p.k. |
| **8** | Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Trajnim refresh të emergjencave ATCO me REF-06695-02-06-2019, me fond limit 66,666,666 lekë pa tvsh, me fitues BOE **"Co. & M.Al. E.P.N. Al" sh.p.k** me vlerë të ofertës ekonomike **66,666,666** lekë pa tvsh, ku ka rezultuar se KVO-ja nuk ka sqarime për operatorin ekonomik Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò me çmimin e ofertës: 54,800,000 (pesëdhjetë e katër milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh, për arsye se është sókualifikuar nga KVO-ja sepse nuk ka dorëzuar bilancet për vitin 2015, 2016, 2017 e cila pretendon se në bilancet e dorëzuara nga kjo kompani ato nuk i përkasin kompanisë ñGl. AS. D.IVSò, por i përkasin | 9-98 | E lartë | Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për skualifikimin e ofertës ekonomike për të cilën nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik konkurrues, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **66,666,666 lekë pa tvsh**. Të konsiderojë faktin se shqyrtimi i ofertave, duhet të udhëhiqet në përputhje me parimet e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kompanisë ñGl.ATS. L.ò, në (E.W.) dhe se këto dy shoqëri nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën, ndërkohë Operatori Ekonomik pretendon se kjo është e njëjta kompani me **50%** aksione në bashkëpronësi, duke dhënë edhe mundësi verifikimi për këtë rast, përshkruar në formularin e ankesës nr. 640 prot, datë 06.03.2019. | | | përgjithshme të përzgjedhjes, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, duke respektuar kërkesat e nenit 2, dhe nenit nenit 53, pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.<br>- Në procedurat e së njëjtës natyrë, në rast se do të ketë pretendime apo sqarime mbi ofertat e paraqitura apo dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik konkurrues, nëse ekzistojnë të tilla, nga KVO-ja të kërkohen sqarime shtesë për të bërë një krahasim sa më të drejtë të tyre në fazën e shqyrtimit të ofertave dhe ti kthehet një përgjigje operatorit ekonomik të skualifikuar duke argumentuar arsyet e skualifikimit të tij. |
| **9** | Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: ñShpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeò me REF-07076-02-08-2019, me fond limit 22,416,560 (njëzetë e dy milion e katërqind e gjashtëmbëdhje mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh, me fitues operatori ekonomik ñR.ò sh.p.k me vlerë të ofertës ekonomike 21,130,060 lekë pa tvsh, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, hartuar nga AK me proçesverbanin e datës 08.02.2019, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **21,130,060 lekë pa tvsh.** | 91-92 | E lartë | Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë shpalljen fitues në paligjshmëri përdorimin me paligjshmëri të prokurimit në vlerën **21,130,060 lekë pa tvsh**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi në fushën e prokurimit, si pasojë e së cilës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. |

**3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.**

- Në 22 raste nga 27 procedura prokurimi të audituara, rezultuan me disa mangësi dhe shkelje, si rezultat i veprimeve në kundërshtim me kriteret e vlerësimit (LPP, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, udhëzime dhe urdhra të APP-së), në paligjshmëri, në përdorim pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **109,095,377 lekë,** nga ku**:**

**-** Vlera **96,687,709 lekë** paraqet në 4 raste përdorim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve të shoqërisë duke vlerësuar dhe shpallur fituesin nga KVO në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST.

**-** Vlera **12,407,668 lekë** paraqet në 3 raste përdorim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike duke instaluar dhe përdorur paisje jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratat e zbatimit të punimeve.

**-** Nga auditimi i zbatimit të 1 kontratave për punë publike, është evidentuar dëm ekonomik në vlerën **5,602,680 lekë** për mos realizim të njërës nga komponentët së zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò .

**<u>Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë</u>**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së ñAlbcontrol SHAò për periudhën 01.11.2018 deri më 31.12.2020, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar[1].

**<u>Baza për opinionin e kualifikuar</u>**

Nga auditimi, kemi konstatuar se, në subjektin e audituar Albcontrol, në 22 raste, nga 27 procedura prokurimi të audituara, rezultuan me mangësi dhe shkelje, si rezultat i veprimeve në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat kanë sjellë përdorim pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **109,095,377 lekë,** nga ku**:**

- Në 4 raste, janë vlerësuar subjektet dhe shpallur fitues nga KVO në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim, duke sjellë përdorim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve të shoqërisë në shumën **96,687,709 lekë**

-Në 3 raste, janë instaluar dhe përdorur pajisje jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në kontratat e zbatimit të punimeve, duke sjellë përdorim pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në shumën **12,407,668 lekë.**

-Nga auditimi i zbatimit të 3 kontratave për punë publike, është evidentuar dëm ekonomik në vlerën **5,602,680 lekë** mos realizim të zërave në kontratë shërbimi.

**Përgjegjësitë e drejtuesve Shoqërisë Albcontrol SHA:**

Strukturat drejtuese të ñAlbcontrolò SHA, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (Kriteret e vlerësimit).

Gjithashtu, strukturat drejtuese të ñAlbcontrolò SHA janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, për procesin e raportimit financiar, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimeve

**Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar: Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e

[1] *Opinioni i kualifikuar shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale, por jo të përhapura*

përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000 dhe 4100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne, si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## I. HYRJA

### 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

**- Objekti i auditimit synon:**
Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:
- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.
-Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

### 2. Qëllimi i auditimit
Qëllimi i auditimit të veprimtarisë ekonomike të subjektit është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.
Për fushën e prokurimeve qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në cfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuara personat përgjegjëstë ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.
Objektivi i auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.
Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:
1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse:
   - Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
   - Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
   - Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;

- Veprimtaria e shoqërisë është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
- Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.

4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullave përkatëse të prokurimit publik, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore.
4. Shkalla e realizimit të objektivat kryesore të përcaktuar në programet ekonomike dhe financiare.
5. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së ñAlbcontrolò SHA.

**3. Identifikimi i çështjes**

Raporti përfundimtar i auditimit mbi përputhshmërinë e Albcontrol SHA të periudhës 01.09.2018 ï 30.09.2021 ka identifikuar sipas kritereve të specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave respektivisht:
- Zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të KLSH-së;
- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratorit;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
- Organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm të Albcontrol SHA.

**4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

**5. Përgjegjësitë e audituesve**

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni.
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj.
- Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).
- Promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në shoqërinë Albcontrol SHA, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

**6. Kriteret e vlerësimit**

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 ñKushtetuta e Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar; Ligji nr.25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 ñPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuarò; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuarò; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 ñPër sponsorizimetò, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 ñPër arkivatò; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i punës i Republikës së Shqipërisëò, ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 ñPër përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetëroreò, i ndryshuarò, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 ñKodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisëò; Ligji 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 ñKodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisëò, i ndryshuarò; Ligji nr.8821, datë 15.10.2001 ñPër Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it;
- VKM nr.570, datë 3.10.2018 ñPër Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetëroreò; VKM nr.914 datë 29.12.2014 ñRregullat e Prokurimit" i ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar
- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò; Udhëzimi i APP nr.3, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr. 4, datë 09.01.2018òñMbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronikeò; Udhëzimi i APP nr.2, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronikeò; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë etj.
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

**7. Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 ï 165);
- Ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit

në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò;
- Si dhe në praktikat më të mira të fushës.

**8. Metodat e auditimit**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar: shoqëri publike me rëndësi strategjike, kompleksiteti i veprimtarisë kryesore në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, efiçencën dhe rregullshmërinë e operimit të avioneve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjërë në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror të ratifikuar, me Organizatën e Eurokontrollit, Rregulloreve të Parlamentit e Komisionit Europian, Konventës së Çikagos e anekseve të saj, ICAO-s etj; periudha tre vjeçare e aktivitetit; periudha dhe koha e zhvillimit të auditimit, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* ï  në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

**9. Dokumentimi i auditimit**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Albcontrol SHA, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura,  programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### a. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Albcontrol u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992 dhe në 3 shkurt 1999, u transformua në shoqëri aksionare, e quajtur Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror. Albcontrol menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR), në përputhje me standardet ndërkombëtare të lundrimit ajror. Që prej vitit 2003, Albcontrol është anëtare e EUROCONTROL. Në vitin 2009, Albcontrol është anëtarësuar në CANSO Global (Civil Air Navigation Services Organization) dhe që prej Janarit të vitit 2016, është anëtare me të drejta të plota e CANSO Europe Region. Misioni i Albcontrol është të ofrojë shërbime të lundrimit ajror në hapësirën shqiptare (FIR), në kushtet e parrezikshmërisë, cilësisë, kujdesit ndaj mjedisit dhe i orientuar ndaj klientit.
Shoqëria Albcontrol SHA ushtron veprimtarinë e saj sipas objektit që ka për shërbime të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, efiçencën dhe rregullueshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuar në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet e ratifikuara dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror.
Organet e shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Shoqëria është e organizuar sipas sistemit me dy nivele, ku funksionet e mbikëqyrjes ushtrohen nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa funksionet e administrimit nga Administratori.
Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është: Të ofrojë shërbime të navigimit (lundrimit) ajror, të nevojshëm për të garantuar sigurinë, evidencën dhe rregullshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe me gjerë të publikuara në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror të ratifikuara.

### b. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

### 1. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Referuar auditimit të mëparshëm, mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara në Albcontrol SHA me shkresën nr.1190/6, datë 21.12.2018 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, është kryer auditimi i zbatimit të rekomandimeve me programin e auditimit nr. 429 prot, datë 10.06.2019 dhe autorizimit nr. 429/1 prot, datë 10.06.2019, u konstatua mosrealizim i plotë i tyre nga Albcontrol, pasqyruar me gjetjen si vijon:

**►Titulli i Gjetjes: Realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara subjektit Albcontrol SHA, me shkresën nr.1190/6, datë 21.12.2018 nga KLSH, rezultoi se Albcontrol SHA ka hartuar programin dhe ka raportuar në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit 6 mujor nga data e njoftimit të raportit të përfundimtar të auditimit. Për zbatimin e rekomandimeve të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces.
Nga KLSH me program auditimi nr.429 prot., datë 10.06.2019, dhe autorizimi nr.429/1 prot., datë 10.06.2019 drejtuar Albcontrol SHA nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është rikërkuar zbatimi i tyre ***dhe në lidhje me to shkalla e realizimit ka qenë si më poshtë vijon:***
Albcontrol SHA, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe në zbatim të shkresës nr.prot.501, datë 21.02.2019, ka informuar marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Drejtorisë për zbatimin e tyre (rekomandimeve).
Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga Albcontrol SHA, është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimit në zbatim të nenit 15 germa ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, me shkresë nr.prot. 501, datë 21.02.2019, ñProgrami i Punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSHò.
Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatojmë se është zbatuar nga Albcontrol SHA i cili ka informuar KLSH për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve në zbatim të nenit 30 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, me shkresën nr.prot.1314, datë 11.06.2019.
Në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 546/1 prot., datë.23.06.2020, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 28.09.2020 deri më datë 24.12.2020, në subjektin Albcontrol SHA për periudhën nga 01.09.2018 deri më 30.09.2020, nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, **<u>përsa më sipër, konstatohet se:</u>**
**Për 4 Masa Organizative** të mbetura në proces zbatimi *nga <u>Albcontrol SHA konstatohet :**1** masë është zbatuar pjesërisht, **2**</u> masa janë zbatuar plotësisht, **1** masë është në proces.*
Për 1 masë për shpërblim dëmi të mbetur në proces zbatimi në vlerën 33,435,330 lekë*, nga Albcontrol SHA: 1 masë është në proces.*
Për 1 masë për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të mbetur në proces zbatimi në vlerën 1,512,840 lekë *, nga Albcontrol SHA : 1 masë nuk është zbatuar.*
**Kriteri:** Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSHò, neni 15, pika c.
**Ndikimi/Efekti**: Zbatimi i plotë i rekomandimeve do të ndikojë në përmirësimin e aktivitetit të Albcontrol SHA
**Shkaku:** Mungesa e veprimeve të strukturave drejtuese për zbatimin e rekomandimeve.
**Rëndësia:** I mesëm
**Rekomandime:** Këshilli mbikëqyrës i Albcontrol SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në proçese gjyqësore.

*Rezultatet e auditimit për këtë çështje paraqiten si më poshtë:*
**<u>Mbi hartimin e Plan veprimit dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit 20 ditor dhe raportimi me shkrim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga dhënia e rekomandimeve.</u>**
Albcontrol SHA, në zbatim të shkresës nr. 501 prot, datë 21.02.2019 ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit, mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Drejtorisë për zbatimin e rekomandimeve.
Nga Albcontrol SHA, është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH -së, në përputhje me nenin 15 gërma ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëpërmjet urdhrit të brendshëm me nr. 48 prot, datë 15.01.2019, dërguar pranë KLSH me shkresë nr. 501 prot, datë 21.02.2019.
Nga Albcontrol SHA, është respektuar afati 6 mujor, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, dërguar me shkresën nr. 1314 prot, datë 11.06.2019.
**<u>Mbi pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.</u>**

## A. MASA ORGANIZATIVE

**Për 4 masa organizative të mbetura në proçes zbatimi** nga Albcontrol SHA konstatohet se **1** masë është zbatuar pjesërisht, **2** masa janë zbatuar plotësisht dhe **1** masë është në proces zbatimi.

*Trajtuar më hollësisht, si vijon :*

**1.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara. [***Në vazhdimësi***]

Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, me shkresën nr.1314 prot, datë 11.06.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetitò, janë në proces realizimi i plotë i rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së. Referuar auditimit aktual rekomandimet e dhëna nga auditimet e mëparshme, referuar kryerjes së proçedurave të prokurimit kanë rezultuar të zbatuara pjesërisht. **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

**8.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm të marrin masa për rishikimin e vlerës së mbetur dhe jetës së dobishme të makinerive, pajisjeve që influencohen nga zhvillimi teknologjik, dhe nëse pritshmëria e tyre ndryshon nga parashikimet e mëparshme, të kryejë ndryshimet e duhura. Këto veprime janë pjesë e rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare, për planifikimin, zbatimin e programit ekonomik si dhe kërkesat e ardhshme për investime. [***Në vazhdimësi***]

Asambleja e Aksionarit ka proceduar me emërimin e ekspertëve me vendimin nr.122 prot, datë 11.10.2018 ñPër rivlerësimin e Aseteve të Shoqërisëò si dhe është lidhur me këto të fundit kontrata për hartimin e raportit të vlerësimit të aktiveve (proces në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombetare të kontabilitetit SNK 16 dhe 36) me nr. 134 prot, datë 14.01.2019. Aktualisht nga ekspertët e emëruar është kryer rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë ñAlbcontrolò SHA sipas përcaktimeve dhe afateve kontraktore. **Rekomandimi është zbatuar.**

**13.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, duhet të marrë masa që në vazhdimësi, në vlerësimin e ofertave të ardhura për ofertat anomalisht të ulta, të jetë i kujdesshëm që të kualifikojë ato operatorë ekonomik, që kanë dhënë mjaftueshëm sqarime lidhur me anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, të vërtetuara këto me prova shkresore në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, me shkresën nr.1314, datë 11.06.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe referuar proçedurave të prokurimit të audituara nga grupi i auditimit konstatohet se Autoriteti Kontraktor ka mbajtur relacione shpjeguese në rastet e lartpërmendura. **Rekomandimi është zbatuar.**

**13.2 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për evidentimin e përgjegjësive dhe të merren vendimet përkatëse, mbi shkaqet dhe arsyet e mosekzekutimit të kontratës me objekt ñBlerje e pajisjes ILS për implementimin e procedurës RW 36ò, pavarësisht se nuk është kryer asnjë pagesë nga Autoriteti Kontraktor. [***Menjëherë***]

Albcontrol SHA nëpërmjet strukturave përkatëse ka komunikuar zyrtarisht me subjektin, për të ezauruar zgjidhjen e problematikës me mirëkuptim provuar kjo me praktikat me nr. 526 prot., datë 25.02.2019 drejtuar Operatorit Ekonomik TCN dhe TCN International SHPK me kërkesen për përmbushje të detyrimeve kontraktore si dhe me praktikën me nr. 526/1 prot, datë 27.05.2019, me shkresën nr. 2037 prot, date 11.09.2019 kthim pergjigje të operatorit TCN, dhe shkresën nr.1102/1, datë 30.06.2020 kthim pergjigje të operatorit TCN, ky operator ofrohet për të përmbushur kushtet e kontratës sipas grafikut të kontratës dhe meqë janë evidentuar problematika, plani i pagesave të përcaktohet në korrik 2021 dhe ky operator ka pranuar që për një vit në vijim Albcontrol SHA mos të paguajë asnjë pagesë operatorit për sistemin ILS. Në vijim nga sektori përkatës informohet do të ndiqet rruga gjyqësore për evitimin e dëmit, në rast të mosekzekutimit vullnetarisht të detyrimeve kontraktore. **Rekomandimi është në proces.**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**Për 1 masë për shpërblim dëmi, e mbetur në proçes zbatimi**, **nga Albcontrol SHA:** 1 masë është në proces.

*Trajtuar më hollësisht si vijon:*

**1.1- Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Albcontrol SHA dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **33,435,330 lekë** e cila përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shoqërisë dhe që i përket penalitetit që i duhet mbajtur operatorit ekonomik ñT. C. N. - T. C. N. I.ò SHPK, për arsye të mosekzekutimit të zërave të punimeve sipas preventivit dhe të tejkalimit të afateve të kontratës nr. 1646/4 prot, datë 16.03.2016 midis Albcontrol SHA me përfaqësues titullarin e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ñT. C. N. & T. C. N. I. SHPK. [***Menjëherë***]

Albcontrol SHA nëpërmjet strukturave përkatëse ka komunikuar zyrtarisht me subjektin, për të ezauruar zgjidhjen e problematikës me mirëkuptim provuar kjo me praktikat me nr. 526 prot, datë 25.02.2019 drejtuar Operatorit Ekonomik ñT. C. N. ï T. C. N. I.ò SHPK me kërkesen për përmbushje të detyrimeve kontraktore si dhe me praktikën me nr. 526/1 prot, datë 27.05.2019, me shkresën nr.2037, date 11.09.2019 kthim pergjigje të operatorit T. C. N., dhe shkresën nr.1102/1 datë 30.06.2020, kthim përgjigje të operatorit T. C. N., ky operator ofrohet për të përmbushur kushtet e kontratës sipas grafikut të kontratës dhe meqë janë evidentuar problematika, plani i pagesave të përcaktohet në korrik 2021 dhe ky operator ka pranuar që për një vit, në vijim Albcontrol SHA mos ti paguajë asnjë pagesë operatorit për sistemin ILS. Në vijim, nga sektori përkatës informohet se do të ndiqet rruga gjyqësore për evitimin e dëmit, në rast të mos ekzekutimit vullnetarisht të detyrimeve kontraktore. **Rekomandimi është në proces.**

**C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.** Nga Albcontrol SHA *:* **1 masë nuk është zbatuar**, e mbetur në proçes zbatimi.

*Trajtuar më hollësisht si vijon:*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të shqyrtojë vlerën **1,512,840 lekë,** vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në proçedurat e prokurimit me blerje të vogla ñBlerje TV Ledò me vlerë 592,440 lekë me TVSH, për vitin 2016 dhe ñBlerje Moket Poliamid, për vitin 2017 me vlerë 920,400 lekë me TVSH, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, për arsye se kjo vlerë përbën **efekt ekonomik negativ** për shoqërinë. [***Menjëherë***]

Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA ka nxjerrë urdhrin brendshëm me nr. 48 prot, datë 15.01.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe shkresën nr.1314 prot, datë 11.06.2019 ñMbi zbatimin e rekomandimeveò dhe referuar masës për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, është analizuar, por nuk është marrë akoma një vendim. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

**D. MASA DISIPLINORE**, nga Albcontrol Sha*:* **nuk janë pranuar masa disiplinore.**

*Trajtuar më hollësisht si vijon:*

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kontratës Kolektive të Punës neni 38, si dhe kontratave individuale të punës, neni 14, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Albcontrol SHA, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojë procedurat administrative për dhënien e masave disiplinore nga ñ***Vërejtje me shkrim***ò deri në ñ***Largim nga Puna***ò në varësi të shkallës së përgjegjësisë

personale, për nëpunësit e shoqërisë që kanë qenë pjesë e komisioneve të blerjeve me vlera të vogla, njësi prokurimi dhe grupet e marrjes në dorëzim në procedurat e prokurimit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. [***Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2019***]
Referuar këtij rekomandimi titullari i ñAlbcontrolò SHA, nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, është nxjerrë urdhri i brendshëm me nr. 48 prot, datë 15.01.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe shkresa me nr.1314 prot, datë 11.06.2019, por nuk janë nisur proçedura administrative për dhënien e masave disiplinore nga ñ**Vërejtje me shkrim**ò deri në ñ**Largim nga Puna**ò në varësi të shkallës së përgjegjësisë personale, për nëpunësit e shoqërisë që kanë qenë pjesë e komisioneve të blerjeve me vlera të vogla, njësi prokurimi dhe grupet e marrjes në dorëzim në proçedurat e prokurimit të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Referuar periudhës brenda të cilës Administratori i shoqërisë duhet të kishte dhënë masa disiplinore. **Rekomandimi nuk është pranuar.**
Si përfundim arrijmë në konkluzionin se:

- Nga **4 masa organizative të rekomanduara** gjithsej, **2** masa janë zbatuar plotësisht, **1** masë është zbatuar pjesërisht, **1** masë është në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 0, nuk janë pranuar 0.
- Nga **1 masë për shpërblim dëmi të rekomanduara** gjithsej, 0 janë zbatuar plotësisht, 0 janë zbatuar pjesërisht, **1** është në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 0, nuk janë pranuar 0.
- Nga **1 masë për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhiminme ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara** gjithsej, 0 janë zbatuar plotësisiht, 0 janë zbatuar pjesërisht, **1** është në proces zbatimi dhe 0 nuk janë zbatuar, nuk janë pranuar 0.
- Nga **1** masë disiplinore e rekomanduar gjithsej, 0 është zbatuar plotësisht, 0 është zbatuar pjesërisht, 0 është në proces zbatimi dhe **1** nuk është zbatuar.

**2. Mbi ligjshmërinë e emërimit dhe funksionimit të organeve drejtuese, vendimet e marra si dhe zbatimi i tyre.**

**Sipas statutit të miratua**r me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë **me nr.25, datë 1.11.2013**, pjesa II ñAksionet dhe Kapitaliò, neni 7 ñKarakteristika të përgjithshme të aksioneveò, pika 3 citon ñAksionet janë 100% në pronësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjesò.

Kjo është jo në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.08.2008, i ndryshuar, neni 135, pika 2 ñAsambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutitò dhe shkronjën b, pikën 2 të Nenit 13 ñTë drejtat dhe detyrimetò të Seksionit I ñAsambleja e përgjithshmeò e Statutit, pasi nga auditimi konstatohet se sipas Urdhrit të aksionarit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.148 datë 21.11.2017, është miratuar zmadhimi i kapitalit themeltar...ñ. Pra aktualisht aksionari i vetëm i shoqërisë është MFE.

**Rregullorja e shoqërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 26.11.2018 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të brendshëm".**

Pas miratimit të Rregullores së funksionimit të brendshëm, struktura e shoqërisë ka pësuar ndryshime, ndryshime të cilat nuk janë reflektuar në Rregulloren e brendshme.
Shoqëria Albcontrol SHA ushtron veprimtarinë e saj sipas objektit që ka për shërbime të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, efiçencën dhe rregullueshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuar në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet e ratifikuara dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror.
Organet e shoqërisë sipas pikës 1 të benit 12 ñOrganet e shoqërisëò të Statutit janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori

Sipas pikës 2 të nenit 12 të Statutit, shoqëria është e organizuar sipas sistemit me dy nivele, ku funksionet e mbikëqyrjes ushtrohen nga Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa funksionet e administrimit nga Administratori.
Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është: të ofrojë shërbime të navigimit (lundrimit) ajror, të nevojshëm për të garantuar sigurinë, evidencën dhe rregullshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe me gjerë të publikuara në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror të ratifikuara.

**Anëtarësia e Këshillit Mbikqyrës të "ALBCONTROL"SHA", për periudhën objekt auditimi**
Këshilli Mbikëqyrës është organi i shoqërisë i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe në cilësinë e organit mbikëqyrës, mbikëqyr vënien në zbatim të politikave tregtare të shoqërisë sipas kompetencave të parashikuara nga Ligji dhe nga Statuti.
Konstatohet se VKM nr. 642, datë 11.10.2005 **"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore",** e ndryshuar pika 4 citon ñNë përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime mund të përzgjidhen:
*a) nëpunës të institucioneve shtetërore, kur legjislacioni në fuqi nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera;*
*b) specialistë të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, me vjetërsi në pune jo më pak se 5 vjet, dhe personat që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara.*
*Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës".*

**Në udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës, në shoqëritë anonime shtetërore", dal në zbatim të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", citohet: "Kandidati për anëtar në Këshillin Mbikëqyrës, duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:**

*a) Të jetë punonjës i institucioneve shtetërore qendrore, **që kanë administrim të drejtpërdrejtë me sektorin ku bën pjesë shoqëria,** kur legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera.*
*b) Të jetë specialist i institucioneve kërkimore shkencore*
*c) Të jetë pedagog i universiteteve Shtetërore, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet.*
*d) Të jetë person me autoritet profesional, të konfirmuar në fusha të caktuara.*

Sipas pikës 3 të nenit 16 ñAnëtarët e Këshillit Mbikëqyrësò të Statutit, Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të zgjidhen sipas kritereve të profesionalizimit dhe kompetencës dhe të kenë të paktën 1 eksperiencë prej 5 vitesh në:
- *funksione administrative dhe kontrolli apo funksione drejtuese pranë ndërmarrjeve/shoqërive.*
- *veprimtari profesionale apo të mësimdhënies univeristare në degët: juridikë /ekonomikë / financë apo teknik- shkencore të lidhura me veprimtarinë e shoqërisë.*
- *funksione administrative ose drejtuese, pranë administratës publike ose enteve publike që veprojnë në sektorë të përafërt me veprimtarinë e shoqërisë.*

**Për sa më sipër pika 3, neni 16 i statutit të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë me nr.25, datë 1.11.2013, nuk ka qënë në përputhje të plotë me udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës, në shoqëritë anonime shtetërore", dalë në zbatim të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore".**

**Konstatohet se me propozim të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave, Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe me urdhrin e Asamblesë të Përgjithshme nr.112, datë 20.10.2017** ñPër ndryshim në Këshillin Mbikqyrësò është vendosur emërimi në detyrë, për anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të ñALBCONTROLò SHA, si në vijim:

- *znj. A. K.,*
- *z. H. H.,*
- *z. G. Gj.,*
- *znj. M. K.,*
- *znj. B. I.,*
- *z. A. A..*

Për këtë ndryshim është bërë aplikimi dhe regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
Ky emërim është bërë jo në përputhje me udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 ñPër emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës, në shoqëritë anonime shtetëroreò, dalë në zbatim të VKM nr. 642, datë 11.10.2005 ñPër Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetëroreò pasi:
- **A. K.**, me detyrë Drejtore e Departamentit të Administratës Publike, me urdhër nr. 198 prot., datë 21. 03. 2014 të ministrit z. A. A. është emëruar anëtare e Këshillit Mbikëqyrës në SHA ñAeroporti Nënë Terezaò-Tiranë, duke mos përmbushur kriterin ligjor: ñNuk është punonjëse e institucioneve shtetërore qendrore, që kanë në administrim të drejtpërdrejtë, sektorin ku bën pjesë shoqëria që e pranon anëtare të këshillit Mbikëqyrësò.
- **G. Gj.** me detyrë të mëparshme Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me urdhër nr.3, datë 23.09.2013 të ministrit A. A. është emëruar ñAnëtar i Këshillit

Mbikëqyrësò në ñAgjencia Ndërkombëtare e Transportit Ajrorò (ANTA)-Tiranë, duke mos përmbushur kriterin ligjor: ñNuk është punonjëse e institucioneve shtetërore qendrore, që kanë në administrim të drejtpërdrejtë, sektorin ku bën pjesë shoqëria që e pranon anëtare të këshillit Mbikëqyrësò.
Në vijim me VKM nr. 570, datë 03.10.2018 *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore"* është shfuqizuar Vendimi nr.642, datë 11.10.2005, i Këshillit të Ministrave, *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore",* si dhe udhëzimi nr.318, datë 8.4.2009, i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, *"Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore".*

Pika 2 e VKM nr. 570, datë 3.10.2018 ñPër këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetëroreò, citon se: **"Anëtarët e këtyre këshillave propozohen si më poshtë vijon:**
*a)2/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga përfaqësuesi i pronarit, për pronën shtetërore;*
*b)1/3 e numrit të anëtarëve propozohen nga ministri i linjës administrative apo organi i vetëqeverisjes vendore, që përfaqëson shtetin, për shoqëritë shtetërore përkatëse.*

Sipas pikës 4 të VKM nr. 570, datë 3.10.2018 ñPër Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetëroreò: Në përbërje të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore mund të përzgjidhen:
*a) Nëpunës të institucioneve shtetërore, kur legjislacioni në fuqi nuk pengon pjesëmarrjen e tyre në funksione të tjera;*
*b) Specialistë të institucioneve kërkimore e shkencore, të universiteteve, me vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet dhe personat që gëzojnë autoritet profesional në fusha të caktuara;*
*c) Njëri nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe të financës.*

**VKM nr. 570, datë 3.10.2018** *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore"* dhe shfuqizimi i udhëzimit nr.318, datë 8.4.2009, i ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ñPër emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore, **ka legjitimuar emërimin në detyrë, për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të "ALBCONTROL" SHA, përcaktuar me urdhrin e Asamblesë të Përgjithshme nr.112, datë 20.10.2017.**

*Neni 16 "Numri, emërimi, përbërja dhe kriteret", Seksioni II "Këshilli Mbikëqyrës", i Statutit të Shoqërisë Aksionare Albcontrol citon "Këshilli Mbikëqyrës është organ kolegjial i përbërë nga 6 anëtarë, nga të cilët 2 anëtarë propozohen nga Ministria e Financës, 2 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe 2 të tjerë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*

**Për sa më sipër rezulton se Statuti është i papërditësur dhe njeh si organ propozues për antarë një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017.**

**Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 25, datë 23.04.2019** ñ*Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës"* u vendos lirimi nga detyra i anëtarit z. H.H. dhe u emërua në detyrë Znj.V. H. Për këtë ndryshim është bërë aplikimi dhe regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit në datë 25.04.2019.
**Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 2, datë 06.01.2020** *"Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës"* u vendos lirimi nga detyra i anëtarit **z. A. A**. dhe u emërua në detyrë Znj. **L. O**.. Për këtë ndryshim është bërë aplikimi dhe regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit në datë 23.01.2020.
**Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 154 datë 25.11.2020** *"Për ndryshim në Këshillin*

*Mbikqyrës"* u vendos lirimi nga detyra i anëtari znj. Belinda Ikonomi dhe u emërua si anëtar i ri z. **B. K**..

*Për këto ndryshime janë bërë aplikimet dhe regjistrimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.*

**Aktualisht anëtarësia e Këshillit Mbikqyrës përbëhet nga:**
*z.G. Gj. Kryetar,*
*znj.M. K. zv.Kryetar,*
*z. B. K., anëtarë.*
*znj. A. K., anëtarë.*
*znj.V. H., anëtarë.*
*znj L. O. anëtarë.*

**Vendimarrja e Këshillit Mbikqyrës të "ALBCONTROL" SHA" për periudhën 01.09.2018-31.03.2021**

**Për periudhën 01.09.2018-31.12.2018, Këshilli Mbikqyrës ka kryer 1 mbledhje dhe ka marrë 4 vendime, konkretisht:**

**Në mbledhjen e datës 26.11.2018** pjesëmarrës:
z.G. Gj. Kryetar,
znj. M. K. zv.Kryetar,
z. A. A., anëtarë,
z. H. H., anëtarë,
znj.B. I., anëtarë.
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
*-Vendimin nr.8, datë 26.11.2018 "Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA për vitin 2019";*
*-Vendimin nr.9, datë 26.11.2018 "Për miratimin e rregullores së brendshme të "ALBCONTROL" SHA";*
*-Vendimin nr.10, datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me nr.2, datë 30.06.2015 "Për përcaktimin e kufijve dhe niveleve të pagave për pozicion në shoqërinë "ALBCONTROL" SHA";*
*-Vendimin nr.11, datë 26.11.2018 "Mbi projekt programin strategjik 2019-2021 dhe planin vjetor të auditimit 2019.*

**Për vitin 2019 Këshilli Mbikqyrës ka kryer 7 mbledhje dhe ka marrë 29 vendime, konkretisht:**

**Në mbledhjen e datës 16.01.2019**, pjesëmarrës:
z.G. Gj. Kryetar
znj. M. K. zv.Kryetar
z. A. A., anëtarë
z. H. H., anëtarë
znj.B. I., anëtarë
znj. A. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
*-Vendimi nr.1, datë 16.01.2019 "Për lirimin e znj. B.B. nga detyra e administratorit të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*
*-Vendimi nr.2, datë 16.01.2019 "Për emërimin e z. M.K. në detyrën e administratorit të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*

*Të dy vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar me Vendim të Asamblesë së Aksionarit të shoqërisë "Albcontrol", pra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht me Vendimin Nr 3 dhe 4 datë 21.01.2019.*
Për këto ndryshime janë bërë aplikimet dhe regjistrimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Jo në përputhje me pikën 3 të nenit 23 "Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës"** e cila citon: *...në vendimin për emërimin në detyrë përcaktohet edhe paga e administratorit në përputhje me aktet ligjore dhe në varësi të situatës financiare të shoqërisë"*, nuk është caktuar në vendim paga e administratorit z. M.K.

Konstatohet gjithashtu se kontrata e punës së Administratorit z. K. ñPër administrimin dhe drejtimin e shoqërisë ñAlbcontrolò SHA, është lidhur në datën 03.05.2019, pra mesatarisht më shumë së 3 muaj më vonë se emërimi i tij. Gjithashtu pika 1, neni 3 ñKohëzgjatja e kontratësò citon: Kjo kontratë lidhet për 1 afat 3 vjecar, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate përkatësisht për periudhën **3 maj 2019 deri në 3 maj 2021**, afat që në fakt përkon me 2 vite, jo 3.
*Nga minutat e takimit konstatohet se propozimi i z. K. si administrator është në vijim të konsultimeve me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si punonjës aktual i Albcontrol në pozicionin e Drejtorit Ekonomik.*

**Në mbledhjen e datës 11.03.2019** është marrë vendimi si më poshtë vijon:
-*Vendimi nr.3, datë 11.03.2019 "Për miratimin e marrëveshjes së ortakëve "T. H.Y. AO, "ALBCONTROL" SHA dhe "M.D.N. I." SHPK si dhe Statutin e Shoqërisë "AIR ALBANIA" SHPK*.
Nuk disponohen minuta takimi/procesverbal. Dakortësia për vendimin është dhënë me vendim qarkullues nëpërmjet e-mailit.
Sa i përket **vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 11.03.2019** ñPër miratimin e marrëveshjes së ortakëve ñT. H. Y.ò ao, ñALBCONTROLò sha dhe ñM.D.N. I.ò shpk si dhe statutin e shoqërisë ñAir Albaniaò shpkò, nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se me shkresën nr.prot. 670, datë 11.03.2019 nga Administratori i Shoqërisë kjo vendimmarje është përcjellë për miratim në Asamblenë e Aksionarëve. Me vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr.104 datë 31.07.2018 ñPër miratimin në parim të pjesëmarrjes së Albcontrol SHA në shoqërinë e transportit ajror ñAir Albaniaò dhe vendimin e Asamblesë së Aksioniarit nr.108 datë 07.09.2018 ñPër miratimin e marrëveshjes së ortakëve për statutin e shoqërisë ñAir Albania shpkò, është bërë miratimi paraprak në parim.
**Me kartelën shoqëruese nr.196 datë 13.03.2019, të Këshillit të Ministrave, është dërguar vendimi i KM me nr.196 datë 13.03.2019***"Për miratimin e marrëveshjes së ortakëve "T. H. Y. AO, "ALBCONTROL" SHA dhe "M.D.N. I." SHPK si dhe Statutin e Shoqërisë "AIR ALBANIA" SHPK*. (me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Këshillit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë).

**Në mbledhjen e datës 03.05.2019** pjesëmarrës:
z. G. Gj. Kryetar
znj.M. K. zv.kryetar
z. A. A., anëtarë
znj.V. H. , anëtarë
znj. A. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
-*Vendimi nr.4, datë 03.05.2019 "Për miratimin e kontratës së administrimit të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*
-*Vendimi nr.5, datë 25.06.2019 "Mbi dhënien e miratimit për kalimin kapital (pa pagesë) të disa*

*pajisjeve të punës Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, Tiranë.*

Nëpërmjet vendimit nr.5, datë 25.06.2018, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur dhënien e miratimit për kalimin kapital (pa pagesë) të disa pajisjeve dhe orendive të zyrës në pronësi të ñAlbcontrolò sha, në favor të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Disaporën, Tiranë. Sipas aneksit bashkëlidhur mbi të dhënat kontabile të pajisjeve dhe orendive të zyrës vlera e mbetur e tyre në datën 31.12.2018 është vlerësuar 1,454,590 lekë.
Ky vendim është rezultat i kërkesës me nr.prot 38, datë 08.03.2019 nga Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Tiranë.

-*Vendimi nr.6, datë 25.06.2019 "Për financimin e D.P.P.Sh., për blerjen e 30 pajisjeve të radiokomunikimit personal (radio dore).*

Vendimi 6, datë 25.06.2018 ka financuar D.P.P.Sh., për blerjen e 30 pajisjeve të radiokomunikimit personal (radio dore) në vlerën prej 819,720 lekë me TVSH, në vijim të kërkesës së kësaj të fundit me nr.3025 prot., datë 12.04.2019.
Konstatohet se bashkëlidhur është një formular përllogaritës të FL nga specialisti i Administrimit të IT të D.P.P.Sh. për ñRadio dore dixhitale+bateri rezervëò i mbajtur në datën 11.04.2019 (një ditë para kërkesës zyrtare të dërguar në Albcontrol): 220 euro/copë * 124,2 = 819,720 lekë e paraqitur si oferta më e ulët.
Në këtë formular të specialistit të Administrimit të IT të D.P.P.Sh. citohet se ky testim tregu në lidhje me çmimet është kërkuar verbalisht nga ana e Shefit të S.Rr. dhe K.D.T.I., të D.P.P.Sh.
Në gjykimin e grupit të auditimit dokumentacioni i paraqitur nga D.P.P.Sh. nuk është e mjaftueshme dhe nuk disponon gjurmë auditimi për ta vlerësuar.

-*Vendimi nr.7, datë 03.05.2019 "Për financimin e botimit të Global FDI Reports"*
Me vendimin nr.7 datë 03.05.2019 është bërë financimi i botimit të Gazetës Global FDI Reports në vlerën 10,000 euro, në vijim të kërkesës së kësaj të fundit me nr.595 prot., datë 04.03.2019.

-*Vendimi nr.8, datë 03.05.2019 "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*

-*Vendimi nr.9, datë 03.05.2019 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2019";*
Me vendimin nr.9, datë 03.05.2019 është miratuar shtesa në zërin sponsorizime/veprimtari humanitare/fonde bamirësie në vlerën prej 3,150,000 lekë duke arritur në vlerën përfundimtare prej 8,150,000 lekë.

-*Vendimi nr.10, datë 03.05.2019 "Për miratimin e dhënies me qira të një ambienti të shoqërisë për një afat 1 (një) vjeçar";*
Nga auditimi konstatohet se relacioni dhe vendimi miratojnë dhënien me qera të një ambjenti me sipërfaqe 33 m/katrorë, për 1 afat kohor 1 vit, vendim i cili hyn në fuqi menjëherë.

-*Vendimi nr.11, datë 03.05.2019 "Mbi financimin e Urgjencës së Spitalit Francez, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza";*
Konstatohet se me vendimin nr.11, datë 03.05.2019, është financuar nga fondi përkatës i programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontrolò, Urgjenca e Spitalit Francez në vlerën 5,000,000 lekë sipas preventivit të paraqitur.
Kërkesa për financim është bërë me nr. 2251 prot., datë 07.11.2018 në Albcontrol SHA. Ky i fundit është përgjigjur me shkresën nr.2251/1 prot datë 20.11.2018, ku shpreh dakortësinë për

financim si dhe i kërkon preventivin e detajuar. Me shkresën nr.4780/3, datë 13.12.2018 të DP të QSUT-së, protokolluar pranë ñAlbcontrolò me nr prot datë 2251/3 datë 14.12.2018, është dërguar preventivi i detajuar ku sipas tij shuma e shpenzimit është 5,000,000 lekë.
Grupi i auditimit konstaton se programi ekonomik i shoqërisë ñAlbcontrolò është miratuar me vendimin nr.8 datë 26.11.2018. Evidentohet se zëri ñsponsorizime/veprimtari humanitare/fonde bamirësieò është miratuar po në vlerën 5,000,000 lekë, po aq sa ka ardhur preventivi mbi financimin e Urgjencës së Spitalit Francez, Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò.

-*Vendimi nr.12, datë 03.05.2019 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me nr.2, datë 30.06.2015 "Për përcaktimin e kufijve dhe niveleve të pagave për pozicion në shoqërinë "ALBCONTROL" SHA" (i ndryshuar);*
Nga minutat e takimit dhe vendimi konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës në nëntor të vitit 2018 (me vendimin nr.10, datë 26.11.2018) miratoi disa ndryshime në skemën e pagave të shoqërisë të cilat **do të hynin në fuqi në 01.04.2019.** Ndërkohë, me vendimin nr.12, datë 03.05.2019, ky afat shtyhet deri në datën 01.07.2019. **Konstatohet se vendimmarrja për ndryshim afati është marr 1 muaj më vonë pas datës që vendimi ka filluar të jap efekte.**

-*Vendimi nr.13, datë 03.05.2019 "Për financimin e pajisjeve të dhomës së Rontgen-it në Qendrën Shëndetësore Vorë";*
Konstatohet se me vendimin nr.13, datë 03.05.2019, është financuar nga fondi përkatës i programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontrolò, dhoma Rontgen-it në Qendrën Shëndetësore Vorëò, në vlerën 807,120 lekë.

**Në mbledhjen e datës 12.07.2019**, pjesëmarrës:
z. G. Gj. Kryetar
znj. M. K. zv.Kryetar
znj.V. H., anëtarë
znj. B. I., anëtarë
znj. A. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
-*Vendimi nr.14, datë 12.07.2019 "Për miratimin e raportit të audituesve ligjorë dhe të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018";*

-*Vendimi nr.15, datë 12.07.2019 "Mbi shlyerjen e vlerës së mbetur të marrëveshjes së kredisë të lidhër midis "ALBCONTROL" SHA Bankës BNP P., EX-IM B. dhe W. F.B., për financimin e projektit të modernizimit të hapësirës ajrore shqiptare".*

Me vendimin nr.15, datë 12.07.2019 Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur shlyerjen paraprake **(përpara afatit të përcaktuar në kontratë, mars 2020**) të vlerës së mbetur të kredisë së lidhur midis ñAlbcontrolò sha. Bankës BNP P. (banka huadhënëse) EX-IM B. (garantuesi) dhe W.F.B. (agjenti i sigurimit) duke përdorur Fondin Rezervë në W.F.B.
Grupi i auditimit nuk evidenton problematika në lidhje me vendimin nr.15 datë 12.07.2019, por konstaton se kredia është marr në dollar në vlerën 36,737,164 $ dhe ekuivalent në euro 26,655,514 euro. Marrëveshja e kredisë është finalizuar pa miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.655, datë 18.12.2002 ñPër modernizimin e hapsirës ajrore shqiptareò.
Sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e kredisë pagesa e kësteve të kredisë do të realizohet në euro.
Do të shlyhen 20 këste 6 mujore nga të cilat:
*-principali 6 mujor ka një vlerë fikse prej 1,332,775.71 euro;*
*-Interesat janë të ndryshueshme cdo 6 mujor, ato përllogariten mbi bazën e mbetur të principalit duke shumëzuar normën e Eurobor-it + 0.10%.*

Sipas relacionit gjendja e rezervës së Albcontrol SHA në W.F.B. në fund të muajit maj rezultonte 2,695,509 euro, vlerë e mjaftueshme për të mbuluar 2 këstet e mbetura të kredisë.
Albcontrol SHA u ka propozuar bankave mundësinë e shlyerjes së 2 kësteve të fundit (shtator 2019 dhe mars 2020) nga fondi rezervë, duke mos u mbajtur në këtë mënyrë nga të ardhurat e mbikalimeve për llogari të ñAlbcontrolò. ñE.B.ò dakortësoi përdorimin e fondit rezervë me kusht shlyerjen e kredisë përpara afatit 2020, pra duke e parapaguar atë.
**Marrja e kredisë në dollar dhe shlyerja e saj në euro, ka rritur riskun e ekspozimit të humbjeve nga këmbimi i valutave dhe ndryshimi i kurseve të këmbimit. Kontrata e kredisë është nënshkruar nga Qeveria e RSH në datën 30.12.2002. Për sa më sipër në lidhje me miratimin e marrëveshjes në dollar dhe likuidimin e saj në euro nuk është përgjegjësi e Albcontrol.**

-*Vendimi nr.16, datë 12.07.2019 "Për mosmiratimin e "Raportit të përgjithshëm të vlerësimit të aseteve të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA" të ekspertëve znj. S.Sh. (EKR) dhe z. R.Ll. (EKR)";*
-*Vendimi nr.17, datë 12.07.2019 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik te shoqërisë ALBCONTROL SHA për vitin 2019" (i ndryshuar);*
Konstatohet se me vendimin nr.17, datë 12.07.2019, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar ndryshimet e fondeve në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontrolò, është miratuar kërkesa për shtim fondi në vlerën prej 2,500,000 lekë në bazë të kërkesave për sponsorizim.

-*Vendimi nr.18, datë 12.07.2019 "Për mbështetje financiare të programit "Code for Albania 2019-2020".*
Kërkesa për financim është bërë me nr.1277 prot., datë 05.06.2019. Kjo kërkesë është miratuar me vendimin nr.18, datë 12.07.2019 në vlerën prej 2,450,000 lekë.
Grupi auditimit konstaton se anëtari z. A.A. ka firmosur në fund të procesverbalit të minutave të takimit edhe pse nuk rezulton i pranishëm sipas dokumentimit.

**Në mbledhjen e datës 29.07.2019,** pjesëmarrës:
z. G. Gj. Kryetar
znj. M. K. zv.Kryetar
znj.V. H., anëtarë
z. A. A., anëtarë
znj. A. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
-*Vendimi nr.19, datë 29.07.2019 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë ALBCONTROL SHA per vitin 2019" (i ndryshuar);*

-*Vendimi nr.20, datë 29.07.2019 "Mbi hulumtimin e tregut bankar për mundësinë e kredimarrjes në lidhje me investimet navigacionale në projektet e infrastrukturës aeroportuale"* .

Me vendimin nr.20, datë 29.07.2019 Këshilli Mbikëqyrës autorizon administratorin e shoqërisë ñAlbcontrolò të procedojë për hulumtimin e tregut bankar me qëllim vlerësimin e potencialeve të kreditimit si dhe vlerat e interesave më lidhje me investimet navigacionale në projektet e infrastrukturës aeroportuale.
Nga relacioni bashkëlidhur i D. P. konstatohet se dhe shlyerja e parakohshme e kredisë marr me vendimin nr.15, datë 12.07.2019 lidhet pikërisht me këtë arsye, që Albcontrol SHA të jetë i lirë nga detyrimi për planëzimin e të ardhurave për shlyerje kredie dhe me mundësinë për marrje të re kredie.
Kjo kredi sipas relacionit do të merret për arsyen se me miratimin e kontratës koncesionare për aeroportin e Kukësit me VKM me nr.146, datë 20.03.2019 ñPër miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, ndërmjet RSH, të përfaqësuar nga MIE dhe BOE ñG. T. M.ò

shpk dhe ñB.ò shpk, si dhe koncesionari dhe shoqërisë koncesionare ñK. I. A.ò shpk, për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësitò rrjedhin disa detyrime edhe për Albcontrol SHA, që kanë të bëjnë si me infrastrukturën navigacionale brenda këtij aeroporti ashtu dhe për procese të tjera në funksion të shërbimeve navigacionale, për të cilat Albcontrol SHA është duke punuar me qëllim përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë, në afatet e përcaktuara.
Në relacion përmendet se plani aktual i të ardhurave të Albcontrol SHA nuk krijon hapësira për mbulimin financiar të investimeve navigacionale kapitale në funksion të aeroporteve të Kukësit dhe Vlorës. Për këtë arsye nevojitet kredimmarrja.

**Në mbledhjen e datës 25.09.2019, pjesëmarrës:**
z. G. Gj. Kryetar
znj. M. K. zv.Kryetar
znj.V. H., anëtarë
z. A. A., anëtarë
znj. A. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
-*Vendimi nr.21, datë 25.09.2019 "Për miratimin e raportit të ekspertit kontabël të regjistruar për sistemimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*
-*Vendimi nr.22, datë 25.09.2019 "Për një ndryshim në Programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2019" (i ndryshuar).*

Me vendimin nr. 22, datë 25.09.2019 është miratuar ndryshim fondi për shtim të zërit sponsorizime/veprimtari humanitare/fonde bamirësie në vlerën prej 5,000,000 lekë duke arritur në 15,650,000 lekë, për të kontribuar në ndërtimin e banesave që janë dëmtuar nga tërmeti i 21 shtatorit të vitit 2019.
Dhe shtim në nënzërin ñShpenzime për qira operacionale/leasing në vlerën 1,300,000 lekë zë i paparashikuar më parë për projektin e aeroportit të Ku. dhe Vl., marrje me qera një automjet me parametra të larta sigurie.
Sipas relacionit vlera totale e shpenzimit arrin në vlerën 8,400,000 lekë dhe do të mbulohet nga zbritja e nënzërit që i bashkangjitet kësaj kërkese.
Konstatohet se në fakt vlera totale e shpenzimit është 6,300,000 lekë (pra 5,000,000+1,300,000) dhe bashkëlidhur relacionit dhe vendimit nuk dokumentacion bashkëlidhur. **Nuk argumentohet nevoja e një automjeti me parametra të larta sigurie.**

-*Vendimi nr.23, datë 25.09.2019 "Për kalimin pranë "AIR ALBANIA" të pasurisë me nr.6/57-N15, me sipërfaqe 38.40 $m^2$ si kontribut në kapital dhe të pasurisë me nr.6/57-N9, me sipërfaqe 317.10 $m^2$ në huapërdorje".*

**Në mbledhjen e datës 19.12.2019,**
z. G. Gj. Kryetar
znj.M. K. zv.Kryetar
znj.V. H., anëtarë
z. A. A., anëtarë
znj. A. K., anëtarë
znj.B. I., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
-*Vendimi nr.24, datë 19.12.2019 "Mbi Programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA, për vitin 2020".*
Me vendimin nr. 24, datë 19.12.2019, Këshlli Mbikëqyrës vendosi tëi propozojë MFE si aksionari i vetëm i shoqërisë Albcontrol SHA miratimin e programit të zhvillimit ekonomik *të shoqërisë*

*"ALBCONTROL" SHA* për vitin 2020.

*-Vendimi nr.25, datë 19.12.2019 "Për miratimin e Raportit të Vlerësimit "Për përcaktimin e sasisë dhe çmimit të skrapit*ò.
Me vendimin nr.25, datë 19.12.2019, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar raportin e vlerësimin *"Për përcaktimin e sasisë dhe çmimit të skrapit"* i cili do të shërbejë për fillimin e procedurës së ankandit.
Nga përshkrimi i dhënë në raport ekspertët kanë vlerësuar se 2 makina, të vlerësuara jashtë përdorimi, vlerësohen me vlerë tregu sa sasia e hekurit, aluminit dhe inoxit për skrap si në vijim:

a) *Autoveturë Hynday CF3, viti prodhimit 1998 për 30,000 lekë*
b) *Autoveturë Hynday GDH, viti prodhimit 2015 për 60,000 lekë.*

*-Vendimi nr.26, datë 19.12.2019 "Për një ndryshim në Programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2019" (i ndryshuar).*
Me vendimin nr.26, datë 19.12.2019, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar ndryshimet në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë të Albcontrol SHA si në vijim:
*-uljen e zërit shpenzime për natën e vitit të ri me vlerën 16,500,000 lekë*
*-uljen e zërit shpërblim i punojësve me vlerën 60,000,000 lekë*
*-rritjen e zërit sponsorizime/veprimitari humanitare/fond bamirësie në vlerën 76,500,000 lekë.*
Sipas relacionit ky fond prej 76,500,000 lekë do të kalojë për rindërtimin e banesave të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit.
**Është e paargumentuar përse ky ndryshim është bërë pas vendimit nr.24, datë 19.12.2019 nëpërmjet të cilit** Këshilli Mbikëqyrës vendosi tô propozojë MFE si aksionari i vetëm i shoqërisë Albcontrol SHA miratimin e programit të zhvillimit ekonomik sha për vitin 2020. <u>Në këtë program ekonomik janë paraqitur variantet e shpenzimeve përfundimtare të zërave të vitit 2019 pa ndryshimet e fundit me vendimin nr.26, datë 19.12.2019.</u>

*-Vendimi nr.27, datë 19.12.2019 "Mbi dhënien e ndihmës financiare z. A.H. punëmarrës i "ALBCONTROL" SHA";*
*-Vendimi nr.28, datë 19.12.2019 "Për miratimin e projekt-programin strategjik 2020-2022 dhe planin vjetor të auditimit 2020";*
*- Vendimi nr.29, datë 19.12.2019 "Për transferimin e fondit 76,500,000 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind mijë lekë) të ALBCONTROL SHA në e-Albania".*

Në lidhje me gjithë autorizimet e dhëna nga Albcontrol, sipas relacioneve evidentohet se janë dhënë të bazuara në Ligjin 7892 datë 21.12.1994 ñPër sponsorizimetò, i ndryshuar, neni 1.
Në lidhje me këtë ligj konstatohet se:
*a)* Neni 1 citon *"Ky ligj rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim "sponsorizime", të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit.*

**<u>Për vitin 2020 Këshilli Mbikqyrës ka kryer 5 mbledhje dhe ka marrë 11 vendime, konkretisht:</u>**

**Në mbledhjen e datës 24.04.2020** është marrë vendimi (nuk ka procesverbal minuta takimi) si më poshtë vijon:
*-Vendimi nr.1, datë 24.04.2020 "Për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të "ALBCONTROL" SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë".*
Nga grupi i auditimit konstatohet se referuar vendimit nr.1, datë 24.04.2020 ñPër uljen e pagave të

punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të ñALBCONTROLò SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisëò referuar impaktit të pandemisë botërore të shkaktuar nga COVID-19, Këshilli Mbikqyrës i Albcontrol SHA për marrjen e këtij vendimi është bazuar në VKM nr.243, datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyroreò, programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2020; nenit 41 të Kontratës Kolektive me nr.prot 656, datë 30.03.2017, deri në kthimin në normalitet të situatës financiare.

Këshilli Mbikëqyrës për marrjen e vendimit mbështetet në nenin 41 të ñKontratës Kolektiveò me nr.prot 656., datë 30.03.2017, i cili citon se ñ**Palët në këtë kontratë kolektive nuk do të jenë përgjegjëse në qoftë se përmbushja e ndonjë prej detyrimeve ose parashikimeve të kësaj kontrate, vonohet ose pengohet për shkak të ndonjë ngjarje të forcës madhore**ò.

**Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:**
-Pika 5 e vendimit nr.1, datë 24.04.2020 vendos ñ...pezullimin e të gjitha të drejtave të punëmarrësve me efekte financiare(të pacituara në këtë vendim) të fituara me kontratën kolektive, deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisëò.
**Ky vendim nuk ka asnjë mbështetje dhe argumentim ligjor, përpos faktit që pezullimi i gjithë të drejtave të punëmarrësve me efekte financiare nënkupton pezullim të plotë për cdo të drejtë, duke filluar që nga paga bazë e cdo shtesë mbi këtë pagë.**
-Neni 6 ñKohëzgjatja e kontratësò përcakton se: ñKjo kontratë lidhet për një afat 3-vjecar, afat i cili fillon që nga dita e nesërme e nënshkrimit të saj nga palët. Kontrata i shtrin efektet e saj ndaj punëmarrëve dhe punëdhënësit, deri në përfundim të afatit 3-vjecarò.
**Sipas këtij përcaktimi ky afat 3-vjeçar mbaron në datën 01.04.2020. Për sa më sipër vendimi nr.1 i datës 24.04.2020 "Për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të "ALBCONTROL" SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë" është përtej këtij afati dhe si rrjedhojë i pambështetur në përcaktimet dhe klauzolat e kontratës kolektive.**
Kjo pavlefshmëri mbështetet edhe nga pika 1 e nenit 40 ñZgjidhja e kontratës kolektive të punësò e cila citon se ñ...Kjo kontratë kolektive pushon së ushtruari efektet e saj ndaj palëve kontraktuese, kur përmbushet afati i zgjidhjes së saj parashikuar nga neni 6 i kësaj kontrate.
-Pika 7 e vendimit nr.1, datë 24.04.2020, citon: ñKy vendim i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2020, pra me fuqi prapavepruese, jo në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, Neni 105 ñEfektet prapavepruesëò i cili citon se Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:
*a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;*
*b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;*
*c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.*
-Ky vendim është jo në përputhje edhe me pikën 3 të nenit 43 e cila citon se: ñ...Për çështje të caktuara palët kanë të drejtë të rinegociojnë çdo vit..ò Për sa më sipër marrja e këtij vendimi është kryer pa negocim dhe diskutim.

Konstatohet gjithashtu se në relacionin nr.647, datë 16.04.2020 të përgatitur nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, Drejtori Juridik dhe Drejtori i Divizionit Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm në Abcontrol SHA, bashkëlidhur vendimit nr.1, datë 24.04.2020 ñPër uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të ñALBCONTROLò SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisëò të Këshillit Mbikqyrës , në pikën II ñPropozimet e Eurocontrol për

përballimin e situatës, Eurocontrol (Organizata Europiane për Sigurinë në Aviacionin Civil) ka paraqitur 2 propozime:

*1. Eurocontrol propozon aprovimin nga shtetet anëtare të masave në lidhje me një modifikim të përkohshëm të shtyrjes të datës së fundit të marrjes së pagesave për tarifat e përdoruesve të hapësirës ajrore. Ky modifikim propozohet vetëm për katër muajt. Propozimi bazohet në pamundësinë e kompanive për të paguar faturën e muajit shkurt dhe në vijim në kushtet e kufizimeve të aktivitetit;*

*2 Propozimi i dytë ka të bëjë me aprovimin e një mase financiare për të kufizuar mungesën e fluksit të parave në rast të shtyrjes së datës së fundit të marrjes së pagesave të përdoruesve të hapësirës ajrore ( sipas propozimit të parë), ose në pamundësi të marrjes së pagesave si rezultat i trafikut të ulët që pritej për periudhën Mars-Qershor/Korrik 2020, duke lejuar Eurocontrol të hyjë në një marrëveshje kreditimi në vlerën 1.27 miliardë euro, kreditim i cili do të mbulohet kryesisht nga pagesat e shtyra nga operatorët ajrorë.*

**Konstatohet se:** Në pikën III të relacionit shoqëria ka konsideruar të detyrueshme reduktimin e shpenzimeve ku janë përfshirë shpenzimet operative për personelin si shpenzimet për paga apo të tjera të fituara nga punëmarrësit mbi bazë e kontratës kolektive në fuqi, *por kjo masë e ndërmarrë, nuk pasqyrohet në propozimet e Eurocontrol për përballimin e situatës COVID -19.*

**Në vendim kanë firmosur të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Mungojnë minutat e takimit / procesverbali.**

**Si konkluzion:** *Vendimi nr.1, datë 24.04.2020 "Për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të "ALBCONTROL" SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë"është jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

*Nga komunikimet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, midis Albcontrol dhe përfaqësuesve të Eurocontrol konstatohen korrespondenca duke filluar nga 18 mars 2020, në lidhje me problematikat e shkaktuara nga pandemia e Covid-19.*

**Në mbledhjen e datës 15.06.2020**, pjesëmarrës:
z.G. Gj. Kryetar
znj.M. K. zv.Kryetar
znj.B. I., anëtarë
znj. V. H., anëtarë
znj.A. K., anëtarë
Znj. L. O., anëtarë

**Është marrë vendimi si më poshtë vijon:**

*-Vendimi nr.2, datë 15.06.2020 "Mbi dakordësinë për përfshirjen e "ALBCONTROL" SHA në marrëveshjen e kredisë së EUROCONTROL për përballimin e krizës së shkaktuar nga Covid - 19".*

**Konstatohet se**: Sipas relacionit Albcontrol SHA do të përfshihet në marrëveshjen e kredisë së Eurocontrol për përballimin e krizës së shkaktuar nga Covid-19. Përfshirja në këtë kredi vjen si pasojë e nevojës për likuiditet për të mundësuar mbulimin e shpenzimeve operative (paga, shpenzime operacionale).

**Terma dhe kushtet e pjesës së kredisë që i takon Shqipërisë:**

*Principali 3,610,482.90 euro*

*Qëllimi: Mbulimi i minimumit të kostove operative si rezultat i pagesave të shtyra në kohë për periudhën mars-korrik.*

*Maturimi: deri më 31.03.2022*

*Norma e interesit: EURIBOR 3-mujor + 1.5 % ( në rast se Euribori do të jetë negativ, atëherë do*

*të konsiderohet 0).*
*Pagesa e interesit: Interesi i akumuluar në vlerën 6,267 euro për periudhën nga 30.06.2020 deri më 30.09.2020 (pagesa do të kryhet në datën 30.09.2020).*
*Komisione disbursimi: 0.3% mbi shumën totale të kredisë.*

Konstatohet se përfshirja në këtë kredi për mbulimin e shpenzimeve operative (për pjesën e pagave) është e pambështetur për aq kohë sa Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.1, datë 24.04.2020 ka vendosur për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të ñALBCONTROLò SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisëò. Ky vendim në fakt përfaqëson propozimin e dytë të Eurocontrol për përballimin e shpenzimeve, duke mbështetur në këtë mënyrë konstatimin e mësipërm të grupit të auditimit në lidhje me uljen e pagave.

**Në mbledhjen e datës 27.07.2020**, pjesëmarrës:
z.G. Gj. Kryetar
znj.M. K. zv.Kryetar
znj.B. I., anëtarë
znj. V. H., anëtarë
Znj. L. O., anëtarë

**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
*-Vendimi nr.3, datë 27.07.2020 "Për miratimin e raportit të audituesve ligjorë dhe pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2019";*
*-Vendimi nr.4, datë 27.07.2020 "Për miratimin e raportit të vlerësimit të aseteve të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA";*
*-Vendimi nr.5, datë 27.07.2020* **"***Mbi dhënien e ndihmës financiare z. A.Sh. punëmarrës i "ALBCONTROL" SHA.*

**Në mbledhjen e datës 30.10.2020**, pjesëmarrës:
z.G. Gj. Kryetar
znj.M. K. zv.Kryetar
znj. V. H., anëtarë
znj.A. K., anëtarë
Znj. L. O., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
*-Vendimi nr.6, datë 30.10.2020 "Mbi dhënien e miratimit për marrjen e kredisë nga "AIR ALBANIA SHPK", në vlerën 5,000,000 euro.*

Me shkresën e datës 29.10.2020 të Administratorit të shoqërisë Air Albania, drejtuar shoqërisë Albcontrol SHA, citohet se nga ana e shoqërisë Air Albania do të merren masat e nevojshme për të vënë në dispozicion pasqyrat financiare sipas standarteve përkatëse si dhe do të mundësohet rimbursimi i shpenzimeve në momentin më të parë sipas mundësive financiare. Gjithashtu kërkohet vijimi i procedurave në mënyrë urgjente për miratimin e projektvendimit. Me shkresën nr. 20616 prot., datë 02.11.2020 është marr vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit ñPër miratimin e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.6, datë 30.10.2020 ñMbi dhënien e miratimit për marrjen e kredisë nga ñA.AL. SHPKò.

**Në mbledhjen e datës 21.12.2020**, pjesëmarrës:
z. G. Gj. Kryetar
znj. V. H., anëtarë
znj.A. K., anëtarë

znj. L. O., anëtarë
z. B. K., anëtarë
**Janë marrë vendimet si më poshtë vijon:**
*-Vendimi nr.7, datë 21.12.2020 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2020.*
*-Vendimi nr.8, datë 21.12.2020 "Mbi programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2021.*
*-Vendimi nr.9, datë 21.12.2020 "Për miratimin e programit strategjik të auditimit për periudhën 2021-2023 dhe planit vjetor të auditimit të brendshëm të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA për vitin 2021.*
*-Vendimi nr.10, datë 21.12.2020 "Për një ndryshim të planit vjetor të auditimit të brendshëm të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA për vitin 2020.*
*-Vendimi nr.11, datë 21.12.2020 "Për një shtesë mbi numrin total të punonjësve të shoqërisë të 10 punonjësve me kontratë pune me afat të pacaktuar si dhe një shtesë në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 24.04.2020 "Për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të "ALBCONTROL" SHA, për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë".*

Me vendimin nr.1, datë 24.04.2020 Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur miratimin e një shtesë prej 10 punonjësish, me kontratë pune me afat të pacaktuar, mbi numrin total të punonjësve duke e cuar numrin total në 342, të cilët janë në procedura licensimi për studentë kontrollorë pranë Autoritetit të Aviacionit Civilë dhe me marrjen e licensës do të duhet të fillojnë marrëdhënien e punës në statusin e studentë Kontrollorë në Albcontrol sha. Shtimi i punonjësve argumentohet me faktin e projektit të aeroportit të Ku. dhe Vl., të cilët krahas investimeve në infrastrukturën navigacionale, është detyrimisht i nevojshëm dhe investimi në burime njerëzore.

**<u>Për periudhën 01.01.2021-30.03.2021 Këshilli Mbikqyrës ka kryer 1 mbledhje dhe ka marrë 2 vendime, konkretisht:</u>**

**Pjesëmarrës:**
z. G. Gj. Kryetar
znj. M. K. zv.Kryetar
znj. V. H., anëtarë
znj. A. K., anëtar
z. B. K., anëtar
**Janë marr vendimet si në vijim:**
*-Vendimi nr.1, datë 25.02.2021 "Për emërimin e sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë "Albcontrol" SHA, është liruar nga detyra e Sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës znj. I.D. dhe në vend të saj është emëruar Znj. A.H.*

*-Vendimi nr.2, datë 25.02.2021 "Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "ALBCONTROL" SHA të vitit 2021.*
Konstatohet se sipas këtij vendimi është shtuar nënzëri ñasistencë ligjore për cështjen e ngrirjes së llogarive bankare në Eurocontrolò **në vlerën 12,500,000 lekë**, programuar të mbulohet nga zbritja e zërit ñamortizimò.
Sipas relacionit kjo situatë vjen në kuadër të lëshimit të një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg me objekt ñbllokimin/ngrirjen e llogarive të Shqipërisë në Eurocontrol. Republika si palë e paditur ka humbur. Është lëshuar një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg për bllokimin e llogarive të Albcontrol. Edhe pse cështja është në Apel, pala paditëse ka të drejtë tõ drejtohet gjykatës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata.

Nga minutat e takimit konstatohet se nga anëtarja znj. H. sqarohet si në vijim: ñ*Legjislacioni ku bazohet Eurocontrol përjashton zbatimin e kërkesave që merren në varësi të arbitrazhit. Gjykata belge ka kërkuar bllokimin e fondeve të shtetit shqiptar që janë në Eurocontrol por fondet nuk janë bllokuar dhe nuk do të bllokohen pa mbaruar të gjitha procedurat ligjore. Për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës belge do të angazhohet Eurocontrol, Avokatura e Shtetit dhe një studio ligjore belge. Është kontaktuar me studion belge që ka bërë mbrojtjen e një rasti të ngjashëm me Rumaninë ku mbrojtja doli me suksesò.*

**Grupi auditimit konstaton se** neni 9 ñZyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtarò e ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò , pika 1 citon: **Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.**

Për sa më sipër vendimmarrja për kontraktimin e një zyre ligjore në gjykimin e grupit të auditimit është e paargumentuar dhe mbështetur.

***Për periudhën objekt auditimi nga grupi i auditimit, janë konstatuar disa parregullsi dhe shkelje jo në përputhje me kuadrin rregullator të shoqërisë, referuar vendimarrjes së organeve drejtuese të shoqërisë Albcontrol SHA:***

**Sa i përket vendimmarrjes nga Këshilli Mbikëqyrës:**

***1.*** *Në materialet që i paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në Këshillin Mbikëqyrës, rezulton se relacionet e paraqitura për ndryshimet në Programin e Zhvillimit Ekonomik , nuk paraqiten të detajuara për sa i përket ndryshimit të fondeve të propozuara, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, të statutit të shoqërisë.*

***2.*** *Raportet dhe materialet e përgatitura për t'u paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, i janë vënë në dispozicion këtij organi vetëm një ditë përpara duke mos lënë një kohë të mjaftueshme për njohjen e materialit nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, sipas të cilit Raportet dhe materialet e përgatitura për t'u paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë para mbledhjes.*

***3.*** *Sipas statutit të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë me nr.25, datë 01.11.2013 aksionari i vetëm i shoqërisë vazhdon të figurojë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ndërkohë që aktualisht aksionari i vetëm i shoqërisë është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Përsa i përket statutit të shoqërisë, Albcontrol SHA vazhdon të funksionojë me statutin e miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë me nr.25, datë 01.11.2013, jo në përputhje me ligjin 9901,datë 14.08.2008, i ndryshuar , neni 135, pika 2"Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutit".*

***4.*** *Për vitet 2019, dhe 2020 konstatohet se nuk ka një program vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, për aktivitetin e shoqërisë Albcontrol SHA, jo në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me ligjin 9901,datë 14.08.2008, i ndryshuar.*

***5.*** *Janë evidentuar problematika në lidhje me argumentimin e vendimeve, të detajuara si në raportin e mësipërm.*

*Për veprimet dhe mosverpimet e mësipërme ngarkohet Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA.*

**Vendimarrja dhe Urdhrat e Administratorit të Shoqërisë për periudhën 01.09.2018-31.03.2021**

Administratori i shoqërisë referuar veprimtarisë funksionale të Albcontrol SHA për periudhën objekt auditimi ka nxjerrë rreth 245 urdhra të brendshëm shërbimi, kryesisht ngritje grup pune;

rreth 487 urdhra prokurimi të ndarë sipas specifikave për periudhën e auditimit; dhe rreth 1,773 urdhra të karakterit: emërime, lirime nga detyra, leje vjetore, paga dhe urdhra për ngritje grupe pune.

Tabela evidentuese e urdhrave të brendshëm të ALBCONTROL SHA për periudhën *01.09.2018 – 31.03.2021*

| Periudha | Urdhra të Brendshëm Shërbimi / të ndryshme | Urdhra të Brendshëm Prokurimi | Urdhra të tjerë (emërime, lirime nga detyra, leje vjetore, pagesa, ngritje grupe pune etj.) | Total |
|---|---|---|---|---|
| 01.09.2018 -31.12.2018 | 52 | 85 | 280 | **417** |
| 01.01.2019 -31.12.2019 | 167 | 265 | 987 | **1419** |
| 01.01.2020 -31.12.2020 | 38 | 3 | 49 | **90** |
| 01.01.2021- 31.03.2021 | 13 | 2 | 36 | **51** |
| **Total** | **270** | **355** | **1352** | **1977** |

*Pagesat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi total*

| Emër Mbiemër | Periudha objekt auditimi | Vlera Bruto/muaj | Vlera bruto total | Tatim në Burim total | Vlera neto total |
|---|---|---|---|---|---|
| G. Gj. | 31 muaj | 43,140 | 1,337,340 | 200,601 | 1,136,739 |
| A. K. | 31 muaj | 28,760 | 891,560 | 133,734 | 757,826 |
| H. H. | 8 muaj | 28,760 | 230,080 | 34,512 | 195,568 |
| V. H. | 23 muaj | 28,760 | 661,480 | 99,222 | 562,258 |
| M. K. | 31 muaj | 28,760 | 891,560 | 133,734 | 757,826 |
| B. I. | 31 muaj | 28,760 | 891,560 | 133,734 | 757,826 |
| L. O. | 15 muaj | 28,760 | 431,400 | 64,710 | 366,690 |
| A. A. | 16 muaj | 28,760 | 460,160 | 69,024 | 391,136 |
| **Total** | | | **5,795,140** | **869,271** | **4,925,869** |

*Pagesa e sekretares së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi*

| Emër Mbiemër | Periudha objekt auditimi | Vlera Bruto/muaj | Vlera bruto total | Tatim në Burim total | Vlera neto total |
|---|---|---|---|---|---|
| I. D. | 30 muaj | 15,000 | 450,000 | 67,500 | 382,500 |

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultuan pagesa të konsiderueshme të anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës në shoqëritë anonime ndërkohë që këta punonjës nuk kanë marrë pjesë ose kanë marrë pjesë në një numër minimal mbledhjesh. Pavarësisht këtij kontributi të kufizuar në numër mbledhjesh, pagesat e tyre janë mujore, kjo e mbështetur nga Statuti i cili në nenin 24 *"Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës"* citon: ...**përfiton shpërblim mujor për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës**...jepet sipas akteve ligjore në fuqi, dhe pika 7 e **VKM nr. 570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore" citon: Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime.**
***Pra, edhe pse kontributi i tyre nuk është mujor dhe me Statut bëjnë të paktën 4 mbledhje në vit, shpërblimi është caktuar që të jetë çdo muaj.***

►**Titulli i Gjetjes nr. 1:** Mosndryshim i emërtimit të Aksionarit të Albcontrol SHA dhe mospërditësim i statutit të shoqërisë nga Asambleja e Aksionarit.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi konstatohet se sipas pikës 3, nenit 7 ñKarakteristika të përgjithshme të aksioneveò, kreut II ñAksionet dhe Kapitaliò të statutit të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë nr.25, datë 1.11.2013, aksionari i vetëm i shoqërisë Albcontrol SHA vazhdon të figurojë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.<br>Ndërkohë që aktualisht aksionari i vetëm i shoqërisë është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila me urdhrin nr.148, datë 21.11.2017, ka miratuar edhe zmadhimin e kapitalit themeltar. Konstatohet gjithashtu se Sipas nenit 16 ñNumri, emërimi, përbërja dhe kriteretò, Seksioni II ñKëshilli Mbikëqyrësò, i Statutit të Shoqërisë Aksionare anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës propozohen si në vijim: *2 anëtarë nga Ministria e* |

| | |
|---|---|
| | *Financës, 2 nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe 2 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.*<br>**Për sa më sipër rezulton se shoqëria e zhvillon veprimtarinë e vet mbështetur në një Statut të papërditësuar dhe njeh si organ propozues të antarëve të Këshillit Mbikëqyrës, një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017, konkretisht** *Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,* kjo jo në përputhje me pikën 2 ñAsambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutitò, nenin 135 të ligjit nr. 9901, datë 14.08.2008, i ndryshuar dhe shkronjën b, pikën 2 të nenit 13 ñTë drejtat dhe detyrimetò të Seksionit I ñAsambleja e përgjithshmeò e Statutit. |
| **Kriteri:** | -Pika 2 ñAsambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutitò, nenin 135 i Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2008, i ndryshuar;<br>-Shkronja b, pika 2 e Nenit 13 ñTë drejtat dhe detyrimetò të Seksionit I ñAsambleja e përgjithshmeò e Statutit. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Për sa më sipër rezulton se shoqëria e zhvillon veprimtarinë e vet mbështetur në një Statut të papërditësuar dhe njeh si organ propozues të antarëve të Këshillit Mbikëqyrës, një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017, konkretisht Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. |
| **Shkaku:** | Mospërditësim i statutit të shoqërisë nga Asambleja e Aksionarit. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA të marrin masa të menjëhershme duke i drejtuar kërkesë Asamblesë së Aksionarit, me qëllim ndryshimin e emërtimit të aksionarit dhe përditësimin e Statutit. |

►**Titulli i Gjetjes nr. 2:** Vendimmarrje e Këshillit Mbikëqyrës, pa argumentuar çdo çështje në relacione shpjeguese, për çështje me rëndësi për veprimtarinë funksionale të Albcontrol SHA.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi, konstatohet se për propozimet dhe vendimmarrjet e ndryshimeve në Programin e Zhvillimit Ekonomik nuk janë relatuar me detaje arsyet mbi këto ndryshime.<br>Materialet argumentuese relatuese mbi këto vendimmarrje, i janë vënë në dispozicion këtij organi vetëm një ditë përpara miratimit duke mos marrë kohë të mjaftueshme për njohjen dhe vlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë këto ndryshime janë miratuar brenda ditës, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*sipas të cilit Raportet dhe materialet e përgatitura për tôı paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë para mbledhjes. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò,<br>- Statuti i shoqërisë Albcontrol SHA. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Vendimmarrje e Këshillit Mbikëqyrës pa argumentuar të gjitha çështjet në procesverbalet e mbledhjeve të tij, sipas afateve të kritereve ligjore dhe rregullative. |
| **Shkaku:** | Mosrespektimi i kritereve ligjore dhe rregullative nga ana e Këshillit |

| | |
|---|---|
| | Mbikëqyrës, për relatimin e çdo vendimmarrje të tij. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, të marrë masa që të relatojë dhe të argumentojë në procesverbalet dhe mbledhjet e tij, çdo vendimmarrje sipas afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator të funksionimit të shoqërisë. |

►**Titulli i Gjetjes nr. 3:** Vendimi nr.2, datë 25.02.2021 ñPër një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontroLò SHA të vitit 2021.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi konstatohet se KB i Albcontrol SHA ka marrë vendimin nr.2, datë 25.02.2021 ñPër një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë ñAlbcontrolò SHA të vitit 2021.<br>Nga relacioni bashkëlidhur këtij vendimi argumentohet se shtohet nënzëri *"Asistencë ligjore për çështjen e ngrirjes së llogarive bankare në Eurocontrol"* **në vlerën 12,500,000 lekë**, vlerë e cila programohet të mbulohet nga zbritja e zërit ñamortizimò, në kuadër të lëshimit të një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg me objekt ñbllokimin/ngrirjen e llogarive të Shqipërisë në Eurocontrolò.<br>Pasi pala shqiptare si palë e paditur ka humbur çështjen, pala paditëse i është drejtuar gjykatës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata dhe si rrjedhojë është lëshuar një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg për bllokimin e llogarive të Albcontrol.<br>Për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Belge është angazhuar Eurocontrol, Avokatura e Shtetit dhe një studio ligjore belge e kontraktuar nga Albcontrol për asistencë ligjore.<br>*Konstatohet se vendimi nr.2, datë 25.02.2021 i Këshillit Mbikëqyrës për kontraktimin e studios ligjore belge është jo në përputhje me pikën 1, nenin 9 "Zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar" të Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" sipas të cilit:* ***Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.*** |
| **Kriteri:** | Pika 1, neni 9 ñZyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtarò i Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 ñPër Avokaturën e Shtetitò. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Shpenzime pa efektivitet në vlerën 12,500,000 lekë, veprim ky jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. |
| **Shkaku:** | Vendimmarrje e Këshillit Mbikëqyrës e pambështetur në kuadrin ligjor në fuqi. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, në lidhje me mbrojtjen për kundërshtimin e vendimit të gjykatës belge dhe angazhimin në këtë proces të një studio ligjore nga ana e Albcontrol SHA, të sigurohet koordinimi i mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit duke garantuar eficencën maksimale në strategjinë e mbrojtjes, si dhe në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të saj. |

►**Titulli i Gjetjes nr. 4:** Shpërblimet e anëtarëve dhe sekretares së Këshillit Mbikëqyrës.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e shoqërisë dhe shpërblimeve të përfituara, u konstatua se pavarësisht faktit se mund të mos kenë marr pjesë në mbledhje ose kanë marr pjesë në një numër të kufizuar mbledhjesh vjetore, pagesat e tyre vlerësohen mujore, kjo e mbështetur nga neni 24 *"Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës"* i Statutit i cili parashikon se ñanëtarët përfitojnë shpërblim mujor për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës i cili jepet sipas akteve ligjore në fuqiò dhe pika 7 e VKM nr. 570, datë 3.10.2018 *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore"* e cila parashikon se *"Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonime".*<br>***Për sa më sipër edhe pse pjesëmarrja në mbledhje nuk është mujore dhe sipas Statutit Këshilli Mbikëqyrës bënë të paktën 4 Mbledhje në vit, shpërblimi është caktuar që të jetë mujor. Për periudhën objekt auditimi shpërblimet për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretares rezultojnë në vlerën 6,245,140 lekë bruto ose 5,308,369 lekë neto, pas mbajtjes së tatimit në burim.*** |
| **Kriteri:** | -neni 24 *"Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës"* i Statutit<br>-pika 7 e VKM nr. 570, datë 3.10.2018 *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore"* . |
| **Ndikimi/Efekti**: | Përfitim i pagesave mujore në kushtet kur pjesëmarrja e tyre në mbledhje nuk është mujore. |
| **Shkaku:** | VKM nr. 570 datë 3.10.2018 *"Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore".* |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandime:** | Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të merren masa për propozimin e rishikimit të VKM nr. 570, datë 3.10.2018 me qëllim shpërblimin e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje. |

*Nga përfaqësuesit e "Albcontrol SHA" është observuar me shkresën me nr. 566/68 prot, datë 14.12.2021 dhe protokolluar në KLSh me nr. 445/6 prot, datë 14.12.2021. Sqarojmë se duke qenë së në këtë observacion janë paraqitur të njëjtat argumente të dërguara edhe mbi akt konstatimin, grupi i auditimit i qëndron trajtimit dhe sqarimit sipas projekt raportit të auditimit.*

**3. Mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit ekonomiko–financiar strategjik dhe atij vjetor të shoqërisë si dhe realizimi i tij.**

Nga lidhje me këtë drejtim të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Programet e Zhvillimit Ekonomik, planifikimi dhe realizimi i tij;
-Ndryshimet përgjatë periudhës nën auditim të programeve ekonomike;
-Vendimmarrja e Këshillit Mbikqëqyrës;
-Vendimmarrja e Aksionerit.
Nga auditimi konstatohet:
Shoqëria Albcontrol SHA ushtron veprimtarinë e saj sipas objektit që ka për shërbime të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë, eficencën dhe rregullueshmërinë e operimit të avionëve në hapësirën ajrore dhe në aerodromet civile të Shqipërisë dhe më gjerë të publikuar në AIP Albania, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet e ratifikuara dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror.
Projekt programet ekonomiko-financiare për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të "Albcontrolò SHA janë hartuar mbi bazën e realizimit të treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshëm të vitit aktual, për vitin pasardhës që programohet.
Projekt programi i çdo viti është hartuar nga drejtoria e shoqërisë dhe pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, është paraqitur për mendim në MIE e më pas për miratim nga MFE, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në udhëzimin e METE nr. 394, datë 21.08.2014 ñMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetërorò i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr. 15, datë 02.05.2018 ñMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetërorò, si dhe në ligjin 9901, datë 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò.
**Për periudhën 01.09.2018 - 31.12.2018,** Drejtoria e Albcontrol SHA, Këshilli Mbikëqyrës, dhe MIE, kanë ndjekur procedurat normale për hartimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit ekonomiko-financiar të vitit 2018.
Për vitin 2018 nga shoqëria është hartuar programi i zhvillimit ekonomik i cili është miratuar me vendimin nr.16, datë 07.12.2017 të Këshillit Mbikëqyrës. Programi Ekonomik është miratuar nga MFE, me shkresën nr.383/1, datë 18.01.2018, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin nr. 394, datë 21.08.2014 ñMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorò
Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm i është dërguar Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë ñRaporti mbi realizimin e treguesve të zhvillimit ekonomik të Shoqërisë Albcontrol SHA, për vitin 2018ò, në datë 9.04.2019, me shkresën nr. 845 prot., i njëjti raport i është dërguar dhe Këshillit Mbikëqyrës, me shkresën nr. 846 prot., datë 9.04.2019.
Gjithsesi, realizimi i programit të zhvillimit ekonomiko-financiar, me ndryshime, në mënyrë të përmbledhur, për periudhën Shtator-Dhjetor 2018, paraqitet në vijim.
Sipas programit të miratuar, shoqëria Albcontrol SHA dhe trafikut të parashikuar nga Eurocontrol, kishte parashikuar tû shërbente gjithsej 39,533 avionëve për periudhën tetor-dhjetor 2018 dhe të ardhurat e gjeneruar paraqiten si më poshtë:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi tetor-dhjetor | Realizimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Ulje ï Ngritje | 120,632 | 101,542 |
| 2 | Mbikalime | 661,652 | 637,745 |
| 3 | Nga burime të tjera | 17,000 | 46,730 |
| 4 | Rimbursimi TVSH | 41,591 | --- |
| | **Totali** | **840,825** | **786,017** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e mësipërme, por dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit ulja e të ardhurave ka ardhur kryesisht nga ulja e numrit të fluturimeve, pasi piku i fluturimeve për vendim tonë është kryesisht

në periduhën e verës.

**Shpenzimet:** Sipas programit dhe ndryshimeve të miratuara nga pronari, për periudhën tetor-dhjetor 2018 nga shoqëria Albcontrol SHA, shpenzimet në total janë parashikuar në vlerën 937,638(000) lekë. Me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës me nr.1, datë 19.02.2018, vendimin nr.3, datë 12.04.2018 dhe vendimin nr. 4, datë 25.06.2018, janë miratuar disa ndryshime në Programin Ekonomik të shoqërisë, ku ka pasur ndryshime të vlerave për disa nën zëra të shpenzimeve dhe investimeve, por që nuk kanë ndryshuar vlerën totale të programuar në fillim viti. Në tabelën më poshtë po paraqesim të detajuara zërat e shpenzimeve:

*Në 000/ lekë*

| Nr. | Emërtimi | Parashikimi | Realizimi |
|---|---|---|---|
| | Totali i shpenzimeve gjithsej | **937,638** | **1,124,406** |
| **1** | Pakësimi i gjendjes në prodhim | - | - |
| **2** | Shpenz.të shfryt.e rrjedhjes | **855,033** | **1,038,519** |
| a | Mat. të para e materiale të tjera. | - | - |
| b | Mallra | 9,525 | 9,825 |
| c | Furnitura | 50,550 | 77,586 |
| d | Shërbime gjithsej | 127,620 | 165,149 |
| e | Pagat e personelit | 241,684 | 249,231 |
| f | Pagesat e Sigurimeve Shoqërore | 18,750 | 18,813 |
| g | Shpenzime të tjera për Personelin | 71,800 | 77,920 |
| h | Shpenzime për ekspert kontabël e vlerësues | - | - |
| i | Tatim Taksa | 200 | - |
| j | Shpenzime të tjera rrjedhëse | 58,600 | 86,083 |
| k | Provizione | - | - |
| l | Amortizimi i pajisjeve | 218,304 | 218,304 |
| m | Specializime trajtime Personeli | 3,000 | 4,925 |
| n | Trajnime të Stafit kontrollor+teknik | 55,000 | 130,683 |
| **3** | Shpenzime financiare | 900 | 4,382 |
| **4** | Shpenzime të jashtëzakonshme | **-** | **-** |
| **5** | Pagesa për "Koston" e "Licencim"nga AAC | **40,500** | **55,667** |
| **6** | Kuota e Anëtarsimit në EUROCONTROL | **35,505** | **25,838** |
| **7** | Pagesa e Anëtarsimit në CANSO | **-** | **-** |
| **8** | Pagesa për koston e shërbimit SAR | **5,700** | **-** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sikurse konstatohet nga të dhënat e mësipërme, pamvarësisht nga rënia e të ardhurave për këtë periudhë, është rritur niveli i shpenzimeve, por kjo vjen si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve në periudhat e mëparshme, realizimi i prokurimeve me vonesë, etj. Duke reflektuar këtë në treguesit, por në tërësi për vitin 2018 shpenzimet paraqiten me mosrealizim. Treguesit kryesorë të shoqërisë për vitin 2018 janë realizuar si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Programimi | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 3,850,453 | 3,684,957 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 3,850,453 | 3,463,415 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 1,787,267 | 1,112,976 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 332 | 332 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 223,683 | 216,100 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 945,416 | 932,689 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

*Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Kështu të ardhurat janë realizuar në masën 96%, shpenzimet në masën 90% dhe investimet në masën 62%, çka ka ndikuar në ecurinë financiare të saj.*

***Për vitin 2019.*** Programi ekonomik për vitin 2019 dhe treguesit ekonomik 2019-2021, është

hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:
-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 48.28 Euro për çdo ñService Unitò, ose 6,090 lekë. Për vitin 2020 kosto është parashikuar 47.84 Euro dhe për vitin 2021 kjo kosto parashikohet 47.27 Euro për çdo ñService Unitò.
-për llogaritjen e të ardhurave nga terminali është 227.82 Euro për çdo ñService Unitò, ose 28,739.91 lekë.
Shoqëria dhe me dakordësinë e EUROCONTROL ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2018, si rezultat i rritjes së trafikut në total në masën 7.6% për avionët që do të ñMbikalojnëô dhe 10% për avionët që do të ñulen e ngrihenò në Aeroportin ñNënë Terezaò.
Programi është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar me vendimin nr. 8, datë 26.11.2018.
Nga Ministria e Energjitikës dhe Infrastrukturës është shprehur dakordësia për programin e zhvillimit ekonomik me shkresën nr. 14881/1, datë 26.12.2018.
Aksioneri (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka miratuar me shkresën nr. 21693/1, datë 08.01.2019, treguesit ekonomik të vitit 2019, *<u>të ardhura dhe shpenzime të balancuara</u>* për 3,979,251 mijë lekë si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 3,979,251 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 3,979,251 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 1,949,099 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 347 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 217,247 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 980,000 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

***Gjatë vitit 2019 janë bërë ndryshime*** në zërat e shpenzimeve, por pa ndryshuar treguesit kryesore ekonomikë, në pesë raste dhe janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.
Nga auditimi i materialeve të vënë në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që propozonte vendimmarrjen e Këshillit. Propozimet e Drejtorit të Përgjithshëm që i janë paraqitur e miratuar në Këshillit Mbikëqyrës janë si më poshtë:

- ✓ Relacioni nr. 989 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 02.05.2019, është miratuar me Vendimin nr. 9, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 03.05.2019;
- ✓ Relacioni nr. 1958 i Drejtorit të Përgjithshëm, i datës 11.07.2019, është miratuar me Vendimin nr. 17, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 12.07.2019;
- ✓ Relacioni nr. 1784, i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 29.07.2020, është miratuar me Vendimin nr. 19, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 29.07.2019;
- ✓ Relacioni nr. 2127, i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 25.09.2020, është miratuar me Vendimin nr. 22, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 25.09.2019;
- ✓ Relacioni nr. 2677, i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 18.12.2020, është miratuar me Vendimin nr. 26, të Këshillit Mbikëqyrës, më datë 19.12.2019.

Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qene e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat

menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, neneve 163, 164 dhe 166, të Statutit të shoqërisë ñAlbcontrolò SHA, konkretisht nenit 21, pika 4 sipas të cilit përcaktohet: ñRaportet dhe materialet e përgatitura për tôu paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë, para mbledhjesò dhe me Rregulloren e Brendshme të ñAlbcontrolò SHA, miratuar me vendimin nr.9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, kreu IV ñFunksionimi i shoqërisëò, nenet 37; 38; 39.

Konstatohet se relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik në mospërputhje me kërkesat e Rregullores së shoqërisë, neni 39 ñMarrëdhëniet me Këshillin Mbikëqyrësò, pika 3, ku përcaktohet: *"Materiali përgatitet në formën e një projekt-vendimi dhe shoqërohet me relacionin shpjegues përkatës. Para paraqitjes në Këshillin Mbikëqyrës, relacioni firmoset nga Drejtoria që e propozon atë, sipas hierarkisë, deri te Drejtori i Përgjithshëm si dhe nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës. Përfaqësues të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt shqyrtimi, marrin pjesë në mbledhjen e radhës së Këshillit Mbikëqyrës, dhe prezantojnë materialin për pjesën teknike"*, si dhe pika 4, ku përcaktohet: *"Materiali në Këshillin Mbikëqyrës relatohet nga Drejtori i Divizionit përkatës, i cili është i detyruar të japë shpjegime dhe argumente teknikë të nevojshëm lidhur me të, nëse i kërkohet nga anëtarët e Këshillit"*.
- Me vendimin nr. 9, datë 03.05.2019 janë bërë shtesa në disa prej zërave të shpenzimeve si, shpenzime konsulence, shpenzime për policinë private, sponsorizime/veprimtari humanitare/fond bamirësie, gjithsej në shumën 13,050 mijë lekë. Referuar ndryshimit të nën zërit ñKonsulence Ernest & Youngò me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 03.05.2019 mbi bazën e materialit të vënë në dispozicion nga subjekti, konstatohet se në relacionin e Drejtorit të Përgjithshëm, me nr. 989 prot., të datës 02.05.2020, drejtuar Këshillit Mbikëqyrës, ky propozim ndryshimi është përfshirë pa asnjë specifikim konkret, lidhur me arsyet dhe nevojën për këtë shtim vlere në nën zërin përkatës. Në relacion shprehet se: ñNë programin e miratuar për vitin 2019 nën zëri ñKonsulencë Ernest & Youngò është miratuar në vlerën 18,000 mijë lekë, kërkojmë të shtohet me vlerën 6,200 mijë lekë duke arritur vlerën 24,000 mijë lekëò, por nuk ka asnjë të dhënë shtesë mbi arsyet që justifikojnë dhe bëjnë të nevojshëm propozimin dhe miratimin e tij nga ana e Këshillit Mbikëqyrës. Po kështu konstatohet se, në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, mbajtur nga Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës, nuk ka asnjë referim lidhur me diskutimin e bërë për shtesën e vlerës prej 6,200 mijë lekë, në favor të ñKonsulencë Ernest & Youngò, e cila pas miratimit të ndryshimit shkon në vlerën 24,200 mijë lekë, nga 18,000 mijë lekë të parashikuara në Programin e Zhvillimit për vitin 2019.

-Me vendimin nr. 19, datë 29.07.2019 janë bërë ndryshime në zërat e investimeve, duke shtuar zërin ñImplementim MLATò, si dhe janë shtuar dy zëra të rinj investimi, ñMasterplani i Navigimit Ajror për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorësò me vlerë 237,600 mijë lekë dhe ñBlerje e modulit të ri të aRCgis e trajnim stafiò për vlerën 12,000 mijë lekë. Parashikimi dhe kryerja e zërit ñMasterplani i Navigimit Ajror për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorësò me vlerë të parashikuar në shumën 237,600 mijë lekë, *ka rënduar shpenzimet e kësaj shoqërie, kjo referuar nenit 7 të Kodit Ajror, ku autoritet përgjegjës për studime të këtij lloji është Ministria për Infrastrukturën*

*dhe Energjinë dhe AAC si përfaqësues i shtetit për shërbimin ajror. Në "ALBCONTROL" SHA administrohet shkresa nr. 7065, datë 29.05.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "Mbi zhvillimin e infrastrukturës aeroportuale në vend", protokolluar në shoqëri me nr. 1782 prot.,datë 29.07.2019, pra në të njëjtën ditë me paraqitjen e relacionit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës, kohë kjo e pamjaftueshme për të marrë në shqyrtim dhe vendosur lidhur me këtë kërkese të ministrit, ose këtë investim. Në këtë shkresë ndër të tjera kërkohet: "Në kuadër të këtyre projekteve dhe veçanërisht të aeroportit të Vlorës, sjellim në vëmendje, të vlerësoni potencialet tuaja financiare apo bashkëpunimin me subjektet bankare (nëpërmjet mundësive të kreditimit) për të mundësuar zhvillimin e infrastrukturës navigacionale, në këto aeroporte sipas planeve përkatëse të zhvillimit".*

-Me vendimin nr. 22, datë 25.09.2019 janë shtuar zërat shpenzime për qira operacionale dhe sponsorizime/veprimtari humanitare, gjithsej në shumën 6.300 mijë lekë.

-Me vendimin nr. 26, datë është shtuar zëri sponsorizime/veprimtari humanitare/fond bamirësie në shumën 76,500 mijë lekë, i cili ka kaluar në buxhetin e shtetit për përballimin e fatkeqësisë natyrore nga tërmeti i 26 nëntorit, duke pakësuar shpërblimin e punonjësve më 60 milion lekë dhe shpenzime për festat e fundvitit me 16.5 milion lekë, pasi nuk është dhënë shpërblimi i fundvitit për punonjësit.

**Realizimi i treguesve** kryesorë për vitin 2019 paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Programimi | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 3,979,251 | 3,657,270 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 3,979,251 | 3,501,696 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 1,949,099 | 1,403,133 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 347 | 332 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 217,247 | 212,550 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 980,000 | 917,368 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

*Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se edhe për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Kështu të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 88% dhe investimet në masën 72%, çka ka ndikuar në ecurinë financiare të saj.*

Realizimi i volumit të punës kundrejt programimit paraqitet si më poshtë

*Në numër*

| | Aktiviteti | Plani 2019 | Fakti 2019 | % |
|---|---|---|---|---|
| | Ulje-Ngritje | 27,000 | 28,294 | 105 |
| | Mbikalime | 195,000 | 186,933 | 96 |
| | **Totali Albcontrol** | **222,000** | **215,227** | **97** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Për këtë vit u është shërbyer 6,773 avionëve më pak se programimi i miratuar nga EUROCONTROL, ndërsa krahasuar me një vit më para u është shërbyer më shumë 14,881 avionëve, pa përfshirë 1,500 avionë, të cilët në zbatim të VKM-ve dhe Rregulloreve të EUROCONTROL janë të përjashtuar nga pagesat (avionë VIP, ushtarakë, etj.)

**Të ardhurat financiare të shoqërisë paraqiten** si më poshtë:

*Në 000/lekë*

| Aktiviteti | Realizimi i 2018 | Plani 2019 | Realizimi 2019 | Në % |
|---|---|---|---|---|
| Ulje-Ngritje | 469,856 | 501,147 | 471,899 | 94 |
| Mbikalime | 3,128,372 | 3,208,104 | 3,075,508 | 96 |
| **Totali** | **3,598,228** | **3,709,251** | **3,547,407** | **96** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga ñUlje-Ngritje të avionëveò janë realizuar në masën 94%, ose 29,248 mijë lekë më pak, ndërkohë që të ardhurat në valutë për këtë aktivitet kanë rezultuar me një rritje prej 5% në krahasim me planifikimin, ose janë realizuar në shumën 3,822,334 Euro, ku mosrealizimi i të ardhurave vjen si pasojë e rënies së kursit të këmbimit. Të ardhurat nga ñMbikalimetò janë realizuar në masën 96%, ose 132,596 mijë lekë më pak, por me një rritje kundrejt vitit 2018 me 505,779 Euro. Pavarësisht se të ardhurat në valutë janë realizuar në shumën 24,884,930 Euro, ose me një tejkalim prej 1%, të ardhrat gjithsej shprehur në ñlekëò nuk janë realizuar, e kjo si rezultat i mosrealizimit të zërit ñMbikalimeò dhe ndikimit të rënies së kursit të këmbimit të monedhës Euro.

***Shpenzimet***. Për realizimin e aktivitetit normal të saj shoqëria në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2019, kishte parashikuar të shpenzonte 3,979,251 mijë lekë. Për këtë vit shpenzimet janë realizuar në shumën 3,501,696 mijë lekë, në masën 88% të programimit, ose për 477,315 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesore paraqitet si më poshtë:

*Në 000/lekë*

| NR. | E m ë r t i m i | Planifikimi | Realizimi | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mallra | 51,850 | 45,647 | 88 |
| 2 | Furnitura | 413,900 | 383,237 | 93 |
| 3 | Shërbime gjithësej | 577,720 | 338,438 | 59 |
| 4 | Paga personeli | 980,000 | 917,368 | 94 |
| 5 | Trajtim shpërb.personeli | 137,355 | 112,128 | 82 |
| 6 | Sigurime Shoqërore | 77,263 | 77,646 | 100 |
| 7 | Tatim taksa | 8,300 | 5,897 | 71 |
| 8 | Shpenzime rrjedhëse | 255,800 | 207,519 | 81 |
| 9 | Amortizimi | 956,608 | 956,608 | 100 |
| 10 | Specializ.trajnim.personeli | 14,500 | 6,592 | 45 |
| 11 | Trajnim kontroll.teknikës | 146,650 | 119,170 | 81 |
| 12 | Shpenzime financiare | 4,950 | 4,046 | 82 |
| 13 | Kosto e AAC | 167,000 | 167,000 | 100 |
| 14 | Kosto EUROCONTROL | 136,000 | 119,061 | 88 |
| 15 | Të tjera | 20,355 | 12,579 | 62 |
| | **TOTALI** | **3,979,251** | **3,501,699** | **88** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Duke analizuar mos realizimin në disa nga zërat e shpenzimeve të programuara konstatohet se:

Zëri ***"Mallra"*** që përfshin nënzërat, (karburante, mallra konsumi, veshje e unifoma, materiale të tjera, etj.) është realizuar në masën 88%, ose nga 51,850 mijë të programuara janë realizuar në shumën 45,647 mijë lekë, ose më pak 6,203 mijë lekë.

Zëri ***"Furnitura"*** është realizuar në masën 93%, nga 413,900 mijë lekë të programuara për janë shpenzuar 383,237 mijë lekë, ose 30,663 lekë më pak.

Zëri ***"Shërbime"*** është realizuar në masën 60%, ose nga 608,720 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 367,198 mijë lekë, ose më pak 241,522 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve (DVOR, ILS, DME, për sistemet KWM të instaluara Adder, mirëmbajtje Remote Surfice Management), etj.

Zëri ***"Shpenzime rrjedhëse"*** është realizuar në masën 81%, ose nga 255,800 mijë lekë të programuara janë shpenzuar 207,519 mijë lekë, ose më pak 48,281 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen nënzërat: ñprojekti i certifikimit të Albcontrolò; ñshpenzime për marrje konsulenceò, ñshpenzime të ndryshme si përkthime, bërje manuale, revista vjetoreò, ñshpenzime për kontrollin mjekësorò, ñshpenzime për të përndjekurit politikëò, ñpritje-përcjellje etj.

Zëri ***"Shpenzime financiare"*** është realizuar në masën 82%, ose nga 4,950 mijë lekë të programuara, janë shpenzuar 4,046 mijë lekë, ose më pak 904 mijë lekë.

Në vlerën e shpenzuar janë kryer nga ana jonë pagesat e interesave të kredisë për 12 mujorin e vitit 2019 në shumën 510,000 mijë lekë, nga 340,000 mijë lekë që ishte programuar, me një realizim prej 150%, si rezultat i vendimmarrjes për shlyerjen e plotë të kësteve të kredisë përtej

vitit 2019.

**Investimet.** Sipas programit ekonomik ñAlbcontrolò SHA shpenzimet per investime ishin parashikuar në shumën 1,949,099 mijë lekë, ndërsa realizimi i investimeve sipas strukturës, paraqitet si më poshtë:

*Në 000/ lekë*

| Emërtimi | Programimi | Realizimi |
|---|---|---|
| Studime dhe Projektime | 42,915 | 18,550 |
| Makineri dhe pajisje | 459,511 | 161,049 |
| Pajisje Orendi | 77,125 | 7,987 |
| Mirëmbajtje/pjesë ndërrimi | 759,962 | 565,829 |
| Ndërtime, Rikonstruksione | 164,200 | 39,193 |
| Investime të mbartura nga vitet paraardhëse | 105,386 | 100,525 |
| Shlyerje e këstit të kredisë | 340,000 | 510,000 |
| **Totali** | **1,949,099** | **1,403,133** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme investimet janë realizuar në masën 72%, nga 1,949,099 mijë lekë që ishin planifikuar janë realizuar në shumën 1,403,133 mijë lekë, ose me një mosrealizim prej 545,966 mijë lekë më pak, ku një nga arësyet e mosrealizimit është dhe zhvillimi procedurave të prokurimit dhe lidhja e kontratave me vonëse, duke kaluar një vlerë e konsiderueshme e tyre për tu realizuar në vitin pasardhës.

Zëri **"Studime dhe Projektime"** është realizuar në masën 43% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 24,365 mijë lëkë.

Zëri **"Makineri Pajisje"** është realizuar në masën 35% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 298,462 mijë lëkë.

Zëri **"Pajisje Orendi"** është realizuar në masën 10% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 24,365 mijë lëkë.

Zëri **"Mirëmbajtje e pjesë ndërrimi"** është realizuar në masën 75% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 194,133 mijë lëkë.

Zëri **"Ndërtime dhe Rikonstruksione"** është realizuar në masën 22% kundrejt programimit, ose më pak për shumën 128,007 mijë lëkë.

Bazuar në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 12.07.2019 ñMbi shlyerjen e vlerës së mbetur të Marrëveshjes së Kredisë të lidhur midis ñAlbcontrolò dhe bankës ñB. P. N. P., EX-IM B.ò dhe ñW. F.B.ò, për financimin e projektit të modernizimit të hapësirës ajrore shqiptare, Albcontrol SHA në vazhdim të negociatave disa mujore me bankat kredidhënëse ka vendosur të parapaguajë dy këstet e fundit të kredisë, përkatësisht kështin e 19-të dhe të 20-të të mbetur nga plani i shlyerjes së kredisë, me fondet në dispozicion nga Llogaria e Rezervës ñDebt Service Reserveò- DSR-01. Kështu kësti i 20 i skeduluar për muajin mars 2020, është parapaguar brenda vitit 2019, duke përmbyllur detyrimet e kredisë disa vjecare.

***Për vitin 2020.*** Programi ekonomik për vitin 2020 dhe treguesit ekonomik 2020-2022, është hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:

-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 48.44 Euro për çdo ñService Unitò, ose 5,866 lekë. Për vitin 2021 kosto është parashikuar 48.39 Euro dhe për vitin 2022 kjo kosto parashikohet 48.30 Euro për çdo ñService Unitò.

-për llogaritjen e të ardhurave nga terminali është 227.48 Euro për çdo ñService Unitò, ose 27,544.08 lekë.

Shoqëria dhe me konfirmimin e EUROCONTROL ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2019, si rezultat i rritjes së trafikur në total në masën 4.2% për avionët që do të ñMbikalojnëô dhe 12% për avionët që do të ñulen e ngrihenò në Aeroportin ñNënë Terezaò, ku të ardhurat nga mbikalimet janë burimi kryesor, pasi zënë 85% të të ardhurave gjithsej të shoqërisë. Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë janë paraqitur të balancuara në shumën 4,100,565 mijë lekë.

Programi është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar me vendimin nr. 24, datë 19.12.2019.
Nga Ministria e Energjetikes dhe Infrastrukturës është shprehur dakordësia për programin e zhvillimit ekonomik me shkresën nr. 10811/1, datë 09.01.2020.
Asambleja e Përgjithshme/Aksioneri (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka miratuar me shkresën nr. 23982/1, datë 20.01.2020, treguesit ekonomik të vitit 2020, ***të ardhura dhe shpenzime të balancuara*** për 4,100,565 mijë lekë si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 4,100,565 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 4,100,565 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 1,858,941 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 332 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 208,670 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 982,000 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Referuar situatës pandemike, si rezultat i uljes së konsiderueshme të numrit të fluturimeve, shoqëria ka rishikuar treguesit e planifikuar të vitit 2020, ku të ardhurat nga 4,100,565 mijë lekë që ishin në programin fillestar bëhen në 2,304,225 mijë lekë, si pasojë e rënies sa trafikur ajror, ku për periudhën janar-tetor ka rënë me 52.7% e krahasuar me vitin 2019. Shoqëria për të siguruar vazhdimësinë e biznesit dhe për të menaxhuar situatën në kushtet e rënies drastike të të ardhurave në kuadër të propozimeve të EUROCONTROL ka marrë një kredi në **3,610,483 Euro**, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.06.2020 të Këshillit Mbikëqyrës ñMbi dakordësinë për përfshirjen e Albcontrol SHA në marrëveshjen e kredisë së EUROCONTROL për përballimin e krizës së shkaktuar nga Covid -19ò, dhe e garantuar nga Qeveria e RSH, ku shlyerja e principalit të kredisë ka filluar 4 muaj nga data e marrëveshjes, datë 02.11.2020 dhe deri më 02.03.2022.
Gjithashtu, shoqëria ka reduktuar shpenzimet operative dhe të funksionimit, shpenzimet për paga, duke paguar me pagën minimale një numër të konsiderueshëm të stafit administrativ, por dhe duke reduktuar pagat në përgjithësi, përfshirë dhe kontrollorët e trafikut ajror, si dhe ka pezulluar përkohësisht disa prej shpenzimeve për investime.
Treguesit e rishikuar së bashku me relacionin shoqërues i janë paraqitur për miratim Këshillit Mbikëqyrës dhe janë miratuar me vendimin nr. 7, datë 21.12.2020, gati në përfundim të vitit financiar, pas publikimit të raportit të EUROCONTROL dhe që shërben për vendimmarrjen e shoqërisë në planifikimin e treguesve për vitin e ardhshëm.
Aksioneri/Asambleja me shkresën nr. 24198/1, datë 18.01.2021 ka miratuar ndryshimet në treguesit ekonomikë të shoqërisë, ku të ardhurat janë në shumën 2,394,255 mijë lekë, shpenzimet gjithsej janë 2,304,255 mijë lekë, ndërsa investimet janë 913,334 mijë lekë. Në fakt shoqëria ka paraqitur të ardhura të balancuara me shpenzimet, pasi ka përfshirë dhe shlyerjen e kredisë në shumën 90,000 mijë lekë. Aksioneri ka miratuar një fond page për 574,000 mijë lekë që i takon 332 punonjësve (numër mesatar) dhe me pagë mesatare 144,076 lekë.

**Realizimi i treguesve** kryesorë për vitin 2019 paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Programimi | Programi i ndryshuar | Realizimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 4.100,565 | 2,394,255 | 1,795,689 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 4,100,565 | 2,394,255 | 1,862,878 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 1,858,941 | 913,334 | 288,792 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 362 | 332 | 332 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 208,670 | 144,076 | 136,908 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 982,000 | 574,000 | 545,440 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

*Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme konstatohet se si rezultat i situatës pandemike, në kushtet e kufizimit të aktivitetit të saj edhe për këtë vit shoqëria nuk ka realizuar asnjë nga treguesit kryesorë, si të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Kështu të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 81% dhe investimet në masën 32%.*

Rënia drastike e trafikut ajror, shoqëruar edhe me kufizimet e plota apo pjesore që kanë shoqëruar këtë periudhë, ka ndikuar ndjeshëm në pozitën financiare të ñALBCONTROLò SHA, duke nisur që nga mesi i muajit mars dhe duke u përshkallëzuar me kalimin e kohës. Nisur nga fakti se të ardhurat e saj gjenerohen vetëm nga shërbimet e lundrimit ajror shoqëria është vënë në vështirësi serioze duke ndikuar ndjeshëm dhe në pozitën financiare të saj.

Realizimi i volumit të punës kundrejt programimit paraqitet si më poshtë

*Në numër*

| | ***A k t i v i t e t i*** | ***Plani 2020*** | ***Fakti 2020*** | ***%*** |
|---|---|---|---|---|
| | Ulje-Ngritje | 15,100 | 15,080 | 99.8 |
| | Mbikalime | 109,418 | 86,232 | 79 |
| | ***Totali Albcontrol*** | ***124,518*** | ***101,312*** | ***81*** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Si rezultat e pandemisë Covid-19, për këtë vit u është shërbyer 23,217 avionëve më pak se programimi i miratuar nga EUROCONTROL dhe e amenduar nga aksionari.

**Të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqërisë paraqiten** si më poshtë

*Në 000/lekë*

| ***A k t i v i t e t i*** | ***Realizimi i 2019*** | ***Plani i amenduar*** | ***Realizimi i*** | ***Në %*** |
|---|---|---|---|---|
| Ulje-Ngritje | 471,899 | 257,042 | 237,869 | 93 |
| Mbikalime | 3,075,508 | 1,362,824 | 1,426,373 | 105 |
| ***Totali*** | ***3,547,407*** | ***1,619,866*** | ***1,664,242*** | ***103*** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga ñUlje-Ngritje të avionëveò janë realizuar në masën 93%, ose 29,248 mijë lekë më pak, ndërkohë që të ardhurat në valutë për këtë aktivitet kanë rezultuar me një rritje prej 5% në krahasim me planifikimin, ose janë realizuar në shumën 3,822,334 Euro, ku mosrealizimi i të ardhurave vjen si pasojë e rënies së kursit të këmbimit. Të ardhurat nga ñMbikalimetò janë realizuar në masën 105%, ose 132,596 mijë lekë më pak.

***Shpenzimet***. Për realizimin e aktivitetit normal të saj shoqëria në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2020, kishte parashikuar të shpenzonte 4,100,565 mijë lekë, por si rezultat i situatës programimi u ul në shumën 2,394,255 mijë lekë. Për këtë vit shpenzimet janë realizuar në shumën 1,862,878 mijë lekë, në masën 81% të programimit, ose për 441,347 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit, ndërsa krahasuar me planin fillestar realizimi është në masën 45%.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesore paraqitet si më poshtë:

*Në 000/ lekë*

| | ***E m ë r t i m i*** | ***Planifikimi Fillestar*** | ***Planifikimi (Amenduar)*** | ***Realizimi*** | ***%*** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mallra | *52,645* | *41,620* | *28,494* | *68* |
| 2 | Furnitura | *421,270* | *159,073* | *142,495* | *90* |
| 3 | Shërbime gjithësej | *525,630* | *365,460* | *222,395* | *61* |
| 4 | Paga personeli | *982,000* | *574,000* | *545,440* | *95* |
| 5 | Trajtim shpërb.personeli | *218,636* | *19,502* | *18,629* | *96* |
| 6 | Sigurime Shoqërore | *84,484* | *65,000* | *61,643* | *95* |
| 7 | Tatim taksa | *8,300* | *7,500* | *6,782* | *90* |
| 8 | Shpenzime rrjedhëse | *171,050* | *100,800* | *46,303* | *46* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Amortizimi | *1,020,692* | *624,000* | *538,924* | *86* |
| 10 | Specializ.trajnim.personeli | *14,500* | *6,600* | *4,426* | *67* |
| 11 | Trajnim kontroll.teknikës | *244,215* | *125,325* | *44,721* | *36* |
| 12 | Shpenzime financiare | *7,500* | *9,000* | *7,715* | *86* |
| 13 | Kosto e AAC | *168,300* | *75,000* | *66,310* | *88* |
| 14 | Kosto EUROCONTROL | *154,609* | *116,415* | *116,415* | *100* |
| 15 | Të tjera | 26,734 | 14,930 | 12,186 | 82 |
| | ***TOTALI*** | ***4,100,565*** | ***2,304,225*** | ***1,862,878*** | ***81*** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë:
Zëri *"**Mallra**"* që përfshin nënzërat, (karburante, mallra konsumi, materiale të tjera, etj.) është realizuar në masën 68% të programit të amenduar, ose më pak 13,126 mijë lekë; zëri *"**Furnitura**ò* është realizuar në masën 90% të programit të amenduar, ose më pak 16,578 mijë lekë; zëri *"**Shërbime**"* është realizuar në masën 61%, ose 143,065 mijë lekë më pak se programi i amenduar; zëri *"**Paga Personeli**"* është realizuar në masën 95% të programit të amenduar, ose më pak 54,497 mijë lekë; zëri ñ*Shpenzime rrjedhëse"* është realizuar në masën 46% të programit të amenduar, ose më pak 54,497 mijë lekë dhe zëri *"**Shpenzime financiare**"* është realizuar në masën 86% të programit të amenduar, ose më pak 1,285 mijë lekë.
***Investimet***.*Për vitin 2020* shoqëria Albcontrol SHA kishte programuar të realizonte investime në vlerën 913,334 mijë lekë. Nisur nga ulja drastike e trafikut për vitin 2020, rrjedhimisht edhe e të ardhurave cuan shoqërinë të rishikonte programin e investimeve kapitale, duke e ulur atë por dhe duke pezulluar disa prej tyre.
Të analizuara sipas zërave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Emërtimi | Planifikimi Filestar | Planifikimi i Amenduar | Realizimi |
|---|---|---|---|
| Studime dhe Projektime | 73,100 | 3,100 | 0 |
| Makineri dhe Pajisje | 970,799 | 421,510 | 15,777 |
| Pajisje Orendi | 10,400 | 1,900 | 0 |
| Mirëmbajtje/pjesë ndërrimi | 507,560 | 219,880 | 74,372 |
| Ndërtime,Rikonstruksione | 64,138 | 40,000 | 0 |
| Investime të mbartura nga vitet paraardhëse | 232,944 | 226,944 | 198,643 |
| **Totali** | **1,858,941** | **913,334** | **288,792** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Në total, programi i nvestimeve për vitin 2020 është realizua në masën 32 % kundrejt planifikimit, ose më pak në shumën 624,542 mijë lekë, pamvarësisht nga rishikimi i këtij treguesi në ulje, ku tre prej tyra nuk kanë realizim, ndërsa dy zëra të tjerë paraqiten me mosrealizim të ndjeshëm.
Gjatë këtij viti shoqëria Albcontrol SHA ka vazhduar të punojë në sajë të kredisë së dhënë nga EUROCONTROL, si dhe gjendjen CASH, të cilën e ka patur në dispozicion nga arkëtimet mujore.
***Për vitin 2021*.** Programi ekonomik për vitin 2021 dhe treguesit ekonomik 2021-2023, janë hartuar duke u mbështetur në koston bazë të njësisë (Service Unit), ku ky tregues është parashikuar:
-për llogaritjen e të ardhurave nga mbikalimet është 58.79 Euro për çdo ñService Unitò, ose 7,263.50 lekë. Për vitin 2022 kosto është parashikuar 58.63 Euro dhe për vitin 2022 kjo kosto parashikohet 57.31 Euro për çdo ñService Unitò.
-për llogaritjen e të ardhurave nga terminali është 235.67 Euro për çdo ñService Unitò, ose 29,117.59 lekë.
Shoqëria referuar dhe ñParashikimi i ecurisë së trafikut 5 vjeçar 2020-2024ò hartuar nga EUROCONTROL në nëntor 2020, ka planifikuar rritje të ardhurash krahasuar me vitin 2020, si rezultat i rritjes së trafikut në total në masën 47% për avionët që do të ñMbikalojnëô dhe 62% për avionët që do të ñulen e ngrihenò në aeroportin ñNënë Terezaò. Të ardhurat dhe shpenzimet e

shoqërisë janë paraqitur të balancuara në shumën 3,348,171 mijë lekë.
Programi është paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës dhe është miratuar me vendimin nr. 8, datë 21.12.2020.
Nga Ministria e Energjetikes dhe Infrastrukturës është shprehur dakordësia për programin e zhvillimit ekonomik me shkresën nr. 9005/1, datë 31.12.2020, ndërsa Asambleja e Përgjithshme/Aksioneri (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) ka miratuar me shkresën nr. 24199/1, datë 18.01.2021, treguesit ekonomik të vitit 2021, ***të ardhura dhe shpenzime të balancuara*** për 4,100,565 mijë lekë si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi/Treguesit | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhura gjithsej | 000/lekë | 3,348,171 |
| 2 | Shpenzime gjithsej | 000/lekë | 3,348,171 |
| 3 | Investime gjithsej | 000/lekë | 904,019 |
| 4 | Numri i punonjësve | Numër mesatar | 347 |
| 5 | Paga mesatare | Lekë | 169,834 |
| 6 | Fondi i pagave | 000/lekë | 766,120 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Për 3/mujorin e parë 2021 është bërë një ndryshim në treguesit ekonomikë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 25.02.2021, ku është shtuar zëri ñAsistencë ligjore për çështjen e ngrirjes së llogarive bankare në EUROCONTROLò në shumën 12,500 mijë lekë, duke zbritur për të njëjtën shumë zërin ñAmortizimeò, vlerë e cila rëndon shpenzimet e shoqërisë, në kushtet e vështira financiare të saj dhe në një kohë që është Avokatura e Shtetit e cila mbron interesat e ligjshme të shtetit shqiptar. Ngrirja e llogarive bankare në muajin dhjetor 2020 në EUROCONTROL për llogari të shtetit shqiptar sa i takon çështjes ñBechetiò, të ardhura që i takojnë Albcontrol SHA, ka ndikuar negativisht në ecurinë e shoqërisë duke e vënë në vështirësi financiare për një periudhë prej gati 10 muajve (Eurocontrol ka transferuar për llogari të Albcontrol SHA të ardhura vetëm deri në javën e parë të muajit dhjetor 2020).
***Realizimi i volumit të punës*** kundrejt programimit për 3/mujorin e parë të vitit 2021,paraqitet si më poshtë:

*Në numër*

| | Aktiviteti | Plani 3/m i 2021 | Fakti 3/m i 2021 | % |
|---|---|---|---|---|
| | Ulje-Ngritje | 5,040 | 3,090 | 61 |
| | Mbikalime | 23,268 | 12,170 | 52 |
| | **Totali Albcontrol** | **28,308** | **15,260** | **54** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Si rezultat e pandemisë Covid-19, për këtë vit u është shërbyer 13,048 avionëve më pak se programimi i miratuar nga EUROCONTROL dhe e amenduar nga aksionari, duke mos përfshirë 331 avionëve të përjashtuar nga pagesa.

**Të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqërisë paraqiten** si më poshtë :

*Në 000/lekë*

| Aktiviteti | Plani i | Realizimi | Në % |
|---|---|---|---|
| Ulje-Ngritje | 80,532 | 46,275 | 57 |
| Mbikalime | 410,653 | 258,181 | 63 |
| **Totali** | **491,185** | **304,456** | **62** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, të ardhurat nga ñUlje-Ngritje të avionëveò janë realizuar në masën 57%, ose 34,257 mijë lekë më pak, të ardhurat nga ñMbikalimetò janë realizuar në masën 63%, ose 152,472 mijë lekë më pak dhe në total ka një mosrealizim të të ardhurave prej 186,729 mijë lekë.

**Shpenzimet.** Për këtë 3-mujor, shoqëria ka shpenzuar në total 404,591 mijë lekë, ose 61% të shpenzimeve të parashikuara në programin ekonomik të miratuar, ose 257,157 mijë lekë më pak. Realizimi i shpenzimevë për zërat kryesore paraqitet si më poshtë:

*Në 000/ lekë*

| | E m ë r t i m i | Planifikimi | Realizimi | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mallra | 11,150 | 5,408 | 49 |
| 2 | Furnitura | 41,200 | 4,105 | 10 |
| 3 | Shërbime gjithësej | 80,200 | 37,701 | 47 |
| 4 | Paga personeli | 191,530 | 106,999 | 56 |
| 5 | Trajtim shpërb.personeli | 4,056 | 361 | 9 |
| 6 | Sigurime Shoqërore | 19,963 | 14,779 | 74 |
| 7 | Tatim taksa | 1,000 | 0 | 0 |
| 8 | Shpenzime rrjedhëse | 14,550 | 463 | 3 |
| 9 | Amortizimi | 195,144 | 195,144 | 100 |
| 10 | Specializ.trajnim.personeli | 1,300 | 1,243 | 96 |
| 11 | Trajnim kontroll.teknikës | 17,000 | 750 | 4 |
| 12 | Shpenzime financiare | 2,500 | 1,426 | 57 |
| 13 | Kosto e AAC | 32,750 | - | - |
| 14 | Kosto EUROCONTROL | 39,986 | 31,207 | 78 |
| 15 | Të tjera | 9,419 | 5,005 | 53 |
| | **TOTALI** | **661,748** | **404,591** | **61** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë: zëri *"**Mallra**"* është realizuar në masën 68% të programimit, ose më pak 5,742 mijë lekë; zëri *"**Furnitura**ò* është realizuar në masën 10% të programimit, ose më pak 37,095 mijë lekë; zëri *"**Shërbime**"* është realizuar në masën 47%, ose 84,531 mijë lekë më pak; zëri *"Paga Personeli"* është realizuar në masën 56% të programit, ose më pak 54,497 mijë lekë; zëri ñ***Shpenzime rrjedhëse***" është realizuar vetëm në masën 3% të programit; zëri *"Kosto e AAC"* nuk paraqitet me realizim, pasi shoqëria nuk ka likuiduar asnjë detyrim ndaj Autoritetit të Aviacionit Civil, etj., që vjen kryesisht nga mungesa e të ardhurave dhe likuiditetit të shoqërisë.

***Investimet***. Bazuar në ñProgramin e Zhvillimit Ekonomik 2021ò, shoqëria Albcontrol SHA kishte programuar të realizonte gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021, investime që arrinin në vlerën 61,200 mijë lekë, por në fakt nuk u realizua asnjë nga investimet e parashikuara për këtë tre mujor, si rrjedhoje jo vetëm e efeteve negative nga pandemia në industrinë e aviacionit civil, por dhe të gjendjes së vështirë financiare në të cilën po përballet shoqëria prej 10 muajve, si rezultat i bllokimit të llogarive të saj në EUROCONTROL që prej muajit dhjetor 2020.

►**Titulli i Gjetjes:** Vendimmarrje e përshpejtuar nga Këshilli Mbikëqyrës i propozimeve për ndryshimet e Programit të Zhvillimit Ekonomik, në kushtet kur nuk evidentohet nevoja urgjente.

| | |
|---|---|
| **Situata 1:** | Nga auditimi i materialeve të vënë në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.<br>Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës |

| | |
|---|---|
| | janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb.<br>Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. |
| **Kriteri:** | Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë ñALBCONTROLò SHA, nenit 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të ñALBCONTROLò SHA, miratuar me vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV ñFunksionimi i shoqërisëò, nenet 21, 37, 38, 39. |
| **Ndikimi:** | Mungesë transparence në vendimmarjen e Këshillit Mbikëqyrës e në disa raste dhe efekte negative në buxhetin e shoqërisë. |
| **Shkaku:** | Vendimmarrje e përshpejtuar nga ana e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për miratim të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik, në mungesë të nevojës urgjente. |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandimi:** | Këshilli Mbikqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar.<br>Drejtori i Përgjithshëm (Administratori) dhe Departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare. |

## 4. Auditim mbi shërbimet e kryera nga shoqëria si dhe zbatimi i sistemit të taksave mbi korridoret ajrore referuar dispozitave ligjore në fuqi.

Albcontrol u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992 dhe, në 3 shkurt 1999, u transformua në shoqëri aksionare, e quajtur Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror. Albcontrol SHA menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR), në përputhje me standardet ndërkombëtare të lundrimit ajror. Në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të lidhur ndërmjet EUROCONTROL dhe óShteteve kontraktueseô (shtete të cilët kanë lidhur marrëveshje me EUROCONTROL), vendet Evropiane kanë dakordësuar të adoptojnë një politikë të unifikuar në lidhje me sistemin e pagesave për shërbimet ajrore. Në këtë marrëveshje është dakordësuar ngritja e një sistemi për vendosjen dhe mbledhjen e taksave të korridoreve ajrore duke shfrytëzuar shërbimet e EUROCONTROL-it. Në bazë të nenit 7 dhe nenit 8 të kësaj marrëveshjeje, EUROCONTROL kryen vlerësimin në përputhje me rregullat e aplikuara, për taksat e korridoreve për çdo fluturim në zonat ajrore. Gjithashtu, është EUROCONTROL, institucioni i cili mbledh të gjithë taksat e korridoreve ajrore të cilat paguhen në zyrat qendrore të EUROCONTROL, nga përdoruesit e hapësirave ajrore (operatorët ajrorë) dhe në bazë të nenit 20 të kësaj marrëveshjeje, shuma e depozituar nga EUROCONTROL, i paguhet respektivisht vendeve që janë në marrëveshje me EUROCONTROL-in.

Në Dhjetor të vitit 2015, Albcontrol SHA, ka lidhur një marrëveshje me EUROCONTROL mbi taksat e terminalit. Në bazë të kësaj marrëveshjeje Albcontrol SHA, ka kaluar tek EUROCONTROL kompetencat mbi kalkulimin, faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave për llogari të Albcontrol.

Nga auditimi i dokumentacionit është konstatuar se për periudhën 01.09.2018-31.12.2018, Albcontrol SHA, ka ofruar shërbimet e navigimit ajror, në përputhje me standardet ndërkombëtare, marrëveshjet dhe rregulloret në fushën e lundrimit ajror, me EUROCONTROL etj. Sipas programit të miratuar, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tôu shërbente gjithsej për periudhën janar-dhjetor 2018, 194,745 avionëve dhe vetëm për periudhën Tetor-Dhjetor 39,533 avionëve, për të kryer mbikalime në hapësirën ajrore të Shqipërisë, ose ulje-ngritje në Aeroportin Ndërkombëtar ñNënë Terezaò. Të dhënat më të detajuara, për shërbimin navigacional për këtë periudhë, që janë edhe burimi kryesor i të ardhurave për shoqërinë Albcontrol SHA, paraqiten sa vijon:

***Nr. Avionësh***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2018 | Realizimi Janar-Dhjetor 2018 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 23,369 | 25,368 | 108.5 % |
| 2 | Mbikalime | 171,376 | 174,978 | 102.1 % |
| | **Totali** | **194,745** | **200,346** | **102.8 %** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në mijë lekë***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2018 | Realizimi Janar-Dhjetor 2018 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 490,761 | 469,856 | 95.7 % |
| 2 | Mbikalime | 3,140,769 | 3,128,371 | 99.6% |
| | **Totali** | **3,631,530** | **3,598,227** | **99.1 %** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në euro***

| Nr | Kompania | 2018 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Faturimet | Likuidimet | Penalitete/Kamatëvonesa |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Eurocontrol Mbikalime | 24,265,118.30 ú | 24,128,909.37 ú | 30,654.27 ú |
| 2 | Eurocontrol Terminal | 3,682,535.94 ú | 3,634,994.79 ú | |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA

Sipas programit të miratuar, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tû shërbente gjithsej për vitin 2019, një numri prej 222.000 avionë, të cilët do të mbikalonin në hapësirën ajrore të Shqipërisë, ose do të uleshin e ngriheshin në Aeroportin Ndërkombëtar ñNënë Terezaò.
Të dhënat më të detajuara, për shërbimin navigacional për këtë periudhë janë si më poshtë vijon:

***Nr. Avionësh***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2019 | Realizimi Janar-Dhjetor 2019 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 27,000 | 28,294 | 104,7% |
| 2 | Mbikalime | 195,000 | 186,933 | 95.9% |
| | **Totali** | **222,000** | **215,227** | **96.9%** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në mijë lekë***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2019 | Realizimi Janar-Dhjetor 2019 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 501,147 | 471,899 | 94.1% |
| 2 | Mbikalime | 3,208,104 | 3,075,508 | 95.9% |
| | **Totali** | **3,708,251** | **3,547,407** | **95.7%** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në euro***

| Nr | Kompania | 2019 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Faturimet | Likuidimet | Penalitete/Kamatëvonesa |
| 1 | Eurocontrol Mbikalime | ú 25,106,395.62 | ú 24,928,439.26 | ú 21,797.06 |
| 2 | Eurocontrol Terminal | ú 3,862,291.72 | ú 3,635,073.44 | ú 11,140 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

Sipas programit të amenduar, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tu shërbente gjithsej për vitin 2020, një numri prej 124.518 avionë, të cilët do të mbikalonin në hapësirën ajrore të Shqipërisë, ose do të uleshin e ngriheshin në aeroportin Ndërkombëtar ñNënë Terezaò.
Të dhënat më të detajuara, për shërbimin navigacional për këtë periudhë janë si më poshtë vijon:

***Nr. Avionësh***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2020 | Realizimi Janar-Dhjetor 2020 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 15,100 | 15,080 | 99.9% |
| 2 | Mbikalime | 109,418 | 86,232 | 78.8% |
| | **Totali** | **124,518** | **101,312** | **81.4%** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në mijë lekë***

| Nr. | Aktivitetet | Parashikimi Janar-Dhjetor 2020 | Realizimi Janar-Dhjetor 2020 | Realzimi në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ulje - Ngritje | 257,042 | 237,869 | 92.5% |
| 2 | Mbikalime | 1,362,824 | 1,426,373 | 104.7% |
| | **Totali** | **1,618,866** | **1,664,242** | **102.8%** |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

***Në euro***

| Nr | Kompania | 2020 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Faturimet | Likuidimet | Penalitete/Kamatëvonesa |
| 1 | Eurocontrol Mbikalime | ú 12,148,996.81 | ú 10,756,123.18 | ú 36,208.60 |
| 2 | Eurocontrol Terminal | ú 1,931,574.73 | ú 1,829,945.01 | ú 29,650.80 |

Burimi i të dhënave: Albcontrol SHA (Përpunimi: Grupi i auditimit)

Më konkretisht, në vitin 2018, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tâu shërbente 23,369 avionëve për shërbime të terminalit dhe 171,376 avionëve për shërbimin e mbikalimit. Faktikisht, përgjatë vitit 2018 shoqëria u ka shërbyer 25,368 avionëve për shërbime të terminalit, duke u shërbyer 1,999 avionëve më tepër sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 108.5 % dhe u ka shërbyer 174,978 avionëve për shërbime të mbikalimeve, duke u shërbyer 3,602 avionëve më tepër sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 102.1%.
Në numër total të shërbimeve të ofruara për trafikun ajror, për vitin 2018 shoqëria Albcontrol SHA, ka shërbyer në numër shërbimesh ajrore në nivelin 102.8% të sa programuar.
Në vitin 2019, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tâu shërbente 27,000 avionëve për shërbime të terminalit dhe 195,000 avionëve për shërbimin e mbikalimit. Faktikisht, përgjatë vitit 2019 shoqëria u ka shërbyer 28,294 avionëve për shërbime të terminalit, duke u shërbyer 1,294 avionëve më tepër sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 104.7 % dhe u ka shërbyer 186,933 avionëve për shërbime të mbikalimeve, duke u shërbyer 8,067 avionëve më pak sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 95.9 %.
Në numër total të shërbimeve të ofruara për trafikun ajror, për vitin 2019 shoqëria Albcontrol SHA, ka shërbyer në numër shërbimesh ajrore në nivelin 96.9 % të sa programuar.
Në vitin 2020, shoqëria Albcontrol SHA kishte parashikuar tâu shërbente (sipas programit të amenduar) 15,100 avionëve për shërbime të terminalit dhe 109,418 avionëve për shërbimin e mbikalimit. Faktikisht, përgjatë vitit 2020 shoqëria u ka shërbyer 15,080 avionëve për shërbime të terminalit, duke u shërbyer 20 avionëve më pak sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 99.9 % dhe u ka shërbyer 86,232 avionëve për shërbime të mbikalimeve, duke u shërbyer 23,186 avionëve më pak sesa parashikuar ose duke realizuar programin në 78.8 %.
Në numër total të shërbimeve të ofruara për trafikun ajror, për vitin 2020 shoqëria Albcontrol SHA, ka shërbyer në numër shërbimesh ajrore në nivelin 81.4 % të sa programuar.

Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet, sikurse paraqitur grafikisht edhe më poshtë, një rënie e theksuar e shërbimeve të ofruara përgjatë vitit 2020, në krahasim me vitet 2018, 2019 si në drejtim të numrit të shërbimeve të terminalit dhe të mbikalimeve ashtu edhe në drejtim të të ardhurave të gjeneruara përmes ofrimit të këtyre shërbimeve. Kjo rënie e ndjeshme rezulton të jetë shkaktuar nga situata e pandemisë globale COVID-19, e cila e preku gjerësisht sistemin e navigimit ajror civil.




Burimi: Grupi i auditimit




Burimi: Grupi i auditimit




Burimi: Grupi i auditimit

Nëse do të krahasajomë aktivitetin e viteve 2018, 2019 dhe 2020 vihet re se në drejtim të nivelit të të ardhurave të gjeneruara si rezultat i shërbimeve të ofruara, viti 2020, pavarësisht se në vlerë absolute ka rënie të theksuar në krahasim me vitet 2018 dhe 2019, ka një realizim mbi 100% të të ardhurave krahasuar me sa parashikuar në programin vjetor, konkretisht **1,664,242 mijë lekë** nga **1,618,866 mijë lekë** të parashikuara ose 102.8 %.

**5. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli. - Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. - Respektimi i dispozitave ligjore për për pagat dhe shpërblimet e punonjësve. - Zbatimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin. - Zbatimi i vendimeve të Gjykatave për marrëdhëniet e punës dhe efektet financiare të rrjedhura prej tyre.**

Nga lidhje me këtë drejtim të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës mbi strukturën dhe nivelin e pagave
-Struktura organizative
-Dosjet e personelit
-Rregullorja e brendshme
-Rregullorja për përcaktimin e e kritereve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës
-Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës
-Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës
-Procedurat e dhënies të masave disiplinore
-Listë pagesat e punonjësve

Marrëdhëniet e punës në Albcontrol SHA, janë rregulluar me:
-Ligji nr. 7691, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò (i ndryshuar)
-Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ñPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtareò (i ndryshuar)
-Ligji nr. 8821, datë 15.10.2001 ñPër aderimin e Republikës së Shqipërisë në Eurocontrolò
-Statutin e shoqërisë
-*Kontratën kolektive të punës nr. 656 prot., datë 30.03.2017* nënshkruar ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Albcontrol SHA dhe punëmarrësve, përfaqësuar nga Sindikata e Pavarur e Kontrollorëve të Trafikut Ajror (SPKTA) e Sindikatës së Pavarur të Teknikëve të Kontrollit Ajror (SPKTA).
-Rregullorja e brendshme në fuqi, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 26.11.2018.

Nga auditimi konstatohet se:
Struktura organizative e Albcontrol është e organizuar në 4 divizione, përkatësisht në divizionin operacional, divizionin teknik, divizionin e sigurisë, dhe divizionet administrative, në total prej 347 punonjës mesatarë. Struktura organizative e Shoqërisë për periudhën objekt auditimi ka pësuar nje riorganizim, në funksion të përmbushjes së misionit të saj sipas standardeve të kërkuara nga organizmat ndërkombëtare të fushës, të rritjes së efiçiencës së burimeve njerëzore, me fokus parrezikshmërinë në ofrimin e shërbimit të lundrimit ajror. Struktura organizative e Albcontrol SHA, ka pësuar disa ndryshime në muajin mars 2018 dhe janar 2019, me urdhrin nr. 83, datë 28.01.2019, të cilat janë reflektuar në disa njësi, brenda numrit total të punonjësve.

Nivelet e pagave në këtë shoqëri janë miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 30.06.2015 ñPër përcaktimin e kufijve dhe niveleve të pagave në shoqërinë Albcontrol SHAò, vendim i cili ka qenë në fuqi deri në 01.07.2019.
-Me vendimin nr. 10, datë 26.11.2018, Këshilli Mbikëqyrës ka ripërcaktuar kufijtë dhe nivelet e pagave për pozicionet në Albcontrol SHA, vendim i cili do të hynte në fuqi në datën 01.04.2019.
Për këtë ndryshim në Këshillin Mbikëqyrës është paraqitur relacioni nga Drejtori i Përgjithshëm

znj. B.B. Në këtë realacion nga shoqëria nuk janë parashikuar efektet financiare që do të ketë në vitin e ardhshëm nga rritja e pagave, por vetëm në Programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë për vitin 2019, miratuar nga aksioneri më datë 08.01.2019, ku është parashikuar një rritje prej 30 milionë lekë nga hyrja në fuqi e pagave të rishikuara më 01.04.2019.

Në këtë relacion argumentohet:...*"Prej vitit 2001 "Albcontrol" SHA aderon në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrl-it mbi bazën e ligjit nr. 8821, datë 15.10.2001 'Për aderimin e Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrl-it". Në cilësinë e zbatuesit direkt të kësaj marrëveshje shoqëria ka si detyrim, zbatimin e të drejtës ndërkombëtare që buron nga kjo organizatë, ku aplikohen rregulla të unifikuara nga të gjitha shtetet anëtare. Një prej parimeve të unifikuara të detyrueshme për zbatim nga të gjithë shtetet anëtare të kësaj organizate është parimi i kostos bazë, sipas të cilit programi i zhvillimit ekonomik(buxheti) duhet të planifikohet dhe realizohet në mënyrë të tillë që të ardhurat e shoqërisë të jenë të barabarta me shpenzimet. Sipas këtij parimi dhe rregullave të përcaktuara nga EUROCONTRL:*

*i. Shoqëria nuk duhet të sigurojë fitim;*

*ii. Nuk ka limit që kufizon shpenzimet e enteve në fjalë(për të siguruar realizimin e misionit të tyre, ofrimin e shërbimeve navigacionale në kushtet e parrezikshmërisë);*

*iii. Elementët e kostos bazë janë:* ***a) kosto e stafit;*** *b) kosto operative; c) kosto e amortizimit dhe d) kosto e riskut të kapitalit".*

*...Nga sa më sipër qartësohet se, buxheti i secilit shtet anëtar miratohet në Eurocontrol, i cili është i detyrueshëm për zbatim. Në referencë të nenit 122/3 të Kushtetutës së Shqipërisë, vendimmarrja e këtij organi, ka epërsi mbi përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të shtetit shqiptar prej momentit të aderimit në këtë organizatë."*

Nisur sa më sipër, meqenëse shoqëria ka aplikuar kufij dhe nivele pagash me diferencë dukshëm më të larta krahasuar me nivelet e pagave të institucioneve dhe shoqërive të tjera në vend, të miratuara këto nga Këshilli Mbikëqyrës në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, por bazuar dhe në politikat e kostos të Eurocontrolit, ku në shoqëritë simotra kostoja e stafit zë nga 60 deri 70% të kostos bazë, shoqëria ka propozuar: *"... Në kuadër të politikave të Eurocontrol dhe përafrimin e mundshëm me to, nëpërmjet këtij materiali është synuar një shtrirje e kufijve të pagave, rritje për pozicion si dhe përshtatja me riorganizimin e fundit të strukturës së shoqërisë".*

Referuar propozimit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, difrenca mesatare për shkallë është si më poshtë:

| Nr. | Pozicioni | Dif mesat për shkallë |
|---|---|---|
| A | Drejtor i Përgjithshëm | 7% |
| B | Drejtor Divizioni | 5% |
| C | Drejtor Drejtorie (Kontrollor) | 5% |
| D | Drejtor Drejtorie | 5% |
| E | Shef Sektori(kontrollor) | 4% |
| F | Shef Sektori | 4% |
| G | Ekspert(kontrollor) | 3% |
| H | Ekspert | 3% |
| I | Instruktor/Kontrollor/Supervizor(5) | 3% |
| J | Kontrollor | 3% |
| K | Student/Kontrollor/Assitent FDR/FDA | 3% |
| L | Ing Level II | 3% |
| M | Ing Level (BMS) (4) | 3% |
| N | Specialist II | 3% |
| O | Specialist I/ Asistent | 3% |
| P | METEO (Sinop, Vrojt. Klimat) | 3% |
| O | Elektricist/ Teknik | 3% |
| R | Shofer | 3% |
| S | Punonjës Shërbimi | 3% |

*Burimi: ALBCONTROL SHA*

*Konstatojmë se, rritja e nivelit të pagave në asnjë rast nuk është lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, pra fitim apo humbje, në referencë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, por sipas parimit të Eurocontrol ku shoqëria funksionon me të ardhura e shpenzime të balancuara, pra nuk siguron fitim. Shoqëria ndërton strukturën e shpenzimeve ose të kostos për njësi referuar parimeve të Eurocontrol, ku në pikën 2.3.1 përcaktohet kosto e stafit, ndërsa në pikën 3.2.2, përshkruhet mënyra e mbulimit të humbjeve duke u shpërndarë në vitet pasardhëse.*

-Me vendimin nr. 12, datë 03.05.2019 të Këshillit Mbikëqyrës është bërë një ndryshim në vendimin nr. 10, datë 26.11.2019, duke e shtyrë datën e implementimit të ndryshimit të kufijve të pagave nga data 01.04.2019 në datën 01.07.2019. Në relacionin e paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë është argumentuar: *"... Aktualisht duke konsideruar pamjaftueshmëri në likuiditet, pasi të ardhurat e kompanisë të siguruara nga trafiku janë të kufizuara e vijnë duke u rritur me afrimin e sezonit, konsideruam të bëjmë një shtyrje për zbatimin e këtij vendimi, duke filluar zbatimin prej datës 01.07.2019"*, ndërsa me urdhrin e tij nr. 657., datë 26.07.2019 është bërë ndryshimi i nivelit të pagave sipas pozicioneve të punës.
-Niveli i pagave ka pësuar sërish ndryshim me *vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr 1, datë 24.04.2020 "Për uljen e pagave të punëmarrësve dhe pezullimin e të drejtave të fituara me kontratën kolektive të punëmarrësve të "Albcontrol" SHA për një periudhë të pacaktuar deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë"*.
Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës është marrë bazuar në impaktin e pandemisë botërore shkaktuar nga COVID-19 në industrinë e aviacionit, shërbimet e navigimit ajror dhe rrjedhimisht në situatën financiare të Albcontrol SHA në kushtet kur trafiku ajror ka rënë me 90% të volumit.
Referuar këtij vendimi, punonjësve u është ulur në mënyrë nominative paga bazë, është hequr shtesa e përhershme prej 20% mbi pagën pazë për vështirësi, po kështu, është vendosur mosaplikimi i shtesave me karakter të përhershëm mbi pagën bazë prej 20% dhe 60% për punë pa ndërprerje (me turne) dhe aplikimi i shtesave sipas përcaktimeve në Kodin e Punës.
Sipas vendimit elementët e pagës për punonjësit që do vazhdojnë punën do të jenë:
-paga bazë
-shtesa për vjetërsi punë
-shtesa me karakter të përhershëm prej 40% (shtesa për liçensën vetëm për Kontrollorët e Trafikut Ajror)
-shtesa me karater të përhershëm prej 20% (për Asistentët e të Dhënave të Fluturimit).
-Punëmarrësit, Kontrollorët e Trafikut Ajror, si pasojë e uljes së volumit të punës, do të punojnë me rrotacion një muaj punë dhe një muaj në shtëpi, kur janë në shtëpi do të marrin vetëm pagën bazë, etj., ndërsa Asistentët e të Dhënave të Fluturimit do të jenë në shtëpi përgjatë të gjithë pandemisë dhe paguhen vetëm me pagën bazë përgjatë gjithë periudhës deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë.
-Nxjerrja e një pjese të stafit si pasojë e uljes së volumit të punës me pagë minimale të përcaktuar me VKM, përgjatë gjithë periudhës, deri në kthimin në normalitet të situatës financiare të shoqërisë.
Gjithashtu, punonjësve u janë ndërprerë përfitimet dhe trajtimet e tjera që u janë njohur nga kontrata kolektive e punës, *megjithëse theksojmë faktin se Kontrata Kolektive e punës ka përfunduar më 30.03.2020 dhe para kësaj date nuk janë përmbyllur negociatat për lidhjen e kontratës së re, kjo referuar nenit 6 të saj.*
Nga auditimi i korespondencës me EUROCONTROL, në kushtet kur trafiku ajror ka rënë me 90% të tij, rezulton se propozimet e tij, që i referohet dhe vendimmarrja e Këshilli Mbikëqyrës janë si më poshtë:
1.App./PC/20-05-REV-DGD20_0185,COVID 19: Airspace User Charges ku Eurocontrol ka propozuar aprovimin, nga Shtetet Anëtare, të masave në lidhje me një modifikim të përkohshëm (shtyrjes) të datës së fundit të marrjes së pagesave për tarifat e përdoruesve të hapësirës ajrore. Ky

modifikim propozohet vetëm për 4 muaj. Propozimi bazohet në pamundësinë e kompanive për të paguar faturën e muajit shkurt dhe në vijim në kushtet e kufizimeve të aktivitetit.
2.App./PC/20-05-REV-DGD20_01888,COVID 19: Airspace User Charges i cili ka të bëjë me aprovimin e një mase financiare për të kufizuar mungesën e fluksit të parave në rast të shtyrjes së datës së fundit të marrjes së pagesave së përdoruesve të hapësirës ajrore, ose në pamundësi të marrjes së pagesave, si rezultat i trafikut të ulët gjatë periudhës Mars-Korrik 2020, duke i lejuar EUROCONTROLIT të hyjë në një marrëveshje kreditimi në vlerën 1.27 miliard euro ( total për të gjitha vendet anëtare) me qëllim ofrimin e një shume të kërkuar dhe të argumentuar për mbulimin e kostove minimale të funksionimit të shoqërisë.
Në muajin mars (datë 18.03.2020) ka patur dhe një komunikim të EUROCONTRL me Drejtorin e Autoritetit të Aviacionit Civil, ku paraqitet gjendja e paprecedente e aviacionit dhe vështirësitë serioze në kryerjen e pagesave për shërbimet e kryera në muajin shkurt ndaj Albcontrol SHA, duke sjellë në vëmendje dhe menaxhimin me kujdes të shpenzimeve.
Për të audituar saktësinë e zbatimit të dispozitave ligjore e nënligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli u përzgjodhën listëpagesat për muajt: dhjetor 2018, qershor 2019, korrik 2019, shtator 2020, dhjetor 2020 dhe mars 2021, ku nga auditimi nuk rezultuan shkelje dhe mangësi.
Për periudhën nën auditim personeli i Albcontrol SHA ka përfituar shpërblime bazuar në Kontratën Kolektive të Punës dhe në performancën e tyre, konkretisht: për periudhën qershor-dhjetor 2018 referuar urdhrit të brendshëm nr. 1054 prot., datë 18.12.2018 ñPër shpërblimin e punonjësve për periudhën e vlerësimit qershor 2018 deri dhjetor 2018ò; për periudhën janar 2019 deri maj 2019 sipas urdhrit të brendshëm nr. 672 prot., datë 01.08.2019, ndërsa për 6 mujorin e dytë të vitit 2019 punonjësit nuk kanë përfituar shpërblim për shkak të situatës së krijuar prej tërmetit së datës 26.11.2019, ku fondi i parashikuar ka kaluar në favor të buxhetit nëpërmjet platformës e-Albania.

*Të dhëna mbi emërimet dhe largimet nga 01.09.2018 deri më 30.03.2021.* Për periudhën 01.09.2018 derri më 31.12.2018 janë emëruar 5 punonjës dhe janë larguar nga Albcontrol SHA, 11 punonjës, ndër të cilët:

- Me kërkesë të punëmarrësit ï 8 punonjës;
- Dalje në pension - 3 punonjës;

Për vitin 2019 janë punësuar 18 punonjës dhe janë larguar nga Albcontrol SHA, 14 punonjës, ndër të cilët:

- Me kërkesë të punëmarrësit - 10 punonjës;
- Dalje në pension - 4 punonjës;
- Zgjidhje të kontratës së punës nga Punëdhënësi - 9 punonjës;

Për vitin 2020 janë punësuar 2 punonjës dhe janë janë larguar nga Albcontrol SHA, 21 punonjës, ndër të cilët:

- Me kërkesë të punëmarrësit ï 12 punonjës;
- Dalje në pension - 8 punonjës;
- Zgjidhje të kontratës së punës për shkak të ndarjes nga jeta - 1 punonjës.

Për vitin 2021 janë punësuar 14 punonjës dhe janë janë larguar nga ñALBCONTROLò SHA, 14 punonjës, ndër të cilët:

- Me kërkesë të punëmarrësit -7 punonjës;
- Dalje në pension - 5 punonjës;
- Zgjidhje të kontratës së punës nga punëdhënësi - 1 punonjës.
- Zgjidhje të kontratës së punës për shkak të ndarjes nga jeta - 1 punonjës.

-Në një rast të zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi janë respektuar afatet e njoftimit sipas parashikimeve të nenit 143 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës së Republikës së Shqipërisëò (i ndryshuar), parashikimet e nenit 144 për proceduren e zgjidhjes së kontratës nga

punëdhënësi, megjithëkëtë nga punëmarrësi është hapur proces gjyqësor, proces i cili është në shkallë të parë të gjykimit.

*Mbajtja e dokumentacionit të personelit.* Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit për 5 punonjës, konstatohet se në përgjithësi dokumentacioni mbahet i rregullt. Rregjistrat themeltarë të shoqërisë janë të plotësuar me të dhënat identifikuese të punonjësve, data e fillimit të punës arsimi profesional, kurset e ndryshme të kryera, paga mujore. Gjithashtu janë shënuar shkaku i largimit nga puna, data, masa disiplinore, shtesat e ndryshme. Për çdo punonjës mbahet dosje e veçantë, me dokumentacionin përkatës dhe kontratën e punës individuale sipas pozicionit të punës.

**6. Auditimi i veprimtarisë financiare të institucionit.**

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve financiare të kryera nga institucioni nëpërmjet arkës dhe bankës si dhe për blerjet me vlerë të vogël.
- Saktësimi dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.
- Inventarizimi i pasurisë së institucionit.

Në zbatim të këtij drejtimi të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Urdhër pagesat e realizuara nëpërmjet bankës, ku janë përzgjedhur urdhër pagesat e realizuara në periudhën Shtator-Dhjetor 2020 dhe Janar-Mars 2021.
- Mandat pagesat dhe mandat arkëtimet e realizuara nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë për periudhën Shtator-Dhjetor 2020 dhe Janar-Mars 2021.
- Procedurat e realizimit të blerjeve të vogla.

Nga auditimi i veprimeve të kryera rast pas rasti, nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë rezultoi se, regjistrimet kontabile në ditar janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël, bazuar në dokumentet justifikuese. Të gjitha mandatarkëtimet dhe mandatpagesat janë plotësuar dhe firmosur në rregull, sipas të dhënave të dokumenteve justifikuese dhe për çdo muaj është kuadruar ditari i arkës me gjendjen e librit të arkës konform me ligjin nr. 25, datë 11.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

Nga auditimi i blerjeve me vlera të vogla për kufirin deri 100 mijë lekë të kryera nëpërmjet arkës, u konstatua së Albcontrol SHA ka kryer për periudhën e përzgjedhur 8 procedura blerjë me vlerë 404 mijë lekë, ku rezultoi se AK ka vepruar në përputhje me udhëzimin e APP.

Nga auditimi e veprimeve të kryera nga Albcontrol nëpërmjet bankës për periudhën 01.09.2020 deri më 31.03.2021 rezultoi se, dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin e aktiveve. Urdhër-pagesat janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) konform pikës 35, te Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik, për të cilat nuk u konstatua mangësi.

Për periudhën e përzgjedhur për auditim nga Albcontrol SHA janë kryer në SPE të APP 9 procedura për blerje me vlera të vogla me vlerë 5,087 mijë lekë, ku nga auditimi rezultoi se janë kryer në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime dhe me Udhëzimin e APP.

Për të gjithë periudhën objekt auditimi nga shoqëria janë kryer shpenzime për blerje të biletave të udhëtimit me avion gjithsej në shumën 86,814,025 lekë, për të cilën nuk është kryer procedurë prokurimi, por është kryer blerje rast pas rasti nëpërmjet tre ofertave të marra në treg.

Shpenzimet e kryera sipas viteve paraqiten si më poshtë:

Në lekë

| Nr. | Periudha | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | 2018 | 45,080,995 |
| 2 | 2019 | 38,534,675 |
| 3 | 2020 | 3,099,565 |
| 4 | 3/Mujori I viti 2021 | 98,790 |

| | | |
|---|---|---|
| | **TOTALI** | **86,814,025** |

Burimi: Albcontrol SHA

Për kryerjen e këtyre shpenzimeve është ndjekur kjo procedurë ndër vite, por pas konstatimit tonë, duke filluar nga muaji gusht 2021 nga shoqëria blerja e biletave të avionit po kryhet nëpërmjet sistemi dinamik të blerjeve në SPE.

Inventarizimi i aktiveve. Nga drejtimi i shoqërisë para mbylljes së llogarisë vjetore është kryer inventarizimi i përgjithshëm i aktiveve, në zbatim të procedurave, rregullave të parashikuara në ligjin nr. 10236, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar ligjin nr. 25, datë 11.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pikat 73-103.

Albcontrol SHA ka kryer inventarët për vitin 2018, në bazë të urdhrit nr. 1068, datë 20.12.2018, për vitin 2019_në bazë të urdhrit nr. 919, datë 11.12.2019 dhe për vitin 2020 me nr. 830, datë 15.12.2020 të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Komisionet e inventarizimi të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë në relacionin e paraqitur konkludoi se gjendja fizike është e barabarte me gjendjen kontabël te shoqërisë Albcontrol SHA.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se inventarët janë nënshkruar nga komisionet përkatëse të inventarizimit dhe dokumentacioni është azhurnuar me kontabilitetin. Gjatë periudhës nën auditim shoqëria ka nxjerrë nga përdorimi dhe ka tjetërsuar Aktive Afatgjata Materiale me vlerë kontabile gjithsej 210,102 mijë lekë dhe vlerë të mbetur përdorimi 11,112 mijë lekë, procedurë e cila ka filluar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 342, datë 26.04.2018. Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve është miratuar paraprakisht nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.8, datë 03.05.2019 dhe më pas ka marrë miratimin dhë të Asamblesë së Aksionarit me vendimin nr. 56, datë 17.07.2019 dhe me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 733, datë 29.08.2019 është ngritur grupi i punës për asgjësimim dhe tjetërsimin e aktiveve. Nga auditimi konstatohet se procedura për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe tjetërsimin e aktiveve është bërë në përputhje me përcaktimet e neneve 95 deri 111 të udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.

Mbajtja e të dhënave të magazinës, hyrjet, daljet bëhen nëpërmjet sistemit ORACLE nga sektori i financës. Për cdo veprim të kryer nga magazina për periudhën e audituar 01.09.2020 deri më 31.03.2021, konstatohet që ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, fatura, urdhër dorëzime, etj.

-Shoqëria ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me të gjitha kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër si datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, mbajtjen në mënyrë shkresore të tij, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 30.

Shoqëria në janar të 2020 ka përfunduar dhe vlerësimin e aseteve të shoqërisë bazuar në kontratën ñPër rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale të shoqërisëò dhe në zbatim të SNK 16 "Aktive afatgjata materialeò dhe SNK 36 ñ Zhvlerësimi i aseteveò miratuar me urdhrin nr. 122, datë 11.10.2018 të Ministrit të MFE. Pas miratimi të raportit të përgjithshëm të vlerësimit të asseteve të shoqërisë nga ekspertët nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 4, datë 27.07.2020, janë bërë sistemit e aseteve në pasqyrat financiare të shoqërisë.

**7. Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.**

- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të prokurimit publik.
- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

***Të përgjithshme:***

Realizimi i prokurimeve nga shoqëria ñAlbcontrolò SHA për periudhën 01.09.2018 - 31.03.2021:

Nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 2018 -2021 ku rezulton se, janë realizuar gjithsej 125 procedura me FL në vlerën 2,221,667,411 lekë pa TVSH nga ku: 15 procedura për (shërbime, mallra dhe punë) në shumën 2,184,067,411 lekë pa tvsh + 49 proceduraóÓBlerje me vlerë të vogëlñ në shumën 37,600,000 lekë pa tvsh, ku të ndara sipas viteve, rezulton si vijon:

**Për vitin 2018**, janë realizuar gjithsej **25** procedura në shumën **472,151,349** lekë pa tvsh, nga ku: **15** procedura për shërbime, mallra dhe punë në shumën **464,151,349** lekë pa tvsh + **10** procedura ï

- ñBlerje me vlerë të vogëlò në shumën **8,000,000** lekë pa tvsh, respektivisht sipas llojit të tenderave, rezultojnë:

- ñTender i hapurò **14** procedura, me F.L. **459,409,006** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 383,553,624 lekë, me kursim të fondeve në shumën 75,855,382 lekë ose 16.51 % më poshtë se fondi limit.
- ñKërkesë negocim pa shpalljeò, **1** procedurë, me F.L. **4,742,340** lekë pa tvsh, kontratë të lidhur 4,742,340 lekë pa tvsh, pa kursim të fondeve.
- ñBlerje me vlerë të vogëlò gjithsej **10** procedura, me F.L. **8,000,000** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 3,794,250 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 4,205,750 lekë pa tvsh ose 52.57 % më poshtë se fondi limit.

**Për vitin 2019**, janë realizuar gjithsej **68** procedura në shumën **1,313,441,656** lekë pa tvsh, nga ku: **40** procedura për shërbime, mallra dhe punë në shumën **1,292,641,656** lekë pa tvsh + **28** procedura ĂBlerje me vlerë të vogëlñ në shumën **20,800,000** lekë pa tvsh, respektivisht sipas llojit të tenderave, rezultojnë:

- ñTender i hapurò **32** procedura, me F.L. **1,261,266,660** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 1,205,089,117 lekë, me kursim të fondeve në shumën 56,177,543 lekë ose 4.45 % më poshtë se fondi limit.
- ñKërkesë për propozimò, **8** procedurë, me F.L. **31,374,996** lekë pa tvsh, kontratë të lidhur 28,859,796 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 2,515,200 lekë pa tvsh ose 8.01 % më poshtë se fondi limit.
- ñBlerje me vlerë të vogëlò gjithsej **28** procedura, me F.L. **20,800,000** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 13,406,277 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 4,205,750 lekë pa tvsh ose 35.54 % më poshtë se fondi limit.

**Për vitin 2020**, janë realizuar gjithsej **24** procedura në shumën **436,074,406** lekë pa tvsh, nga ku: **13** procedura për shërbime, mallra dhe punë në shumën **427,274,406** lekë pa tvsh + **11** procedura

- ñBlerje me vlerë të vogëlò në shumën **8,800,000** lekë pa tvsh, respektivisht sipas llojit të tenderave, rezultojnë:

- ñTender i hapurò **10** procedura, me F.L. **414,774,407** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 391,671,459 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 23,102,948 lekë pa tvsh ose 5.57 % më poshtë se fondi limit.
- ñKërkesë për propozimòñ, **3** procedurë, me F.L. **12,499,999** lekë pa tvsh, kontratë të lidhur 9,965,466 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 2,534,533 lekë pa tvsh ose 20.27 % më poshtë se fondi limit.
- ñBlerje me vlerë të vogëlò gjithsej **11** procedura, me F.L. **8,800,000** lekë pa tvsh, kontrata të lidhura pa tvsh në shumën 6,548,956 lekë pa tvsh, me kursim të fondeve në shumën 2,251,044 lekë pa tvsh ose 25.58 % më poshtë se fondi limit.

**<u>Për vitin 2021 (01.01.2021 – 31.03.2021)</u>**, janˣ realizuar gjithsej **8** procedura në shumën **32,800,000** lekë pa tvsh, nga ku:, respektivisht sipas llojit të tenderave, rezultojnë:

-ñTender i hapurò **1** procedurë, me F.L. **25,000,000** lekˣ pa tvsh, kontrata tˣ lidhura pa tvsh nˣ shumˣn **24,500,000** lekˣ pa tvsh, me kursim tˣ fondeve nˣ shumˣn **500,000** lekˣ pa tvsh ose 2.00 % mˣ poshtˣ se fondi limit.

- ñKˣrkesˣ për propozimò, **1** procedurë, me F.L. **3,000,000** lekˣ pa tvsh, kontratë tˣ lidhur **2,890,000** lekë pa tvsh, me kursim tˣ fondeve në shumën **110,000** lekë pa tvsh ose 3.3 % më poshtë se fondi limit.

-ñBlerje me vlerˣ tˣ vogˣlò gjithsej **6** procedura, me F.L. **4,800,000** lekˣ pa tvsh, kontrata tˣ lidhura pa tvsh nˣ shumˣn **3,230,550** lekˣ pa tvsh, me kursim tˣ fondeve nˣ shumˣn **1,569,450** lekˣ pa tvsh ose 32.6 % mˣ poshtˣ se fondi limit.

<u>Parashikimi mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimeve nga grupi i auditimit të KLSh-së të objekteve të prokuruara për periudhën 01.09.2018 - 31.03.2021:</u>

- U konsideruan si objekte me risk dhe u planifikuan për tâu audituar nga grupi i auditimit prokurimet si më poshtë vijon:

Për periudhën e auditimit (2018-31.03.2021), u planifikuan për tâu audituar **45 (dyzet e pesë)** procedura/objekte për punë publike, mallra dhe shërbime, në vlerën **1,415,391,740** lekë pa TVSH ose në masën 63.70% të mbulimit të prokurimeve**,** respektivisht:

**<u>Për vitin 2018</u>**: U planifikuan për tâu audituar 12 (dymbëdhjetë) tendera në vlerën **345,209,006 lekë pa TVSH,** ose në masën **73.85 %.**

**<u>Për vitin 2019</u>**: U planifikuan për tu audituar 23 (njëzet e tre) tendera në vlerën **880,108,327 lekë pa TVSH,** ose në masën **67 %.**

**<u>Për vitin 2020</u>**: U planifikuan për tu audituar 10 (dhjetë) tendera në vlerën **190,074,407 lekë pa TVSH,** ose në masën **46 %.**

Për periudhën (2018-31.03.2021), u audituan **27 (njëzet e shtatë)** procedura prokurimi (Punë publike, mallra dhe shërbime) me FL në vlerën **1,071,725,172** lekë pa TVSH dhe kontratë të lidhur në vlerën 1,039,522,746 ose në masën 75.71 % të mbulimit të prokurimeve të planifikuar për tu audituar, ose 48.23 % të mbulimit të realizimit të përgjithshëm**,** respektivisht sipas tabelës:

Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Në zbatim të pikës mbi auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike, në Albcontrol SHA, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve për punë publike të përfunduara në periudhën e auditimit 01.09.2018 ï 31.03.2021, ku janë realizuar **5** investime/kontrata për punë publike në vlerën **163,311,209 lekë pa TVSH ose 195,973,450.8 lekë pa TVSH**, respektivisht sipas viteve:

- **Për vitin 2018**: Janë realizuar 3 (tre) investime/kontrata për punë publike në vlerën 80,793,820 lekë pa TVSH ose 96,952,584 lekë me TVSH
- **Për vitin 2019**: Janë realizuar 2 (dy) investime/kontrata për punë publike në vlerën 82,517,389 lekë pa TVSH ose 99,020,866.8 lekë me TVSH.
- **Për vitin 2020** deri më **31.03.2021** nuk janë prokuruar kontrata për punë publike.

Pasqyrimi i kontratave për punë publike.

| **Nr.** | **Objekti i Prokurimit** | **Fondi Limit pa TVSH** | **Vlera e kontratës paTVSH** | **Operatori Ekonomik i shpallur fitues** | **Data e lidhjes se kontrates** | **Data e perfundimit kontrates** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Viti 2018** | | | | | |
| **1** | Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës | 37,294,821 | **37,294,821** | ñA.I.G.C.ò SHPK | 27.12.2017 | 15.01.2019 Kolauduar me datë 28.02.2019 Marrje në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | dorëzim 28.10.2019 |
| 2 | Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC | 50,000,000 | **38,756,659** | ñRr.U. A. nr. 2 E. | 27.12.2018 | 14.06.2019 |
| 3 | Shtese kontrate per rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës | 4,742,340 | **4,742,340** | ñA.I.G.C.ò SHPK | 31.12.2018 | 15.01.2019 |
| | **Viti 2019** | | | | | |
| 1 | Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknik | 83,333,333 | **79,098,683** | ñRr.U. A. nr. 2 E. | 21.05.2019 | 01/20/20 |
| 2 | Mbi financimin e rikosntruksionit të ambjenteve të Urgjencës së Spitalit Francez, Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" | 4,166,666 | **3,418,706** | ñE.ò | 07/22/19 | 09/21/19 |
| | Shuma | 179,537,160 | **163,311,209** | | | |

Burimi: Shoqëria Albcontrol SHA

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të zhvillimit të prokurimeve si dhe të zbatimit të kontratave për punë publike, në vijim po pasqyrojmë problematikat e konstatuara, si më poshtë vijon:

**7.1.** Prokurimi me objekt ñ**Shpenzime për policinë private"** me nr. reference të prokurimit: REF-61368-06-16-2020.

Të dhëna të përgjithshme mbi objektin e prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 1105, datë 08.06.2020<br>**Titullari AK: M.K.**<br>**Procedura prokurimit** ï e hapur me mjete elektronike<br>**Fondi limit**: 9,124,407 lekë pa tvsh<br>**Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | **Njësia e Prokurimit: Nr. 1105, datë 08.06.2020**<br><br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **KVO**<br>**Nr. 1105/1 datë 08.06.2020**<br><br>J.B., Kryetare<br>J.K., anëtar<br>E.LL., anëtar |
| **Data e hapjes:** 10.07.2020 ora 11:000<br>**Shtyhet dt e hapjes:** 5 ditë<br>**Datë:** 15.07.2020 | OE ñNa..ò SHPK | Kontrata Nr. 1105/5 Prot, datë 23.07.2020 |
| **OE:**<br>Pjesemarres 3<br>s`kualifikuar 2<br>kualifikuar 1 | **Oferta Fituese 8,992,387.65** lekë pa TVSH | Miratimi i procedurës, datë 15.07.2020 |
| | **Diferenca me fondin limit:**<br>132,019.35lekë pa TVSH | Vlera e kontratës:<br>**8,992,387.65** lekë pa TVSH |

Në zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime për policinë privateò me nr. reference të prokurimit: REF-61368-06-16-2020 morën pjesë në tender 3 (tre) OE ku nga KVO janë skualifikuar operatorët respektivisht:

- OE ñV.S.G.ò SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 9,000,000 lekë pa TVSH, sepse nuk plotësonte:

1. OE tek kriteret e përgjithshme nuk plotësonte pikën 1.a, sepse ka paraqitur një vërtetim të datës 27.10.2019 për statusin e tij aktiv. ky vërtetim nuk është marrë në konsideratë.
2. Nuk plotësonte pikën 1.b dhe 1.c duke mos paraqitur dokumente.
3. Ky OE nuk ka paraqitur dokumentacionin që kërkohet në Kriteret e Veçanta.
4. Nuk plotëson pikën 3.1.1 tek kapaciteti ligjor/profesional.

Kurse OE ñK.ò SHPK, nuk ka paraqitur asnjë dokument dhe, nuk plotëson kriteret e përgjithshme për Kualifikim.

KVO ka shpallur fitues OE ñNa..ò SHPK, sepse plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit me ofertën ekonomike me vlerë 8,992,389 lekë pa TVSH. Nuk u

konstatuan problematika në hartmin e DST, konkretisht në hartimin e kritereve të pranim kualifikimit si dhe në llogaritjen e FL. Zhvillimi i procedurës së prokurimit është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit dhe nuk u konstatuan parregullsi.

**7.2.** Prokurimi me objekt ñ**Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA**)ò me nr. Reference të prokurimit: REF-23459-05-23-2019. si dhe,
**7.3.** Prokurimi me objekt ñ**Sigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA)"** me nr. Reference të prokurimit: REF-70342-05-22-2018ò.

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos argumentim dhe saktësim i pasqyrimit të pajisjeve informatike/programeve informatike, duke shkaktuar rritje të paargumentuar saktë të vlerës së përllogaritur të kontratës.
**Situata:** Në 2 (dy) raste nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të pasqyrës së asteve të Albcontrol SHA në tenderin me objekt: ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò me nr. Reference të prokurimit: REF-23459-05-23-2019ò dhe tenderit me objekt: ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA)ò me nr. Reference të prokurimit: REF-23459-05-23-2018, u kostatua se:
**-** Në zbatim të procedurave për prokurimin ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò viti 2019, grupi i punës me shkresën nr. 1106/2, datë 21.05.2019, i përbërë nga; D.Z., H.P. dhe T.F. ka mbajtur proces ï verbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,150,365,227 lekë, ku në këtë pasqyrë janë përfshirë programe/Pajisje informatike në shumën 71,280,236 lekë. Këto paisje informatike/programe informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqryruara në mënyrë të pa argumentuara dhe grupuar më saktë në asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga rreziqet e mundshme.
- Në zbatim të procedurave për prokurimin ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò viti 2018, grupi i punës, me shkresën nr. 660/2, datë 02.05.2018, i përbërë nga: D.Z., H.P. dhe T.F. ka mbajtur procesverbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,218,035,800 lekë, ku në këtë pasqyrë janë përfshirë, përfshirë programe/pajisje informatike në shumën 146,914,175 lekë. Këto paisje informatike/programe informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqryruara në mënyrë të pa argumentuara dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga rreziqet e mundshme. Për sa më sipër trajtuar, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, Kreu II, pika 2, shkronja ñaò; me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 28.
**Kriteri:** Për sa më sipër, është në kundërshtim me nenin 9 ñLlogaritja e vlerës së kontratësò të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar.
**Ndikimi/Efekti:** Për sa konstatuar, me kriteret e mësipërme është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme konkurrenca, çka bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar.
**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: D.Z., H.P. dhe T.F..*
**Rëndësia:** E mesme
**Rekomandime:** Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA si dhe nga Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkuruese të merren masa që në vazhdimësi në përllogaritjen e fondit limit të kontratave të ngjashme me objekt ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò të bazohen në inventarin e saktë të aseteve të shoqërisë, duke argumentuar dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga 11 rreziqet. Disa zëra që nuk i përkasin këtij grupimi të adresohen me emërtim të ri të zërit dhe në grupin e duhur teknikisht.

**7.4.** Prokurimi dhe zbatimi i punimeve të ndërtimit për objektin: ñ**Mbi financimin e rikonstruksionit të ambienteve të Urgjencës së Spitalit Francez, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"** me nr. reference të prokurimit: REF-1382-06-20-2019.

Nga auditimi mbi zhvillimin e tenderit me objekt ñMbi financimin e rikonstruksionit të ambienteve të Urgjencës së Spitalit Francez, Qendra Spitalore Universitare ñNënë Terezaò me nr. Reference të prokurimit: REF-1382-06-20-2019, me të dhëna të përgjithshme të pasqyruara në tabelë, nuk u konstatuan problematika.

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 1382, datë 20.06.2019<br>**Titullari AK: M.K.** | **Njësia e Prokurimit: Nr. 1382, datë 20.06.2019**<br>A.M.<br>S.P.<br>E.LL. | **KVO nr.1382/1 datë 20.06.2019**<br><br>J.B., Kryetare<br>E.N., anëtar<br>J.M., anëtar |
| **Procedura prokurimit** ï Kërkesë për propozim me mjete elektronike | | |
| **Fondi limit**: 4,166,666 lekë pa tvsh | | |
| **Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | | |
| **Data e hapjes:** 03.07.2019 ora 11:000<br>**Shtyhet dt e hapjes:** 09.07.2019<br>**Data e shpërndarjes**: 20.06.2019 | OE ñEu..ò SHPK | Kontrata Nr. 1382/4 Prot, datë 22.07.2019 |
| **OE:**<br>Pjesëmarrës 5<br>s`kualifikuar -<br>kualifikuar 5 | **Diferenca me fondin limit:**<br>747,960 lekë pa TVSH | Miratimi i procedurës, datë 20.06.2019 |
| | **Oferta Fituese 3,418,706** lekë pa TVSH | Vlera e kontratës:<br>**3,418,706**lekë pa TVSH |

*Në prokurimin me objekt "Mbi financimin e rikosntruksionit të ambjenteve të Urgjencës së Spitalit Francez, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"" morën pjesë 5 (pesë) operator ekonomik dhe nga KVO janë kualifikuar 5 operatorë ekonomik sepse plotësonin të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit duke renditur të OE të parin me ofertën ekonomike më të ulët OE "Eu.." SHPK me ofertë ekonomike 3,418,706. Për mënyrën e vlerësimit nga OE pjesëmarrës nuk ka patur ankesa. Zhvillimi i procedurës së prokurimit është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit.*

**7.5.** Tenderi i zhvilluar me objekt ñ**Shtesë kontrate, për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës**ò me nr. Reference të prokurimit: REF-01711-12-26-2018.

**Të dhëna të përgjithshme mbi objektin e prokurimit:**

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 2611/1, datë 26.12.2018 | **Njësia e Prokurimit: Nr. 2611/1, datë 26.12.2018**<br><br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **KVO:**<br>**Nr.2611/2 datë 26.12.2018**<br><br>J.B., Kryetare<br>E.N., anëtar<br>E.LL., anëtar |
| **Procedura prokurimit** :<br>Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. | | |
| **Fondi limit**:<br>4,742,340 lekë pa tvsh | | |
| **Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | | |
| **Data e hapjes:** 27.12.2018 ora 11:00 | OE ñA.I.G.C.ò sh.a | Kontrata Nr. 2611/4 Prot, datë 31.12.2018 |
| **OE:** | **Diferenca me fondin limit** zero | Miratimi i procedurës, datë |

| | | |
|---|---|---|
| Pjesemarres 1<br>s`kualifikuar -<br>kualifikuar 1 | lekë pa TVSH | 27.12.2018 |
| | **Oferta Fituese 4,742,340** lekë pa TVSH | Vlera e kontratës:<br>**4,742,340** lekë pa TVSH |
| | **Titullari AK:**<br>Znj. B.B.. | |

Në prokurimin me objekt ñShtesë kontrate, për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò me nr. Reference të prokurimit: REF-01711-12-26-2018 mori pjesë 1 (një) OE ku nga KVO është kualifikuar dhe është shpallur fitues, sepse plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit me ofertën ekonomike me vlerë 4,742,340 lekë pa TVSH. **Zhvillimi i procedurës së prokurimit është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit dhe nuk u konstatuan parregullsi.**

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt ñ**Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës**ò.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve të kontratës bazë me objekt ñRehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò me këto të dhëna të përgjithshme:

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës".** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 2317/4 Prot datë 27.12.2017 | **15.Vlera e kontratës**<br>44,753,785 lekë me tvsh<br>OE fitues ñA.I.G.C. ò SHPK | **16.Likuiduar:**<br>- Paradhënie 31,327,649 lekë (Formular urdhër transferte datë 27.12.2017; fat tatimore nr. 117, datë 27.12.2017, seri 51770495).<br>-Sit 1 ne vlerën 7,195,607 lekë me TVSH. (U Transferte dt 6.11.2018; F Tatimore nr. 66 dt 15.06.2018).<br>- Sit perf. vlera 3,434,464 lekë me TVSh (U Transferte dt 18.02.2019; F Tatimore nr. 119, dt 05.12.2018).<br>- Sit nr. 1 perf. vlera 5,406,268 lekë me TVSh (U Transferte pa datë; F Tatimore nr. 10, dt 05.02.2019, seri 51770154). |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>**-**Vlera 44,166,021 lekë me tvsh | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 22.01.2018<br>Përfundimi punimeve: 22.09.2018 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Sôka |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>Ing. V.M. | Licenca nr. 2049/6 | Kontrata, nr. prot 135/1, datë 18.01.2018 |
| **21. Kolaudatori i punimeve:**<br>ñI.ò SHPK | Licenca Nr: MK 0919/8 | Kontrata e shërbimit të kolaudimit, nr. prot. 135/3, datë 21.09.2018 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 05.10.2018 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Është mbajtur por pa datë, kjo vërtetuar me nr. 2281/1, datë 28.10.2019 lëshuar nga Titullari i AK, Z. M.K.. | |

si dhe të kontratës për ñShtesë kontrate për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò me këto të dhëna, rezultoi sa vijon:

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Shtesë kontrate, për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencës".** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 2611/4 Prot datë 31.12.2018 | **15.Vlera e kontratës**<br>4,742,340 lekë pa tvsh<br>OE fitues ñA.I.G.C. ò SHPK | **16.Likuiduar:**<br>-Situac përfundimtar me vlerë 5,406,268 lekë me tvsh (U Transferte dt 30.10.2019; F Tatimore nr. 10 dt 05.02.2019) |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>**-**Vlera 5,406,268 lekë me tvsh | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 31.12.2018<br>Përfundimi punimeve: 15.01.2019 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Sôka |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>Ing. V.M. | Licenca nr. 2049/6 | Kontrata, nr. prot 135/1 prot, datë 18.01.2018 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>ñ I.ò shpk | Licenca Nr: MK 0919/8 | Kontrata e shërbimit të kolaudimit, nr. prot. 370/1 datë 11.02.2019 |

| | |
|---|---|
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 28.02.2019 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Është mbajtur por pa datë, kjo vërtetuar me nr. 2281/1, datë 28.10.2019 lëshuar nga Titullari i AK Z. M.K.. |

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për të dy kontratat, të situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime ndërtimi të paargumentuara qartë në librezën e masave në vlerën **2,373,260 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: ñVeshje fasade me xham struktural i pathyeshëmò dhe ñVeshje fasade me Alekubond, përfshi strukturënò.

**Kriteri**: Mos argumentim dhe saktësim i pasqyrimit të zërave në librezën e masave, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò kreu II, pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2317/4 prot, datë 27.12.2017; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2611/4 prot., datë 31.12.2018.

**Impakti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar plotësim jo i saktë i librezës së masave i cili nënkupton realizimin në fakt të punimeve të ndërtimit.

**Shkaku**: Neglizhencë dhe pasqyrimim jo i saktë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve zërave në librezën e masave në vlerën **2,373,260 lekë pa TVSH**. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V.M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.*

**Rëndësia**: *E lartë*

**Rekomandim:** Albcontrol SHA, të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve: ñ*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*ò dhe ñ*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*ò të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mospasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

**7.6.** Prokurimi me objek: ñ**Shpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjese ndërrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)"** me nr. Reference të prokurimit: REF-19403-04-24-2019ò.

Nga auditimi i zhvillimit të prokurimit, me të dhëna të përgjithshme nuk u konstatuan problematika.

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 948, datë 24.04.2019<br>**Procedura prokurimit** ï e hapur me mjete elektronike<br>**Fondi limit**: 29,300,000 lekë pa tvsh<br>**Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | **Njësia e Prokurimit: Nr. 948, datë 24.04.2019**<br>A.M.<br>S.P.<br>E.LL. | **KVO**<br>**Nr.948/1 datë 24.04.2019**<br><br>M. Et., Kryetare<br>E.N., anëtar<br>J.M., anëtar |
| **Data e hapjes:** 20.05.2019 ora 11:000<br>**Shtyhet dt e hapjes:** 5 ditë<br>**Datë:** 27.05.2019 | OE ñ4.A.M.ò SHPK | Kontrata Nr. 948/4 Prot, datë 10.06.2019. |
| **OE:**<br>Pjesemarres 1<br>s`kualifikuar - kualifikuar 1 | **Diferenca me fondin limit** 51,074 lekë pa TVSH<br>**Oferta Fituese 29,248,926** lekë pa TVSH<br>**Titullari AK: M.K.** | Miratimi i procedurës, datë 24.04.2019<br>Vlera e kontratës:<br>**29,248,926** lekë pa TVSH |

*Në prokurimin me objekt "Shpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjesë ndërrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)" me nr. Reference të prokurimit: REF-19403-04-24-2019 mori pjesë 1 (një) OE ku nga KVO është kualifikuar dhe është shpallur fitues, sepse plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit me ofertën ekonomike 29,248,926 lekë pa TVSH.* ***Zhvillimi i procedurës së prokurimit është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit dhe nuk u konstatuan parregullsi****.*

**7.7.** Prokurimi me objekt ñ**Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknik**ò vitin 2019 me nr. Reference të prokurimit: REF-14539-03-20-2019 + zbatimi kontratës me nr. 732 prot, datë 20.03.2019.

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Vendosja e specifikimeve teknike pa një argumentim të thelluar teknik ose ligjor të nevojës.

**Situata:** Nga auditimi mbi zhvillimin e prokurimit me objekt Investime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò vitin 2019 me nr. Reference të prokurimit: REF-14539-03-20-2019, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës, u konstatua problematika si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 732, datë 20.03.2019<br>**Procedura prokurimit** :<br>E hapur me mjete elektronike<br>**Fondi limit**:<br>83,261,772 lekë pa tvsh<br>**Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | **Njësia e Prokurimit: Nr. 732, datë 20.03.2019**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **KVO:**<br>**Nr.732/1 datë 20.03.2019**<br><br>J.B., Kryetare<br>M.Et., anëtar<br>E.N., anëtar |
| **Data e hapjes:** 22.04.2019 ora 11:00 | BOE ñRr.U.A nr. 2ò sh.a & ñCuò SHPK | Kontrata Nr. 732/4 Prot, datë 21.05.2019 |
| **OE:**<br>Pjesemarres 3<br>s`kualifikuar 2<br>kualifikuar 1 | **Oferta Fituese 79,098,683** lekë pa TVSH<br>**Diferenca me fondin limit: 4,163,089** lekë pa TVSH<br>**Titullari AK:** Z. M.K. | Miratimi i procedurës, datë 2204.2019<br>Vlera e kontratës:<br>**94,918,419.6** lekë pa TVSH |

**Hartimi i Specifikimeve Teknike.**

**-** Me urdhrin e prokurimit nr. 732, datë 20.03.2019, kërkohet kryerja e prokurimit me FL në vlerën 83,261,772 lekë pa TVSH për procedurën me objekt: ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm z. M.K.

**-** Me urdhrin nr. 732/1, datë 20.03.2019, kërkohet ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për procedurën me objekt: ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm të AK.

Hartmi i specifikimeve teknike për prokurimin me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò me nr. Reference të prokurimit: REF-14539-03-20-2019, lidhur me **Zërin (An) F.V. Pajisje e brendshme kasetë AUXA54GALH, marka GENERAL FUJITSU, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw <u>në sasinë 12 copë</u>** nuk është aspak i argumentuar dhe e dokumentuar saktë, dhe nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.

**- P***ërcaktimi i markës së kondicionerit "***GENERAL FUJITSU***" për "***Zërin (An) F.V. Paisje e brendshme kasetë AUXA54GALH, marka GENERAL FUJITSU, ngarkesë ftohëse 14 kw****" është i gabuar. Në këtë mënyrë AK "Albcontrol SHA" ka orientuar dhe ka paracaktuar Markën e Kondicionierit, në këtë mënyrë duke përjashtuar markat e tjera të kondicionerëve.*

**- P***ërcaktimi i markës së pompës së jashtme VRF V III "***GENERAL FUJITSU***" për "***F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH**

**(162+162+90). Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw***" është i gabuar. Në këtë mënyrë AK "Albcontrol SHA" ka orientuar dhe ka paracaktuar Markën e "Chillerit". Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit: A.M., S.P. dhe F.H., veprim ky në kundërshtim me DT hartuar me procesverbalin me datë 20.03.2019, me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

**Kriteri:** Për sa më sipër, është në kundërshtim me *me procesverbalin me datë 20.03.2019, me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

**Ndikimi/Efekti:** Për sa konstatuar, me kriteret e mësipërme është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme konkurrenca, çka bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: Znj. A.M., kryetare dhe anëtarët NjP; Znj. S.P., Z. F.H..*

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, si dhe Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkuruese, në rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekte/kontrata me natyrë të ngjashme, duhet të evidetojnë kritere të veçanta të dhe të kryejnë një argumentim të thelluar teknik ose dhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre, kritere të cilat nuk mund të sjellin kufizimin e pjesmarrjes së Operatorëve Ekonomik, ofertues të mundshëm të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës.

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP të disa zëra pune në librezën e masave për kontratën me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò viti 2019 si dhe vendosje e pajisjeve jo sipas specifikimeve teknike.

**Situata:** Në zbatim të procedurës së prokurimit me nr. REF-14539-03-20-2019 për objektin ñInvestime për infrastrukturën e divizionit Teknikò është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 732/4 prot., datë 21.05.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Z. M.K. dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCuò SHPK, përfaqësuar nga ñRr.U.A nr. 2ò SHA me licencë NZ.2480/15 dhe NIPT J62904264O, përfaqësuar nga Z. K.H. Vlera e kontratës është 79,098,683 lekë pa TVSH ose 94,918,419.6 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë së difekteve është përcaktuar 12 muaj nga data e marrjes së përkohshme në dorëzm të punimeve të objekt ñInvestime për infrastrukturën e divizionit Teknikò.

Të dhëna të përgjithshme të kontratës:

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Investime për infrastrukturën e divizionit Teknik".** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 732/4 Prot datë 21.05.2019 | **15.Vlera e kontratës**<br>79,098,683 lekë pa tvsh<br>BOE fitues ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCuò SHPKò SHPK | **16.Likuiduar:**<br>- Vlera 24,192,787.48 lekë (F Tatimore nr. 7, datë 15.11.2019 seri 30082957, Situacioni nr. 1).<br>- Vlera 7,231,000 lekë (F. Tatimore nr. 6, datë 12.03.2020, seri 30082966, Situacioni nr. 2). |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 90,989,837.67 lekë me tvsh | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 27.06.2019<br>Rifillimi i punimeve: 08.08.2019<br>Përfundimi punimeve: 27.04.2020 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Shkresa nr. 732/10 prot, datë 16.12.2019 |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE ñZe.ò SHPK | Licenca nr. 3360/2 | Kontrata, nr. prot 1184/1, datë 29.03.2019 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE ñG.R. Al.ò SHPK | Licenca Nr: MK 2703/10 | Kontrata e shërbimit të kolaudimit, nr. prot. 1023/1, datë 13.05.2020 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 20.05.2020 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Datë: 26.06.2020 Grupi i marrjes në dorëzim: J.M.; D.N. dhe V.Z. | |

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për të dy kontratat, të situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në

terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan vplume të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP me librezën e masave në vlerën **2,401,029 lekë pa TVSH**, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

| Nr Anal | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **Punime shtresash** | | | | | | | |
| 15(An) | Shtrim dysheme me Rezinë EPOXY Autoniveluese 3-5 mm (Rezistente ndaj kalimit të mjeteve të magazinës). | $m^2$ | 3,800 | 454.65 | 454.65 | 421.3 | 33.35 | 125,400 |
| | **Punime suvatimi e veshje me pllaka.** | | | | | | | |
| 40(An) | F.V Porte metalike dekorative rrëshqitëse | $m^2$ | 6,459 | 46.18 | 46.18 | 39.18 | 7 | 45,213.00 |
| | **Makineritë e sistemit Aspirim/Kondicionimit** | | | | | | | |
| 152 | Pajisje të brendshme kasetë AUXA54GALH, marka General Fujitsu, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw | $N^0$ | 185,868 | 12 | 12 | - | 12 | 2,230,416 |
| | **Totali në lekë pa TVSH** | | | | | | | **2,401,029** |

Gjithashtu nga auditimi mbi zbatimin e kontratës u konstatua realizimi i zërit të punëve ñF.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90) jo në përputhje me specifikimet teknike për treguesit: Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kwò argumentuar si vijon:

Tabela nr. 2.

| Nr Anal | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **Punime Kondicionimi** | | | | | | | |
| 1 | F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90). Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw | Cop | 1 | 1 | 1 | 1 (jo sipas Specifikime ve Teknike) | - | 5,354,194 |
| | **Totali në lekë pa TVSH** | | | | | | | 5,354,194 |

**Zëri 1 (An) F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90). Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw.**

Situacioni përfundimtar pasqyron 1 copë **Chiller** model **WSAN-XEE 702**, me çmim 4,680,214 lekë pa TVSH. Libreza e masave, pasqyron 1 copë **Chiller** model **WSAN-XEE 702**.

Në fakt, nga auditimi në objekt rezultoi se nga sipërmarrësi i punimeve është vendosur **chiller** me tregues teknik jo në përputhje me specifikimet teknike dhe Kushtet e Kontratës së zbatimit me objekt: ñGodinë 1 Kat Magazinë dhe sistemimi i sheshit ekzistuesò. Referuar specifikimeve teknike, pajisja **Chiller** duhej të plotësonte këto tregues teknik si vijon:

- Kapaciteti teknik në ftohje 128 kw
- Kapaciteti teknik në ngrohje 131.5 kw
- Tipi chiller është përcaktuar **AJH414LALBH**

Nga auditimi i paisjes chiller në objekt, rezultoi me këto tregues:

- Kapaciteti teknik në ftohje 56 kw (2.28 herë më e vogël se Specifikimet Teknike)
- Kapaciteti teknik në ngrohje 63 kw (2.08 herë më e vogël se Specifikimet Teknike)

- Tipi chiller është SANYS DC Inverter Modeli: CVE5600UC3

Pra, vendosja e popes së nxehtësisë (Chiller) VRF nga sipërmarrësi i punimeve BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCu.ò SHPK me tregues më të ulët sesa treguesit e përcaktuar në Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, ka shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **5,354,194 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:

- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.
- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 13).
- Shtojcën 18 (Kushtet e përgjithshme të kkontratës), Neni 13 ñKontraktori që Kryen Punimetò, pika 13.1 ku citohet se: ñKontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderitò të kontratës me nr. 732/45 prot, datë 21.05.2019. Pika 13.3 ku citon se: ñKodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktorò, Neni 14 (Materialet dhe pajisjet) të kontratës nr. 732/4 prot, datë 21.05.2019.

**Kriteri**: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 732/4 prot., datë 21.05.2019.

**Impakti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e shoqërisë Albcontrol SHA.

**Shkaku**: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në plotësimin me saktësi të librezë së masave. *<u>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L.H., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.</u>*

**Rëndësia** : *E lartë*

**Rekomandime 1:** Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

**Rekomandime 2:** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve ñ*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90); Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*ò apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Eficencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

***<u>Pretendimi i subjektit të audituar.</u>***

*Nëpërmjet observacionit me nr. prot 566/68 datë 14.12.2021, protokolluar në KLSH me nr. 445/6 prot, datë 14.12.2021, nga shoqëria sipërmarrëse* ñRr.U.A nr. 2ò SHA *përfaqësuar nga z. K.H., janë paraqitur pretendimet se mos kryerja e punimeve të ndërtimit në vlerën 2,401,029 lekë nuk qëndron duke bërë sqarimet si vijon:*

***1**- Për zërin "Shtrim dysheme me Rezinë EPOXY Autoniveluese 3-5 mm (Rezistente ndaj kalimit të mjeteve të magazinës), <u>sipërmarrësi i punimeve i qëndron gjetjes</u> së grupit të auditimit.*

***2-** Lidhur me zërin" F.V Portë metalike dekorative rrëshqitëse" sipërmarrësi i punimeve i qëndron gjetjes së grupit të auditimit.*
***3.** Lidhur për Zërin 40 (An.) "F. V Paisje e brendshme kasete A UXA54GALH, marka GENERAL FUJITSU, ngarkese ftohese 14 kw, ngarkese ngrohese 16 kw", sqarojmë se njësitë e brendëshme të kondicionimit janë vendosur kanalore, fuqia 15 kW në Ftohje, 17 kW në ngrohje, me presion statik 70 Pa dhe sasi ajri maksimale 2000 $m^3$ /h dhe me nje nivel zhurme relativisht të vogel, 40-44 dB(A). Pra, numri i pajisjeve është montuar sipas sasisë së situacionit, por si model është i ndryshëm duke patur parasysh që për këtë lloj ndërtese është më i përshtatshem ky lloj modeli pasi ben qarkullimin më të mirë të ajrit dhe rrjedhimisht edhe nje kondicionim dhe ruajtje temperature me të mire dhe uniforme. Gjithashtu ngarkesa ftohëse dhe ngrohese e pajisjeve të montuara është më e madhe se e pajisjeve të specifikuara në preventive dhe specifikime teknike.*
***4.** Lidhur me zërin (An.) "F. V Paisje e jashtme VRF VIII. Marka GENERAL FUJITSU. Modeli: AJH414LALBH (162 + 162 + 90). Ngarkeseftohese 128 kw, ngarkese ngrohese 131.5 kw" sipërmarrësi i punimeve i qëndron gjetjes së grupit të auditimit dhe nuk ka observuar.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit.***
***3.** Ju dakortësoheni me mendimin e audituesit, sepse realisht në fakt u vërtetua se, sistemi i instaluar në objekt është pak më i vogël (5%+7%) në kapacitetet në ftohje(cooling) dhe në ngrohje (heating), në krahasim me ato të caktuara në specifikimet teknike të projektit, por që është brenda tolerancave të lejuara.*
*Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin në terren dhe konstatoi se volumet për disa zëra pune nuk janë pasqyruar qartësisht në librezën e masave. Përsa sipër, ky pretendim merretpjesërisht  në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit të audituar.***
*Nëpërmjet observacionit me nr. prot 566/68, datë 14.12.2021, protokolluar në KLSH me nr. 445/6 prot, datë 14.12.2021, nga shoqëria mbikëqyrëse "Ze." SHPK përfaqësuar nga z. L.H., janë paraqitur pretendimet si vijon:*
***1.** Zëri "F. V Paisje e brendshme kasete A UXA54GALH, marka GENERAL FUJITSU, ngarkese ftohese 14 kw, ngarkese ngrohese 16 kw", sqarojmë se njësitë e brendëshme të kondicionimit janë vendosur kanalore, fuqia 15 kW në Ftohje, 17 kW në ngrohje, me presion statik 70 Pa dhe sasi ajri maksimale 2000 $m^3$ /h dhe me nje nivel zhurme relativisht të vogel, 40-44 dB(A). Pra, numri i pajisjeve është montuar sipas sasisë së situacionit, por si model është i ndryshëm duke patur parasysh që për këtë lloj ndëertese është më i përshtatshem ky lloj modeli pasi ben qarkullimin më të mirë të ajrit dhe rrjedhimisht edhe nje kondicionim dhe ruajtje temperature me të mire dhe uniforme. Gjithashtu ngarkesa ftohëse dhe ngrohese e pajisjeve të montuara është më e madhe se e pajisjeve të specifikuara në preventive dhe specifikime teknike, duke e bërë edhe më funksional.*
***2.** Lidhur me zërin (An.) "F. V Paisje e jashtme VRF VIII. Marka GENERAL FUJITSU. Modeli: AJH414LALBH (162 + 162 + 90). Ngarkeseftohese 128 kw, ngarkese ngrohese 131.5 kw" mbikëqyrësi sqaron se:*
*Siç jemi shprehur edhe në observacionin e mëparshëm sistemi i instaluar në objekt në krahasim me ato të caktuara në specifikimet teknike të projektit, është brenda tolerancave të lejuara dhe është funksional.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit***
***1.** Ju dakortësoheni me mendimin e audituesit, sepse realisht në fakt u vërtetua se, sistemi i instaluar në objekt është pak më i vogël (5%+7%) në kapacitetet në ftohje(cooling) dhe në ngrohje (heating), në krahasim me ato të caktuara në specifikimet teknike të projektit, por që është brenda tolerancave të lejuara. Për sa më lart, grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar, pasi ka bërë verifikimin në terren me Mbikëqyrësin e punimeve. Nëse do të ishte siç pretendohet në observacion, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kishin kërkuar ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjendeshin pajisje siç janë ofertuar dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës.*

| |
|---|
| *I njëjti qëndrim nga auditues është edhe për zërin "F. V Paisje e jashtme VRF VIII. Marka GENERAL FUJITSU. Modeli: AJH414LALBH (162 + 162 + 90). Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.* |

**7.8.** Prokurimi me objekt ñ**Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC" me nr. Reference të prokurimit:** REF-93468-11-09-2018 si dhe zbatimi i kontratës për punë publike me nr. 2255/5 prot, datë 27.12.2018.

Të dhëna të përgjithshme mbi objektin e prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 2255, datë 08.11.2018<br>**Procedura prokurimit** :<br>E hapur me mjete elektronike<br>**Fondi limit**:<br>41,663,423 lekë pa tvsh<br>**Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | **Njësia e Prokurimit: Nr. 2255, datë 08.11.2018**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **KVO:**<br>**Nr.2255/1 datë 08.11.2018**<br><br>V. H., Kryetare<br>E.N., anëtar<br>J.B., anëtare |
| **Data e hapjes:** 13.12.2018 ora 11:00 | BOE òRr.U.A nr. 2ò SHA & òTr Enò SHPK | Kontrata Nr. 2255/5 Prot, datë 27.12.2018. |
| **OE:**<br>Pjesemarres 2<br>s`kualifikuar 1<br>kualifikuar 1 | **Oferta Fituese 38,756,659** lekë pa TVSH | Miratimi i procedurës, datë 08.11.2018 |
| | **Diferenca me fondin limit:**<br>2,906,764 lekë pa TVSH | Vlera e kontratës:<br>**46,507,991** lekë pa TVSH |

Në prokurimin me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò, kanë marrë pjesë 2 (dy) OE respektivisht:
BOE ñRr.U.A. nr. 2ò SHA & ñTr. En.ò SHPK me ofertë 38,756,659 lekë dhe OE ñE.Vlò SHPK pa ofertë ekonomike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KVO ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE ñRr.U.A. nr. 2ò SHA & ñTr. En.ò SHPK, sepse plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit dhe ka skualifikuar OE ñEl.Vlò SHPK, i cili ka paraqitur vetëm ekstraktin e QKB. **Zhvillimi i procedurës së prokurimit është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit dhe nuk u konstatuan parregullsi.**

►**Titulli i gjetjes:** Mos pasqyrim i argumentuar të volumet e situacionuara në vlerën 923,494.15 lekë pa TVSH në plotësimin e librezë së masave, për kontratën me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò.

**Situata:** Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë pasqyruar në tabelë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, grafiku i punimeve, etj.

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACC".** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 2255/5 Prot datë 27.12.2018<br><br>Akt-Marrëveshje me nr. 2255/12, datë 03.04.2019 mbi shtyrjen e afatit të punimeve me një muaj. | **15.Vlera e kontratës**<br>46,507,991 lekë me tvsh<br>BOE fitues ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr. En.òSHPK | **16.Likuiduar:**<br>- Vlera 5,601,589 lekë (Urdhër transferte datë 11.01.2019, fat tatimore nr. 31, datë 28.12.2018 seri 30082538).<br>- Vlera 3,700,000 lekë (Urdhër transferte datë 16.11.2019, fat tatimore nr. 31, datë 28.12.2018 seri 30082538).<br>- Vlera 10,885,156 lekë (Urdhër transferte datë 29.05.2019, fat tatimore nr. 5, datë 31.03.2019, seri 30082544).<br>- Vlera 5,884,603 lekë (Urdhër transferte datë 11.09.2019, fat tatimore nr. 5, datë |

| | | |
|---|---|---|
| | | 31.03.2019, seri 30082544).<br>- Vlera 18,059,763.72 lekë (Urdhër transferte datë 31.10.2019; F. Tatimore nr. 12, datë 31.08.2019, seri 30082901, Situacioni situacion përfundimtar2). |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 46,453,801.71 lekë me tvsh | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 14.01.2019<br>Afati 4 muaj<br>Përfundimi punimeve: 14.06.2019 (nr. 2255/13 prot, datë 14.06.2019) | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Shkresa nr. 62/1 prot, datë 10.01.2019 |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>Ing. P.M. | Licenca nr. MK. 0004/1 | Kontrata, nr. prot 62/1, datë 10.01.2019 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>Ing. S.R. | Licenca Nr: MK 1443/2 | Kontrata e shërbimit të kolaudimit, nr. prot. 1377/1, datë 24.06.2019 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 05.07.2019 dhe nr. prot. 1377/2. | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Datë: ---- | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan mos argumentim i volumeve në plotësimin e librezës së masave në vlerën **923,494 lekë pa TVSH**.

**Punime të kryera jo sipas specifikimeve teknike.**

Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të kondicionimit për zërin ñF.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702ò u konstatua se ky zë pune është realizuar jo sipas specifikimeve teknike, pasqyruar në tabelën.

| Nr Anal | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **Punime Kondicionimi** | | | | | | | |
| 1 | F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702 | Cop | 1 | 1 | 1 | 1 (jo sipas Specifikimeve Teknike) | - | 4,680,214 |
| | **Totali në lekë pa TVSH** | | | | | | | **4,680,214** |

**Zëri 1 (An) F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702**

Situacioni përfundimtar pasqyron 1 copë Chiller model **WSAN-XEE 702**, me çmim 4,680,214 lekë pa TVSH. Libreza e masave, pasqyron 1 copë Chiller model **WSAN-XEE 702**.

Në fakt, nga auditimi në objekt rezultoi se nga sipërmarrësi i punimeve është vendosur chiller me tregues teknik jo në përputhje me specifikimet teknike dhe Kushtet e Kontratës së zbatimit me objekt: ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò. Referuar specifikimeve teknike, pajisja Chilleri duhej të plotësonte këto tregues teknik si vijon:

- Kapaciteti teknik në ftohje 183 kw
- Kapaciteti teknik në ngrohje 212 kw
- Tipi chiller është përcaktuar WSAN-XEE 702

Nga auditimi i paisjes në objekt, rezultoi: se janë vendosur dy paisje; 1 chiller (Daikin) për pjesën e katit përdhe dhe një VRV (Kondicionier) për pjesën e katit të parë; fuqia e të dyja paisjeve në ftohje (cooling)124 kw = 84 kw + 33.5 kw.

Fuqia në ngrohje: 1 chiller (Daikin) për pjesën e katit përdhe dhe një VRV (Kondicionier) për pjesën e katit të parë; fuqia e të dyja paisjeve në ngrohje (Heate) 128.5 kw = 37.5 kw + 91 kw.
Fakti:

- Kapaciteti teknik në ftohje 124 kw
- Kapaciteti teknik në ngrohje 128.5 kw
- Tipi chiller është përcaktuar Daikin

Pra, vendosja e popes së nxehtësisë (Chiller) nga sipërmarrësi i punimeve BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr. Eg.ò SHPK nuk është realizuar sipas Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, në shumën **4,680,214 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:

- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.
- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 12).
- Shtojca 17 (Kushtet e përgjithshme të kontratës), Neni 13 ñKontraktori që Kryen Punimetò, pika 13.1 ku citohet se: ñ Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderitò; Neni 14 ñMaterialet dhe paisjetò të kontratës të kontratës me nr. 2255/5 prot, datë 27.12.2018.

**Kriteri**: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr.2255/5 prot., datë 27.12.2018.

**Impakti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar realizim i zërit 1 (An) F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw, Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702 jo në përputhje me specifikimet teknike.

**Shkaku**: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në plotësimin dhe argumentimin e volumeve në librezën e msave. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. P.M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.*

**Rëndësia** : *E lartë*

**Rekomandim 1:** Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

**Rekomandim 2:** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve ñF.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702ò apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negociimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Eficencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

***Pretendimi i subjektit të audituar.***

*Nëpërmjet observacionit me nr. prot 566/68, datë 14.12.2021, protokolluar në KLSH me nr. 445/6 prot, datë 14.12.2021, nga sipërmarrës i punimeve z. K.H., janë paraqitur pretendimet dhe argumentet mbi akt konstatimin nr. 26, datë 30.09.2021 të mbajtur nga grupi i auditimit, si vijon:*
***1-** Për zërin "F.V bolier 80 litër, ujë të ngrohtë", mbikëqyrësi i punimeve është dakordësuar me qëndrimin e grupit të auditimit.*
***2-** Lidhur me zërin "Shtresë termoizoluese me lesh guri KNAUF t=10 cm", sipërmarrësi pretendon seky zë është realizuar dhe mund të verifikohet lehtë në objekt.*
***3.** Lidhur për "Zëri 1 (An) F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702", nuk ka paraqitur observacion duke u dakordësuar me qëndrimin e grupit të auditimit.*
***Qëndrimi i Grupit të Auditimit***
***2.** Sqarimi se për zërin "Shtresë termoizoluese me lesh guri KNAUF t=10 cm" është realizuar në gjykimin tonë nuk qëndron sepse:*
*- **së pari**: në observacionin mbi akt konstatimin jeni shprehur se nga ana Juaj, janë marrë masa nga që të realizohet shtresa termoizoluese me lesh guri KNAUF t =10 cm,*
*- **së dyti**: Keni pasur kohën e mjaftueshme që vërtetoni kryerjen e këtij zëri me fotografi apo dokument (procees verbal, apo akt konstatimi ku të nënshkruajnë të gjitha palët, siç grupi i auditimit e kërkoi brenda aftit të evadimit në subjekt të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*
*Sa më sipër observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.*

**7.9.** Prokurimi me objekt ñ**Studim "Kukës obstacle survey"** me nr. Reference të prokurimit: REF-85935-09-17-2018.

Të dhëna të përgjithshme mbi objektin e prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 1916, datë 17.09.2018<br>**Procedura prokurimit** :<br>E hapur me mjete elektronike<br>**Fondi limit**:<br>40,000,000 lekë pa tvsh<br>**Burimi i financimit**:<br>Nga të ardhurat e vetë Albcontrol SHA. | **Njësia e Prokurimit: Nr. 1916, datë 17.09.2018**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H.<br><br>**Grupi i punës:**<br>z. I.Zh., kryetar<br>znj. S.M., anëtare<br>z. A.B., anëtar | **KVO:**<br>**Nr.1916/1 datë 17.09.2018**<br><br>S. R., kryetar<br>E.N., anëtar<br>E.LL., anëtare<br><br>**Nr.1916/2 datë 28.09.2018**<br>T.M., kryetar<br>E.N., anëtar<br>E.LL., anëtare |
| **Data e hapjes:**<br>11.10.2018 ora 11:00<br>Mbas modifikimit:<br>**Data e hapjes:**<br>**16.10.2018** ora 12:00 | BOE ñA. Co.ò sh.p.k dhe ñE.ò SPA | Kontrata Nr. 1916/7 Prot, datë 12.11.2018. |
| **OE:**<br>Pjesemarres 4 BOE<br>s`kualifikuar 2 BOE<br>kualifikuar 2 BOE | **Oferta Fituese 23,180,500** lekë pa TVSH | Vlera e kontratës:<br>**23,180,500** lekë pa TVSH |

***Vlerësimi nga KVO:***

1. Në procedurën e prokurimit me objekt ñKukës obstacle surveyò morën pjesë 4 OE, konkretisht:
   - BPOE òA. Co.ò sh.p.k dhe ñE.ò SPA me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH.
   - BPOE òB-V. En.ò sh.p.k & òIn. Y Se.ò SA me çmim oferte 19,800,000 lekë pa TVSH.
   - OE òCo. & Ma. Al.ò Sh.p.k me çmim oferte 36,800,000 lekë pa TVSH.
   - OE òL. & Cò sh.p.k. me çmim oferte 39,000,000 lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqituara nga ofertuesit pjesëmarrës në tender, KVO ka kualifikuar BPOE òA. Co.ò sh.p.k & òE.ò SPA dhe BPOE òCo. & Ma. Al.ò Sh.p.k si dhe ka skualifikuar BPOE òB-V. En.ò sh.p.k & òIn. Y Se.ò SA dhe BPOE òL. & Coò sh.p.k.

Fitues është shpallur BPOE ñA. Co.ò sh.p.k dhe ñE.ò S.P.A. me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH, si BOE i cili plotëson të gjitha kushtet e DST dhe me një diferencë me FL në vlerën 16,819,500 lekë. Grupi i auditimit, mbas auditimit të dokumenteve fizik si dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE të paraqitura nga të gjithë operatorët, mendon se nga KVO nuk u konstatuan parregullsi dhe se ka vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve.

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Mos ngritje Komisionit të Shqyrtimit të ankesës nga Titullari i AK..

**Situata:** Zhvillimi i procedurës se prokurimit ka rezuktuar si vijon:
- Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave me datë 16.10.2018, ora 12:00, kanë marrë pjesë 4(katër) OE, përkatësisht:

1. BPOE òA. Co.ò sh.p.k dhe òE.ò SPA me çmim oferte **23,180,500** lekë pa TVSH.
2. BPOE òB-V. En.ò sh.p.k & òIn.Y Se.ò SA me çmim oferte **19,800,000** lekë pa TVSH.
3. OE òCo. & Ma. Al.ò Sh.p.k me çmim oferte **36,800,000** lekë pa TVSH.
4. OE òL. & Coò sh.p.k. me çmim oferte **39,000,000** lekë pa TVSH.

- Sipas proces verbalit të shqyrtimit të ofertave me datë 18.10.2018 ora 15:30 dhe verifikimit në SPE janë paraqitur OE dhe BOE, si më poshtë vijon:
- NjP dhe KVO me datë shkresën me nr. 1916/ prot., datë 17.10.2018 dhe nr. 1916/3., datë 17.10.2018 i kanë kërkuar BPOE ñA. Co.ò sh.p.k & ñE.ò s.p.a. kërkesë mbi argumentimin në lidhje me ofertën anamalisht të ulët.
- BPOE ñA. Co.ò sh.p.k në shkresën drejtuar ñAlbcontrolò SHA sqaron se, çmimi i ofertës 23,180,500 lekë pa TVSH, bazohet në marrëdhënien eksluziveme ofertuesin e këtij shërbimi ñE.ò S.P.A. për shkak të eksperiencës shumëvjeçare në këtë fushë dhe të teknologjive të avancuara që përdor, oferta e marrë nga kjo kompani është shumë e ulët dhe përpos kësaj OE ñE.ò SPS ka ofruar me sukses shërbime të kësaj natyre pranë Albcontrol SHA, duke e njohur tashmë tipologjinë e territorit si dhe pritshmërinë profesionale dhe cilësinë të produkteve të ofruara... dhe se është i yni si kontraktor që në rast të shpalljes fitues, tõi përmbahemi zbatimit të kontratës, duke ofruar shërbime më të njëjtën cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar.

**Vlerësimi sipas KVO-së:** KVO ka vlerësuar se BPOE ñA. Co.ò sh.p.k & ñE.ò s.p.a.; BOE ñCo. & Ma. Al.ò sh.p.k i plotësonin të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, ndërsa dy operatorët e tjerë kanë mangësitë si më poshtë vijon:

**1. BOE "B-V. En." sh.p.k & "A. In. Y Se. SA" <u>nuk i plotësonte kriteret si vijon</u>:**

a- Kontrata e bashkëpunimit midis OE ñB-V En.ò sh.p.k dhe nuk është sipas kërkesave ligjore në nenin 74, pika 2 të LPP ku citon se: ñPara dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëarët e këtij bashkimi...ò.

Në kontratë nuk është përcaktuar përqindja e secilit operator, pra kontrata nuk është sipas kërkesave ligjore dhe nga KVO është konsideruar e pa vlerë.

BOE ñB-V. En.ò shpk & ñ A. In. Y Se.ò SA nuk plotësonte:

kapaciteti teknik pika 1, Kontratat e ngjashme të dorëzuara nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në këtë kriter ku duhet që OE të ketë kryer shërbime të ngjashme në vlerë sa 40% e FL, ndërkohë që kontratat e paraqitura janë në vlerën 5,120,639 lekë pa TVSH.

b- Kriteri teknik pika 8. OE nuk ka paraqitur një projekt teknik ku të përmbante të gjitha kërkesat e përcaktuar në specifikimet teknike.

**2. OE "L. & CO" sh.p.k <u>nuk i plotësonte kriteret si vijon</u>:**

a- Nuk plotësohet pika 1 (Kapaciteti Teknik).

Kontratat e ngjashme nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në këtë kriter ku duhet që OE të ketë kryer shërbime të ngjashme në vlerë sa 40 % e fondit limit.

OE ñL. & C.ò është pjesë e BOE ñL. & C.ò dhe ñU. A. S.ò dhe ñS.ò. Në ktëkontratë nuk është përcaktuar përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh është paraqitur një kontratë me realizim 65% e punimeve, e papërfunduar, nuk ka dokument mbi pagesat dhe marrjen në dorëzim.
b- Nuk plotësohet pika 5 (Kapaciteti Teknik).
Nuk është paraqitur certifikata PAS 99: 2012 nga ñL. & C.ò.
c-Nuk plotësohet pika 8 (Kapaciteti Teknik).
OE nuk ka paraqitur skedulin me afatin kohor të të gjithë projektit, etapat e rëndësishme të punës dhe datat e proceseve të miratimit të përcaktuara në specifikimet teknike....
Rënditja përfundimtare nga KVO:
1. BPOE ñA. Co.ò shpk dhe ñE.ò SPA me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH.
2. OE ñCo. & Ma. Al.ò shpk me çmim ofertë 36,800,000 lekë pa TVSH.
Me nr. 1916/4, datë 18.10.2018 nga Titullari i AK znj. B.B.., është miratuar Raporti Përmbledhës për miratimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyòò. Ky raport përmbledhës është konceptuar nga S.P. dhe aprovuar nga E.N..
**Shqyrtimi i ankesës nga BPOE "B.V.A.A.L. En." shpk dhe "A. I. Y Se." shpk.**
OE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk me shkresën me nr. 108 prot., datë 22.10.2018 (Protokolluar në Albcontrol SHA me nr. prot. 2135, datë 22.10.2018) ka paraqitur një ankesë pranë Albcontrol SHA për procedurën me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò.
Pretendimit e BPOE.
**1.** BPOE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk dhe ñAi. In. Y Se.ò shpk, ka dorëzuar pranë AK një marrëveshje konsorciumi, në të cilën shprehet qartë marrja e përgjegjësisë së palëve të angazhuara si një operator i vetëm në 100% për realizimin e objektit të tenderit...
**2.** ...AK, ka realizuar llogaritjen për vlerën e njërit prej anëtarëve të BOE, më saktë OE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk për të konstatuar që nuk plotësohet vlera 40%. Kontratat e paraqitura nga BOE janë të ngjashme me kërkesat e kualifikimit, ku citojmëò ñOE duhet të paraqesë kontrata të së njëjtës natyrë, ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme në fushën e aviacionit civil, në një vlerë sa 40% e FL që prokurohet të realizuara gjatë tre viteve të fundit, dhe specifikimeve teknikeò..... OE 1. BOE ñB.V.A.A.l. En.ò sh.p.k ka paraqitur kontrata ku tregohet qartë matje gjeodezike, ndërsa OE ñAi. In. Y Se. SAò ka paraqitur kontrata dhe certifikata të ndryshme ku tregohet eksperienca e gjatë në aviacionin civil, në të cilat përfshihen të gjitha kërkesat e cituara në specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit sipas DST.
**3.** BOE ñB.V.A.A.l. En.ò sh.p.k & ñAi. In. Y Se. SAò ka paraqitur ckedulin me afatin kohor të gjithë projektit, etapat e rëndësishme të punës dhe datat e proceseve të miratimit të përcaktuara në ST....
Titullari i AK, me urdhërin e brendshëm nr. 1916/5, datë 23.10.2018 ka urdhëruar NjP dhe KVO-në të pezullojnë vazhdimin e procedurës së prokurimit me objekt: ñStudim ñKukës obstacle surveyò deri në kthimin e përgjigjes ankesës me nr. prot. 2135, datë 22.10.2018 të ñB.V.A.A.L. En.ò sh.p.k.
- Titullari i AK Albcontrol SHA, Znj. B.B.. me shkresën me nr. 2135/1 prot., datë 24.10.2018 me objekt: Kthim përgjigje, informon BPOE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk dhe ñA. In. Y Se.ò SA, se ankesa nuk merret parasysh nga Autoriteti Kontraktor Albcontrol SHA duke argumentuar pretendimet e operatorit ankimues.
**Problematikë e konstatuar:**
AK Albcontrol SHA, me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi OE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk me shkresën me nr. 108 prot., datë 22.10.2018 (Protokolluar në Albcontrol SHA me nr. prot. 2135, datë 22.10.2018) për procedurën me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò, ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO) sipas urdhrit të brendshëm nr. 1916/5 datë 23.10.2018, të pezullojë vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në kthimin e përgjigjes së ankesës.

Në vijim, titullari i AK Albcontrol SHA, me shkresën me nr. 2135/1 prot., datë 24.10.2018 me objekt: Kthim përgjigje, informon OE ñB.V.A.A.L. En.ò shpk, se ankesa nuk merret parasysh nga Autoriteti Kontraktor ñAlbcontrolò SHA duke argumentuar pretendimet e operatorit ofertues ankimues.
Konstatohet se nga titullari i Albcontrol SHA *nuk është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim*. Komisioni i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, kreu ñXò ñShqyrtimi i ankesaveò, neni 78 ñAnkesat në autoritetin kontraktorò pika 6 (a) dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Albcontrol SHA.
-Me nr. 1916/6 prot, datë 06.11.2018 nga Titullari i AK, është realizuar njoftimi i fituesit.
**Kriteri:** Për sa më sipër, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, kreu ñXò ñShqyrtimi i ankesaveò, neni 78 ñAnkesat në autoritetin kontraktorò pika 6 (a).
**Ndikimi/Efekti:** Shmangie e komisionit të shqyrtimit të ankesave nga ekspert të fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.
**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në shqyrtimin e ankesave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: Titullarin e AK.*
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandime:** Titullari i Autoriteti Kontraktor, për rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, duhet të eliminojë praktikat e kthimit të përgjigjes mbi pretendimet e ngritura nga vetë titullari, por të ngrejë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.

**7.10.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"Sigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidentet ajrore**ôô REF-14465-03-20-2019ôô me vlerë 74 749 200 (lekë pa tvsh).

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: ''Sigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidentet ajrore'' REF-14465-03-20-2019''** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 712 datë 19.03.2019 | **3. Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>J.B.<br>E.N.<br>E. Ll. |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>74 749 400 lekë tvsh | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>74 749 200 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>200 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>23.04.2019 | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancimnga Albcontrol sha | 10. **Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 , Bashkimi i Operatorëve Ekonomik |
| **11. Ankimime AK-**<br>Sôka | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sôka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr.712/3 Prot, datë 02.05.2019 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh) | |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**
**B 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se

procedura ñSigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidentet ajoreò, u inicua me kërkesën me nr.703 prot, datë 18.03.2019 nga Drejtore e Divizionit Administrativ J.B.. Në këtë kërkesë nuk ka një analizë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Mbi specifikimet teknike të përgatitur nga struktura e specializuar, ngritur me urdhrin nr.703/1, datë 18.03.2019, në pikën 1.2 Kufijtë e Përgjegjësisë citohet: a) kufiri maksimal për dëme të kombinuara do të jetë 200.000.000 euro për çdo ngjarje, b) për dëme materiale 9.000.000 euro, c) dëmtime personale do të jetë kufiri prej 7.000.000 euro për çdo ngjarje dhe 70.000 për çdo person dhe në agregat.

Këto kritere, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen tepër të sforcuara sepse AK nuk ka arsyetuar dhe argumentuar çmimin e tyre, ku është i bazuar në marrjen e tyre dhe në këto kushte Autoriteti Kontraktor nuk ka nxitur pjesëmarrjen operatorëve të tjerë ekonomikë në proçedurat e prokurimit publik.

**B.3.1** Përllogartija e fondit limit në vlerë **74,749,400 lekë** pa tvsh, nga grupi i punës, për llogaritjen e vlerës limit, i ngritur me urdhërin nr. 703/3 prot., datë 19.03.2019, ka marrë një kontratë të ngjashme dhe për rrjedhojë ka përllogaritur një vlerë, pothuajse të njëjtë me atë të vitit 2018.

Nga auditimi është konstatuar se, grupi i punës ka zgjedhur alternativën mbi çmimet e botuara në INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj), por në procesverbalin nr.703/4, datë 19.03.2019 nga grupi i i punës thuhet specifikisht: Nga informacioni konstatuam se nuk kishte çmime të publikuara nga INSTAT, *ndërkohë nuk ka asnjë dokumentacion justifikues vërtetues mbi dokumentimin e këtij rasti*. Më pas AK, vijon me alternativën tjetër, me çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vet apo nga autoritetet e tjera kontraktore dhe nga informacioni konstatuam se shoqëria kishte kontratë të ngjashme të mbyllur, në datë 02.05.2018 me nr. 709/4 prot., me objekt: ñSigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidenteve ajororeò për të njëjtat specifikime të kërkuara nga grupi i punës i ngritur për përcaktimin e specifikimeve teknike, ku të dhënat e kësaj kontrate përbënin objektin e këtij prokurimi janë pasqyruar si më poshtë:

**Bashkim i përkohshëm i operatorëve:**

- A. ï S. (A.) SH.A
- S. U. G. A. SHA
- S. I. V. I. G. (S.) SH.A

**Në kontratën me vlerën 74.749.400 lekë**

Grupi i punës, i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm që vlera limit e kontratës për këtë proçedurë prokurimi të jetë: 74,749,400 (shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind) lekë pa tvsh.

Bashkëlidhur kësaj proçedure gjendet dhe kontrata e mëparshme me nr. 709/4 prot., datë 02.05.2018 e nënshkruar në vlerën 74,474,940 lekë pa TVSH dhe afati kohor i policës do të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

Referuar kontratës noteriale me nr. 856 Rep. dhe nr. 454 Kol, të datës 12.04.2018, bashkimi i shoqërive të mësipërme me qëllim: ndarja e riskut me objekt ñsigurmi i riskut nga të tretët dhe aksidenteve ajroreò, organizuar nga Albcontrol SHA dhe vlefshmëria e saj hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe zgjat deri në përfundim të periudhës së sigurimit të risqeve të marra në bashkësigurim, që është 1 vjeçare, dhe përkon me mbarimin e policës së sigurimit, në datën 27.04.2019.

**B.4.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 23.04.2019, ora 11:00 është paraqitur oferta e parë: BPOE ñA.ò sh.a, ñS. U. G. A.òsh.a dhe ñS. I. V. I. G.ò sh.a me çmimin e ofertës:

- **74,747,200 (shtatëdhjetë e katër milion e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.**

Referuar kësaj ofertë, OE, ka aktive kontratën e mëparshme dhe se ky operator rrjedhimisht ka interes në këtë procedurë prokurimi. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (*këtu e në vijim Operatori Ekonomik - OE*) është në djeni mbi çmimin që prokurohet, realizuar nga kontrata e mëparshme, e vitit 2018 fituar nga i njëjti OE, me afat vlefshmërie të policës së sigurimit nga data 28.04.2018 deri më datë 27.04.2019.

Si rezultat, paraqitja e ofertave dhe përllogaritja e fondi limit, janë me të njëjtët operator ekonomik dhe faktet e mësipërme e bëjnë proçedurën të ekspozuar dhe me risk, e për rrjedhojë ajo nuk është e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, ku cilësohet se:

*"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*ò, ndërkohë AK ka marrë si vlerë të mirëqenë, vlerën e përafërt të kontratës së mëparshme, duke zbritur vetëm diferencën prej 540 lekë (7,474,940 - 74,749,400).

Konstatohet se vlera e përllogaritur e fondit limit është e përafërt me vlerën e çmimit fitues dhe kjo është tregues që OE ka interes mbi çmimin e prokurimit dhe lë hije dyshimi mbi fituesit e kësaj proçedure, e për më tepër, vit pas viti (*referuar kontratave të ngjashme*), fituesi është zgjedhur me vetëm një garues, që është konkurenti i vetëm, me rreth 100% të vlerës që prokurohet, duke e konsideruar si procedurë të ekspozuar dhe me risk.

**B.5.1** Me formularin nr. 712/3, datë 02.05.2019 është shpallur fituesi, BPOE ñA.ò sh.a, ñS. U. G. A.òsh.a dhe ñS. I. V. I. G.òsh.a në vlerën **74,747,200** pa tvsh, identifikuar si oferta e suksesshme.

**B.6.1** Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 03.05.2019 ka lidhur kontratën nr. 712/4 Prot., datë 03.05.2019, me BPOEñA.ò sh.a, ñS. U. G. A.òsh.a dhe ñS. I. V. I. G.òsh.a në vlerën 74,747,200 pa tvsh.

Më datë 03.05.2019 është administruar formulari i sigurimit të kontratës, nga shoqëria e sigurimeve ñE.ò sha, me nr. serial 07030420026877.

Albcontrol ka likujduar faturën bankare sipas faturës tatimore të shitjes, me nr. serie 74246733, datë 03.05.2019 dhe është siguruar polica e sigurimit me afat 1 (një) vjeçare, me datë 03.05.2019 deri në datën 02.05.2020, ora 24:00.

►**Titulli i Gjetjes**: Parregullsi në 9 raste për fillimin/inicimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, për periudhën 01.09.2018- 30.09.2020.

| | |
|---|---|
| **Situata**: | Nga shqyrtimi i proçedurave të prokurimit publik, me objekt: "Sigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidentet ajroreõõ REF-14465-03-20-2019õõ, "Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Angleze õõREF-38124-10-03-2019, "Trajnim refresh të emergjencave ATCO" REF-06695-02-06-2019, "Shpenzime për kontrollin mjeksor" REF-39921-10-17-2019, "Blerje pajisje elektronike" REF-35828-09-13-2019, "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeõõ REF-07076-02-08-2019, "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra" REF-07097-02-08-2019, "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi V.S.C. I. G." REF-11358-03-01-2019, "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje V.S.C. I. G." REF-61369-02-24-2020, kërkesat për fillimin e këtyre proçedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha, për realizimin e këtyre prokurimeve, nga çdo Divizion/Drejtori që inicion procesin si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin të jetë është parashikuar kryerja e këtyre investimeve/shpenzimeve, jo në përputhje të plotë me kërkesat e e nenit 12, pika 2, gërma a) të ligjit Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Drejtoritë dhe Divizionet e shoqërisë për |

| | |
|---|---|
| | mosplotësim të dokumentacionit të nevojshëm për inicimin e procedurave të prokurimit. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar VKM 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mosevidentim i saktë i nevojave për investime dhe shpenzime të Albcontrol SHA sipas planeve ekonomike të saj, krahasuar me mosargumentimin e kërkesave në dosjet e prokurimit të Divizioneve /Drejtorive të shoqërisë. |
| **Shkaku**: | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i Legjislacionit të Prokurimit Publik |
| **Rëndësia**: | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, tëi iniciojë këto procedura duke evidentuar në kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë, duke bërë një përshkrim të shkurtër/relacion, bashkëlidhur kërkesës për fillimin e procedurave. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të projekt raportit të auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/38 prot, nr. 566/39 prot, nr. 566/40 prot, nr. 566/68 prot, datë 14.12.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikat B.1.1 (trajtuar në akt konstatimet nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9), ky prokurim është i miratuar në plan buxhetin, me vendimin nr. 8, datë 26.11.2018 dhe vendimin nr. 24, datë 19.12.2020 të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimit të Asamblesë së Aksionarit, gjithashtu ky plan – buxhet është miratuar nga PP, në regjistrin e prokurimeve.*

*Kjo procedurë është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore, kërkesa për fillimin e procedurës, përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen. Sa më sipër, ky konstatim është i pasaktë.*

***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*

*Së pari, audituesit u janë referuar dosjeve përkatëse të Prokurimeve dhe në gjitha praktikat për inicimin/fillimin e proçedurave të Prokurimeve Publike, bashkëlidhur kërkesave nuk ka një dokumentacion shoqërues ose argumentim përkatës mbi nevojat e domosdoshmërisë për kryerjen e shërbimeve apo blerjen e mallrave. Në çdo praktike duhet të jenë të pasqyruara kërkesat nga Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve të programeve ekonomike dhe nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë, në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 12, pika 2, gërma a) të ligjit Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. Pra, në rastet për inicimin e procedurës, kërkesat duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:*

*a) <u>një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve</u>, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;*

*b) <u>arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar</u>;*

*Nisur nga sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë, përderisa observacionet nuk janë shoqëruar me një dokumentacion justifikues dhe përpos këtyre ato do të trajtohen në projekt-raportin e auditimit deri në dërgimin e argumentave/fakteve shkresore nga ana juaj. Praktikisht, në të gjitha kërkesat për fillimin e procedurave nuk gjendeshin bashkëlidhur arsyet, ose një relacion i shkurtër mbi fillimin e domosdoshmërisë së Procedurave të Prokurimeve sipas pretendimit tuaj, por vetëm një kërkesë, sipas 2 modeleve ilustruese trajtuar më poshtë.*



Albcontrol
AIR NAVIGATION SERVICES OF ALBANIA
www.albcontrol.al

Nr.prot. 240 Tiranë 28/1 /2019

Kërkesë

Lënda: "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VCS-INDRA, GAREX"

Drejtuar: Sektorit të Prokurimeve

Ju kërkojmë në bazë të Plan Buxhetit për vitin ushtrimor 2019, të merrni masa për fillimin e procedurës me objekt: "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VCS-INDRA, GAREX".

Ju urojmë punë të mbarë,

Z. Maksim Et'hemaj
Drejtor i Divizionit Teknik



Albcontrol
AIR NAVIGATION SERVICES OF ALBANIA
www.albcontrol.al

Nr.prot. 165 Tiranë 23/1/2020

Kërkesë

Lënda: "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbajtje VCS-INDRA, GAREX"

Drejtuar: Sektorit të Prokurimeve

Ju kërkojmë në bazë të Plan Buxhetit për vitin ushtrimor 2020, të merrni masa për fillimin e procedurës me objekt: "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbajtje VCS-INDRA, GAREX".

Ju urojmë punë të mbarë,

Z. Maksim Et'hemaj
Drejtor i Divizionit Teknik

*Së dyti, për pikat 2 dhe 3 argumentat tuaja merren në konsideratë, ndërsa mbi argumentimin e fondin limit, për alternativat e përzgjedhura, sjellim në vëmendjen tuaj se kur shpreheni që nuk ka çmime të publikuara në INSTAT, ato duhet të dokumentohen me një proçesverbal ose dokumentacion justifikues mbi këto raste.*

**7.11.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Anglezeò** REF-38124-10-03-2019 me vlerë 45,833,333 lekë (pa TVSH).

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "**Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Anglezeõò REF-38124-10-03-2019 | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 2185 datë 03.10.2019 | **3. Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>E.LL. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>J.B.<br>E.N.<br>L. S. |
| **2.Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>45 833 333 lekë tvsh | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>44 920 000 **lekë** | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>913,333 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>04.11.2019 | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim nga Albcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 , BPOE - ñC. & M. Al.òshpk |
| **11. Ankimime AK-**<br>Sõka | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sõka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | Nr. 2185/5, datë 13.11.2019 | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 2185/4 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>53,904,000 lekë | |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**B.1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstatohen se procedura e prokurimit me objekt: ñTrajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Anglezeò u inicua me kërkesë nr. 2151, datë 27.09.2019, firmosur nga Drejtor i Divizionit Administrativ D.I. Në këtë kërkesë nuk ka një analizë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Lidhur me specifikimet teknike, referuar shtojcës 8, në DST, pika 3.3 kapaciteti teknik, *mbi*

*çertifikatat ISO,* Autoriteti Kontraktor ka kërkuar:

1. OE duhet të zoteroje ISO 9001: 2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
2. OE duhet të jetë në zotërim të çertifikates ISO/IEC 27001:2013 të standartit ndërkombetar të menaxhimit të sigurisë së informacionit;
3. OE duhet të jetë në zotërim të çertifikatës PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit;
4. OE duhet të jetë në zoterim të çertifikates AS9100C për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë-Kërkesat për Aviacionin, Hapsirën dhe Organizatat e Mbrojtjes ;
5. OE duhet të jetë në zotërim të çertifikatës ISO 31000:2018 të standartit ndërkombetar të menaxhimit të Riskut.

Referuar specifikimeve të përshkruara, nga Autoriteti Kontraktor, në asnjë rast nuk ka argumentuar përse janë përshkruar këto kërkesa, cili është qëllimi i tyre, përse shërbejnë dhe në kuptim të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, këto të dhëna janë të paargumentuara, e në gjykimin e grupit të auditimit, janë kërkesa diskriminuese duke kufizuar konkurencën dhe duke mos mundësuar trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe në thelb ato kanë shërbyer si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Si rezultat i tyre ofertuesi ka qenë vetëm me një OE, me një garues në zhvillimin e Procedurës së Prokurimit dhe është shpallur fituesi OE i vetëm ñC. & M. Al.ò shpk si rezultat e kërkesave të sforcuara nga AK.

**B.3.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, AK ka zgjedhur alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar për marrjen e ofertave këta OE;

1. **"A." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 42,700,000 lekë pa TVSH
2. **"D. N." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 50,300,000 lekë pa TVSH
3. **"E." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 44,500,000 lekë pa TVSH

Për këtë arsye AK vendosi që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: **45,833,333** lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i ofertave në QKB, u konstatua se:

***1.*** Operatori ekonomik ñA.ò SHPK, me Nipt K.., ka në objektin e aktivitetit të tij, *ofrimi i sherbimeve, ne telefonine rurale fikse, punime e montintime në impiantet e prodhimit dhe të shperndarjes së energjise, punime sherbimi në siperfaqen e gjelberimit, parqe, pyje, pastrim siperfaqe urbane, ndriçim, sinjalizim urban…dhe nuk ka në objekt në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, me administrator është D. D.*.

***2.*** Operatori Ekonomik ñE.ò sh.p.k, me Nipt K..., ka në objekt aktivitetin e tij, *tregtim të artikujve industrial,ushqimor, të konsumit të gjerë, materiale të ndryshme ndërtimi, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, elektroshtepiake, dhe elektronike, materiale plastike, fibra… me administrator është D. D.*.

***3.*** Operatori Ekonomik ñD.ò sh.p.k, me Nipt, L..., ka në objekt aktivitetin e tij, *Projektim, instalim i sistemeve, rrjeteve e pajisjeve fundore të telekomunikacionit, programimi e instalimi sistemeve te radiokomunikacionit, ndërtime rrugore të kategorisë I, II, II, IV, V, ndërtime hekurudhore, detare, portuale…. me administrator E. K.*

Si rezultat, përllogaritja e fondi limit nuk është e bazuar pasi ofertuesit ñA.ò shpk dhe ñE.ò shpk, janë me të njëjtin administrator D. D., ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit dhe të tre OE **nuk kanë për objekt** ushtrimin e veprimtarisë që prokurohet dhe faktet e mësipërme, e bëjnë proçedurën e përllogaritjes së fondit limit, të pavlefshme, pasi nuk është aspak e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, ku cilësohet se:

*"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*ò, ndërkohë në bazë testimit të tregut kryer nga AK, asnjë prej Operatorëve Ekonomik nuk ka për objekt ushtrimin e aktivitetit që prokurohet. Për rrjedhojë, nga AK është nxjerrë një përllogaritje jo reale e vlerës për kryerjen e këtij shërbimi.

**B.4.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 04.11.2019, ora 10:00 është paraqitur oferta e parë: Operatori Ekonomik ñC. & M. Al.ò shpk me çmimin e ofertës:

- **44,920,000 lekë pa tvsh.**

**B.5.1** Për këtë proçedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 12.11.2019, me nr. 2185/3 prot., ka identifikuar ofertën e mësipërme, si ofertën ekonomike më të suksesshme dhe ka lidhur kontratën nr. 2185/4 prot., datë 13.11.2019, me OE ñC. & M. Al.ò shpk në vlerën **44,920,000** pa tvsh.
Konstatohet se oferta fituese është konkurenti i vetëm, e zgjedhur me vetëm një garues, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik, duke e konsideruar si një proçedurë të ekspozuar dhe me rrisk.
Në këto kushte, AK, nuk ka arritur qëllimin e këtij ligji, nuk ka rritur efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e PP, të kryera nga autoritetet kontraktore, nuk ka siguruar mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

**B.6.1** Sipas kontratës noteriale nr. 2185/4 prot., datë 13.11.2019, porositësi kërkon realizimin e trajnimit KTA, në përputhje të plotë me specifikimet teknike, përcaktimet e parashikuara në dokumentat e tenderit dhe pagesa do të kryhet në adresën bankare Banka C., me nr. llogarie 00000155072 dhe IBAN AL 022121115700000000000155072.
Më datë 13.11.2019 është administruar formulari për sigurimin e kontratës, nga shoqëria óI.ô, me nr. serial 0019891.
Sipas kontratës së lidhur, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4, është parashikuar se sipërmarrësi, pra (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej 30% të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të DST, nuk cilësohet se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 9643 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë 20.11.2006, sipas së cilës përcaktohet: ò*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”*. Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.
Në opinionin e grupit të auditimit, kjo pagesë paradhënie në masën **30 %**, nuk është e parashikuar sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër zhvillimit e trajnimit deri në përfundimin e ekzekutimit të kontratës, që përkon me mbarimin e trajnimit. Rrjedhimisht, me kryerjen e trajnimit, autoriteti kontraktor paguan shumën përkatëse sipas kontratës së nënshkruar.
Si përfundim, konstatohen të administruara certifikatat e studentëve pjesmarrës në trajnim.

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Parregullësi në argumentimin e kritereve specifike në procedurën e prokurimit publik me objekt Trajnim KTA të rinj Rating ACS/TWR dhe gjuhën angleze. |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i procedurës me objekt Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën angleze me REF-38124-10-03-2019, mbi specifikimet e përshkruara nga AK, në asnjë rast nuk ka argumentuar përse janë përshkruar këto kërkesa, cili është qëllimi i tyre, përse shërbejnë dhe në kuptim të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, këto të dhëna janë të paargumentuara. Në kuptim të nenit 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô i |

| | |
|---|---|
| | ndryshuar, sanksionohet: **Hartimi dhe publikimi i dokumentave të tenderit.** *Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit. Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.* ***Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*** *Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.* |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.<br>VKM nr. 914., datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô |
| **Ndikimi/efekti:** | Mos argumentim jo i saktë i kritereve në DST, mbi çertifikatat ISO. |
| **Shkaku:** | Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të PP. Personat përgjegjës, njësia e Prokurimit: A.M., S.P. dhe E.LL.<br>E mesme |
| **Rëndësia:**<br>**Rekomandimi:** | Nga titullari i shoqërisë të merren masa në ardhmen, që në Procedurat e Prokurimit Publik, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, për çdo kriter të kërkuar në DST, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një proçesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, me qëllim të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullësi në 5 raste në përllogaritjen e fondit limit. |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i procedurës me objekt Trajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën angleze me REF-38124-10-03-2019, përllogaritja e fondi limit nuk është aspak e bazuar pasi ofertuesit ñA.ò shpk dhe ñE.ò shpk, janë me të njëjtin administrator, ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit dhe të tre operatorët ekonomik nuk kanë për objekt ushtrimin e veprimtarisë që prokurohet dhe faktet e mësipërme, e bëjnë proçedurën e përllogaritjes së fondit limit të pavlefshme, pasi nuk është aspak e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.<br>Nga shqyrtimi i procedurës me objekt Trajnim refresh të emergjencave ATCO me REF-06695-02-06-2019, përllogaritja e fondi limit nuk është aspak e bazuar pasi ofertuesit ñQ-P.-I.ò sh.p.k dhe ñT.M.C. T. M. C. janë me të njëjtin administrator A. M., ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit dhe në arsyetimin e audituesit, dy OE me të njëjtin administrator (ortak) nuk japin kurrsesi 2 oferta të ndryshme ekonomike sepse janë në kushtet e konfliktit të interesit dhe përpos kësaj, 2 prej Operatorëve Ekonomik |

| | |
|---|---|
| | nuk kanë për objekt ushtrimin e veprimtarisë që prokurohet, nuk janë të liçensuar nga shteti për objektin e prokurimit dhe faktet e mësipërme, e bëjnë proçedurën të pavlefshme pasi nuk është aspak e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje të plotë kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar.<br>Nga shqyrtimi i procedurës me objekt "Shpenzime për kontrollin mjeksor" me REF-39921-10-17-2019, përllogaritja e fondi limit nuk është aspak e bazuar sepse përllogaritja e vlerës limit të objektit të prokurimit, dhe në hartimin e specifikimeve teknike, ***është përcaktuar formalisht pa pasur një çmim tavan për njësi dhe shërbim, përsa i përket numrit të përgjithshëm dhe kostos financiare për kategorinë e stafit/familjarëve të tyre***, jo në përputhje me kërkesat e nenit 59, pika 2, gërma c, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ôPër Prokurimin Publikô, i ndyshuar.<br>"*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*".<br>Mosidentifikimi dhe mospërcaktim i saktë i numrit të punonjësve të familjarëve përfitues të shërbimeve mjekësore dhe paqartësi në ofrimin e shërbimeve duke i numëruar si shërbime dhe jo si numër përfitues/shërbime, nga ana e Albcontrol SHA, nuk është bërë një analizë e kostos, për të krahasuar shpenzimet mjeksore për numrin e saktë të stafit dhe familjarëve që do përfitonin nga ky shërbim. Mos kryerja e kësaj analize, ka sjellë si rezultat shpenzime të panevojshme për buxhetin e Albcontrol SHA (e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë).<br>Mosvlerësim i duhur i procedurave të prokurimit me transparencë passjell një mospërcaktim të saktë të raportit përfitues/shërbim, në këtë mënyrë nuk argumentohet përdorimi i fondit limit për kryerjen e këtij shërbimi.<br>Nga shqyrtimi i proçedurave të prokurimit publik, me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indraôô me REF-07097-02-08-2019 dhe "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREXôô me REF-61369-02-24-2020 u konstatua se dy operatorët ekonomik kanë për objekt fushën e prokurimit, ndërsa operatori ekonomik ñT.M.C. (T. M. C.) sh.p.k, me Nipt ....., nuk ka për objekt fushën e prokurimit dhe si e tillë, përllogaritja e fondit limit, nuk është aspak e bazuar dhe autoriteti kontraktor ka nxjerrë një përllogaritje jo reale të vlerës për kryerjen e këtij shërbimi, jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, për Prokurimin Publik, i ndryshuar për të cilët kërkohet minimumi 3 operatorë ekonomik, për të marrë një mesatare mbi çmimet e tregut. |
| **Kriteri:** | Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër PP, i ndryshuarò.<br>VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ôPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô.<br>Përllogaritje jo reale e vlerës së fondit limit për kryerjen e këtij shërbimi. |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/efekti:**<br><br>**Shkaku:**<br><br>**Rëndësia:**<br>**Rekomandimi:** | Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të Prokurimit Publik. Njësia përgjegjëse: H.P., T.F., V. I.<br>E Lartë<br>Nga Titullari i shoqërisë të analizohen rastet dhe të merren masa që përllogaritja e fondit limit të bëhet në mënyrë të saktë, që në rast të zgjedhjes së alternativës me tre OE në përllogaritjen e fondit limit, duhen përzgjedhur ata operatorë ekonomik që kanë për objekt fushën e prokurimit dhe fenomene të ngjashme mos përsëritet në të ardhmen, në Proçedurat e Prokurimit Publik.<br>Për procedurën me objekt shërbime për kontrollin mjeksor, nga grupi i punës në përllogaritjen e fondit limit dhe grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, të përcaktojnë qartë shërbimet e planifikuara, shoqëruar me numrin e saktë të shërbimeve, duke argumentuar në mënyrë transparente dhe çmimin e shërbimeve që planifikohen të kryhen, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në grafikun e DST. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/68 prot., datë 14.12.2021.*

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikat 1,2,3,4,5 se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 2153/1, datë 27.09.2019, se konstatimi juaj është i pasaktë, si pasojë e referencës së gabuar të këtyre kërkesave si specifikime teknike që hartohen bazuar në nenin 23 të LPP (të cilat janë përcaktuar në shtojcën nr. 9 të DST)... Kërkesat teknike në fjalë, përshkruajnë standarte të cilësisë të cilat janë të gjitha ngushtësisht të lidhura me objektin e shërbimit që prokurohet dhe të mirënjohura ndërkombëtarisht në fushën e edukimit për trafikun ajror. Hartimi i tyre është i dokumentuar dhe i argumentuar teknikisht nëpërmjet procesverbaleve të mbajtura nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*

*3.Mbi hartimin e fondit limit, ju bëjmë me dije se... QKB ushtron funksionet e saj në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.31/2015 "Për QKB" dhe nuk ofron asnjë të dhënë për ofertat e testimit të tregut sipas konstatimit tuaj [...]dhe grupi i përllogaritjes së fondit i është referuar përcaktimit ligjor për fondin limit duke përzgjedhur një nga alternativat që përcakton neni 59, për sa kohë që nuk ndalohen të pranohen oferta nga shoqëri që kanë objekt të përgjithshëm dhe me mbulim të gjerë të aktivitetit të tyre, grupi i punës në përmbushje të detyrimit ligjor për testimin e tregut, sipas përcaktimeve të lartëpërmendura, ka përllogaritur këtë fond limit, bazuar në përgjigjet e ftesave të dërguara nga këto operatorë ekonomik.*

*4.Referuar konstatimit të pikës B.5.1 se kontrata jepet me çelësa në dorë ...është i pasaktë.*

*5. Referuar konstatimit tuaj në pikën B6.1, mbi pagesën paraprake në masën 30 % të vlerës së kontratës, sqarojmë se, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e prokurimit publik...ky është një nga detyrimet bazë të Kodit Civil të RSH....Theksojmë se paradhënia nuk është kriter kualifikimi gjatë vlerësimit të ofertave, e për pasojë nuk mund të jetë pjesë e DST-ve para shpalljes së fituesit.*

***<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.</u>***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Lidhur me pikën 1 ajo është trajtuar gjerësisht në pjesën e parë dhe nuk po trajtohet në vijim.*

*<u>Së pari</u>, lidhur me pikën 2 të observacionit të trajtuar nga ana juaj, specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë në pajtueshmëri me kërkesat funksionale, por llogjika jonë qëndron se për çdo çertifikatë ISO, duhen përshkruar qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke argumentuar qëllimin e çertifikatës, përse shërben, arsyeja dhe qëllimi që*

*kërkohen, që të dalë në pah jo vetëm qëllimi i çertifikatës, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale, referuar nenit 23, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. Pra, në kuptim të këtij neni, çdo kriter i vendosur, duhet argumentuar përse shërbejnë dhe cili është kuptim i tyre, duke bërë një përshkrim të shkurtër të çertifikatave përkatëse me qëllim që të shërbejë për njohjen e të gjithë operatorëve ekonomik që hyjnë në konkurim. Llogjika jonë ka të bëjë me faktin që Autoriteti Kontraktor, për çdo ISO të kërkuar, të përpilojë një dokument mbi argumentimin e kritereve, kjo për ti shërbyer operatorëve ekonomik për të kuptuar qëllimin dhe rëndësinë e tij, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Meqënëse argumentet dhe observimet janë të njëjta me ato të paraqitura në fazën e projekt raportit, mendimi i grupit të auditimit do të mbetet i pandryshuar dhe në proçedruat e ardhshme, ato sigurisht do të kryhen në përputhje me frymën e ligjit të ri të prokurimeve nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.*

*Së dyti, lidhur me pikën 3 mbi përllogaritjen e fondit limit, autoriteti kontraktor gëzon një nga metodat alternative të përzgjedhjes që i jep ligji, por llogjikisht duhet që Operatorët Ekonomik, të kenë lidhje me fushën e prokurimit, mbi objektin me të cilën zhvillohet procedura e prokurimit. Natyrisht që ligji nuk e specifikon këtë fakt, që mund të pranohen oferta nga shoqëri që kanë objekt të përgjithshëm dhe me mbulim të gjerë të aktivitetit të tyre, por praktikisht ato duhen të lidhen me fushën që ka të bëjë me objektin e prokurimit, mbi të cilën po kërkohen shërbime për atë fushë specifike, psh.* ***nuk mund të japin kurrsesi oferta ekonomike mbi trajnimin e gjuhës angleze****, ata operatorë ekonomik që tregtojnë artikuj industrial, ushqimor, materiale të ndryshme ndërtimi, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, elektroshtepiake, ashtu sikurse nuk mund të japin 2 oferta ekonomike të ndryshme dy shoqëri të ndryshme, me të njëjtin administrator. Këto fakte i bëjnë argumentet tuaj të pasakta dhe përderisa nuk shoqërohen me një dokumentacion justifikues që vërtet ata OE të përzgjedhur mund të kryejnë trajnime të gjuhës angleze, dhe rrjedhimisht nuk merren në konsideratë e do të trajtohen në projekt raportin e auditimit.*

*Së treti, lidhur me pikën 4, trajtuar në akt konstatimin tonë në pikat B.4.1 dhe B.5.1 sqarojmë se ky fakt është përshkruar si argument me qëllim rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik dhe merret pjesërisht në konsideratë.*

*Së katërti, lidhur me pikën 5, mbi paradhënien në vlerën 30 % apo 40 % , këto veprime bien ndesh me kriterin e vendosur në DST nga Autoriteti Kontraktor, kur ai kërkon që OE fitues, duhet të ketë bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Lidhur me këtë fakt, logjika jonë nuk ka të bëjë me vendosjen si kriter kualifikimi, por nuk duhet të praktikohet. Në këtë pikë argumenti i paraqitur nga ju, nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në projekt raportin e auditimit.*

**7.12.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"*Trajnim refresh të emergjencave ATCO*"** REF-06695-02-06-2019 me vlerë **66,666,666** (lekë pa tvsh).

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "Trajnim refresh të emergjencave ATCO'' REF-06695-02-06-2019''** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 351 datë 06.02.2019 | **3.Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>E. B.<br>E.N.<br>E.LL. |
| **2.Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñI hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>66,666,666 lekë tvsh | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>66,666,000 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh) 666 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9.Burimi Financimit** | 10. **Operatoret Ekonomike** |

| | | |
|---|---|---|
| 23.04.2019 | Vetfinancim nga Albcontrol sha | a)Pjesëmarrës në tender 2 |
| **11. Ankimime AK-**<br>Nr. 640 Prot., datë 06.03.2019 | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Nr.640/1 Prot, datë 07.03.2019 | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>13.03.2019 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>79,680,000 lekë | |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**B.1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura ñTrajnim refresh të emergjencave ATCOò, u inicua me kërkesën me nr. 137, datë 14.01.2019 nga Drejtore e Trajnimit të Liçensimit E.B.. Në këtë kërkesë nuk ka një analizë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.3.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, AK ka zgjedhur alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar për marrjen e ofertave këta Operator Ekonomik;

1. **"Q.-P.-I." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 63,000,000 lekë pa tvsh
2. **"E." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 70,600,000 lekë pa tvsh
3. **"T. M. C." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 66,400,000 lekë pa tvsh

Për këtë arsye AK vendosi që tëi propozojë Drejtorit të Përgjithshëm, që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: 66,666,666 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i ofertave në QKB, u konstatua se përllogaritja e fondi limit nuk është aspak e bazuar pasi ofertuesit ñ**Q.-P.-I." sh.p.k** dhe ñ**T.M.C. T. M. C."** janë me të njëjtin administrator **A. M.**, ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit dhe në arsyetimin e audituesit, dy OE me të njëjtin administrator (ortak) nuk japin kurrsesi 2 oferta të ndryshme ekonomike sepse janë në kushtet e konfliktit të interesit dhe përpos kësaj, 2 prej Operatorëve Ekonomik **nuk kanë për objekt** ushtrimin e veprimtarisë që prokurohet, nuk janë të liçensuar nga shteti për objektin e prokurimit dhe faktet e mësipërme, e bëjnë proçedurën të pavlefshme pasi nuk është aspak e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje të plotë kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, ku cilësohet se:

*"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*ò, ndërkohë në bazë testimit të tregut kryer nga AK, 2 prej OE nuk kanë për objekt ushtrimin e aktivitetit që prokurohet. Për rrjedhojë, nga AK ka nxjerrë një përllogaritje jo reale të vlerës për kryerjen e këtij shërbimi, sepse emrat e ofertuesëve që kanë dorëzuar ofertat janë të njëjtë dhe nuk kanë për objekt ushtrimin e aktivitetit, në fushën e prokurimit, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar dhe nenit 26 e 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar.

**B.4.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 04.03.2019, ora 11:00 janë paraqitur ofertat si më poshtë:

- Ofertuesi i parë: BOE ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò me çmimin e ofertës: **54,800,000** lekë pa TVSH.
- Ofertuesi i dytë: BOE ñC. & M. Al.ò shpk dhe ñE. P. N. ABò me çmimin e ofertës: **66, 666,000** lekë pa TVSH.

**B.5.1** Për këtë proçedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 13.03.2019, me nr. 351/4 prot. ka identifikuar ofertën e mësipërme, si ofertën ekonomike më të suksesshme dhe ka lidhur kontratën nr. 351/5 prot., datë 15.03.2019, me OE ñC. & M. Al.ò shpk në vlerën **66,666,000 pa TVSH.**

Konstatohet se BPOE ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò është skualifikuar nga KVO për arsye se nuk ka dorëzuar bilancet për vitin 2015, 2016, 2017 dhe në bilancet e dorëzuara nga kjo kompani ato nuk i përkasin kompanisë ñG. A.S. D. IVS, por i përkasin kompanisë ñG.A.T.S. L. në (E.W.) dhe KVO-ja shprehet se këto dy shoqëri nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën, ndërkohë OE pretendon se kjo është e njëjta kompani me 50% aksione në bashkëpronësi, duke dhënë edhe mundësi verifikimi për këtë rast, përshkruar në formularin e ankesës nr. 640 prot., datë 06.03.2019.

Lidhur me këtë rast, në opinonin e audituesit, në rast se KVO-ja do të kishte dyshime/pretendime për sqarime për dokumentacionin e dorëzuar nga OE, duhet të zbatonte nenin 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku është parashikuar: ñ*1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave" dhe pika "...4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

KVO-ja ka skualifikuar BOE sepse ka paraqitur një dokument që është nënshkruar nga Administrator i shoqërisë për vërtetimin e xhiros, ndërkohë që duhej të dorëzonte vërtetim nga organi i Administratës Tatimore dhe jo një deklarim të një nëpunësi të vetë operatorit. Referuar Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE), rezulton se BPOE, ka dorëzuar formularin e xhiros vjetore të 3 viteve të fundit, në përputhje me *nenin 46, pika 1, gërma "c", Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar*, ku është parashikuar: ñ**Kualifikimi i ofertuesve"** [...] 1. *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.*

Ndërkohë KVO-ja ka skualifikuar OE në lidhje me këtë kriter, sepse pretendohej që të dorëzohej një vërtetim nga organi i Administratës Tatimore. Rezulton se vërtetimi është dorëzuar nga BPOE ñA. C.ò, me vulë elektronike, datë 22.02.2019, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANË

Nr. T00875087 Date, 22.02.2019

VËRTETIM
(Për pagim Detyrimesh)

Vërtetojmë se:
Z./Zoj. Valentina Taipi
Tatimpaguesi: AIR COMMUNICATION
NIPT-i: L32409043I
Aktiviteti: Shërbime të tjera si teknologjisë së informacionit
Adresa: Njësia Nr. 2, Rruga Xhorxhi Martini, Vila Nr. 16, Kati perdhe, Apartamenti 2 , Tiranë, Tiranë

Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor te papaguar deri me datën: 22.02.2019 ora 10:44:11

Ky vërtetim jepet për Tender.

Drejtuesi i Shërbimit të Tatimpaguesve



Global ATS
Petersdalsvej 1 A, 3. Sal
2770 Kastrup

To Whom it May Concern — Date 04.03.2019

**Turnover Declaration**

We Global ATS Denmark IVS with Business Register No. 39090562, hereby declare that its net turnover for fiscal year 2016 (Global ATS Ltd), 2017 (Global ATS Ltd) and 2018 was as following.

- 2016 in the amount of Euros 1,813,814 €
- 2017 in the amount of Euros 3,407,153 €
- 2018 in the amount of Euros 469,296 €

Yours Sincerely,

Dirch Jans

Position: Co-Funder

Adresa — LOGO

Per te interesuarit — Date 04.03.2019

Deklarate per shiron vjetore

Ne Global ATS Denmark IVS me numer identifikimi 39090562 ketu deklarojme se shiroja jone vjetore per vitin fiskal 2016 (Global ATS Ltd), 2017 (Global ATS Ltd), 2018 ishte sic vijon

- 2016 shuma ne Euro 1,813,814 €
- 2017 shuma ne Euro 3,407,153 €
- 2018 shuma ne Euro 469,296 €

Sinqerisht jaqi,

(Firma)

Dirch Jans

Bashkë - Themelues

**Perkthim dokumentacioni ne Gjuhen Shqipe.**

PËRKTHYESE ZYRTARE
JONIDA TATAZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 308 REP.

**VËRTETIM**

Vërtetohet firma e përkthyeses Jonida Llazo TATAZI, e njohur nga Ministria e Drejtësisë, identifikuar me Leshtojëllimin Numër Personal ID I951210170, banuese në Tiranë, e njohur personalisht prej meje, e cila përkthen në Shqip dokumentin e mësipërm dhe e nënshkroi para meje dhe unë Noteri e vërtetoj këtë akt sipas ligjit.

Tirane, me 21.03.2019

NOTER PUBLIK
Alket H. SKENDAJ

Si përfundim, arrijmë në konkluzionin se: nëse AK, do tu kërkonte sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, atëherë KVO-ja mund të arrinte të kualifikonte ofertën me çmimin më të ulët, duke kursyer shumën prej **11.886.600 lekë** që është më e ulët sesa oferta fituese, në përputhje me kërkesat e **nenit 53**, pika **1** dhe **4** të ligjit **nr. 9643**, **datë 20.11.2006**, ñ**Për Prokurimin Publik**ò, i ndryshuar, që në thelb është edhe qëllim i këtij ligji.

**B.6.1** Për këtë proçedurë prokurimi, Albcontrol SHA, ka lidhur kontratën nr.351/5 prot, datë 15.03.2019, me BPOE ñCo. & M.Al. E.P.N. Alò .

Më datë 13.03.2019 është administruar formulari i sigurimit të kontratës, nga shoqëria ñI.ò, me nr. serial 0019061.

Sipas kontratës së lidhur, njëlloj si në proçedurën e mësipërme, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të DST, nuk cilësohet se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku përcaktohet: *Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese*. Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Në opinionin e grupit të auditimit, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar sipas kërkesave të LPP, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e FL që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër zhvillimit e trajnimit deri në ekzekutimin e kontratës, që përkon me mbarimin e trajnimit. Rrjedhimisht, me kryerjen e trajnimit, autoriteti kontraktor paguan shumën përkatëse sipas kontratës së nënshkruar.

Në përfundim, konstatohet se janë të administruara çertifikatat e studentëve pjesmarrës në trajnim.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në shqyrtimin e ofertave në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Trajnim refresh të emergjencave ATCO". |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i procedurës me objekt Trajnim refresh të emergjencave ATCO me REF-06695-02-06-2019, KVO ka skualifikuar BPOE ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò, për arsye se nuk ka dorëzuar bilancet për vitin 2015, 2016, 2017 dhe në |

| | |
|---|---|
| | bilancet e dorëzuara nga kjo kompani ato nuk i përkasin kompanisë ñG. AS D. IVS, por i përkasin kompanisë ñG. ATS L.ò, në (E.W.) dhe KVO-ja shprehet se këto dy shoqëri nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën. Në dokumentat e paraqitura nga OE shprehet se kjo shoqëri ka disa nën degë të saj, ndërkohë nga ana tjetër ka kualifikuar BPOE ñCo. & M.Al. E.P.N. Alñ, si një akademi ndërkombëtare e cila pretendon se ka disa nën degë të saj me qendër në disa shtete Europiane, si S., etj dhe ka dhënë opsione akomodimi, ofrimin e trajnimit me qendër në S., ndërkohë të gjitha dokumentat e paraqitura nga OE, ñMbi rregullat e liçensimit të kontrollorëve të trafikut ajror si dhe rregullat për çertifikim konform kërkesave sipas DST, janë ato të paraqitura, nga shoqëria ñE.P.N. AB, M. S.ò.<br>Lidhur me këtë rast, nëse KVO-ja do të kishte dyshime/pretendime për sqarime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga OE, duhet të respektonte nenin 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ku në këtë pikë është parashikuar shqyrtim i ofertave: ñ*1.Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave" dhe pika "...4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj*ñ.<br>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. VKM 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô. |
| **Kriteri:** | Shqyrtim jo i drejtë në paraqitjen e dokumentacionit të një prej operatorëve ekonomik.<br>Mosrespektimi i duhur i LPP. Njësia përgjegjëse ï KVO me përbërje: E. B., E.N. dhe E.LL. |
| **Ndikimi/efekti:** | E Lartë |
| **Shkaku:** | Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për skualifikimin e ofertës ekonomike për të cilën nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik konkurrues, BPOE ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D. IVSò, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **66,666,666 lekë pa tvsh**. |
| **Rëndësia:** | |
| **Rekomandimi:** | Të konsiderojë faktin se shqyrtimi i ofertave, duhet të udhëhiqet në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, duke respektuar kërkesat e nenit 2, dhe nenit nenit 53, pika 1 dhe 4 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.<br>Në procedurat e ardhshme, në rast se do të ketë pretendime apo sqarime mbi ofertat e paraqitura apo dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik konkurrues, nëse ekzistojnë të tilla, nga KVO-ja të kërkohen sqarime shtesë për të bërë një krahasim sa më të drejtë të tyre në fazën e shqyrtimit të ofertave dhe ti kthehet një |

| | |
|---|---|
| | përgjigje operatorit ekonomik të skualifikuar duke argumentuar arsyet e skualifikimit të tij. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/68 prot., datë 14.12.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikën [...],2 mbi hartimin e fondit limit, ju bëjmë me dije se... Qendra Kombëtare e Biznesit ushtron funksionet e saj në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.31/2015 "Për QKB" dhe nuk ofron asnjë të dhënë për ofertat e testimit të tregut sipas konstatimit tuaj [...]dhe grupi i përllogaritjes së fondit i është referuar përcaktimit ligjor për fondin limit duke përzgjedhur një nga alternativat që përcakton neni 59, për sa kohë që nuk ndalohen të pranohen oferta nga shoqëri që kanë objekt të përgjithshëm dhe me mbulim të gjerë të aktivitetit të tyre, grupi i punës në përmbushje të detyrimit ligjor për testimin e tregut, sipas përcaktimmeve të lartëpërmendura, ka përllogaritur këtë fond limit, bazuar në përgjigjet e ftesave të dërguara nga këto operatorë ekonomik.*

*3.Referuar konstatimit në pikën B.5.1 po ju sqarojmë si më poshtë;*

*Së pari, mungesa e bilanceve të paraqitura që janë kërkuar në mënyrë të shprehur si dokumenta për kualifikim, nuk mund të konsiderohen si paqartësi apo devijim i vogël në kuptim të nenit 53 pika 1, dhe 4 të LPP, e në kuptim të nenit 53, pika 1 dhe 3 të LPP, kur operatori ka dështuar të përmbushë një nga dokumentat e tenderit ''.... Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën oferën e operatorit ekonomik të pavlefshme...''pra, jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 dhe 3 të LPP. Në këtë rast kemi dy shoqëri të ndryshme të cilat përbëjnë entitete juridike të veçanta dhe e vetmja lidhje midis këtyre dy shoqërive është fakti që "G. A.T.S. L.'' ka investuar kapital te shoqëria "G. A.T.S. D. IVS", por ky fakt nuk i bën këto Shoqëri të njëjta.*

***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Lidhur me pikën 1 ajo është trajtuar gjerësisht në pjesën e parë dhe nuk po trajtohet në vijim.*

*Së pari, lidhur me pikën 2 mbi përllogaritjen e fondit limit, ajo është trajtuar hollësisht në titullin e gjetjes më sipër dhe për rrjedhojë ajo nuk merret në konsideratë.*

*Së dyti, referuar observacionit tuaj në pikën 3, lidhur me pikën B.5.1 të akt konstatimit tonë, argumenti i paraqitur prej jush në këtë pikë rezulton i drejtë kur argumentohet se ''.... Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme...'' '' e cila nuk mund të ndryshohet me sqarime apo me konsiderimin si devijim, pasi në këtë rast do të kishim të bënim me kthimin e një oferte nga e pavlefshme në të vlefshme, gjë që është e ndaluar nga neni 53, pika 1 e LPP.*

*Në fakt, argumenti i paraqitur prej nesh në akt konstatimin, nuk ka të bëjë me kualifikimin e operatorit ekonomik (për këtë pjesë jemi në një mendim me tuajin), por autoriteti kontraktor e konkretisht (KVO-ja), nuk ka respektuar plotësisht nenin 53, pika 1, të LPP, lidhur mbi sqarimet shtesë në dokumentat e paraqitura të Air Communication, e cila pretendon se "**G. A.S. D. IVS"** dhe **"G. A.T.S. L.", në (E. W.)** është e njëjta kompani me **50%** aksione në bashkëpronësi, **duke dhënë edhe mundësi verifikimi për këtë rast**, përshkruar në formularin e ankesës nr. 640 prot., datë 06.03.2019. Ndërkohë, KVO-ja nuk ka kryer asnjë verifikim mbi dokumentimin e rastit, nëse fakti mbi 50 % të aksioneve rezulton i vërtetë apo i gabuar, i cili duhej të ishte i dokumentuar me një proçesverbal dhe administruar në praktikën e tenderit. Në këtë kuptim, KVO-ja ka vepruar me dy standarde dhe jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 53, pika 1, të LPP. Observimi i paraqitur prej jush është i ngjashëm me observimet e mëparshme dhe kjo gjë është trajtuar gjerësisht në Projekt Raport. Llogjika jonë ka të bëjë me faktin se pretendimet e operatorit të skualifikuar nuk janë marrë tërësisht në konsideratë nga KVO-ja, duke mos i dhënë atij një mundësi verifikimi dhe duke mos e dokumentuar me*

*një procesverbal shtesë pretendimet e tij, me qëllim të qartësohej subjekti i skualifikuar. Për pasojë mendimi i grupit të auditimit mbetet i pandryshuar..*

**7.13.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"*Shpenzime për kontrollin mjeksor*"** REF-39921-10-17-2019 me vlerë 41,000,000 (dyzetë e një milion) lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "Shpenzime për kontrollin mjeksor'' REF-39921-10-17-2019** | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 2278 datë 17.10.2019 | **3.Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>J.B.<br>E.N.<br>E. Ll. |
| **2.Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>41,000,000 lekë pa tvsh | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>41,000,000 lekë pa tvsh | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>0 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim ngaAlbcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-** | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sôka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës** | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>41,000,000 | 0,00% TVSH |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**B. 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: Shpenzime për kontrollin mjeksor, është iniciuar nga Drejtore e Divizionit Administrativ J.B., por në këtë kërkesë nuk ka një analizë ose një studim të nevojës së fizibilitetit për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi, jo në përputhje me kriteret e nenit 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Përsa i përket specifikimeve teknike, OE duhet të mbulojë me shërbim, të gjithë punonjësit ekzistues/familjarët e tyre si dhe të gjithë punonjësit e rinj/familjarët e tyre, prej datës së fillimit të punës në varësi të njoftimit të dhënë kontraktorit nga Albcontrol SHA brenda 10 ditësh nga fundi i muajit që fillon punësimi (brenda numrit 332 të punonjësve mbështetur në strukturën e miratuar). Mbulimi me shërbim përfundon në datën e përfundimit të afatit të ekzekutimit të kontratës ose punësimit. Në shërbimet e kontrollit mjekësor për stafin përfshihen paketat: Check-up femra; Check-up meshkuj.

**B.2.2** Referuar shtojsës 8, pika 3.3.7 të kapacitetit teknik, NjP ka vendosur të modifikojë: *se numri 332 është për punonjësit e Albcontrol SHA sipas strukturës së miratuar, ndërsa familjarët që përfitojnë shërbimin janë sipas gjendjes civile të punonjësve.*

Në arsyetimin e grupit të auditimit, konstatohet se AK nuk ka kryer një analizë, **si dhe nuk përcakton** në mënyrë transparente dhe të qartë çmimet për njësi kundrejt shërbimeve që do të përfitojnë stafi/familjarët e Albcontrol SHA, **numrin e familjarëve** dhe mënyrën si do të proçedohet në lidhje me shërbimet kundrejt tyre dhe **çmimin për njësi, si për stafin ashtu edhe për familjarët**, në mënyrë që më pas të nxirrej një vlere e saktë e fondit limit që prokurohet.

**B.3.1** Nga auditimi është konstatuar se për llogaritjen e fondit limit, grupi i punës ka zgjedhur alternativën mbi çmimet e botuara në INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, por në procesverbalin nr. 2212/4, datë 15.10.2019 nga grupi i punës thuhet: Nga informacioni konstatuam se në bazë të specifikimeve teknike të hartuara nga struktura e specializuar, nuk kishte çmime të publikuara nga INSTAT, *ndërkohë nga*

*grupi i punës nuk ka asnjë dokumentacion justifikues vërtetues mbi dokumentimin e këtij rasti*.
Në vijim, AK ka zgjedhur alternativën tjetër, me çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vet apo nga autoritetet e tjera kontraktore dhe nga informacioni konstatuan se shoqëria kishte kontratë të ngjashme të mbyllur, në datë 18.12.2017 dhe ka propozuar që vlera limit për prokurimin: ñShpenzime për kontrollin mjekesorò të jetë **41,000,000 lekë pa tvsh**.
Në arsyetimin e audituesit, konstatohet se përllogaritja e vlerës limit të objektit të prokurimit, ***<u>është përcaktuar formalisht pa pasur një çmim tavan për njësi dhe shërbim, përsa i përket numrit të përgjithshëm dhe kostos financiare për kategorinë e stafit/familjarëve të tyre.</u>***
**B.4.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 18.11.2019, ora 10:00 është paraqitur oferta e parë:
<u>Operatori Ekonomik ñA. H.ò sha me çmimin e ofertës:</u>

- ✓ **41,000,000 lekë pa tvsh**.

Për këtë proçedure prokurimi, Albcontrol SHA, me formularin nr. 2278/3, datë 26.11.2019, ka identifikuar ofertën e mësipërme, si ofertën ekonomike më të suksesshme në vlerën 41,000,000 lekë pa tvsh.
Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë, pa çmim për njësi/staf, pa çmim për njësi/familjar dhe pa çmim për shërbim/total, me ofertë fituese me një konkurent të vetëm, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.
Në konkluzion, arsyetojmë se Autoriteti Kontraktor, nuk ka arritur qëllimin e këtij ligji, nuk ka rritur efiçencën dhe efikasitetin në proçedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, nuk ka siguruar mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në proçedurat e prokurimit publik, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, këto si rezultat i kërkesave të sforcuara të specifikimeve teknike, jo në përputhje me kërkesat e nenit 1 dhe 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar.
Është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: 89055944, datë 10.12.2019.
Në vijim, është nënshkruar kontrata nr. 2278/4, datë 24.12.2019. Sipas kësaj kontrate, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të DST, nuk parashikohet në asnjë rast se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku është e parashikuar: ñ*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese"*. <u>Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore</u>.
Në opinionin e grupit të auditimit, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri në ekzekutimin e kontratës, që përkon kryerjen e shërbimeve mjeksore.
Grupi i punës ka hartuar informacionin për shërbimet e kryera për periudhën e zbatimit të kontratës, shoqëruar me faturat për përfundimiin e zbatimit të kontratës, me nr. 284255132, datë 31.12.2019 me vlerë 12,300,000 lekë, nr. 284283978, datë 23.01.2020 me vlerë

16,400,000 lekë, nr. 356024235, datë 23.12.2020 me vlerë 12,300,000 lekë, në total për realizimin financiar prej 41,000,000 lekë.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/41 prot., datë 07.10.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikën 2 mbi kriteret e kërkuara, AK nuk ka kryer një analizë, si dhe përcakton në mënyrë transparente dhe të qartë çmimet për njësi kundrejt shërbimeve dhe shërbimeve që do të përfitojnë stafi-familjarët dhe numrin e familjarëve.... pamundësia e përcaktimit të çmimit për njësi/staf dhe njësi familjar vjen për arsye të pamundësisë për të parashikuar gjendjen shëndetësore të punonjësit apo familjarit dhe si rrjedhim për ta përllogaritur dhe kategorizuar si ''çmim për njësi'... Dëshirojmë edhe një herë t'ju sjellim në vëmendje, në vijim dhe të observacionit të dorëzuar më parë për këtë objekt nga grupi i punës, vështirësinë në procesin e përcaktimit të numrit të saktë të shërbimeve të planifikuara, që vjen si rezultat i pamundësisë për të parashikuar gjendjen shëndetësore të punonjësit apo familjarit dhe si rrjedhim për ta përllogaritur dhe kategorizuar si ''çmim për njësi''. Fakti është e pamundur që të përcaktosh që në fillim numrin e familjarëve për sa kohë që numri i stafit është i ndryshueshëm për periudhën që shtrihet kontrakta për shkak të qarkullimit të stafit (emërime, lirime, dalje në pension) përgjatë vitit kalendarik. Sa më sipër, për shkak të dinamikës së procesit është praktikisht e pamundur për të përcaktuar numër final punonjësish dhe rrjedhimisht edhe familjarësh, si dhe shërbimesh, në specifikimet teknike.*

*Lidhur me pikën 3, mbi llogaritjen e fondit limit, kur shprehet se nuk kishte çmime të publikuara nga INSTAT...kjo gjë është e asksesueshme nga çdo person në faqen zyrtare.*

*Lidhur me me pikën 4, trajtuar në aktin e konstatimit në pikën B.4.1, se kontrata jepet me çelësa në dorë.... objekti i prokurimit në konstatimin tuaj është i pasaktë pasi është e ndryshme në formë dhe përmbajtje nga kontrata me çelësa në dorë që ju referoni.*

*4. Referuar konstatimit tuaj në pikën B.6.1, mbi pagesën paraprake në masën 30 % të vlerës së kontratës, gjë e cila nuk është përcaktuar në DST dhe bie në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.... paradhënia është një praktikë tregtare dhe kusht i zakonshëm kontraktual, i parashikuar njo vetëm në DST, por edhe në Kodin Civil. Bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 ''Për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar, si dhe në të gjitha udhëzimet e publikuara nga APP, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e PP.*

*Sqarojmë se, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e prokurimit publik...ky është një nga detyrimet bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë....Theksojmë se paradhënia nuk është kriter kualifikimi gjatë vlerësimit të ofertave, e për pasojë nuk mund të jetë pjesë e DST-ve para shpalljes së fituesit.*

***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Lidhur me pikën 1 ajo është trajtuar gjerësisht në pjesën e parë dhe nuk po trajtohet në vijim.*

*Lidhur me pikat 2 dhe 3 mbi kriteret e kërkuara dhe përllogaritjen e fondit limit, grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, duhet të përcaktojë qartë shërbimet e planifikuara, shoqëruar me numrin e saktë të shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve që planifikohen të kryhen sepse realisht ky shërbim është kryer çdo vit dhe autoriteti kontraktor është në djeni mbi luhatjen e një çmimi tavan, në lidhje me totalin e shërbimeve dhe mbi bazën e kësaj do të përllogaritej edhe fondi limit. Pra, në këtë pikë, jemi në kushtet pa çmim për njësi/staf, pa çmim për njësi/familjar dhe pa çmim për shërbim/total. Lidhur me observimin e ardhur, referuar pikës 10.2 argumentimi jonë ka të bëjë me faktin, që çmimi i shërbimeve të kryera të*

*llogaritet në bazë të numrit faktit të punonjësve dhe familjarëve të tyre, në kohën që do të iniciohet procedura e prokurimit publik për kontrollin mjeksor. Psh (332 që supozohet numri i punonjësve të punësuar në Albcontrol + familjarë e tyre, del qartë një shifër faktike).*
*Lidhur me dokumentimin e rastit, kur flitet mbi çmimet e publikuara në INSTAT, e rëndësishme është që ky fakt të dokumentohet me një proçesverbal ose mos përmendet në proçedurat e ardhshme, pavarësisht zgjedhjes së alternativave që të jep LPP. Pra, në këtë pikë observacioni juaj, mendimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë si në fazën e Projektit të Raportit të Auditimit.*
*Përsa i përket pikës 4 të observacionit, kuptimi i saj ka të bëjë me nxitjen e konkurencës, rritjen e efiçencës dhe efikasitetin në proçedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, gjë e cila nuk është kryer nga autoriteti kontraktor në çdo proçedurë, vit pas viti, mbi objektin e këtij prokurimi.*
*Në lidhje me pagesën paraprake lidhur me pikën 5, mbi paradhënien në vlerën 30 %, këto veprime bien ndesh me kriterin e vendosur në DST nga Autoriteti Kontraktor, kur ai kërkon që OE fitues, duhet të ketë bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Lidhur me këtë fakt, logjika jonë nuk ka të bëjë me vendosjen si kriter kualifikimi, por nuk duhet të praktikohet sepse në rast të një falimenti të mundshëm ose për arsye objektive, këto shërbime mund të ndodhi që mos të kryhen, atëherë shuma prej 30 % e paguar, e vlerës së kontratës, do të përbënte një dëm të konsiderueshëm të shoqërisë. Në këtë pikë argumenti i paraqitur nga ju, nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në projekt raportin e auditimit.*

**7.14.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"*Blerje pajisje elektronike*"** REF-35828-09-13-2019 me vlerë **12,498,372** lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pajisje elektronike"** REF-35828-09-13-2019 | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 2046 datë 13.09.2019 | **3.Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>M. E.<br>E. N.<br>E.LL. |
| **2.Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>12,498,372 lekë | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>12,498,372 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>0 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim nga Albcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-** | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sõka | |
| **13.Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 2046/4, datë 28.10.2019 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>14,952,448 lekë | |

**B. Mbi realizimin proçedurës së prokurimit**

**B. 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: Blerje pajisje elektronike, është iniciuar nga Drejtori i Divizionit Teknik M. E., por në këtë kërkesë nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin dhe nevojën e kërkesat e kompanisë për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Përsa i përket specifikimeve teknike, grupi i auditimit konstaton se në pikën 2. autoriteti kontraktor dhe konkretisht grupi për hartimin e specifikimeve teknike ka kërkuar blerjen e programit **Adobe Profesional x 64 bit.**

Në gjykimin e audituesit, vendosja e programit Adobe Profesional x 64 bit, është emër i prodhuesit dhe në këtë kuptim, nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike, nuk duhet të

kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër të veçantë, veprime jo në përputhje të plotë me kërkesat e **nenit 23, pika 5, të ligjit 9643**, **datë 20.11.2006, i ndryshuar**.
*Neni **23** mbi "**Specifikimet teknike**", **pika 5, të ligjit nr. 9643** të PP, përcakohet se:*
[...] *5. "Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."* [...].
**B.2.2** Përsa i përket kapacitetit teknik në pikën **2.3** të **DST**, ku kërkohet që operatori ekonomik duhet të jetë në zotërim të çertifikatës **ISO 18001:2007** mbi **''Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë''** Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit [...].
Në gjykimin e audituesit, vendosja e këtij kriteri është i tepër dhe në këtë mënyrë, këto janë kërkesa të sforcuara duke kufizuar konkurencën dhe duke mos mundësuar trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe në thelb ato kanë shërbyer si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, jo në përputhje të plotë me kërkesat e **nenit 23, pika 4, të ligjit 9643**, **datë 20.11.2006, i ndryshuar**.
*Neni **23** mbi "**Specifikimet teknike**", **pika 4, të ligjit nr. 9643** të PP, përcakohet se:*
[...] *4," Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale*.ò [...].

**B.2.3** Referuar specifikimeve teknike, në pikën **6**, të **DST**, ku kërkohet që ***OE duhet të ketë 2 teknike të çertifikuar nga prodhuesi për fotokopje dhe printera***.
Në arsyetimin e audituesit, vendosja e një kriteri të tillë është i tepërt sepse blerja e printerave dhe fotokopjes është një produkt i ri dhe vendosja e kriterit për 2 teknik konsiderohet si i tepërt dhe i panevojshëm dhe në këtë kuptim, autoriteti kontraktor ka kufizuar konkurencën duke mos mundësuar një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët.
**B.3.1** Përsa i përket përllogaritjes së fondit limit, grupi i punës ka kontaktuar me 3 operatorë ekonomik për marrjen e ofertave, duke zgjedhur alternativën nga çmimet e tregut.
**B.4.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 14.10.2019, ora 11:00 është paraqitur oferta e parë:
Operatori Ekonomik ñ**S. CO"sh.p.k** me çmimin e ofertës:

- ✓ **12,460,374** lekë pa tvsh.

Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, me formularin nr. 2046/3, datë 22.10.2019, ka identifikuar ofertën e mësipërme, si ofertën ekonomike më të suksesshme.
Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë me ofertë fituese me një konkurent të vetëm, pa pjesëmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.
Në konkluzion, në arsyetimin e audituesit AK, nuk ka arritur qëllimin e këtij ligji, nuk ka rritur efiçencën dhe efikasitetin në proçedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, dhe të ulë shpenzimet proçedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në proçedurat e prokurimit publik, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, këto si rezultat i kërkesave të sforcuara të specifikimeve teknike, jo në përputhje me nenin 1 dhe 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.
Është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: 89055042, datë 28.10.2019, nga shoqëria ñA.ò.
Sipas kontratës nr. 2046/4 prot, datë 28.10.2019, bashkëlidhur saj gjenden dhe specifikimet teknike të dorëzurara nga ofertuesi, nënshkruar nga grupi i punës.

Me procesverbalin e datës 18.11.2019 grupi i punës ka pranuar marrjen në dorëzim të mallit, konform specifikimeve teknike, referuar kontratës noteriale nr. 2046/4 prot, datë 28.10.2019.

| | |
|---|---|
| ►**<u>Titulli i Gjetjes</u>:** | Parregullsi në hartimin e specifikimeve teknike në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Blerje pajisje elektronike". |
| **Situata:**<br><br>**Kriteri:** | Nga shqyrtimi i procedurës me objekt "Blerje pajisje elektronike" me REF-35828-09-13-2019, në DST, në pikën 2. grupi për hartimin e specifikimeve teknike ka kërkuar blerjen e programit Adobe Profesional x 64 bit. Në gjykimin e audituesit, vendosja e programit Adobe Profesional x 64 bit, është emër i prodhuesit dhe në këtë kuptim, nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike, nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër të veçantë, veprime jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 23, pika 5, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.<br>*Neni 23 mbi "Specifikimet teknike", pika 5, të ligjit nr. 9643 të PP, përcakohet se:*<br>[...] *5. "Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."* [...].<br>Përsa i përket kapacitetit teknik në pikën 2.3 të DST, kërkohet që OE duhet të jetë në zotërim të çertifikatës ISO 18001:2007 mbi ñSistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punëò. Në gjykimin e audituesit, vendosja e këtij kriteri është i tepër dhe në këtë mënyrë, këto janë kërkesa të sforcuara duke kufizuar konkurencën dhe duke mos mundësuar trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe në thelb ato kanë shërbyer si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 23, pika 4, të ligjit 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.<br>*Neni 23 mbi "Specifikimet teknike", pika 4, të ligjit nr. 9643 të PP, përcakohet se:*<br>[...] *4," Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale.*ò [...].<br>Referuar specifikimeve teknike, në pikën 6, të DST, kërkohet që *OE duhet të ketë 2 teknike të çertifikuar nga prodhuesi për fotokopje dhe printera*. Në këtë kuptim, në arsyetimin e audituesit, vendosja e një kriteri të tillë është i tepërt sepse blerja e printerave dhe fotokopjes është një produkt i ri dhe vendosja e kriterit për 2 teknik konsiderohet i tepërt dhe i panevojshëm dhe në këtë kuptim, autoriteti kontraktor ka kufizuar konkurencën duke mos mundësuar një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët.<br>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar.<br>Kritere me emra të veçantë markash dhe kritere të tepërta, të cilat në |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/efekti:** | thelb kanë kufizuar konkurrencën e hapur. |
| **Shkaku:** | Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të Prokurimit Publik. Njësia përgjegjëse e përbërë nga: M.J., G.Ç., J.T. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, të analizohet rasti dhe të merren masa që në vijim të procedurave në të ardhmen, kriteret me emra markash dhe kriteret e tepërta mos të vendosen në DST, përveç rasteve kur këto kërkesa janë të argumentuara dhe duhen të kenë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët në Procedurat e Prokurimit dhe për të nxitur frymën e konkurrencës. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/68 prot., datë 14.12.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikën ,2 mbi kriteret e kërkuara, çmojmë se ato janë hartuar në përputhje me nenin 23 të LLP-së. Fakti pse është kërkuar programi Adobe Profesional x 64 bit, së pari është i lidhur me kërkesat e vazhdueshme të përdoruesve të programeve dhe së dyti eksporton dhe importon gamën më të gjerë të file, së treti suporton media (Audio, Video) dhe së katërti, shënimet në dokument bëhen si koment dhe si highlight.*

*Lidhur me pikën 3, trajtuar në akt konstatim në pikën B.2.2 dhe B.2.3 për kriterin e vendosur, ku kërkohet ISO 18001:2007, mbi 'Sistemet e menaxhimit dhe sigurisë në punë' dhe 2 teknikë të çertifikuar nga prodhuesi për fotokopjen dhe printera, po ju sqarojmë se, çertifikata ISO mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Në lidhje me disponimin për 2 (dy) teknikë të çertifikuar nga prodhuesi, kërkesa lidhet ngushtë me specifikimet teknike të pajisje që do të furnizohet dhe është e drejtë e AK të kërkojë garanci për realizimin me sukses të projektit, duke patur parasysh që gjatë zbatimit të kontratës mund të lindi nevoja për riparimin/ zëvendësimin e pajisjeve të kontraktuara që mund të paraqesin gjatë periudhës së garancisë.*

*Referuar konstatimit tuaj në pikën 5 dhe 6, mbi përllogaritjen e fondit limit, mbi konsatimin e një shoqërie që nuk ka për objekt fushën e këtij prokurimi sqarojmë se: referuar objekti të aktivitetit të operatorit ekonomik, shoqëria mund të importojë, tregtojë dhe eksportojë çdo lloj malli, artikulli, pajisje apo të tjera veprimtari brenda kuandrit ligjor (...).*

***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Lidhur me pikën 1 ajo është trajtuar gjerësisht në pjesën e parë dhe nuk po trajtohet në vijim.*

*Së pari, lidhur me programin Adobe Profesional x 64 bit, ne i qëndrojmë faktit se vendosja e këtij kriteri, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit **23** mbi "**Specifikimet teknike**", **pika 5, të ligjit nr. 9643** të PP, ku përcakohet se, "Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi dhe rrjedhimisht argumenti juaj është i gabuar. Pra, mund të kërkohej një program, por pa vendosur referenca të markave.*

*Së dyti, lidhur me kriterin e kërkuar ISO 18001:2007, mbi'Sistemet e menaxhimit dhe sigurisë në punë', në këtë prokurim bëhet fjalë për blerje të pajisje elektronike dhe vendosja e këtij kriteri mendojmë se është pa vend sepse kjo përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, i argumentuar nga ana juaj dhe në kuptim të nenit 23, pika 4, të ligjit*

*nr. 9643 të PP, duhet të dalin kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike [...] dhe funksionale, ku objekti i prokurimit ka të bëjë me blerjen e pajisjeve elektronike. Në lidhje me vendosjen e kriterit <u>për 2 (dy) teknikë për printera</u>, theksojmë se riparimi dhe zëvendësimi i pajisjeve të kontraktuara është brenda periudhës së garancisë dhe ajo është një detyrim i operatorit ekonomik fitues për ta përmbushur atë detyrim, aq më tepër që është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: 89055042, datë 28.10.2019, nga shoqëria Albsig. Theksojmë se kriteri i kërkuar për 2 teknikë është i tepërt dhe mund të konsiderohen si kërkesa të sforcuara, duke mos nxitur frymën e konkurrencës dhe pjesmarrjen e operatorëve të tjerë në procedurat e prokurimit publik dhe në fakt procedura është zhvilluar me një konkurent dhe fitues të vetëm.*
*<u>Së treti</u>, referuar konstatimit mbi përllogaritjen e fondit limit, ajo merret në konsideratë.*
*Si përfundim, për pikat 2 dhe 3 observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në projekt raportin e auditimit.*

**7.15.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"*<u>Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike</u>*ëë** REF-07076-02-08-2019 me vlerë **22,416,560** lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "**Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike**ëë REF-07076-02-08-2019 | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 373 datë 08.02.2019 | **2. Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>M.E.<br>E. N.<br>E.LL. |
| **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit** ñI hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>22,416,560 lekë | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>21,130,060 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>1,286,500 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>06.03.2019 | **9. Burimi Financimit**<br>Vetëfinancim Albcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-**<br>Sëka | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sëka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>20.03.2019 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>25,365,072 lekë | |

**B. Mbi realizimin e proçedurës së prokurimit.**

**B.1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeëë, është iniciuar nga Drejtori i Divizionit Teknik M.E., por në këtë kërkesë nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin dhe nevojën e kërkesat e kompanisë për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** ***Mbi kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor, ato janë:***

**1.** OE, duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, realizuar gjatë tre viteteve të fundit nga data e hapjes së tenderit [...].

**2.** OE, duhet <u>të zotëroje **ISO 9001:2008** për sistemin e menaxhimit të cilësisë</u> ose ekuivalente me to.

**3.** OE, duhet <u>të jetë në zotërim të certifikates të cilësisë **ISO 9001:2015**</u> ose ekuivalente me to.

**4.** OE, duhet te jete ne zoterim te çertifikatës **ISO 14001:2005** mbi ñSistemet e menaxhimit te ambientitò. Çertifikata qe do te paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit ose ekuivalente me to.

**5.** OE, duhet te jete ne zotërim të çertifikates **OHSAS 18001:2007** mbi ñSistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë ne puneò. Çertifikata që do të paraqitet kerkohet të jete e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit ose ekuivalente me to.
**6.**OE, duhet të jete në zoterim të çertifikates **ISO/IEC 27001:2013** të standartit nderkombetar te menaxhimit te sigurise së informacionit. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jete e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit ose ekuivalente me to.
**7.** OE, duhet të jetë në zoterim të certifikates **PAS 99:2012** për Sistemin e Integruar të Menaxhimit ose ekuivalente me to.
**8.** OE, duhet të jetë në zoterim të certifikates **ISO/IEC 50001:2011** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të energjise. Çertifikata që do të paraqitet kerkohet të jetë e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit ose ekuivalente me to.
**9.**OE, duhet te ketë te punesuar ne stafin e tij minimiumi **20** persona mesatarisht per periudhen janar ï mars 2018, vërtetuar me listepagesat sipas formularit E-sig025a.
**10.**Opearatori, duhet të ketë liçensë profesionale të shoqërise lëshuar nga MPPT/MTI në kategorine:
NS-13 Implante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
NP-12 Punime te inxhinierise se mjedisit
NS-13 Shesa per mbistruktura speciale.
**11.** OE, duhet të ketë të punesuar në stafin e tij:
a.Inxhinier Elektrik 1(nje)
b.Inxhinier Elektronik 1(nje)
c.Inxhinier Gjeolog 1(nje)
d.Inxhinier Mjedisi 1(nje)
e.Inxhinier Mekanik 1(nje)
-Secili nga punonjesit e mësiperm duhet të jetë i pasqyruar në listepagesën e shoqërisë dhe në Licensën e shoqerisë.
-Për secilin nga pjestarët e stafit teknik OE duhet të paraqesë diplomën, kontatën e punës, liçensën profesionale.
**12.** OE, duhet të jetë i licensuar për: Shërbime ekspertize në projektim, shërbime ekspertize në zbatim të projekteve për mbrojtjen nga zjarri, lëshuar nga QKL.
**13.** OE, duhet të dëshmoje se ka punesuar në stafin e vetë punonjës te kualifikuar si me poshte:
a.Teknikndërtimi,1(nje)
b.Saldator,1(nje)
c.Hidraulik,1(nje)
d.Elektricist,1(nje)
e.Elektromekanik,2(dy)
f. Auto makinist, 1(një)
**14.** OE, duhet te demostrojë se është në zotërim të lejeve dhe liçensave profesionale: Rrjete dhe shërbime ï për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve ekektronike sipas Rregjimit të Autorizimit të Përgjithshëm çertifikate e konformitetit-leshuar nga Autoriteti i Komunikimit Elektronik dhe Postar.
**15.** OE, duhet te kete autorizim ose leje nga prodhuesit i stacionit të radiove UHF ku do të rikonfigurohet dhe përmirësohet rrjeti me F.O. Autorizimi duhet te përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka te drejte për të vërtetuar dhe provuar saktesine e te dhënave e Autorizimit.
**16.** Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund tõ vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se disponon:
[Pick Up - copë 1; Kamioncinë - copë 1; Mineral Skavator - copë 1; Gjenerator - copë 1; Depozitë uji - copë 1; Aparat Saldimi - copë 2; Aparate lidhje për fibrat optike - copë 3].

Në arsyetimin e audituesit, në rast se i analizojmë një për një kërkesat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, ato nuk argumentojnë përse janë përshkruar këto kërkesa që të përmbushen nga operatori ekonomik fitues, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 23, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.
Referuar nenit 23 të ligjit të Prokurimit Publik, pika 3, përcaktohet se: *"në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale".*
Sa më sipër, gjykojmë se këto të dhëna janë të paargumentuar nga autoriteti kontraktor, si kërkesa tepër të sforcuara, diskriminuese, duke kufizuar konkurencën dhe në thelb ato kanë orientuar operatorin ekonomik drejtpërdrejtë një ofertuesi të vetëm në treg.
Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke eliminuar konkurrencën dhe vendosja e disa prej argumentëve, detyrimisht passjell skualifikimin e operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kërkesat e sforcuara të AK.

**B.4.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka zgjedhur alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar për marrjen e ofertave këta Operator Ekonomik;

1. **"A.E. D." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 22,028,700 lekë pa tvsh
2. **"E." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 24,866,600 lekë pa tvsh
3. **"A." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 20,354,380 lekë pa tvsh

Për këtë arsye AK vendosi që ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm, që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: 22,416,560 lekë pa TVSH.

**B.5.1** Në vijim, me hapjen e ofertave më datë 06.03.2019, ora 11:00 është paraqitur oferta e parë:
Operatori Ekonomik ñR.ò sh.p.k me çmimin e ofertës:

- ✓ **21,130,060** lekë pa tvsh.

**B.6.1** Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, me formularin nr. 373/3, datë 15.03.2019, ka identifikuar ofertën e mësipërme, si ofertën ekonomike më të suksesshme.
Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë me çelësa në dorë, me ofertë fituese me një konkurent të vetëm, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.
Nga shqyrtimi i kësaj proçedure, nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike (**SPE**), si edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, referuar shtojcës **A**, pika **2**, **3** është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:
*- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë **ISO 9001:2008** për sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente me to.*
*- Operatori ekonomik duhet të zotëroje **ISO 9001:2015** për sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente me to.*
Rezulton se nga **Operatori Ekonomik fitues R & T,** është dorëzuar vetëm **ISO 9001:2015** dhe mungon çertifikata e zotërimit **ISO 9001:2008** për sistemin e menaxhimit të cilësisë, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor, në DST. Nuk rezulton në asnjë rast që KVO të ketë kryer shqyrtimin apo argumentimin e pasqyruar me proçesverbal, përse mungon një nga kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, e cila mund të përbëjë shkak për skualifikim të OE fitues ose anullim të proçedurës së prokurimit nga KVO-ja, në kundërshtim me nenin 46, pika 1 e 2, nenin 53, pika 3, 4, 5, gërma c dhe nenit 54, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñ*Për Prokurimin Publik*ò, i ndryshuar.
Në nenin **46 ñKualifikimi i ofertuesve**ò, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar përcakohet se : ñ*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e*

*mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2) Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit".*

Në nenin **53** ñ**Shqyrtimi i ofertuesve**ò, pika 3, 4, 5, gërma c, të LPP-së, përcakohet se:

*[...].3"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

*4.Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

*5.Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:*

*c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji*ò *[...].*

Në gjykimin e audituesit, autoriteti kontraktor, nuk ka arritur qëllimin e këtij ligji, nuk ka rritur efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, dhe të ulë shpenzimet procedurale, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në proçedurat e prokurimit publik, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik, këto si rezultat i kërkesave të sforcuara të specifikimeve teknike, jo në përputhje me nenin 1 dhe 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për tôu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. OE janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. ***<u>Mungesa qoftë edhe i një kriterit të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, duke i hequr mundësinë e konkurimit në një proçedure konkurimi</u>.***

**B.7.1** Në vijim, është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: 0019062, datë 19.03.2019, me numër Police **BND0014725**, nga shoqëria Albsig, në vlerën 2,535,608. Është nënshkruar kontrata nr. 373/4, datë 20.03.2019. Sipas kësaj kontrate, njëlloj si në procedurat e mësipërme, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të Dokumentave Standard të Tenderit (DST), nuk parashikohet në asnjë rast se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku është e parashikuar: ñ*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese"*. <u>Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore</u>.

Në arsyetimin tonë, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që

prokurohet, për të cilën presupozohet se ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri me përfundimin e punimeve dhe ekzekutimin e kontratës.
Nga grupi i punës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me nr. 373/4 është mbajtur procesverbali përkatës për kryerjen e shërbimeve.

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në hartimin e specifikimeve teknike dhe në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike ". |
| **Situata:**<br><br>**Kriteri:**<br><br>**Ndikimi/efekti:**<br><br>**Shkaku:**<br><br>**Rëndësia:**<br>**Rekomandimi:** | Nga shqyrtimi i procedurës me objekt "Shpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optike" REF-07076-02-08-2019, në DST, në pikën 2. OE duhet të zotëroje **ISO 9001:2008** për sistemin e menaxhimit të cilësisë, dhe në pikën **3.** OE duhet të jetë në zotërim të certifikates të cilësisë **ISO 9001:2015**, ose ekuivalente me to.<br>Sa më sipër, gjykojmë se këto të dhëna janë të paargumentuar nga autoriteti kontraktor, si kërkesa tepër të sforcuara, diskriminuese, duke kufizuar konkurencën dhe në thelb ato janë kërkesa të njëjta. Përpos kësaj, nga shqyrtimi i kësaj proçedure, nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se nga **Operatori Ekonomik fitues "R. - T.",** është dorëzuar vetëm **ISO 9001:2015** dhe mungon çertifikata e zotërimit **ISO 9001:2008** për sistemin e menaxhimit të cilësisë, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor, në DST. Nuk rezulton në asnjë rast që KVO-ja të ketë kryer shqyrtimin apo argumentimin e pasqyruar me proçesverbal si alternativë, përse mungon një nga kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, e cila mund të përbëjë shkak për skualifikim të operatorit ekonomik fitues ose anullim të proçedurës së prokurimit nga KVO-ja, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 46, pika 1 e 2, nenin 53, pika 3, 4, 5, gërma c dhe nenit 54, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñ*Për Prokurimin Publik*ò, i ndryshuar.<br>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 46 ñkualifikimi i ofertuesveò, pika 2, shqyrtimi i ofertuesveò, pika 3, 4, 5, gërma c, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar.<br>Kritere të tepërta, të cilat në thelb kanë kufizuar konkurrencën e hapur dhe parregullësi në shqyrtimin e ofertave.<br>Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të Prokurimit Publik. Njësia përgjegjëse, struktura për hartimin e specifikimeve teknike E. X., E. B., M.H. dhe KVO M.E., E.N., E.LL..<br>E Lartë<br>Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 21,130,060 lekë pa tvsh. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi në fushën e prokurimit, si pasojë e së cilës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol SHA, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/68 prot, datë 14.12.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Referuar konstatimit tuaj, trajtuar në pikën 2 mbi formimin e punonjësve që kanë hartuar kërkesat e veçanta teknike, janë punonjës me eksperiencë dhe ekspertë të fushës në të cilën operojnë. Bashkëlidhur gjenden çertifikatat.*

*Referuar argumentit tuaj në pikën 3, përshkruar në aktin e konstatimit në pikën B.2.1, objekti i prokurimit, fibra optike është pjesë e rrjetit të komunikimit e për rrjedhojë posedimi i liçensave profesionale të lëshuara në MIE dhe AKEP siguron legjitimitetin për të punuar në një rrjet të tillë prandaj nga ana e AK është kërkuar disponimi i lejeve dhe liçensave profesionale. Konstatimi i grupit se këto kritere janë të sforcuara, diskriminuese dhe orientojnë drejt një operatori të vetëm, mbetet me karakter të përgjithshëm dhe tërësisht subjektiv. Sa më sipër, ky konsatim është i pasaktë.*

*Referuar argumentit tuaj në pikën 4, ku është dorëzuar vetëm ISO 9001:2015 dhe mungon çertifikata e zotërimit ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor, në DST, po ju sqarojmë se: referuar informacionit zyrtar në faqen e Organizatës Ndërkombëtare të Standarteve, rezulton se standarti ISO 9001:2015 është standarti që duke filluar nga data 22.09.2015 ka zëvendësuar standartin ISO 9001:2008. Pra, shoqëria ofertuese R., me disponomin e ISO 9001:2015, e ka përmbushur më së miri kriterin, për sa kohë është shprehur në kriter që këto dy standarte, në vartësi të kohës së lëshimit konsiderohen ekuivalente të njëri tjetrit. Pra asnjë referencë ligjore, nuk është shkelur nga KVO-ja. Sa më sipër ky konstatim është i pasaktë.*

*Në lidhje me pagesën paraprake lidhur me pikën 5, mbi paradhënien në vlerën 30 %, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e prokurimit publik.*

***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*

*Së pari, referuar pikës 2 dhe 3 mbi formimin e punonjësve që kanë hartuar specifikime teknike, bashkëlidhur gjenden dhe çertifikatat, në këtë pikë merret në konsideratë. Përsa i përket disponimin e lejeve dhe liçensave profesionale, mbi konstatimin e grupit se këto kritere janë të sforcuara, diskriminuese dhe orientojnë drejt një operatori të vetëm, ju sjellim në vëmendje se asnjë prej këtyre kërkesave nuk është argumentuar nga grupi për hartimin e specifikimeve teknike, ku në thelb këto kërkesa janë të tepërta duke mos nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë ekonomik dhe si rrjedhojë e këtyre kemi vetëm një konkurent dhe fitues të vetëm. Qëllimi i ligjit të Prokurimit Publik është fryma e nxitjes së konkurrencës në procedurat e prokurimit publik. Observacioni juaj në këtë pikë merret pjesërisht në konsideratë.*

*Së dyti, lidhur pikën 4, observimi i paraqitur prej jush është i njëjti, i cili ka lidhje me ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015, kritere të vendosura në kronologji njëra pas tjetrës nga autoriteti kontraktor në Dokumentat Standartë të Tenderit (DST) rezulton se mosdorëzimi i çertifikatës ISO 9001:2008 nga operatori ekonomik dhe shpallja e fituesit, si pasojë e mungesës së një prej kritereve trajtohet në kushtet e paligjshmërisë, e mund të përbëjë anullim të procedurës së prokurimit, gjë e shprehur edhe në vijimësi të proçedurave të vendimeve të KPP-së. Ju pretendoni se çertifikata e re ka zëvendësuar çertifikatën ISO të vjetër, atë ISO 9001:2008, por ky argument i juaji nuk qëndron, përderisa kjo çertifikatë është kërkuar nga grupi i hartimit të specifikimeve teknike në DST dhe për rrjedhojë duhet të respektohet një proçedurë standarte në kualifikimin e ofertuesve, njëlloj si procedurat e tjera. Vendosja e një kriteri të tillë, mund të përbënte shkak, për ndalimin apo hyrjen në garën e Prokurimit Publik nga operatorë të tjerë, si pasojë e mospasjes së kriterit ISO 9001:2008 i kërkuar në DST. Observacioni juaj në këtë pikë nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet*

*në raportin e auditimit. Së treti, referuar pikës mbi paradhënien në vlerën 30 %, ajo është e njëjtë si në proçedurat e përshkruara më sipër dhe nuk merret në konsideratë.*

**7.16.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: **"*Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra*** REF-07097-02-08-2019 me vlerë 9,166,666 lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-INDRA** REF-07097-02-08-2019 | | |
|---|---|---|
| **1.Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 374 datë 08.02.2019<br>**2.Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>E hapurò | **3 Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>M. E.<br>E. N.<br>E.LL. |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>9,166,666 lekë | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>9,166,650 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>16 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim nga Albcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-**<br>S | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>S | |
| **b. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **13. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 874/4 Prot, datë 20.03.2019 | **14. Vlera e kontratës** (me tvsh) | |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**B. 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-INDRA, është iniciuar nga Drejtori i Divizionit Teknik M.E., por në këtë kërkesë nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin dhe nevojën e kërkesat e kompanisë për kryerjen e këtij shpenzimi, jo në përputhje me kërkesat e nenit 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Grupi i punës, struktura e specializuar, ka përgatitur kërkesat e përgjithshme dhe teknike, mbi kriteret e veçanta të kualifikimit.

***Mbi kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor, ato po i përshkruajmë si më poshtë, vijojnë:***

**a)** OE, duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, realizuar gjatë tre viteteve të fundit nga data e hapjes së tenderit [...].

**b)** OE, duhet të jetë në zotërim të certifikatës të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente me to.

**c)** OE, duhet të jete në zotërim të certifikates **ISO 14001:2005** mbi Sistemet e menaxhimit të ambientitò. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit ose ekuivalente me to.

**d)** OE, duhet të jetë në zotërim të çertifikatës **ISO/IEC 27001:2013** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit te sigurise së informacionit. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit ose ekuivalente me to.

**e)** OE, duhet te ketë autorizim nga prodhuesi ose distributore të autorizuar nga prodhuesi për pajisjen navigacionale DME, LDB-103 prodhuar nga I.ò. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësisinë e të dhënave të Autorizimit të Prodhuesit.

**2.2** Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, në pikën 1, 2. 1, 2.2, 3 dhe 4 kanë të bëjnë me: Të përgjithshme: ***Shërbimet e mirëmbajtes dhe blerjen e pjesëve rezervë, për sistemet dhe pajisjet navigacionale DME, LDB-103 që kërkohen të prokurohen, janë shërbime të cilat kryhen për të ruajtur cilësinë dhe sigurinë''(...), shërbime të mbështetjes teknike (technical support) duke përfshirë***

***komunikimin me e-mail dhe thirrje telefonike gjatë 24/7 ditë të javes, brenda një viti" (...), ''riparimi ose zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara'' dhe ''aktivitete për gadishmërinë për vizita emergjence të specializuara (...) "I." vlerëson që problemet e ndodhura nuk mund të zgjidhen me mështetjen nga distanca ose me ndërhyrjen e personelit të Albcontrol'' (...) dhe '' shërbimi i Blerjes së pajisjeve rezerve, Monitor Trasmitter Unit (MTU), DME, LDB-103, PART NUMBER 00634200004200, 2''.***
ndryshuar.
**2.3** Përsa i përket pikës **3.3, pika 6** të **DST**, ku kërkohet që OE, duhet të ketë **autorizim** ose **leje nga prodhuesi ose distributorë të autorizuar nga prodhuesi për pajisjen navigacionale DME, LDB-103, prodhuar nga Indra (...) Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota tëe prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit.**

**Date: 27/02/2019**

**To: Albcontrol sh.a**

**Authorization Letter**

We **Indra Sistemas S.A.**, a company duly registered under the low of Spain, and located at Avenida de Bruselas, 35, 28108 Alcobendas (Madrid) Spain, do hereby authorize R&T sh.p.k., Rr. Luigj Gurakuqi nr. 15 Tirane, Albania to represent our company in Albania, including:

- Commercial and technical offers provision
- Contract signing
- Contract's warranty provision
- Hardware and software supplement
- Works and services, including technical support fulfilling

R&T sh.p.k. company is our authorized partner since 2010.

Based on this authorization letter R&T sh.p.k. is fully authorized to make Commercial offer for **Dual DME LDB-103 1000W (DME)** installed in Albcontrol Facilities, Tirana, Albania.

Name: Federico Rueda Lacha
Title: Director - International ATM Programs
**Signature and Stamp of Manufacture**

Sa më sipër, arsyetojmë se paraqitja e një dokumenti/letre autorizimi në gjuhë të huaj, në kuadër të çmuarjes së vlerës provuese të saj, rezulton se kjo shkresë është lëshuar nga një shoqëri e huaj, në një gjuhë të huaj dhe nuk arrin të identifikojë origjinalitetin dhe autencitetin e subjektit të dërguar dhe për më tepër, kjo letër nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të provuar përmbajtjen e saj, sepse nga ana e AK është shprehur që: **Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit, <u>por në asnjë rast nuk është argumentuar dhe provuar saktësia e kësaj letre/autorizimi</u>.**

**B.3.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, AK ka zgjedhur alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar 3 OE për marrjen e ofertave;

1. **"G. N." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 9,760,000 lekë pa tvsh
2. **"T.B.S. 96" sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 9,400,000 lekë pa tvsh
3. **"T.M.C." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 8,340,000 lekë pa tvsh

Për këtë arsye AK vendosi që ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm, që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: 9,166,666 lekë pa TVSH.
Nga verifikimi i OE në QKB, u konstatua se OE ñ**T.M.C. (T. M. C.)" sh.p.k**, me Nipt ...., nuk ka për objekt fushën e prokurimit dhe si e tillë, përllogaritja e fondit limit, nuk është aspak e bazuar dhe autoriteti kontraktor ka nxjerrë një përllogaritje jo reale të vlerës për kryerjen e këtij shërbimi, jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar dhe nenit 26 e 28

të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar <u>për të cilët kërkohet minimumi 3 operatorë ekonomik, për të marrë një mesatare mbi çmimet e tregut</u>.

**B.4.1** Në vijim të procedurës, me hapjen e ofertave më datë 06.03.2019, ora 14:12 është paraqitur oferta e parë:

<u>Operatori Ekonomik ñR.ò sh.p.k me çmimin e ofertës:</u>

- ✓ 9,166,650 lekë pa tvsh.

**B.5.1** Për këtë proçedure prokurimi, KVO-ja, me procesverbalin nr. 373/3 prot., datë 15.03.2019 ka identifikuar OE më të suksesshme dhe shpallur njoftimin e fituesit ñR.- Tò.

Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë me çelësa në dorë, me ofertë fituese me një konkurent të vetëm, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.

**B.6.1** Në vijim, është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: **0019063**, datë 19.03.2019, me numër Police BND0014725, nga shoqëria ñAò, në vlerën 1,099,998. Është nënshkruar kontrata nr. 374/4, datë 20.03.2019. Sipas kësaj kontrate, njëlloj si në procedurat e mësipërme, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të DST, nuk parashikohet në asnjë rast se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku është e parashikuar: ñ*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese"*. <u>Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore</u>.

Në arsyetimin tonë, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e FL që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri me përfundimin e punimeve dhe ekzekutimin e kontratës.

Nga grupi i punës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me nr. 373/5, datë 20.03.2019 është mbajtur procesverbali përkatës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës dhe kryerjen e shërbimeve.

**7.17.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: ***"Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX***ôô REF-11358-03-01-2019 me vlerë 34,995,200 lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: " Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX**ôô REF-11358-03-01-2019 | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 577 datë 01.03.2019 | **3.Njësia e Prokurimit**<br>A.M.<br>S.P.<br>F.H. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>M.E.<br>E.N.<br>E.LL. |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | | |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>34,995,200 lekë | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>34,990,800 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>4400 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit** | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim Albcontrol sha | 10. **Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-**<br>Sôka | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sôka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 577/5, datë 09.04.2019 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>41,988,690 lekë | |

**B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**B. 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-INDRAõõ, është iniciuar nga Drejtori i Divizionit Teknik M.E., por në këtë kërkesë nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin dhe nevojën e kërkesat e kompanisë për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Grupi i punës, struktura e specializuar, ka përgatitur kërkesat e përgjithshme dhe teknike, mbi kriteret e kualifikimit.

***Mbi kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor, ato po i përshkruajmë si më poshtë, vijojnë:***

**a)** OE, duhet të ketë vërtetim nga organi i Administratës Tatimore, për xhiron mesatare të tre viteve të fundit, e cila të jetë jo më e vogël se 40 % e fonidt limit dhe bilancet e tre viteve të fundit [...].

OE të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, realizuar gjatë tre viteteve të fundit nga data e hapjes së tenderit [...].

**b)** OE, duhet të jetë në zotërim të certifikates të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente me to.

**c)** OE, duhet te jete ne zoterim te certifikates **ISO/IEC 27001:2013** të standartit ndërkombetar të menaxhimit te sigurise së informacionit. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit ose ekuivalente me to.

**d)** OE, duhet të ketë autorizim nga prodhuesi ose distributore të autorizuar nga prodhuesi për sistemet VSC Garex prodhuar nga shoqëria Indra Sistemas s.a.

**2.2** Përsa i përket pikës **3.3, pika 4** të **DST**, ku kërkohet që OE, duhet te kete **autorizim** ose **leje nga prodhuesi ose distributorë të autorizuar nga prodhuesi për pajisjen navigacionale DME, LDB-103, prodhuar nga Indra (...) Autorizimi duhet te përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit.**

indra

ALBControl – Air Navigation Services of Albania
Kutia Postare
Nr. 8172
Rinas
Albania

20 March 2019

Authorization Letter

We Indra Navia AS, a company duly registered under the legislation of Norway, which are official manufacturers of GAREX products, which have our factory and headquarter in Olaf Helsets vei 6, NO-0694 Norway do hereby authorize R&T sh.p.k., Rr. Luigj Gurakuqi P. 89, Shk.A, Tirane, Albania to represent our company in Albania, including:

- Commercial and technical offers provision
- Contract signing
- Contract's warranty provision
- Hardware and software supplement
- Works and services, including technical support fulfilling

Based on this authorization letter R&T sh.p.k. is fully authorized to make Commercial offer for "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi dhe VCS - INDRA, GAREX" (Maintenance costs and purchase replacement parts for VCS-INDRA, GAREX)

Your Faithfully,

Dag Langerud
Director Communications

Indra Navia AS
PO Box 150 Oppsal
NO – 0619 Oslo, Norway
T +4723180200
F +4723180230
www.indracompany.com

Sa më sipër, arsyetojmë se paraqitja e një dokumenti/letre autorizimi në gjuhë të huaj, në kuadër të çmuarjes së vlerës provuese të saj, rezulton se kjo shkresë është lëshuar nga një shoqëri e huaj, në një gjuhë të huaj dhe nuk arrin të identifikojë origjinalitetin dhe autencitetin e subjektit të dërguar dhe për më tepër, kjo letër nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të provuar përmbajtjen e saj, sepse nga ana e autoritetit kontraktor është shprehur që: **Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit, <u>por në asnjë rast nuk është argumentuar dhe provuar saktësia e kësaj letre/autorizimi</u>.**

**B.3.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka zgjedhur

alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar 3 Operator Ekonomik për marrjen e ofertave;

1. **"A.E. D." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 32,724,000 lekë pa tvsh.
2. **"E." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 35,619,600 lekë pa tvsh.
3. **"C-M Al." sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 36,642,000 lekë pa tvsh.

Për këtë arsye AK vendosi që ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm, që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: 34,995,200 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi i ofertave në QKB, u konstatua se të tre operatorët ekonomik kanë për objekt fushën e prokurimit.

**B.4.1** Në vijim të proçedurës, me hapjen e ofertave më datë 27.03.2019, ora 11:00 është paraqitur oferta e parë:

Operatori Ekonomik ñR.ò sh.p.k me çmimin e ofertës:

- ✓ 34,990,800 lekë pa tvsh.

**B.5.1** Për këtë proçedure prokurimi, KVO-ja, me proçesverbalin nr. 577/3 prot., datë 15.03.2019 ka identifikuar OE më të suksesshme dhe shpallur njoftimin e fituesit ñR.-T.ò.

Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë me çelësa në dorë, me ofertë fituese me një konkurent të vetëm në garë, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik, si rezultat i formulimit të kritereve në favor të një kompanie të vetme të paramenduar.

**B.6.1** Në vijim, është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: **0019077**, datë 08.04.2019, me numër Police BND0014780, nga shoqëria ñAl.ò, në vlerën 4,198,896. Është nënshkruar kontrata nr. 577/4, datë 09.04.2019. Sipas kësaj kontrate, njëlloj si në proçedurat e mësipërme, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të DST, nuk parashikohet në asnjë rast se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku është e parashikuar: ñ*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese"*. Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Në arsyetimin tonë, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e FL që prokurohet, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe presupozohet se OE ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri me përfundimin e punimeve dhe ekzekutimin e kontratës.

Nga grupi i punës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me nr. 577/5, datë 09.04.2019 është mbajtur procesverbali përkatës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës dhe kryerjen e shërbimeve.

**7.18.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtua proçedura e prokurimit publik, me objekt: ***"Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREX***ôô REF-61369-02-24-2020 me vlerë 55,400,000 lekë pa tvsh.

**A. Të dhëna mbi objektin:**

| **Zhvillimi i proçedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREX**ôô REF-61369-02-24-2020 | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 459 datë 24.02.2020 | **3.Njësia e Prokurimit**<br>A.M. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>M.E. |

| | | |
|---|---|---|
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>ñE hapurò | S.P.<br>F.H. | E.N.<br>E.LL. |
| **5. Fondi Limit** (pa tvsh)<br>55,400,000 lekë | **6. Oferta fituese** (pa tvsh)<br>55,122,000 lekë | **7. Diferenca me fondin limit** (pa tvsh)<br>278,000 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>06.05.2020 | **9.Burimi Financimit**<br>Vetfinancim nga Albcontrol sha | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender 1 |
| **11. Ankimime AK-**<br>Sôka | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Sôka | |
| **13. Zbatimi i Kontratës Punëve** | | |
| **14. Lidhja e kontratës**<br>Nr. 459/6, datë 19.05.2020 | **15. Vlera e kontratës** (me tvsh)<br>66,146,400 lekë | |

## B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

**B. 1.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se procedura me objekt: prokurimit "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREXôô, është iniciuar nga Drejtori i Divizionit Teknik M.E., por në këtë kërkesë nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin dhe nevojën e kërkesat e kompanisë për kryerjen e këtij shpenzimi, në kundërshtim me nenin 1, pika dh) e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

**B.2.1** Grupi i punës, struktura e specializuar, ka përgatitur kërkesat e përgjithshme dhe teknike, mbi kriteret e kualifikimit.

***Mbi kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor, ato janë:***

**1)** OE, duhet të ketë vërtetim nga organi i Administratës Tatimore, për xhiron mesatare të tre viteve të fundit, e cila të jetë jo më e vogël se 40 % e fonidt limit të kësaj procedure. Dëshmitë për kryerjen e furnizimeve të mëparshme të jepen nëpërmjet kontratave të lidhura dhe të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse, ose përmes vërtetimit të realizimit të lëshuara nga autoritete kontraktore përfituese.

**2)** OE, duhet të zotërojë **ISO 9001:2015** për sistemin e menaxhimit të cilësisë, ose ekuivalente me to.

**3)** OE, duhet të jetë ne zoterim te certifikates **ISO/IEC 27001:2013** të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit ose ekuivalente me to.

**4)** OE, duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo të tjerë lejuar/çertifikuar/autorizuar nga prodhuesi për sistemin VSC Garex. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si : Telefon , fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të autorizmit të prodhuesit.

**2.2** Përsa i përket pikës **2.3, pika 4** të **DST**, ku kërkohet që OE, duhet te kete **autorizim** ose **leje nga prodhuesi ose distributorë të autorizuar nga prodhuesi për pajisjen navigacionale DME, LDB-103, prodhuar nga Indra (...) Autorizimi duhet te përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit.**

Your Ref.:
Our Ref.: MVA

13 March 2020

**Manufacturer's Authorization**

**Indra Navia AS**, which are official manufacturer of VCCS GAREX products, located at Hagaløkkveien 26, 1383 Asker, Norway, hereby authorize **R&T sh.p.k.**, Rr. "Luigj Gurakuqi", Pall. 89, Shk. A, Tirana, Albania, to present an offer and subsequently negotiate and sign a contract for sale, warranty or maintenance of all the products manufactured by us, for the contract with object "Blerje pjese nderrimi dhe kontrate mirëmbajtje VCS – GAREX, INDRA" ("Purchase of spare parts and maintenance contract VCS – GAREX, INDRA"), REF-51369-02-24-2020.

We hereby extend our full warranty and guarantee for the goods offered by the above mentioned company.

Validity of this authorization is until June 1st 2021.

Indra Navia AS

Petter Sperre
Manager Communication

Indra Navia AS, form. Register of Business Enterprises Org. no. 914 765 220, Registered Office: Hagaløkkveien 26, NO-1383 Asker, Norway

Indra Navia AS
Hagaløkkveien 26
NO-1383 Asker, Norway

T: +47 23 18 02 00
indracompany.com

Sa më sipër, arsyetojmë se paraqitja e një dokumenti/letre autorizimi në gjuhë të huaj, në kuadër të çmuarjes së vlerës provuese të saj, rezulton se kjo shkresë është lëshuar nga një shoqëri e huaj, në një gjuhë të huaj dhe nuk arrin të identifikojë origjinalitetin dhe autencitetin e subjektit të dërguar dhe për më tepër, kjo letër nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të provuar përmbajtjen e saj, sepse nga ana e autoritetit kontraktor është shprehur që: **Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit, por në asnjë rast nuk është argumentuar dhe provuar saktësia e kësaj letre/autorizimi.**

Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent, neni 266 K.Prc.Civile.

Si e tillë, në rast se letra në gjuhë të huaj është dërguar nga shoqëria e huaj, padiskutim është e nevojshme që të plotësohen kërkesat proçeduriale të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me këtë konkludim, vlerësohet edhe përmbajtja e kësaj shkrese në raport me provat dhe dokumentat e tjera shkresore të paraqitura nga operatori ekonomik, të cilat janë lëshuar nga autoritetet shtetërore përkatëse, me nr. prot., nënshkrim dhe vulën përkatëse të institucionit.

Në lidhje me këtë letër, në arsyetimin e audituesit, pasi vlerëson përmbajtjen e këtij autorizimi të thjeshtë dhe i çmon ato në raport me të gjitha dokumentat e tjera të dorëzuara nga Institucionet Shtetërore të RSH, konkludohet se kjo letër/autorizim nuk arrin të provohet origjinaliteti i Shtetit dërgues, për aq kohë sa që autoriteti kontraktor nuk ka arritur të provoj ose argumentoj me dokumentacion justifikues, sesi është provuar saktësia e të dhënave të këtij autorizimi. Konstatohet se autorizimet për të njëjtin objekt procedure prokurimi (2019-2020), janë letra/autorizime të natyrave dhe llojeve të ndryshme, të nënshkruar nga persona ndryshëm dhe kryesisht nga shtete të ndryshme, çka krijon dyshime të arsyeshme mbi autencitetin e tyre.

Në përfundim, arsyetojmë se këto të dhëna janë të paargumentuar nga autoriteti kontraktor, si kërkesa tepër të sforcuara, diskriminuese, duke kufizuar konkurencën dhe në thelb ato kanë orientuar operatorin ekonomik drejtpërdrejtë një ofertuesi të vetëm në treg, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime/liçensime të prodhuesve të përcaktuar, e për më teper ky kriter lë hije dyshimi mbi origjinalitetin e saj.

**B.3.1** Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka zgjedhur alternativën e testimeve të tregut duke kontaktuar 3 Operator Ekonomik për marrjen e ofertave;

1. **“T.M.C. (T. M. C.)” sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 52,500,000 lekë pa tvsh
2. **“DN-D. N.” sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 58,300,000 lekë pa tvsh
3. **“R.” sh.p.k**, paraqiti ofertën e tij me vlerë totale 55,122,000 lekë pa tvsh.

Për këtë arsye AK vendosi që tëi propozojë Drejtorit të Përgjithshëm, që vlera limit e kontratës për këtë procedurë prokurimi të jetë: 55,400,000 lekë pa tvsh.
Nga verifikimi i ofertave në QKB, u konstatua se dy operatorët ekonomik kanë për objekt fushën e prokurimit, ndërsa operatori ekonomik ñ**T.M.C. (T. M. C.)” sh.p.k**, me Nipt ...., nuk ka për objekt fushën e prokurimit dhe si e tillë, përllogaritja e fondit limit, nuk është aspak e bazuar dhe autoriteti kontraktor ka nxjerrë një përllogaritje jo reale të vlerës për kryerjen e këtij shërbimi, jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar dhe nenit 26 e 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar <u>për të cilët kërkohet minimumi 3 operatorë ekonomik, për të marrë një mesatare mbi çmimet e tregut</u>.



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K81826007A |
| 2. Data e Regjistrimit | 26/06/2008 |
| 3. Emri i Subjektit | EMC Training Management Consulting |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 12/06/2008 |
| 6. Koheziganja | Nga: 12/06/2008 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANË Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Hamdi Shpuza, Pallati 6/3, Kati I - te |
| 8. Kapitali | 100,00 |
| 8.1 Numri i pergjithshëm i kuotave | 100,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e sistemit te menaxhimit te cilesise sipas standarteve ndërkombetare te familjes ISO 9000; specifikisht ISO 9001 dhe ISO 9004. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e sistemit te menaxhimit te mjedisit sipas standarteve ndërkombetare te ISO 14001 ose Rregullores Europiane EMAS. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemit te Cilesise per Sektorin e Informacione sipas standarteve ISO 17025. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemit te cilesise per Organet Certifikuese sipas standarteve specifike dhe guidave perkatese me fuqi ISO/IEC 17021, ISO/IEC 17024, ISO/IEC 17011. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve te Cilesise per Organet e Inspektimit sipas standarteve specifike dhe guidave perkatese me fuqi ISO 17020. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve te Menaxhimit te Sigurisë sipas standarteve specifike te Sigurisë me Punë OHSAS 18001. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve te Menaxhimit te Sigurisë në Informacionit sipas ISO 27001. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve te Menaxhimit te Shëndetit sipas ISO 20000. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve Menaxhues te Energjise sipas ISO 50001. Mbeshtetje teknike per industrine per përshtatjen me kërkesat e markave CE. Hartimin, zhvillimin dhe vleresimin e Sistemeve te Kontrollit te Ndotjes ne Pikat Kritike te Kontrollit sipas standarteve ne |

**B.4.1** Në vijim të proçedurës, me hapjen e ofertave më datë 06.05.2020, ora 10:00 është paraqitur oferta e parë:
<u>Operatori Ekonomik ñR.ò sh.p.k me çmimin e ofertës:</u>

- ✓ 55,122,000 ekë pa tvsh.

**B.5.1** Për këtë proçedure prokurimi, KVO-ja, me proçesverbalin nr. 495/5 prot., datë 15.05.2020 ka identifikuar ofertën ekonomike më të suksesshme dhe shpallur njoftimin e fituesit ñR. - T.ò.
Referuar kësaj ofertë, ajo jepet si një kontratë me ofertë fituese me një konkurent të vetëm në garë, pa pjesmarrje të tjerë të operatorëve ekonomik.
**B.6.1** Në vijim, është siguruar formulari i sigurimit të kontratës, me numër serie fature: **0019983**, datë 18.05.2020, me numër Police BND0015448, nga shoqëria ñAl.ò, në vlerën 6,614,640 lekë. Është nënshkruar kontrata nr. 459/6, datë 19.05.2020019. Sipas kësaj kontrate, njëlloj si në proçedurat e mësipërme, përsa i përket vlerës dhe mënyrës së pagesës, parashikuar në nenin 4 të konratës, është parashikuar se sipërmarrësi (AK), ka marrë përsipër pagimin e shumës paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës, por këtë favor autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar në fazën e konkurimit që do tu bëhej konkurentëve në asnjë paragraf të Dokumentave Standard të Tenderit (DST), nuk parashikohet në asnjë rast se operatorët e shpallur fitues do të përfitojnë një paradhënie në masën e 30% të vlerës totale të kontratës me nënshkrimin e saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit **60**, pika **1** e ligjit **nr. 9643** ñPër prokurimin publikò i ndryshuar, datë **20.11.2006**, ku është e parashikuar: ñ*Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”*. <u>Konstatohet sipas DST, që kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore</u>.

Në arsyetimin tonë, kjo pagesë paradhënie në masën 30 %, nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe presupozohet se OE ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri me përfundimin e punimeve dhe ekzekutimin e kontratës.
Nga grupi i punës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës me nr. 577/5, datë 09.04.2019 është mbajtur procesverbali përkatës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës dhe kryerjen e shërbimeve.

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në 3 raste, mbi verifikimin dhe vërtetësinë e dokumentave të tenderit, në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra 2019", "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX 2019", "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREX 2020". |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i procedurave më sipër, rezulton se autoriteti kontraktor, e konkretisht nga grupi i hartimit të specifikimeve teknike ka kërkuar që, operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo të tjerë lejuar/çertifikuar/autorizuar nga prodhuesi për sistemin VSC Garex. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon , fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të autorizmit të prodhuesit. Nga shqyrtimi i 3 procedurave rezulton se në asnjë rast, **nuk është provuar saktësia e kësaj letre/autorizimi.** Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent, në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 266 të Kodit të Proçedurës Civile, njësoj siç veprohet me dokumentat shkresore, të lëshuar nga autoritetet shtetërore të cilat përmbajnë formatin e duhur të një dokumenti shkresor zyrtar që janë, nr. prot, nënshkrimin dhe vulën përkatëse të institucionit.<br>Si e tillë, në rast se letra në gjuhë të huaj është dërguar nga shoqëria e huaj, padiskutim është e nevojshme që të plotësohen kërkesat proçeduriale të Kodit të Procedurës Civile.<br>Në lidhje sa më sipër mbi këtë letër/autorizim autoriteti kontraktor, nuk ka arritur të argumentojë origjinalitetin e letrës/autorizimit të shtetit dërgues, sesi është provuar saktësia e të dhënave të këtij autorizimi. Konstatohet se autorizimet për të njëjtin objekt procedure prokurimi (2019-2020), janë letra/autorizime të natyrave dhe llojeve të ndryshme, të nënshkruar nga persona të ndryshëm dhe kryesisht nga shtete të ndryshme, çka lë hije dyshimi mbi autencitetin e tyre.<br>Këto lloj autorizimesh mund ti disponojë vetëm nje operator ekonomik, të prodhuesve të caktuar në treg dhe si rrjedhoje, ato kanë orientuar operatorin ekonomik drejtpërdrejtë një ofertuesi të vetëm në treg, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime/liçensime të prodhuesve të përcaktuar. Për rrjedhojë, e rëndësishme është të provohet origjinaliteti i autorizimit, duke kontaktuar dhe konfirmuar prodhuesin që ka dhënë autorizimin |

| | |
|---|---|
| | përkatës sepse kjo letër përbën një nga elementët kyç që ndikon në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, që hyjnë në konkurim në Procedurat e Prokurimit Publik.<br>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8116, datë 23.03.1996, i ndryshuar, neni 266 ôKodi i Proçedurës civile të Republikës së Shqipërisëô. |
| **Ndikimi/efekti:** | Kritere të paargumentuara dhe parregullësi në verifikimin dhe vërtetësinë e dokumentave të tenderit. |
| **Shkaku:** | Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të Prokurimit Publik. Njësia përgjegjëse KVO-së me përbërje: M.E., E. N., E.LL.. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, të analizohen rastet dhe të merren masa që për proçedurat e shqyrtuara, si dhe në proçedurat e tjera në vijim, të vërtetohet dhe dokumentohet vërtetësia e dokumentave, lidhur me proçedurat respektive, që janë kërkuar në Dokumentat Standartë të Tenderit (DST) që janë **autorizimi/letra e prodhuesit**, për pajisjet navigacionale, prodhuar nga Indra apo Garex duke kontaktuar me prodhuesin që ka lëshuar dokumentin, siç është përshkruar në pikën përkatëse. |

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në 7 raste, mbi pagesë paradhënie në masën 30 % - 40 %, në Procedurat e Prokurimit Publik. |
| **Situata:** | Nga shqyrtimi i procedurave më sipër, rezulton se autoriteti kontraktor, ka kryer pagesë paradhënie në masën 30 % - 40 %, por ky favorizim nuk është e parashikuar në asnjë rast sipas kërkesave të ligjit të Prokurimit Publik, sepse operatori ekonomik fitues, ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit, e cila është jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, kriter i kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe presupozohet se OE ai i ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri me përfundimin e punimeve dhe ekzekutimin e kontratës, jo në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar.<br>Ligji nr. 8116, datë 23.03.1996, i ndryshuar, neni 266 ôKodi i Proçedurës civile të Republikës së Shqipërisëõ |
| **Ndikimi/efekti:** | Parregullësi në pagesat e paradhënies së operatorëve ekonomik. |
| **Shkaku:** | Mosrespektimi i duhur i legjislacionit të Prokurimit Publik. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, të analizohen rastet dhe të merren masa që për proçedurat në vijim, pagesat e paradhënies të jepen ose kryhen me mbarimin e shërbimeve/punimeve përkatëse. |

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, subjekti i audituar, Albcontrol Sh.a, ka paraqitur observacion me shkresë me nr. 566/68 prot., datë 14.12.2021.*

***Pretendimi i subjektit:***

*2. Përsa i përket kriterit të çertifikatës **ISO 14001:2005** mbi "Sistemet e menaxhimit të ambientit"ajo është në pajtueshmëri me kërkesat në fushën e eduktimit të trajtimit ajror.*

*3.Referuar konstatimit tuaj në pikën B.2.1, B.2.2 dhe B.2.3 (lidhur me akt konstatimet nr.7,8,9) ju sqarojmë se konstatimi juaj është i pasaktë, si pasojë e referencës së gabuar të këtyre kërkesave, si specifikimeve teknike që hartohen bazuar në nenin 23 të LPP. Këto kërkesa përbëjnë kritere të veçanta kualifikimi në lidhje me kapacitetin teknik, që rregullohen nga neni 46 pika 1, gërma ''b'' dhe pika 2 e LPP. Nisur nga vet natyra e objektit të prokurimit, kemi të bëjmë me mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me një pajisje të identifikuar e të përcaktuar qartë, që për më tepër është mjaft sensitive dhe e kushtueshme, pra është e papranueshme që furnizimet e pjesëve dhe shërbimet për këtë pajisje të lejohen të merren nga operatorë që nuk janë të autorizuar nga prodhuesi i pajisjes mos kërkim i autorizimit nga prodhuesit rrezikon mosmarrjen e shërbimeve të çertifikuara nga prodhuesi sipas instruksioneve dhe/ose furnizimin me një pjesë këmbimi jo origjinale. Kjo mund të sjellë pasoja të rënda si dëmtim përfundimtar dhe dalje jashtë funksionit të pajisjes, çka do të sillte një dëm të pariparueshëm.*

*4. Mbi hartimin e fondit limit se: QKB ushtron funksionet e saj në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.31/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe nuk ofron asnjë të dhënë për ofertat e testimit të tregut sipas konstatimit tuaj [...] dhe grupi i përllogaritjes së fondit i është referuar përcaktimit ligjor për fondin limit duke përzgjedhur një nga alternativat që përcakton neni 59 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

*5.Referuar konstatimit tuaj mbi pagesën paraprake në masën 30 % të vlerës totale të kontratës, gjë e cila nuk është përcaktuar në DST dhe bie në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, ''Për Prokurimin Publik'', i ndryshuar.... paradhënia është një praktikë tregtare dhe kusht i zakonshëm kontraktual, i parashikuar jo vetëm në DST, por edhe në Kodin Civil. Bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ''Për Prokurimin Publik'', i ndryshuar dhe VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 ''Për miratimin e rregullave të prokurimit publik'', i ndryshuar, si dhe në të gjitha udhëzimet e publikuara nga APP, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e prokurimit publik.*
*Sqarojmë se, nuk ekziston asnjë pengesë për dhënien e parapagimit në të gjitha procedurat e prokurimit publik...ky është një nga detyrimet bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë....Theksojmë se paradhënia nuk është kriter kualifikimi gjatë vlerësimit të ofertave, e për pasojë nuk mund të jetë pjesë e DST-ve para shpalljes së fituesit.*
***Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH-së.***
*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*
*Së pari, Referuar argumentit tuaj, trajtuar në pikën 2 përsa i përket kriterit të çertifikatës* ***ISO 14001:2005*** *mbi " Sistemet e menaxhimit te ambientit" merret në konsideratë, në pajtueshmëri me kërkesat në fushën e eduktimit të trajtimit ajror të argumentuar prej jush.*
*Së dyti, përsa i përket* ***autorizimit ose leje nga prodhuesi****, ju sjellim në vëmendje se, ky autorizim është lëshuar nga një shoqëri e huaj, në një gjuhë të huaj dhe nuk arrin të identifikojë origjinalitetin dhe autencitetin e subjektit të dërguar dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të provuar përmbajtjen e saj. Autoriteti Kontraktor, ka kërkuar që ka të drejtën për të të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit, por në asnjë rast nuk është argumentuar dhe provuar saktësia e kësaj letre/autorizimi, ndaj është e rëndësishme që në procedurat e ardhshme të provohet saktësia e të dhënave të këtij dokumenti, në rastet kur konstatohen elementë jo të mjaftueshëm për të plotësuar formatin e një dokumenti zyrtar (psh në disa raste është pa firmë, pa vulë). Lidhur me observacionin tuaj, mbi vendosjen e këtij kriteri, kjo është në përputhje me kërkesat teknike, ndërsa mbi vërtetësinë e tij ajo lë hije dyshimi sepse përbën një nga kriteret kyç që ndikon në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik dhe kualifikimin e fituesit. Për këto të dhëna, observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.*
*Së treti, lidhur mbi hartimin e fondit limit, rezulton se një prej operatorëve ekonomik, nuk ka për objekt fushën e prokurimit dhe sipas pretendimit tuaj që QKB nuk ofron asnjë të dhënë për ofertat e testimit të tregut sipas konstatimit tonë dhe observacioni juaj është i pasaktë për aq kohë sa ju nuk argumentoni me dokumentacion shoqërues. Autoriteti kontraktor gëzon një nga metodat alternative të përzgjedhjes që i jep ligji, por llogjikisht duhet që Operatorët Ekonomik, të kenë lidhje me fushën e prokurimit, e lidhur me objektin mbi të cilën zhvillohet procedura e prokurimit. Natyrisht që ligji nuk e specifikon këtë fakt, që mund të pranohen oferta nga shoqëri që kanë objekt të përgjithshëm dhe me mbulim të gjerë të aktivitetit të tyre, por praktikisht ato duhen të lidhen me fushën që ka të bëjë me objektin e prokurimit, mbi të cilën po kërkohen shërbime për atë fushë specifike. Konkretisht Operatori Ekonomik TMC Training, fushën e shërbimit të tij e ka me mbulim të gjerë dhe si i tillë nuk lidhet me kontratën e mirëmbajtjes Indra, në fushën e Prokurimit.*

**7.19. Prokurimi** ***me objekt "Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018.***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 289, datë 01.02.2018, e z. **S.R.**, me detyrë Drejtor i Divizionit Operacional për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosteritò nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo

kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.
Në asnjë pikë të procesverbalit nr.289/2 prot., datë 11.09.2018 për përgatitjen e specifikimeve teknike nuk paraqitet asnjë përshkrim teknik për tipin e hardware-eve që do të mirëmbahen, numrin e pajisjeve në të cilat do të ri-instalohet aplikacioni celular PRS, zgjidhjen teknike mbi të cilën funksionon software për të cilin kërkohet suporti teknik, komponente të cilat janë të rëndësishme për hartimin e ofertave ekonomike dhe teknike nga operatorët ekonomikë.
Nisur nga sa më sipër grupi i auditimit ka konstatuar se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 1833/1, datë 29.08.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me nenin 23, pika 4, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar në të cilin citohet se :
*"Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin."*.
Urdhri nr. 289/1, datë 01.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm i cili ngarkon grupin e punës të përbërë nga z. **S.R**., z. **S.M**. dhe znj. **M.J.** për përgatitjen e specifikimeve teknike për këtë procedurë nuk është zbatuar plotësisht në të gjithë pikat e tij. Në shkronjën b) të pikës 2 të Urdhrit të sipërpërmendur, përcaktohet se afati për përmbushjen e përgjegjësive të grupit të punës është 5 ditë nga marrja në dijeni, ndërkohë që specifikimet teknike janë përcaktuar përmes Procesverbalit nr. 289/2 prot., datë 11.09.2018, pra rreth 7 muaj me vonesë nga afati i përcaktuar në urdhër. Për sa më sipër, konstatohet se nuk është kryer një analizë për të përcaktuar shkaqet e mos-zbatimit të urdhrit brenda afateve të përcaktuar si dhe për më tepër për të analizuar nëse kryerja e kësaj procedure ka qenë ende e domosdoshme për kërkesat e zhvillimit të punës së Albcontrol SHA.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në specifikime teknike apo të DST nuk parashtrohet se cili është prodhuesi i sistemit që ka në përdorim Albcontrol SHA për të cilin kërkohet të realizohet shërbimi i mirëmbajtjes.
KVO i ngritur me urdhrin nr. 1906/2, datë 28.09.2018, i përbërë nga Z. S.M., Z. E.N. dhe Z. E.LL. nuk ka funksionuar në përputhje me nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar ku citohet se: ñ*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit...*ò, dhe nenin 58, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar ku përcaktohet se: *KVO emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.* ***Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.*** *Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të*

*ofertave. Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.* ***Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.****".*

Konstatimi i mësipërm arrihet pasi Z. S. M. me detyrë Drejtor i Divizionit Teknik, në bazë të urdhrit nr. 289/1, datë 01.02.2018 ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike për këtë procedurë prokurimi dhe bazuar në urdhrin nr. 1906/2, datë 28.09.2018 është caktuar si anëtar i KVO-së. Konstatohet se z. S.R. ka paraqitur formular deklarimi për mos-pasje të konfliktit të interesit si anëtar i grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike më datë 11.09.2018, si dhe formular deklarimi për mos-pasje të konfliktit të interesit si anëtar i KVO-së më datë 28.09.2018.

Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 289/3, datë11.09.2018, i përbërë nga Znj. H.P., Znj. V.I. dhe Znj. T.F., për përllogaritjen e fondit limit ka përzgjedhur metodën e studimit të tregut, në bazë të së cilës ka marrë tre oferta ekonomike, konkretisht :

1. ñC. & M. Al.ò shpk, me ofertë në vlerën 3,910,000 lekë pa TVSH.
2. ñA. S.ò shpk, me ofertë në vlerën 4,330,000 lekë pa TVSH.
3. ñE.ò shpk, me ofertë në vlerën 4,260,000 lekë pa TVSH.

Të treja ofertat e sipërpërmendura nuk kanë asnjë datë për të llogaritur afatin e vlefshmërisë së tyre. Gjithashtu, konstatohet se procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 289/4, datë 12.09.2018 i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 289/3, datë 11.09.2018 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në regjistrin tregtar të QKB rezulton se dy operatorët ekonomikë ñC. & M. Al.ò shpk dhe ñA. S.ò shpk nuk kanë në objektin e tyre të aktivitetit dhënien e shërbimeve në fushën e sistemeve informatike çka nuk është në përputhje me pikën 2 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshar, në të cilin citohet se: *"Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:*

- *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.);*
- *ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe*
- *b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- *c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht".*

Nisur nga fakti se dy prej operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është marrë për bazë për përllogaritjen e fondit limit, nuk kanë në objektin e tyre të veprimtarisë dhënien e shërbimeve në fushën informatike, arrihet në përfundimin se llogaritja e fondit limit për këtë procedurë është kryer në mënyrë të paargumentuar, sikurse përcaktohet në pikën 2 të Nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 07.11.2018 ka lidhur kontratën nr. 1906/5, me operatorin ekonomik ñR. F. & A. E.ò sh.p.k **në vlerën 4,166,001 lekë pa TVSH.**

Nga auditimi i likuidimit dhe zbatimit të kontratës është konstatuar se nga ana e kontraktorit është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor raporti nr. 1906/7 prot., datë 20.02.2019 bashkëlidhur me faturën tatimore nr. 48070490. Ky raport është konfirmuar nga grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës i ngritur me urdhrin nr. 1906/6, datë 07.11.2018 i cili për këtë qëllim ka mbajtur dhe procesverbalin nr. 1906/8 prot., datë 22.02.2019.

Kontraktori ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor raportin nr.1906/9 prot., datë 07.05.2019 bashkëlidhur me faturën tatimore nr. 48093458. Ky raport është konfirmuar nga dy anëtarë të grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, konkretisht nga z. S.M. dhe znj. M. J., dhe nuk është konfirmuar nga z. S.R.. Për konfirmimin e shërbimit është mbajtur dhe procesverbali nr. 1906/10 prot., datë 09.05.2019 i cili gjithashtu është sigluar vetëm nga dy anëtarë të grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, konkretisht nga z. S.M. dhe znj. M.J., dhe nuk është sigluar nga z. S.R. çka nuk është në përputhje të plotë me Pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar në të cilën citohet se : *"Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat pergjegjese per financat duhet të kontrollojnë në se fletehyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj".*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk egziston asnjë dokumentacion mbështetës i cili vërteton kryerjen e ndërhyrjeve për të përmirësuar apo optimizuar performancën e sistemit dhe nuk konstatohet në raportet e dorëzuara nga ana e kontraktorit përshkrimi i përgjithshëm i performancës dhe gjendjes së gadishmërisë së sistemit sikurse parashikohet në kontratën nr. 1906/5, datë 07.11.2018.

| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në procedurën e prokurimit ñ***Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*** |
|---|---|
| **Situata:** | 1. Urdhri nr. 289/1, datë 01.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm i cili ngarkon grupin e punës të përbërë nga z. S.R., z. S.M. dhe znj. M.J. për përgatitjen e specifikimeve teknike për këtë procedurë nuk është zbatuar plotësisht në të gjithë pikat e tij. Në shkronjën b) të pikës 2 të Urdhrit të sipërpërmendur, përcaktohet se afati për përmbushjen e përgjegjësive të grupit të punës është 5 ditë nga marrja në dijeni, ndërkohë që specifikimet teknike janë përcaktuar përmes procesverbalit nr. 289/2 prot., datë 11.09.2018, pra rreth 7 muaj me vonesë nga afati i përcaktuar në urdhër. Për sa më sipër, konstatohet se nuk është kryer një analizë për të përcaktuar shkaqet e mos-zbatimit të Urdhrit brenda afateve të përcaktuar si dhe për më tepër për të analizuar nëse kryerja e kësaj procedure ka qenë ende e domosdoshme për kërkesat e zhvillimit të punës së Albcontrol SHA.<br>2. KVO i ngritur me urdhrin nr. 1906/2, datë 28.09.2018, i përbërë nga Z. S.M., Z. E.N. dhe Z. E.LL. nuk ka funksionuar në përputhje me Nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Sa më sipër konkludohet pasi Z. S.M. me detyrë Drejtor i Divizionit Teknik, në bazë të urdhrit nr. 289/1, datë 01.02.2018 ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike për këtë procedurë prokurimi dhe bazuar në urdhrin nr. 1906/2, datë 28.09.2018 është caktuar si anëtar i KVO.<br>3. Kontraktori ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor raportin nr.1906/9 prot., datë 07.05.2019 bashkëlidhur me faturën tatimore nr. 48093458. Ky raport është konfirmuar nga dy anëtarë të grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, konkretisht nga z. S.M. dhe znj. M.J., dhe nuk është konfirmuar nga z. S.R.. Për konfirmimin e shërbimit është mbajtur dhe procesverbali |

| | |
|---|---|
| | nr.1906/10 prot., datë 09.05.2019 i cili gjithashtu është sigluar vetëm nga dy anëtarë të grupit të punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, konkretisht nga z. S.M. dhe znj. M.J., dhe nuk është sigluar nga z. S.R. çka nuk është në përputhje të plotë me Pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar. |
| **Kriteri:** | 1) Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Albcontrol SHA;<br>2) Neni 56 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar;<br>3) Pika 54 e udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar |
| **Ndikimi/Efekti:** | Risk i lartë për shmangie të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandime:** | 1. Nga Administratori i shoqërisë, në raste të mos-zbatimit të Urdhërave të Brendshëm, të analizohet situata dhe të merren masat përkatëse sipas përgjegjësive në bazë të arsyetimit të mosrealizimit të Urdhrit që rezulton nga analizimi i situatës.<br>2. Albcontrol SHA të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë të ketë parasysh në çdo rast se anëtarët e KVO të mos jenë pjesë e grupeve të tjera të punës përgjatë të gjithë fazave të zhvillimit të procedurës. |

***7.20. Prokurimi me objekt "<u>Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol</u>", viti 2019.***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 389, datë 11.02.2019 e znj. D.Z., me detyrë shefe në Sektorin e Buxhetit dhe Kostos, për inicimin e procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

Procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 389/4, datë 21.02.2019 i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 389/3, datë 15.02.2019 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri.

Në vijim, Urdhri i Prokurimit nr. 500, datë 21.02.2019 ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë ñKërkesë me Propozimò me qëllim nxitjen për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, është konstatuar se nuk ka asnjë argumentim të arsyes së përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar njoftimi për ftesë për propozim, gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar ku përcaktohet se: *"Pavarësisht nga publikimi i*

*njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë.”.* Gjithashtu, rezulton se AK, ka ftuar për të bërë propozime për këtë procedurë OE të mëposhtëm:

1. ñS. F.ò
2. ñZyrë Përmbarimore L.D.C.
3. ñS. COò
4. ñT.M.C. (T. M. C.)ò
5. ñC.M.P.&T.ò

Nga verifikimi i kryer në sistemin e QKB rezulton se OE ñS. F.ò, ñZyrë Përmbarimore L.D.C.ò dhe OE ñS. COò, nuk kanë në objektin e veprimtarisë së tyre dhënien e konsulencës financiare për përllogaritjen e kostove, çka ka qenë objekti kryesor i kësaj procedure prokurimi.

Është konstatuar se KVO nuk ka vepruar në përputhje të plotë me pikën 3 të Nenit 53 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar në të cilën citohet se: ó*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*ô Grupi i auditimit arrin në këtë përfundim duke pasur parasysh faktin se në kriteret e pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi nga ana e Autoritetit Kontraktor, konkretisht në Kriteret për Kapacitetin Teknik është kërkuar që *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë eksperienca të tij të ngjashme lidhur me prezantime pranë ICAO (shërbimet e trafikut ajror), panelet ekonomike pjesëmarrje në grupin financiar të Atlantikut të Veriut (ICAO), pjesëmarrje në organe drejtuese lidhur me çështjet “Route Charge”, Kostot NATS dhe Unit Rate, të ketë njohuri dhe eksperienca në politikat lehtësuese të menaxhimit CARFM dhe shërbimet e trafikut ajror, eksperiencë të mëparshme në politikat e shërbimeve të navigimit ajror sipas manualit ICAO 9082,* dhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe nga verifikimi i kryer në SPE konstatohet se Operatori Ekonomik ñC. & M. Al.ò i cili është vlerësuar si fitues nga ana e KVO, ka dorëzuar një deklaratë sipas së cilës z. J.A. P. do të jetë personi përgjegjës për zbatimin e kontratës së shërbimeve të kërkuara në këtë procedurë nga Albcontrol SHA. Kjo deklaratë nuk është shoqëruar me ndonjë kontratë apo marrëveshje ndërmjet ñC. & M. Al.ò dhe z. J.A.P.. Gjithashtu kjo deklaratë është e sigluar vetëm nga ana e ñC. & M. Al.ò dhe nuk është e sigluar nga ana e z. J.A.P. si palë aktive në këtë procedurë.

OE ka dorëzuar një CV të z. J.A.P., një diplomë të z. J.A.P. dhe një deklaratë të z. J.A.P., dokumenta të cilët janë të gjithë të sigluar vetëm nga Operatori Ekonomik ñC. & M. Al.ò, por nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion i cili provon ose vërteton eksperienca të operatorit ekonomik të ngjashme lidhur me prezantime pranë ICAO (shërbimet e trafikut ajror), panelet ekonomike pjesëmarrje në grupin financiar të Atlantikut të Veriut (ICAO), pjesëmarrje në organe drejtuese lidhur me çështjet ñRoute Chargeò, Kostot NATS dhe Unit Rate, njohuri dhe eksperienca në politikat lehtësuese të menaxhimit CARFM dhe shërbimet e trafikut ajror, eksperiencë të mëparshme në politikat e shërbimeve të navigimit ajror sipas manualit ICAO 9082.

KVO, në mungesë të një dokumenti të sigluar nga të dy palët, pra ñC. & M. Al.ò dhe z. J.A.P., nuk duhet të kishte konsideruar vetëdeklarimet e ñC. & M. Al.ô në emër të z. J.A.P. si provë ose vërtetim për eksperienca të ngjashmë apo njohuri dhe eksperienca në shërbimet e trafikut ajror apo politikat e shërbimeve të navigimit ajror.

Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol sha., më datë 29.03.2019 ka lidhur kontratën nr. 500/4, me OE ñC. & M.ò sh.p.k **në vlerën 3,916,000 lekë pa TVSH.**

Nga auditimi i likuidimit dhe zbatimit të kontratës është konstatuar se nga AK është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590523 të datës 05.06.2019 në vlerën 1,314,720 lekë me TVSH për shërbimet e mëposhtme:

- Vizitë në Tiranë për hartimin e ñPreliminary Unit Rateò;
- Takime konsulence për koston e terminalit;
- Përgatitja e raportit përkatës;
- Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme.

Është konstatuar se dokumentacioni bashkëlidhur kësaj fature nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, është konstatuar se ky dokumentacion është i hartuar në gjuhën Angleze dhe nuk është i përkthyer në Shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol SHA.

Pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/6, datë 07.06.2019, të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019.

Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590525 të datës 23.07.2019 në vlerën 633,120 lekë me TVSH për shërbimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje në mbledhjen e qershorit të Komitetit të zgjeruar ñPër miratimin e kostos paraprake të vitit 2020 - Brukselò;
- Përgatitje e raportit përkatës;
- Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme.

Është konstatuar se dokumentacioni bashkëlidhur kësaj fature nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, është konstatuar se ky dokumentacion është i hartuar në gjuhën Angleze dhe nuk është i përkthyer në Shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol SHA.

Pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/7, datë 25.07.2019, të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019.

Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590527 të datës 17.10.2019 në vlerën 633,120 lekë me TVSH për shërbimet e mëposhtme :

- Pjesëmarrje në takimin e grupit studimor të ñKomitetit të Zgjeruar të CRCOò, shtator 2019;
- Përgatitje e raportit përkatës;
- Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme.

Është konstatuar se dokumentacioni bashkëlidhur kësaj fature nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, është konstatuar se ky dokumentacion është i hartuar në gjuhën Angleze dhe nuk është i përkthyer në Shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol SHA.

Pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/8, datë 18.10.2019, të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019.

Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590534 të datës 03.12.2019 në vlerën 1,144,320 lekë me TVSH për shërbimet e mëposhtme:

- Vizita në Tiranë për hartimin e kostos bazë të njësisë për shërbimet ñEn routeò dhe ñTerminalò për vitin 2020.
- Pjesëmarrje në takime konsulence për koston e terminalit e miratimin e saj për vitin 2020;
- Përgatitje e raportit përkatës;
- Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme.

Është konstatuar se dokumentacioni bashkëlidhur kësaj fature nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, është konstatuar se ky dokumentacion është i hartuar

në gjuhën angleze dhe nuk është i përkthyer në shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol SHA.
Pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/9, datë 03.12.2019, të dy prej anëtarëve të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019, konkretisht znj. R.D. dhe znj. H.P., ndërkohë që procesverbali nuk është sigluar nga anëtari tjetër i grupit të punës së sipërpërmendur, znj. D.Z.. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar në të cilën citohet se : *"Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat pergjegjese per financat duhet të kontrollojnë në se fletehyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj".*
Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590535 të datës 16.12.2019 në vlerën 973,920 lekë me TVSH për shërbimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje në mbledhjen e Nëntorit të Komitetit të Zgjeruar të CRCO për miratimin e kostos të shërbimit ñEn-routeò për vitin 2020.
- Pjesëmarrje në takime konsulence në lidhje me koston e terminalit e miratimin e saj për vitin 2020;
- Përgatitje e raportit përkatës;
- Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme.

Është konstatuar se dokumentacioni bashkëlidhur kësaj fature nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, është konstatuar se ky dokumentacion është i hartuar në gjuhën angleze dhe nuk është i përkthyer në shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol SHA.
Pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/10, datë 17.12.2019, të dy prej anëtarëve të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019 konkretisht znj. R.D. dhe znj. H.P., ndërkohë që procesverbali nuk është sigluar nga anëtari tjetër i grupit të punës së sipërpërmendur, znj. D.Z.. Ky veprim nuk është në përputhje me pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar në të cilën citohet se: *"Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat pergjegjese per financat duhet të kontrollojnë në se fletehyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës qe verteton marrjen ne dorezim te aktiveve sipas kushteve te kontrates si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve per investimet, fletë hyrje origjinale, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj".*

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në procedurën e prokurimit ***"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*** |
| **Situata:** | 1. Urdhri i Prokurimit nr. 500, datë 21.02.2019 ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë ñKërkesë me Propozimò me qëllim nxitjen për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim të arsyes së përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar njoftimi për ftesë për propozim, gjë e cila bië në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò<br>2. KVO nuk ka vepruar në përputhje të plotë me pikën 3 të Nenit |

| | |
|---|---|
| | 53 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar<br>Grupi i auditimit arrin në këtë përfundim duke pasur parasysh faktin se në kriteret e pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi nga ana e Autoritetit Kontraktor, konkretisht në Kriteret për Kapacitetin Teknik është kërkuar që *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë eksperienca të tij të ngjashme lidhur me prezantime pranë ICAO (shërbimet e trafikut ajror), panelet ekonomike pjesëmarrje në grupin financiar të Atlantikut të Veriut (ICAO), pjesëmarrje në organe drejtuese lidhur me çështjet "Route Charge", Kostot NATS dhe Unit Rate, të ketë njohuri dhe eksperienca në politikat lehtësuese të menaxhimit CARFM dhe shërbimet e trafikut ajror, eksperiencë të mëparshme në politikat e shërbimeve të navigimit ajror sipas manualit ICAO 9082,* dhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe nga verifikimi i kryer në Sistemin Elektronik të Prokurimeve konstatohet se OE ñC. & M. Al.ò i cili është vlerësuar si fitues nga ana e KVO, ka dorëzuar një deklaratë sipas së cilës z. J.A.P. do të jetë personi përgjegjës për zbatimin e kontratës së shërbimeve të kërkuara në këtë procedurë nga Albcontrol SHA.. Kjo deklaratë nuk është shoqëruar me ndonjë kontratë apo marrëveshje ndërmjet ñC. & M. Al.ò dhe z. J.A.P.. Gjithashtu kjo deklaratë është e sigluar vetëm nga ana e ñC. & M. Al.ò dhe nuk është e sigluar nga ana e z. J.A.P. si palë aktive në këtë procedurë.<br>Operatori Ekonomik ka dorëzuar një CV të z. J. A. P., një diplomë të z. J. A. P. dhe një deklaratë të z. J. A. P., dokumenta të cilët janë të gjithë të sigluar vetëm nga Operatori Ekonomik ñC. & M. Al.ô, por nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion i cili provon ose vërteton eksperienca të operatorit ekonomik të ngjashme lidhur me prezantime pranë ICAO (shërbimet e trafikut ajror), panelet ekonomike pjesëmarrje në grupin financiar të Atlantikut të Veriut (ICAO), pjesëmarrje në organe drejtuese lidhur me çështjet ñRoute Chargeò, Kostot NATS dhe Unit Rate, njohuri dhe eksperienca në politikat lehtësuese të menaxhimit CARFM dhe shërbimet e trafikut ajror, eksperiencë të mëparshme në politikat e shërbimeve të navigimit ajror sipas manualit ICAO 9082.<br>KVO, në mungesë të një dokumenti të sigluar nga të dy palët, pra ñC. & M. Al.ò dhe z. J. A. P., nuk duhet të kishte konsideruar vetëdeklarimet e ñC. & M. Al.ò në emër të z. J. A. P. si provë ose vërtetim për eksperienca të ngjashmë apo njohuri dhe eksperienca në shërbimet e trafikut ajror apo politikat e shërbimeve të navigimit ajror.<br>3. Gjatë zbatimit të kontratës është konstatuar se dokumentacioni shoqërues i faturimeve të kryera nga OE për ofrimin e shërbimit nuk ka asnjë siglim të hartuesit të tij apo të kontraktuesit. Gjithashtu, konstatohet se ky dokumentacion është i hartuar në gjuhën Angleze dhe nuk është i përkthyer në Shqip sikurse operon dhe kryen proceset e punës Albcontrol |

| | |
|---|---|
| | SHA.<br>4. Pagesa e faturës 42590535 të datës 16.12.2019 në vlerën 973,920 lekë me TVSH është konfirmuar përmes procesverbalit Nr. 500/10, Datë 17.12.2019, të dy prej anëtarëve të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019, konkretisht znj. R.D. dhe znj. H.P., ndërkohë që procesverbali nuk është sigluar nga anëtari tjetër i grupit të punës së sipërpërmendur, znj. D.Z.. Ky veprim nuk është në përputhje me me Pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar |
| **Kriteri:** | 1) Pika 4 e Nenit 39 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar;<br>2) Pika 3 e Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar;<br>3) Pika 54 të Udhëzimit Nr. 30, Datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar |
| **Ndikimi/Efekti:** | Devijime jo materiale nga legjislacioni dhe rregullat e prokurimit publik. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik. |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandime:** | 1. Albcontrol SHA në rastet e procedurave të prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duke përdorur llojin e procedurës ñKërkesë për propozimò, në çdo rast të dokumentojë arsyen e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që do të ftojë për të paraqitur propozimet për procedurën përkatëse.<br>2. Albcontrol SHA në rastet e procedurave të prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen të mbajë parasysh se pavarësisht eksperiencave të mëparshme të suksesshme me operatorë ekonomikë të caktuar, të ndjekë me përpikmëri të gjithë hapat dhe veprimet që pëcakton legjislacioni për prokurimin publik.<br>3. Albcontrol SHA të marrë masa që në rastet e pamundësisë së arsyeshme së anëtarëve të grupeve të punës për prezencë në momentin e marrjes në dorëzim të shërbimeve apo mallrave të kryejë zëvendësimin e anëtarit i cili nuk mund të jetë prezent. |

**7.21. Prokurimi me objekt *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 444, datë 15.02.2019, e Z. M.E., me detyrë Drejtor i Divizionit Teknik për inicimin e procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

Procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 444/4, datë 04.03.2019 i grupit të punës të ngritur me Urdhrin nr. 444/3, datë 21.02.2019 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar

operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 444/1, datë 15.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me Nenin 23, pika 4, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar në të cilin citohet se:

*"Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin".*

Sa më sipër arrihet nisur nga fakti se në procesverbalin nr. 444/2 prot., datë 21.02.2019 nuk është paraqitur asnjë diagramë rrjeti apo model lidhjeje të pajisjeve ekzistuese me qëllim njohjen e operatorëve ekonomikë me të gjitha kushtet dhe rrethanat me rëndësi për hartimin e ofertës.

Gjithashtu konstatohet se në pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik, të DST është kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi dhe distributorët e autorizuar të sistemeve të menaxhimit të rrjetit, objekt i këtij prokurimi, për shitjen e tyre në territorin e Shqipërisë, ndërkohë që në DST, përcaktohet vetëm prodhuesi i pajisjeve të rrjetit mbi të cilat është ngritur infrastruktura IT e Albcontrol, por nuk përcaktohet në asnjë paragraf se cili është prodhuesi i sistemeve të menaxhimit të rrjetit që ka në përdorim Albcontrol, çka mbart risk për pasiguri për operatorët ekonomikë duke qenë se në specifikime teknike dhe në DST nuk përcaktohet se cili është prodhuesi i sistemeve të menaxhimit të rrjetit që Albcontrol përdor dhe për të cilët në këtë procedurë prokurimi kërkohet optimizimi dhe rinovimi i suportit të prodhuesit.

Përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 28.03.2019, të mbajtur në ambientet e Albcontrol SHA nga KVO dhe NjP është përcaktuar si ofertues i parë dhe i vetëm BPOE ñI. S.ò sh.p.k dhe ñI.ò sh.p.k. të cilët kanë paraqitur ofertën ekonomike në vlerën **43,926,510 lekë pa TVSH.**

Sipas Formulartit të Ofertës Ekonomike, vlera sipas zërave përkatës është si më poshtë vijon :

***Në lekë***

| Nr | Përshkrimi i mallrave | Sasia | Çmimi për Njësi | Çmimi Total | Afati |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Mirëmbajtje e rrjetit dhe sistemeve të sigurisë** | | | | |
| 1.1 | Rinovim suporti për pajisjet Router | 1 | 847,810 | 847,810 | 12 muaj |
| 1.2 | Rinovim suporti për pajisjet Switching | 1 | 983,170 | 983,170 | 12 muaj |
| 1.3 | Rinovim suporti për pajisjet Firewall dhe licencat e shërbimeve të ofruara (AMP, IPS, Remote VPN) | 1 | 1,716,170 | 1,716,170 | 12 muaj |
| 1.4 | Zgjidhje e integruar për sistemet e sigurisë së rrjetit | 1 | 19,357,480 | 19,357,480 | 12 muaj |
| 2 | Mirëmbajtje e sistemit IP Telefoni | | | | 12 muaj |
| 2.1 | Rinovim suporti për serverat e Call | 1 | 1,529,670 | 1,529,670 | 12 muaj |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Manager dhe licencave përkatës | | | | |
| 2.2 | Rinovim suporti për Voice Gateway | 1 | 196,690 | 196,690 | 12 muaj |
| **3** | **Mirëmbajtje e sistemit Wireless dhe Telekonferencë** | | | | |
| 3.1 | Rinovim suporti për pajisjet Wireless | 1 | 88,190 | 88,190 | 12 muaj |
| 3.2 | Rinovim suporti për sistemin e teleprezencës | 1 | 213,510 | 213,510 | 12 muaj |
| **4** | **Optimizim dhe Rinovim Suporti për Sistemet e Menaxhimit të rrjetit** | **1** | **14,760,460** | **14,760,460** | **12 muaj** |
| **5** | **Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare** | **12** | **352,780** | **4,233,360** | **12 muaj** |
| | **Çmimi Neto** | | | | **43,926,510** |
| | **TVSH** | | | | **8,785,302** |
| | **Çmimi Total** | | | | **52,711,812** |

Në dokumentacionin e dorëzuar nga BPOE ñI. S.ò sh.p.k dhe ñI.ò sh.p.k rezulton se këta dy Operatorë Ekonomikë kanë lidhur ndërmjet tyre kontratën nr. 1808, datë 27.03.2019 me objekt ofertimin dhe si rrjedhojë, negocimin, lidhjen dhe realizimin e kontratës për tenderin me objekt ñMirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim për mirëmbajtjen e rrjetit ITò sipas së cilës OE ñI. S.ò sh.p.k do të mbulojë 72.68% të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor dhe ñI.ò sh.p.k do të mbulojë 27.32% të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor. Konkretisht sipas kësaj kontrate ndarja e përgjegjësive për secilin operator ekonomik është parashikuar si vijon:

| Nr. | Përshkrimi i shërbimeve | Infosoft Systems | Intech + |
|---|---|---|---|
| 1 | Mirëmbajtja e rrjetit dhe sistemeve të sigurisë | X | |
| 1.1 | Rinovim suporti për pajisjet Router | X | |
| 1.2 | Rinovim suporti për pajisjet Sëitching | X | |
| 1.3 | Rinovim suporti për pajisjet fireëall dhe licencat e shërbimeve të ofruara (AMP, IPS, Remote VPN ) | X | |
| 1.4 | Zgjidhje e integruar për sistemet e sigurisë së rrjetit | X | |
| 2 | Mirëmbajtje e sistemit IP Telefoni | X | |
| 2.1 | Rinovim suporti për serverat e Call Manager dhe licencave përkatës | X | |
| 2.2 | Rinovim suporti për Voice Gateway | X | |
| 3 | **Mirëmbajtje e sistemit Wireless dhe Telekonferencë** | X | |
| 3.1 | Rinovim suporti për pajisjet Ëireless | X | |
| 3.2 | Rinovim suporti për sistemin e teleprezencës | X | |
| 4 | **Optimizim dhe Rinovim Suporti për Sistemet e Menaxhimit të rrjetit** | 18.70% | 81.30% |
| 5 | **Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Ëireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare** | X | |

Gjithashtu, OE ñI.ò sh.p.k, më datë 27.03.2019 ka lëshuar një Prokurë të Posaçme përmes së cilës ka deklaruar se është dakord që përfaqësuesi i BPOE të jetë shoqëria ñI. S.ò sh.p.k.
Përmes procesverbalit të shqyrtimit të ofertave të mbajtur më datë 29.03.2019 nga KVO, ka rezultuar si ofertues i suksesshëm dhe fitues BOE ñI. S.òsh.p.k. dhe ñI.ò sh.p.k..
Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 17.04.2019 ka lidhur kontratën nr.591/4, me BOE ñI. S.òsh.p.k. dhe ñI. sh.p.k **në vlerën 43,926,510 lekë pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se në dokumentet standarde të tenderit, autoriteti kontraktor, në seksionin **2.3 Kapaciteti teknik,** ndër të tjera ka kërkuar si vijon :

*3.Operatori Ekonomik duhet te jete i Autorizuar nga Prodhuesi "C.." ose distributoret e autorizuar per shitjen e sherbimit te suportit ne Territorin e Shqipërisë Autorizimi duhet të permbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
*4.Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga Prodhuesi ose distributoret e autorizuar i sistemeve të menaxhimit të rrjetit, objekt i ketij prokurimi, për shitjen e tyre nëe territorin e Shqiperise. Autorizimi duhet të permbaje të dhena të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
*5.Operatori Ekonomik duhet të ketë specializime të thelluara për teknologjite e sigurise, aksesit dhe të telefonise, me qellim menaxhimin e rrjetit të Albcontrol, i cili eshte i ndertuar në produkte dhe teknologji Cisco. Për të dëshmuar këtë aftësi, Operatori Ekonomik duhet të zoterojë:*
- *Specializimin "Advanced Security Architecture"*
- *Specializimin "Cisco Advanced Collaboration Architecture"*
- *Specializimin "Advanced Enterprise Networks Architecture"*

*6.Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje te gjithe stafin dhe personelin e tij tekniko-profesional, i cili do te angazhohet ne sherbimet e kerkuara te mirembajtjes. Ne perberje te stafit Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht stafin e meposhtem.*

*a. Te pakten 3 (tre) specialiste të certifikuar nga prodhuesi Cisco, **fusha "Routing & Switching"** ku minimalisht nje prej tyre ne nivel professional ose ekuivalent*
*b. Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi Cisco, **fusha "Security"** ku minimalisht nje prej tyre ne nivel professional ose ekuivalent*
*c. Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi Cisco per teknologjine **Wireless** ose ekuivalent.*
*d. Te pakten 1 (nje) specialiste rrjeti te certifikuar nga prodhuesi Cisco, **fusha Collaboration (Voice Telephony)** niveli Profesional ose ekuivalent*
***e.** Të pakten 1 (nje) specialist te certifikuar nga prodhuesi Cisco **per dizenjimin e rrjetit** niveli profesional ose ekuivalent*
*f. Të pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per ITIL ose ekuivalent me qellim menaxhimin e sherbimeve te suportit dhe mirembajtjes*

*Personeli i mesiperm duhet te kete aktualisht nje marredhenie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (nje) vit, e vertetuar kjo me formularet E-sig te listepagesave te deklaruara dhe te firmosura nga inspektoret tatimore. Aftesite e tyre teknike duhet te vertetohen me ane te certifikatave ose transkripteve (ne rastin kur aplikohet) te leshuara nga prodhuesi.*

Është konstatuar se në sistemin SPE, ofertuesi i vetëm për këtë procedurë ka mungesë dokumentacioni, konkretisht në pikën 2.3 Kapaciteti Teknik, Pika 6, ku mungon dokumentacioni mbështetës për kërkesat e DST si më poshtë :

*6.Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje te gjithe stafin dhe personelin e tij tekniko-profesional, i cili do të angazhohet nëe sherbimet e kerkuara të mirembajtjes. Nëe përberje të stafit Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht stafin e mëposhtem.*

*a. Të pakten 3 (tre) specialiste te certifikuar nga prodhuesi Cisco, **fusha "Routing & Switching"** ku minimalisht nje prej tyre ne nivel professional ose ekuivalent*
*a. Të pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi Cisco, **fusha "Security"** ku minimalisht nje prej tyre ne nivel professional ose ekuivalent*
*b. Të pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi Cisco per teknologjine **Wireless** ose ekuivalent*

*c. Të pakten 1 (nje) specialiste rrjeti te certifikuar nga prodhuesi Cisco,* ***fusha Collaboration (Voice Telephony)*** *niveli Profesional ose ekuivalent.*

**Ky dokumentacion është i pranishëm vetëm në dosjen fizike të kësaj procedure.**

Është konstatuar se në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, i ngritur me Urdhrin nr. 441/1, datë 15.02.2019, në pikën **5. KËRKESAT TEKNIKE** ndër të tjera janë kërkuar dy komponente kryesore, rinovimi i suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve si dhe shërbime të mirëmbajtjes së pajisjseve nga ana e OE.

Nga grupi i auditimit konstatohet se ky specifikim përbën mbivendosje të shërbimeve që janë kërkuar nisur nga fakti se rinovimi i suportit të prodhuesit nënkupton, ndërhyrjen e prodhuesit të pajisjeve dhe të sistemeve për marrjen e masave korrigjuese ose ndërrimin e pajisjeve në raste të problematikave madhore që mund të shfaqen gjatë përdorimit të pajisjeve.

Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të Albcontrol SHA, Pika 1 d) përcaktohet se Sektori i Shërbimeve Taknike ka për detyrë *"Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe OpManager (Sistemi i monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik);"*.

Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të Albcontrol sha, Pika 2 përcaktohet se Sektori i Asistencës Informatike ka për detyrë:

a) Të sigurojë mbikëqyrje konstante të rrjetit të brendshëm kompjuterik në ñALBCONTROLò SHA;
b) Të sigurojë mbikëqyrje konstante të datacenter-it që i përket Drejtorisë IT;
c) Të sigurojë mbështetje teknike për printerat dhe PC-të e ñALBCONTROLò SHA;
d) Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpermjet biletave elektronike) dhe të gjitha sistemeve të monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik;
e) Të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me informacionin që qarkullon, ruhet dhe aksesohet;
f) Të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit të e - mail dhe vazhdimësinë e shërbimit të internet-it;
g) Të sigurojë shërbimin back - up (kopje rezervë) me qëllim përdorimin e tij në rast defektesh.

Pra, për mirëfunksionimin e sistemeve të sigurisë, shërbimeve të rrjetit, sistemit Wireless, sistemit të Telekonferencës, sistemeve të menaxhimit të rrjetit dhe sistemeve të telefonisë, Albcontrol SHA, ka prokuruar në këtë procedurë prokurimi rinovimin e suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve çõka nënkupton sigurimin nga prodhuesi për marrjen e masave korrigjuese në raste të problematikave ose avarive që mund të shfaqen. Gjithashtu në strukturën organizative funksionon një drejtori e cila në bazë të rregullores së brendshme të Albcontrol ka për detyrë sigurimin dhe mbikqyrjen e mirëfunksionimit të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të monitorimit të rrjetit të brendshëm. Në këtë procedurë, shoqëria Albcontrol SHA ka kryer investim për zërin ñ**Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare"**, në vlerën **4,233,360 lekë pa TVSH ose 5,080,032 lekë me TVSH**. Prokurimi i një shërbimi për të kryer procese dhe shërbime të cilët në bazë të rregullores së brendshme të Albcontrol janë detyrë e një strukture të brendshme të shoqërisë për tõ kryer konsiderohet si përdorim i fondeve pa eficiencë në vlerën **4,233,360 lekë pa TVSH ose 5,080,032 lekë me TVSH.**

Nga auditimi i likujdimit dhe zbatimit të kontratës konstatohet se grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i ngritur me Urdhrin 591/5, Datë 17.04.2019 nuk ka mbajtur procesverbal për verifikimin e realizimit të zërit ñ**Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi**

**i monitorimit të Rrjetit**ò për një periudhë 1-vjeçare nga momenti i lidhjes së kontratës, në kundërshtim me Pikën 47, Kapitulli 3 i Udhëzimit Nr. 30, Datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò në të cilën citohet se: *"Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet me faturën dhe kushtet e kontratës, nuk i merr në dorëzim, por i mban në ruajtje në po ato kushte që mban aktivet e veta, dhe njofton shitësin për t'i tërhequr duke përcaktuar dhe afatin kohor sipas rastit. (brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike në marrëdhënie me furnitorin)".*

Konstatohet se grupi i punës i sipërpërmendur ka firmosur raportet mujore të shërbimit të mirëmbajtjes të dorëzuar nga operatori ekonomik, por nuk ka konfirmuar kryerjen e shërbimeve me anë të ndonjë procesverbali.

Në dokumentacionin e dorëzuar gjatë konkurrimit në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik ka dorëzuar emrat e punonjësve të cilët do të kryejnë shërbimet e kërkuara sipas zërave përkatës të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit. Gjatë zbatimit të kontratës, në raportet mujore të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor rezulton se ndër të tjerë shërbimet janë kryer edhe nga dy punonjës të operatorit ekonomik që nuk janë paracaktuar për zbatimin e kësaj kontrate.

Nga auditimi konstatohet se përmes procesverbalit nr. 591/6, datë 21.06.2019, grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 591/5, datë 17.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm ka raportuar implementimin e zërave të mëposhtëm:

- Rinovim suporti për pajisjet Router;
- Rinovim suporti për pajisjet Switching;
- Rinovim suporti për pajisjet Firewall dhe licencat e shërbimeve të ofruara (AMP, IPS, Remote VPN);
- Rinovim suporti për serverat e Call Manager dhe licencave përkatëse;
- Rinovim suporti për Voice Gateway;
- Rinovim suporti për pajisjet Wireless;
- Zgjidhje e integruar për sistemet e sigurisë së rrjetit.

Për asnjë nga zërat e mësipërm nuk është pregatitur Fletë-Hyrja përkatëse në magazinën e Albcontrol SHA, çdka bie në kundërshtim me nenin 37 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar në të cilin citohet se : ñ*Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)*ò.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se në Raportin nr. 128 prot., datë 20.01.2020, ñRaport mujor mbi shërbimet e Sistemeve Informative të kryera pranë Albcontrol për periudhën 17.12.2019-16.01.2020ô, në pikën 4. Shërbimet e Kryera dhe Thirrje për Suport, është specifikuar se në datë 23.12.2019 është paraqitur një problematikë me përshkrimin ñProblem me lidhjen wireless-u be troubleshooting. Do të procedohet me reset te wireless dhe konfigurim nga e paraò, problematikë e cila në këtë raport ka status ñNë procesò.

Në pikën 4. Shërbimet e Kryera dhe Thirrje për Suport të raportit nr. 128/1 prot., datë 18.02.2020 óRaport mujor mbi shërbimet e Sistemeve Informative të kryera pranë Albcontrol SHA për periudhën 17.01.2019-17.02.2020, përcaktohet e njëjta problematikë me përshkrimin ñProblem me lidhjen wireless-u be troubleshooting. Do të procedohet me reset te wireless dhe konfigurim nga e paraò, problematikë e cila në këtë raport ka status ñNë procesò me datë thirrje 23.12.2019.

Në pikën 4. Shërbimet e Kryera dhe Thirrje për Suport të raportit nr. 128/2 prot., datë 19.03.2020 óRaport mujor mbi shërbimet e Sistemeve Informative të kryera pranë Albcontrol

SHA për periudhën 17.02.2020-17.03.2020, përcaktohet e njëjta problematikë me përshkrimin ñProblem me lidhjen wireless ï u bë troubleshooting. Janë bërë një sërë testimesh por ende nuk është gjetur zgjidhja përfundimtare. Po punohet për zgjidhjen definitive me status ñNë procesò.
Në pikën 4. Shërbimet e Kryera dhe Thirrje për Suport të raportit nr. 128/3 prot., datë 21.04.2020 ñRaport mujor mbi shërbimet e Sistemeve Informative të kryera pranë Albcontrol për periudhën 17.03.2020-16.04.2020ò, përcaktohet e njëjta problematikë me përshkrimin ñProblem me lidhjen wreless ï u bë troubleshooting. Janë bërë një sërë testimesh por ende nuk është gjetur zgjidhja përfundimtare. Po punohet për zgjidhjen definitiveò me status óNë procesô.
Më tej në raportet pasardhës deri në përfundim të kontratës nuk është paraqitur më asnjë informacion në lidhje me statusin e kësaj problematike të paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë operatorit ekonomik që ofron shërbimin. Pra, konstatohet se nuk ekziston asnjë dokumentacion mbështetës për kryerjen e këtij shërbimi nga operatori ekonomik për një periudhë prej 114 ditësh, dhe autoriteti kontraktor nuk ka marrë asnjë masë në lidhje me mos-kryerjen e këtij shërbimi.

**Pretendimi i subjektit:**
*Për sa më sipër, subjekti i audituar ka paraqitur pranë grupit të auditimit observacionin përmes shkresës Nr. 445/6, Datë 14.12.2021 duke pretenduar/sqaruar se në sisteme dhe në rrjet punohet në nivele të ndryshme operimi. Prodhuesit nuk operojnë në nivele te ulta por operojnë në nivele të larta në të cilat përfshihen mirëmbajtjet korrigjuese të defekteve madhore dhe ndërrim fizik në raste të nevojshme, upgrade/update. Operatorët ekonomikë kërkohen të jenë të certifikuar nga prodhuesit për ndërhyrjet operative si dhe komunikimin me ta, kështu që është i nevojshëm suporti i tyre. Stafi i Drejtorisë së IT nuk është i certifikuar nga prodhuesi. Në rrjetin e Albcontrol SHA ka teknologji të avancuara sipas kërkesave dhe standardeve që punon Albcontrol SHA ka teknologji të avancuara sipas kërkesave dhe standardeve që punon Albcontrol SHA dhe stafi i Drejtorisë së IT-së bën operimin e përditshëm në këto sisteme po jo detyrimisht janë certifikuar dhe të kualifikuar në nivelet e larta të operimit në këto teknologji. Drejtoria e IT duke patur të qarta detyrat e veta, i realizon ato, duke organizuar punën brenda Drejtorisë dhe duke kontraktuar kompani të specializuara që ndihmojnë në kryerjen e këtyra detyrave dhe duke ndjekur suportet nga prodhuesit. Kjo arrihet duke menaxhuar sa më saktë stafin e brendshëm, kontraktorët dhe prodhuesit. Subjekti i audituar parashtron dhe sqarimet mbi nivelet e shërbimit dhe sqaron se duke qenë se teknologjitë e implementuara ecin me ritme shumë të shpejta duhet që institucioni t'u përgjigjet me trajnim të stafit në momentin që prodhuesit nxjerrin produkte të reja apo përditësime të produkteve ekzistuese. Misioni i kompanisë dhe strukturave të saj është ofrimi i shërbimit të lundrimit ajror në kushtet e parrezikshmërisë, dhe detyrat funksionale të strukturës së Drejtorisë së TI, janë përshtatur me kompetencat e nivelit të parë të ndërhyrjes për të mos cënuar standardet e sigurisë. Për këtë arsye subjekti pretendon se nuk ka mbivendosje të shërbimeve por garanci për vijueshmërinë e shërbimit 24x7 për sistemet kritike.*

***Qëndrim i grupit të auditimit:***
Observimi i mësipërm nuk paraqet asnjë dokumentacion apo bazë ligjore shtesë për të kundërshtuar atë çfka ka konstatuar grupi i auditimit. Ashtu sikurse edhe parashtuar nga vetë stafi i Albcontrol, nivelet e larta të mirëfunksionimit të teknologjive të prokuruara mbulohen nga prodhuesi dhe jo nga operatorët ekonomikë. Në këtë procedurë prokurimi, në opinionin e grupit të auditimit, shërbimi i mirëmbajtjes që është kërkuar të ofrohet nga operatori ekonomik nuk i tejkalon detyrat që rregullorja e brendshme e Albcontrol përcakton për punonjësit e Drejtorisë së IT, dhe pikëpamja nëse stafi i Drejtorisë së IT është apo jo i certifikuar dhe kualifikuar në nivelet e larta të operimit për teknologjitë që përdor Albcontrol

| |
|---|
| nuk lidhet me konstatimet e grupit të auditimi. Për sa më sipër observacioni i paraqitur nuk merret parasysh. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në procedurën e prokurimit ***"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019*** dhe shpenzim i fondeve pa eficiencë në vlerën 4,233,360 lekë pa TVSH. |
| **Situata:** | 1. Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 441/1, datë 15.02.2019, në pikën **5.** KËRKESAT TEKNIKE ndër të tjera janë kërkuar dy komponente kryesore, rinovimi i suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve si dhe shërbime të mirëmbajtjes së pajisjseve nga ana e OE. Ky specifikim përbën mbivendosje të shërbimeve që janë kërkuar nisur nga fakti se rinovimi i suportit të prodhuesit nënkupton, ndërhyrjen e prodhuesit të pajisjeve dhe të sistemeve për marrjen e masave korrigjuese ose ndërrimin e pajisjeve në raste të problematikave madhore që mund të shfaqen gjatë përdorimit të pajisjeve.<br>Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të Albcontrol sha, Pika 1 d) përcaktohet se Sektori i Shërbimeve Taknike ka për detyrë *"Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe OpManager (Sistemi i monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik);"*.<br>Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të Albcontrol sha, Pika 2 përcaktohet se Sektori i Asistencës Informatike ka për detyrë:<br>a. Të sigurojë mbikëqyrje konstante të rrjetit të brendshëm kompjuterik në ñALBCONTROLò SHA;<br>b. Të sigurojë mbikëqyrje konstante të datacenter-it që i përket Drejtorisë IT;<br>c. Të sigurojë mbështetje teknike për printerat dhe PC-të e ñALBCONTROLò SHA;<br>d. Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpermjet biletave elektronike) dhe të gjitha sistemeve të monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik;<br>e. Të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me informacionin që qarkullon, ruhet dhe aksesohet;<br>f. Të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit të e - mail dhe vazhdimësinë e shërbimit të internet-it;<br>g. Të sigurojë shërbimin back - up (kopje rezervë) me qëllim përdorimin e tij në rast defektesh.<br>Pra, për mirëfunksionimin e sistemeve të sigurisë, shërbimeve të rrjetit, sistemit Wireless, sistemit të Telekonferencës, sistemeve të menaxhimit të rrjetit dhe sistemeve të telefonisë, Albcontrol SHA, ka prokuruar në këtë procedurë prokurimi rinovimin e suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve çdka nënkupton sigurimin nga prodhuesi për marrjen e masave korrigjuese në raste të |

| | |
|---|---|
| | problematikave ose avarive që mund të shfaqen. Gjithashtu në strukturën organizative funksionon një drejtori e cila në bazë të rregullores së brendshme të Albcontrol ka për detyrë sigurimin dhe mbikqyrjen e mirëfunksionimit të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të monitorimit të rrjetit të brendshëm. Në këtë procedurë, shoqëria Albcontrol SHA ka kryer investim për zërin ñSuport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçareò, në vlerën 4,233,360 lekë pa TVSH.<br>2. Grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i ngritur me urdhrin 591/5, datë 17.04.2019 <u>nuk ka mbajtur procesverbal</u> për verifikimin e realizimit të zërit ñSuport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetitò për një periudhë 1-vjeçare nga momenti i lidhjes së kontratës, në kundërshtim me pikën 47, kapitulli 3 i udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Grupi i punës i sipërpërmendur ka firmosur raportet mujore të shërbimit të mirëmbajtjes të dorëzuar nga operatori ekonomik, por nuk ka konfirmuar kryerjen e shërbimeve me anë të ndonjë procesverbali.<br>1. Përmes procesverbalit nr. 591/6, datë 21.06.2019, grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 591/5, datë 17.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm ka raportuar implementimin e zërave të mëposhtëm :<br>- Rinovim suporti për pajisjet Router;<br>- Rinovim suporti për pajisjet Switching;<br>- Rinovim suporti për pajisjet Firewall dhe licencat e shërbimeve të ofruara (AMP, IPS, Remote VPN);<br>- Rinovim suporti për serverat e Call Manager dhe licencave përkatëse;<br>- Rinovim suporti për Voice Gateway;<br>- Rinovim suporti për pajisjet Wireless;<br>- Zgjidhje e integruar për sistemet e sigurisë së rrjetit.<br>Për asnjë nga zërat e mësipërm nuk është përgatitur Fletë-Hyrja përkatëse në magazinën e Albcontrol SHA, çka bie në kundërshtim me nenin 37 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar |
| **Kriteri:** | 1) Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Albcontrol SHA;<br>2) Pikëa 47, Kapitulli 3 i Udhëzimit Nr. 30, ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò Datë 27.12.2011, i ndryshuar.<br>3) Neni 37 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar |
| **Ndikimi/Efekti:** | Përdorim i fondeve të shoqërisë pa eficiencë dhe mos dokumentim i aktiveve të institucionit. |
| **Shkaku:** | Mos analizim i saktë i nevojave dhe kërkesave të shoqërisë në lidhje me investime në drejtim të shërbimeve IT. Mosnjohje dhe |

| | |
|---|---|
| | mosvlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të marrë masa për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse në lidhje me prokurimin e paargumentuar të një shërbimi i cili i mbivendoset detyrave që rregullorja e brendshme e Albcontrol përcakton se duhet të kryhen nga strukturat e brendshme të shoqërisë.<br>2. Me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve pa eficiencë, në të gjithë procedurat e prokurimit që lidhen me sisteme të IT që do të zhvillohen në të ardhmen, divizionet përkatëse të arsyetojnë dhe argumentojnë nevojat dhe përfitimet që do të ketë shoqëria përmes realizimit të procedurave të prokurimit që lidhen me shërbime të sistemeve IT për çdo zë të veçantë.<br>3. Albcontrol SHA të marrë masa që në të ardhmen të dokumentojë përmes procesverbaleve përkatës dorëzimin e shërbimeve apo mallrave. |
| **Pretendimi i subjektit:** | Në sisteme dhe në rrjet punohet në nivele të ndryshme operimi. Prodhuesit nuk operojnë në nivele te ulta por operojnë në nivele të larta në të cilat përfshihen mirëmbajtjet korrigjuese të defekteve madhore dhe ndërrim fizik në raste të nevojshme, upgrade/update. Operatorët ekonomikë kërkohen të jenë të certifikuar nga prodhuesit për ndërhyrjet operative si dhe komunikimin me ta, kështu që është i nevojshëm suporti i tyre. Stafi i Drejtorisë së IT nuk është i certifikuar nga prodhuesi. Në rrjetin e Albcontrol SHA ka teknologji të avancuara sipas kërkesave dhe standardeve që punon Albcontrol SHA ka teknologji të avancuara sipas kërkesave dhe standardeve që punon Albcontrol SHA dhe stafi i Drejtorisë së IT-së bën operimin e përditshëm në këto sisteme po jo detyrimisht janë certifikuar dhe të kualifikuar në nivelet e larta të operimit në këto teknologji. Subjekti i audituar parashtron dhe sqarimet mbi nivelet e shërbimit dhe sqaron se duke qenë se teknologjitë e implementuara ecin me ritme shumë të shpejta duhet që institucioni tâu përgjigjet me trajnim të stafit në momentin që prodhuesit nxjerrin produkte të reja apo përditësime të produkteve ekzistuese. Misioni i kompanisë dhe strukturave të saj është ofrimi i shërbimit të lundrimit ajror në kushtet e parrezikshmërisë, dhe detyrat funksionale të strukturës së Drejtorisë së TI, janë përshtatur me kompetencat e nivelit të parë të ndërhyrjes për të mos cënuar standardet e sigurisë. Për këtë arsye subjekti pretendon se nuk ka mbivendosje të shërbimeve. |
| **Qëndrimi i grupit të auditimit:** | Observimi i mësipërm nuk paraqet asnjë dokumentacion apo bazë ligjore shtesë për të kundërshtuar atë çâka ka konstatuar grupi i auditimit. Ashtu sikurse edhe parashtuar nga vetë stafi i Albcontrol, nivelet e larta të mirëfunksionimit të teknologjive të prokuruara mbulohen nga prodhuesi dhe jo nga operatorët ekonomikë. Në këtë procedurë prokurimi, shërbimi i mirëmbajtjes që është kërkuar të ofrohet nga operatori ekonomik nuk i tejkalon detyrat që rregullorja e brendshme e Albcontrol përcakton për punonjësit e Drejtorisë së IT, dhe pikëpamja nëse stafi i Drejtorisë së IT është apo jo i |

| | |
|---|---|
| | certifikuar dhe kualifikuar në nivelet e larta të operimit për teknologjitë që përdor Albcontrol nuk lidhet me konstatimet e grupit të auditimi. Për sa më sipër observacioni i paraqitur nuk merret parasysh. |

**7.22. prokurimi me objekt *"Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 839, datë 08.04.2019, e Z. M. E., me detyrë Drejtor i Divizionit Teknik për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñ*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL"* nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

Është konstatuar se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.839/1, datë 08.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me Nenin 23, pika 4, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar në të cilin citohet se : *"Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin".*

Ky konstatim është arritur nisur nga fakti se në procesverbalin nr. 839/2 prot., datë 21.02.2019 nuk është paraqitur asnjë diagramë rrjeti apo model lidhjeje të pajisjeve ekzistuese me qëllim njohjen e operatorëve ekonomikë me të gjitha kushtet dhe rrethanat me rëndësi për hartimin e ofertës.

Është konstatuar se procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 839/4, datë 29.05.2019 i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 228/3, datë 28.01.2019 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri.

Duke qenë se procedura e përzgjedhur ka qenë ñKërkesë për propozimò AK ka njoftuar për të paraqitur propozime 5 OE dhe konkretisht ñS. C.ò, ñE.ò, ñI. S.ò, ñC.M.C. G.ò, ñR.ò, por nuk ka asnjë argumentim për të arsyetuar përzgjedhjen e këtyre operatorëve ekonomikë çdò ka nuk është në përputhje me pikën 4 të Nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 óPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô në të cilën citohet se *"Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë".*

Përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 17.06.2019, të mbajtur në ambientet e Albcontrol SHA nga KVO dhe NjP është përcaktuar si ofertues i parë dhe i vetëm ñR.ò sh.p.k. i cili ka paraqitur OE në vlerën 5,156,000 lekë pa TVSH.
Përmes procesverbalit të shqyrtimit të ofertave të mbajtur më datë 17.06.2019 nga KVO, ka rezultuar si ofertues i suksesshëm dhe fitues Operatorin Ekonomik ñR.ò sh.p.k..
Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA., më datë 25.06.2019 ka lidhur kontratën nr.1225/3, me operatorin ekonomik ñR.ò sh.p.k **në vlerën 5,156,000 lekë pa TVSH.**
Është konstatuar se në nenin 4 õVlera dhe Mënyra e Pagesësô të kontratës nr. 1225/4, datë 27.06.2019 është parashikuar që kontraktori do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 30% të vlerës totale të kontratës. Ky parashikim është i pabazuar ligjërisht pasi ai nuk parashikohet në asnjë bazë ligjore apo rregullatore. Gjithashtu, nisur nga fakti që dhënia e parapagesës nuk është përcaktuar që në hatimin e specifikimeve teknike dhe të dokumenteve standarde të tenderit, ndjekja e një procedure të tillë edhe pse akti i paradhënies nuk ndalohet me ndonjë dispozitë të veçantë, nuk përbën arsye për përdorimin e saj pasi nuk garanton siguri për trajtim të barabartë për ofertuesit sikurse parashikohet në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.
Duke përcaktuar parapagimin e 30% të vlerës së kontratës, vlerë e përcaktuar pa asnjë argumentim, pasi në kushtet konkrete mund të ishte edhe 29% edhe 31% ose çfarëdo vlere tjetër, autoriteti kontraktor shkel të gjithë qëllimet e sipërpërmendur pasi operatorët e tjerë ekonomikë, të cilët mund të jenë të interesuar për të konkurruar në këtë procedurë, mund të paraqisin oferta ekonomike më të ulta nëse parashikojnë se 30% e vlerës së kontratës do të parapaguhet nga ana e autoritetit kontraktor.
Nga auditimi i likuidimit dhe zbatimit të kontratës është konstatuar se grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i ngritur me urdhrin nr. 1225/5, datë 27.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm ka mbajtur procesverbalin përkatës për çdo punim apo shërbim të kryer nga ana e kontraktorit si dhe ka dokumentuar aprovimin e raporteve periodike të hartuara nga kontraktori në lidhje me zbatimin e detyrimeve që lindin nga kjo kontratë. Në raste specifike kryerja e punimeve apo shërbimeve është dokumentuar në raportet e punës edhe përmes fotografive dokumentuese përkatëse.

**1. *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 1182, datë 22.05.2019, e Znj. L.R., me detyrë Drejtore e Divizionit të Marrëdhenieve me Palët e Treta për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñSistem INTRANET të ALBCONTROL SHAò nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.
Procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 1182/4, datë 16.09.2019 i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1182/4, datë 16.09.2019 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të Ligjit nr. 9643, Datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri.
Nga verifikimi në të dhënat zyrtare të QKB rezulton se OE ñN. E.ò shpk nuk ka në objektin e tij të aktivitetit zhvillimin apo implementimin e aplikacioneve web dhe marrja për bazë e kësaj oferte për përllogaritjen e fondit limit nuk është në përputhje me pikën 2 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshar, në të cilin citohet se: *"Në përllogaritjen e vlerës*

*limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:*

- *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.);*
- *ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe*
- *b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

*c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht".*

Duke qenë se procedura e përzgjedhur ka qenë ñKërkesë për propozimò AK ka njoftuar për të paraqitur propozime 5 operatorë ekonomikë dhe konkretisht ñS.ò ñC.O.ò, ñB.T. S.ò, ñN. E.ò, ñH. S.ò, ñA.E.D. S.ò, por nuk ka asnjë argumentim për të arsyetuar përzgjedhjen e këtyre operatorëve ekonomikë çôka bie në kundërshtim me pikën 4 të Nenit 39 të VKM 914, datë 29.12.2014 óPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikô në të cilën citohet se *"Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë".*

Përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 26.11.2019, të mbajtur në ambientet e unga KVO dhe Njësia e Prokurimit është përcaktuar si ofertues i parë dhe i vetëm ñBNT Electronicsò sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 1,333,100 lekë pa TVSH në të cilën është përcaktuar që afati kohor për ekzekutimin e shërbimit/blerjes do të jetë 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës**.**

Përmes procesverbalit të shqyrtimit të ofertave të mbajtur më datë 27.11.2019 nga KVO, ka rezultuar si ofertues i suksesshëm dhe fitues OE ñB.N.T. E.ò sh.p.k.. Për këtë procedure prokurimi, Albcontrol SHA, më datë 16.12.2019 ka lidhur kontratën nr. 2076/4, me OE ñB.N.T. E.ò **në vlerën 1,333,100 lekë pa TVSH.**

Është konstatuar se nga ana e kontraktuesit nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor kodi burim i SPE dhe në format shkresor sikurse përcaktohet në pikën **9. Të Drejtat e Kodit të Aplikacionit**, të specifikimeve teknike të hartuara përmes procesverbalit Nr. 1182/2, Datë 02.09.2019 të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1182/1, datë 22.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Pavarësisht se sistemi është hostuar në infrastrukturën fizike të Albcontrol SHA dhe menaxhimi dhe administrimi i tij kryhet nga ana e Albcontrol SHA, nga ana e operatorit ekonomik në përputhje me kontratën nr. 2076/4, datë 16.12.2019 duhet të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, kodi burim i sistemit në format shkresor dhe elektronik.

Nga verifikimi i kryer ne terren, është konstatuar se sistemi i Intranet të Albcontrol nuk është përdorur në asnjë rast për nevoja të shoqërisë apo për mbështetjen e proceseve të punës së shoqërisë. Nga gjurmët e auditimit të veprimeve të kryera në sistemin Intranet të Albcontrol konstatohet se që nga momenti i implementimit të sistemit, pra data 16.01.2020 deri më datë 27.09.2021 në sistem janë kryer vetëm veprime në formën e testimeve nga kontraktori ose nga punonjës së strukturave IT të Albcontrol, gjithsej 21 veprime. (Aneksi nr. 1).

Nisur nga sa më sipër, investimi i kryer nga Albcontrol SHA për zhvillimin e një sistemi Intranet, në vlerën 1,333,100 lekë pa TVSH, ose **1,599,720 lekë ne TVSH** nuk është shfrytëzuar për të kryer funksionet për të cilët është investuar në të nga shoqëria dhe nuk është kryer ndonjë analizim i shkaqeve prej të cilëve ka ardhur kjo situatë. Vlera e sipërpërmendur konsiderohet si përdorim i fondeve pa efektivitet.

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në zbatimin e kontratës ***"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019*** *dhe përdorim i fondeve pa efektivitet në vlerën 1,333,100 lekë pa TVSH ose 1,599,720 lekë me* |

| | |
|---|---|
| | *TVSH* |
| **Situata:** | 1. Nga ana e kontraktuesit nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor kodi burim i sistemit në format elektronik dhe në format shkresor sikurse përcaktohet në pikën **9. Të Drejtat e Kodit të Aplikacionit**, të specifikimeve teknike të hartuara përmes procesverbalit nr. 1182/2, datë 02.09.2019 të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1182/1, datë 22.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Pavarësisht se sistemi është hostuar në infrastrukturën fizike të Albcontrol SHA dhe menaxhimi dhe administrimi i tij kryhet nga ana e Albcontrol SHA, nga ana e operatorit ekonomik në përputhje me kontratën nr. 2076/4, datë 16.12.2019 duhet të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, kodi burim i sistemit në format shkresor dhe elektronik.<br>2. Sistemi i Intranet të Albcontrol nuk është përdorur në asnjë rast për nevoja të shoqërisë apo për mbështetjen e proceseve të punës së shoqërisë. Nga gjurmët e auditimit të veprimeve të kryera në sistemin Intranet të Albcontrol konstatohet se që nga momenti i implementimit të sistemit, pra data 16.01.2020 deri më datë 27.09.2021 në sistem janë kryer vetëm veprime në formën e testimeve nga kontraktori ose nga punonjës së strukturave IT të Albcontrol, gjithësej 21 veprime. |
| **Kriteri:** | 1) Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Albcontrol;<br>2) Dokumentet Standarde të Tenderit. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Përdorim i fondeve të shoqërisë pa efektivitet dhe mos dokumentim i aktiveve të institucionit. |
| **Shkaku:** | Mos analizim i saktë i nevojave dhe kërkesave të shoqërisë në lidhje me investime në drejtim të shërbimeve IT. Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të marrë masa për analizimin e situatës aktuale, të nevojës së institucionit për këtë sistem dhe nxjerrjen e rezultateve për të konstatuar përgjegjësitë përkatëse dhe arsyet e mos-përdorimit të sistemit Intranet të Albcontrol. Në rast se nga analizimi i situatës rezulton se sistemi INTRANET është i dobishëm për shoqërinë të marren masa për të organizuar punën e divizioneve përkatës me qëllim shfrytësimin e sistemit me kapacitet të plotë për nevojat e shoqërisë. |

***7.23. Prokurimi me objekt "<u>Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System</u>" – Faza III", viti 2019;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 228, datë 25.01.2019, e Z. M. E., me detyrë Drejtor i Divizionit Taknik për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019"* nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së

prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.
Është konstatuar se procesverbali i përllogaritjes së fondit limit nr. 228/4, datë 30.01.2019 i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 228/3, datë 28.01.2019 nuk ka të bashkëlidhur shkresën dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA, veprime të cilët nuk janë në përputhje me Pikën 4 të Nenit 48 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA.
Është konstatuar se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.228/1, datë 25.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, i përbërë nga Z. E.B., Znj. J.B. dhe Znj. M.J. nuk janë hartuar në përputhje të plotë me nenin 23, pika 1,2,3,4, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar në të cilin citohet se : *"Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*
*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*
*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*
*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*
*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*
*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*[2]*.*
*Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin."*.

[2] Shtuar me ligjin 131/2012ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar

Ky konstatim arrihet nisur nga fakti se në procesverbalin nr. 228/1 prot., datë 25.01.2019 nuk është paraqitur asnjë skemë e mënyrës së vendosjes së sistemit të akses control. Gjithashtu në specifikime teknike nuk është përcaktuar asnjë diagramë apo skicë të ambienteve ku do të implementohet ky sistem. Në specifikime teknike nuk ka asnjë informacion për sistemet ekzistuese të Albcontrol SHA, me të cilët kërkohet që të implementohet sistemi që do të prokurohet në këtë procedurë. Në specifikimet teknike nuk përcaktohet asnjë paragraf në lidhje me mënyrën e lidhjes së sistemeve dhe pajisjeve. Sa më sipër konkludojnë në risk për pamundësi për njohjen e operatorëve ekonomikë me të gjitha kushtet dhe rrethanat me rëndësi për hartimin e ofertës duke mbartur risk për favorizim të operatorëve ekonomikë të cilët për shkak të kontratave të mëparshme të lidhura me Albcontrol SHA mund të kenë njohuri dhe informacion për sistemet ekzistuese të shoqërisë.
Në specifikime teknike është përcaktuar një zë i veçantë ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, zë i cili është përcaktuar tre herë, konkretisht në pikën A.10, B.8, C.6 sipas ambienteve ku është kërkuar të instalohet sistemi i akses control-it.
Në opinionin e grupit të auditimit, me përjashtim të paraqitjes së skicave AS Build, ky është një shërbim i cili duhet të kryhet një herë dhe nuk duhej të përsëritej sipas ambienteve të shoqërisë, pasi integrimi me SE ekzistues të menaxhimit të akses control, trajnimi dhe integrimi me Rostering System janë shërbime që kryhen në tërësi për sistemin dhe jo sipas ambienteve përkatëse.
Në specifikime teknike është përcaktuar një zë i veçantë, ñSoftware Klientiò, dhe një zë i veçantë ñPC Klientiò.
Në opinionin e grupit të auditimit, për aq kohë sa pajisjet e instaluara të kontrollit të aksesit janë integruar në sistemin aktual të Akses Control të Albcontrol SHA prokurimi i një ñPC klientiò dhe një ñSoftware Klientiò nuk i shërbejnë realizimit të qëllimit që do të arrijë Albcontrol SHA përmes këtij investimi.
Përcaktimet e mësipërme në specifikime teknike mbartin risk për mos-llogaritje të saktë dhe rritje të paargumentuar të fondit limit të kësaj procedure.
Vlera totale e zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, sipas ofertës fituese të ofruar nga operatori ekonomik me të cilin është lidhur kontrata nr. 281/4, datë 06.03.2019 rezulton të jetë në vlerën 4,668,900 lekë pa TVSH ose 5,602,680 lekë me TVSH.
Vlera totale e zërit ñPC Klientiò dhe zërit ñSoftware Klientiò, sipas ofertës fituese të ofruar nga operatori ekonomik me të cilin është lidhur kontrata nr. 281/4, datë 06.03.2019 rezulton të jetë:
- ñP.C.ò Klienti në vlerën 205,000 lekë pa TVSH ose 246,000 lekë me TVSH.
- ñS.ò Klienti në vlerën 135,000 lekë pa TVSH ose 162,000 lekë me TVSH.

Është konstatuar se në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon :
*"Kontrata të ngjashme në një vlerë sa 40 % të vleres se fondit limit që prokurohet ne fushen e sigurise ne aviacionin civil, të realizura gjatë tre viteve të fundit financiare. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe vërtetime të cilësisë së kryerjes së shërbimit. Kur sherbimi i se njejtes natyre eshte realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara."*
Përcaktimi i këtij kriteri në opinionin e grupit të auditimit konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil,

por janë sisteme që funksiojnë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.
òNë Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 3 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon :
*"Operatori ekonomik, duhet të jetë në zoterim të çertifikates* ***ISO 14001:2015*** *mbi "Sistemet e menaxhimit të ambjentit". Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetëe e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetarët e bashkimit duhet të jenëe në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me to."*
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik, duhet të jetë në zotërim të certifikates PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetaret e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kesaj certifikate. Ose ekuivalente me to."*
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 7 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë në zotëerim të certifikates për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetaret e bashkimit duhet të jenëe në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me to."*
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 8 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë në zotërim të certifikates për sistemin e menaxhimit të pergjegjshmërisë sociale SA 8000:2014. Çertifikata që do të paraqitet kerkohet të jetë e vlefshme nëe kohen e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anetaret e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kesaj certifikate. Ose ekuivalente me to."*
Në opinionin e grupit të auditimit, pavarësisht se për të gjithë certifikatat e sipërpërmendura është përdorur termi ñose ekuivalente me toò, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e objektit të procedurës.
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 9 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik, duhet të ketë të punësuar në stafin e tij minimumi 30 persona mesatarisht për periudhen Janar 2018 - Janar 2019, të vertetuar me listepagesat sipas formularit E-sig025a."*
Ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi dhe konsiderohet një kërkesë e tepërt për aq kohë sa afati i lëvrimit është përcaktuar të jetë 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe operatorët ekonomikë mund ta realizojnë këtë procedurë me sukses edhe me një numër më të ulët punonjësish.
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 11 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin e mëposhtëm:*

1) *Inxhinier Ndertimi 1 (një)*
2) *Inxhinier Mekanik 1 (një)*
3) *Inxhinier Mjedisi 1 (një)*
4) *Inxhinier Elektrik 1 (një)*

*Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në listpagesat e shoqërisë dhe në* ***<u>Licencën e Shoqërisë si Drejtues Teknik.</u>*** *Për secilin prej pjestarëve të stafit teknik ofertuesi duhet të paraqesë diplomë, kontrate pune si dhe CV përkatëse."*

Autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar asnjë argumentim për këtë kriter të hartuar. Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për 1 (Një) Inxhinier Ndërtimi dhe 1 (Një) Inxhinier Mjedisi është e tepërt pasi nuk lidhen me realizimin e objektit të kësaj procedure prokurimi.
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 14 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: *"Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin", të figurojnë në listepagesat e shoqerisë. Detyrimisht të paraqitet kontratë pune dhe certifikata perkatese. (në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik ky kriter duhet plotësuar nga të gjithë operatorët)."*
Ky kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor nuk lidhet me asnjë pjesë të realizimit të objektit të kësaj procedure prokurimi dhe për këtë arsye nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në tender.
Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 15 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori, duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e vetë punonjësit e kualifikuar si më poshtë:*

a. *1 teknik ndertimi*
b. *1 saldator*
c. *1 hidraulik*
d. *1 elektricist*
e. *1 Elektromekanik*

*Për secilin duhet te paraqiten:*

- *Kontrata e punes dhe deshmi kualifikimi*ò

Kërkesa e 1 teknik ndërtimi, 1 saldator dhe 1 hidraulik në kriteret e kualifikimit të kësaj procedure nuk lidhet me realizimin e objektit të kësaj procedure prokurimi dhe rrjedhimisht nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë për këtë procedurë prokurimi.
Përcaktimet e kritereve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë në përputhje të plotë me Pikën ñcò të Nenit ñ2ò të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar në të cilin citohet se : *"Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
Përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 25.02.2019, të mbajtur në ambientet e Albcontrol SHA nga KVO dhe NjP është përcaktuar si ofertues i parë dhe i vetëm ñR.ò sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën **52,972,212 lekë pa TVSH.**
Përmes procesverbalit të shqyrtimit të ofertave të mbajtur më datë 25.02.2019 nga KVO, ka rezultuar si ofertues i suksesshëm dhe fitues Operatorin Ekonomik ñR.ò sh.p.k.. Përmes këtij procesverbali KVO, ka sugjeruar vijimin e hapave të mëtejshëm të zhvillimit të procedurës së prokurimit.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga auditimi në SPE konstatohet se operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertë ka mungesë në dokumentacioni, konkretisht në kriterin e kërkuar ó3 punonjës ñInxhinier Elektronikòô dhe kjo mangësi në dokumentacion nuk është marrë parasysh nga KVO, çdka nuk është në përputhje me përcaktimin në pikën 3 të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, në të cilën citohet se : *"Pas mbylljes së seancës publike, KVO verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, KVO kërkon sqarime nga ofertuesit, të 42 cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal."*
Në datë 25.02.2019, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar raporti përmbledhës për miratimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit nr. 281, raport i cili mban nr. 281/2, i datës 25.02.2019.

Në datë 07.02.2019 është administruar në Albcontrol SHA, formulari i ankesës nr. 365 prot., datë 07.02.2019 i dorëzuar në format shkresor nga operatori ekonomik ñP.C. S.ò sh.p.k. Nga verifikimi i grupit të auditimit në SPE rezulton që kjo ankesë nuk është plotësuar apo ngarkuar në sistemin e prokurimeve.
Në këtë ankesë operatori ekonomik ñP.C. S.ò sh.p.k ka parashtruar pretendimet dhe ankesat e tij në lidhje me DST për këtë procedurë prokurimi, në drejtim të përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor për kapacitetin teknik dhe ligjor të ofertuesve që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi. Operatori ekonomik ñP.C. S.ò sh.p.k ka paraqitur në ankesën e tij 9 çështje për të cilat ka kërkuar ndryshimet përkatëse në DST.
Albcontrol SHA i është përgjigjur kësaj ankese përmes shkresës nr. 365/1, datë 08.02.2019 drejtuar operatorit ekonomik ñP.C. S.ò sh.p.k. përmes së cilës ka bërë me dije se ankesa e paraqitur nga ky operator ekonomik ka mbëritur në autoritetin kontraktor më datë 07.02.2019, datë e cila është në tejkalim të afatit ligjor për paraqitjen e ankesave nga operatorët ekonomikë për këtë procedurë prokurimi.
Ankesa ka mbëritur në autoritetin kontraktor jashtë afateve të parashikuara në legjislacionin mbi prokurimin publik por administrimi i kësaj ankese nuk është kryer në përputhje të plotë me pikën 6 të nenit 78 të VKM 914, datë 29.12.2014 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar në të cilën citohet se: ñPër shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:
*a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm i cili duhet të jetë ekspert fushe. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.*
*b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj.*
*c) Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimuesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autorieti kontraktor ta sigurojë këtë informacion.*
*ç) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës i komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formul arin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit".*
Nga grupi i auditimit konstatohet se edhe pse ankesa e depozituar është jashtë afateve të parashikuara në legjislacion, hapat e mësipërm që parashikohen në VKM nuk janë ndjekur në mënyrë rigoroze për shqyrtimin e ankesës së sipërpërmendur.
Është konstatuar se në Nenin 4 ôVlera dhe Mënyra e Pagesësô të kontratës nr. 281/4, datë 06.03.2019 është parashikuar që kontraktori do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 30% të vlerës totale të kontratës. Ky parashikim është i pabazuar ligjërisht pasi ai nuk parashikohet në asnjë bazë ligjore apo rregullatore. Gjithashtu, nisur nga fakti që dhënia e parapagesës nuk është përcaktuar që në hatimin e specifikimeve teknike dhe të dokumenteve standarde të tenderit, ndjekja e një procedure të tillë edhe pse akti i paradhënies nuk ndalohet me ndonjë dispozitë të veçantë, nuk përbën arsye për përdorimin e saj pasi mbart riskun e

mos-nxitjes së operatorëve ekonomikë për pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi dhe mos-trajtim të barabartë për ofertuesit që mund të kenë interes pë pjesëmarrje.
Pas paraqitjes së Formularit të Njoftimit të Fituesit nr. 281/3, datë 05.03.2019, ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE ñR.ò sh.p.k. është lidhur kontrata nr. 281/4, datë 06.03.2019.
Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës nr. 56767532 të datës 06.03.2019 30% paradhënie për kontratën me objekt: ñInstalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me Rostering System ï Faza IIIò, në vlerën 15,891,663 lekë pa TVSH ose 19,069,996 lekë me TVSH.
Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës nr. 51805207 të datës 24.06.2019 në vlerën 23,165,950 lekë me TVSH për furnizimet dhe shërbimet e kryera të përcaktuara në Situacionin nr. 1 të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 281/6, datë 24.06.2019.
Situacioni nr.1 është sigluar nga anëtarët e grupit të punës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës i ngritur me urdhrin nr. 281/5, datë 06.03.2019, grup i cili ka hartuar relacionin nr. 281/7, datë 26.06.2019. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në këtë relacion ndër të tjera është përcaktuar instalimi i sistemit të evakuimit zanor por nuk janë përcaktuar të gjithë zërat përkatës sipas Situacionit nr. 1, çka nuk është në përputhje të plotë me nenin 36 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, ndryshuar në të cilin citohet se: *"Dokumentacioni quhet i rregullt kur pershkruan me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhena te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative12. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eleminojne mundesine per gabime, harresa, numerim te dyfishte si dhe ate te mashtrimeve".*
Bashkëlidhur Situacionit të sipërpërmendur dhe faturës është mbajtur procesverbali i trajnimit për Sistemin e Evakuimit Zanor dhe Mesazheve Publike (VAS) i cili është siguluar nga anëtarët e grupit të punës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe punonjësit e shoqërisë të cilët janë trajnuar.
Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës nr. 51805185 të datës 05.07.2019 në vlerën 21,330,708 lekë me TVSH për furnizimet dhe shërbimet e kryera të përcaktuara në Situacionin nr. 2 të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 281/8, datë 05.07.2019.
Situacioni nr. 2 është siguluar nga anëtarët e grupit të punës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës i ngritur me urdhrin nr. 281/5, datë 06.03.2019, grup i cili ka hartuar relacionin nr. 281/9, datë 08.07.2019. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në pikën ñIntegrimi me Rostering Systemò të Situacionit nr. 2 është përcaktuar si vijon: ñSistemi është konfiguruar në mënyrë që të prodhojë një raport ditor me hyrjen e parë, daljen e fundit dhe kohëzgjatjen e periudhës së punës për çdo punonjës të Albcontrol, i cili u transmetohet burimeve njerëzore në formën e e-mailit. Të gjitha instalimet e reja janë përfshirë në këtë raport dhe tashmë përfshijnë godinën e Administratës dhe ambientet e Meteorologjisë dhe AROò.
Në opinionin e grupit të auditimit metoda e ndjekur si më sipër cituar nuk konsiderohet si integrim i sistemit të akses control me Rostering System pasi integrimi konsiston në komunikimin e sistemeve automatikisht pa ndëhyrje manuale të përdoruesve për transmetimin e të dhënave, si rezultat zëri ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, me vlerë 4,668,900 lekë pa TVSH ose **5,602,680 lekë me TVSH** konsiderohet i parealizuar pjesërisht.

*Për sa më sipër, subjekti i audituar ka paraqitur observacionet përmes shkresës nr. 445/6, Datë 14.12.2021, duke sqaruar si vijon : Në vijim dhe të qëndrimit tonë në observacionin nr. 16, për këtë çështje për sa i përket përcaktimit të kriterit të kontratave të ngjashme në fushën e sigurisë së aviacionit civil, sqarojmë se janë pikërisht elementet e sigurisë së aviacionit civil që e bëjnë specifik sistemin e akses kontrollit dhe të evakuimit në raste alarmi për aviacionin civil dhe këta elementë janë thelbësorë, ndaj përvoja në këtë fushë duhet të mbahet në konsideratë përtej aftësisë për të ngritur sisteme të tilla sipas parimeve dge standardeve të përgjithshme. Albcontrol SHA si ofruesi i vetëm i shërbimit të Lundrimit Ajror në RSH është kategorizuar si një institucion i rëndësisë së vecantë, pjesë e infrastrukturës kritike, dhe ka të përcaktuara ndarjet në zona të kufizuara të sigurisë, për territorin e jashtëm dhe ambjentet e brendshme të tij. Siguria e këtij institucioni është një aspekt i rregulluar nga baza ligjore e mëposhtme :*

*- VKM nr. 1115, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil";*

*-ICAO-Doc 8973;*

*-ECAC-Doc No 30.*

*Kjo bazë ligjore e përcakton godinën operacionale të Albcontrol SHA ashtu si dhe sitet ku janë instaluar pajisje kritike si zona të kufizuara të sigurisë për të cilat rregulloret e mësipërme përcaktojnë masat e sigurisë fizikë, sigurisë së të dhënave po ashtu dhe masat për mbrojtjen e këtyre shërbimeve dhe programet e kontigjencës për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve. Përvec kufizimeve fizike të dukshme, këto zona janë ndarë në veçanti me implementimin e sistemit të akses kontrollit, i cili mundëson kufizimin e lëvizjeve dhe parandalimin hyrjeve të paautorizuara të personave pjesë e personelit të Albcontrol SHA, apo personelit të ofruesit të shërbimit/shërbimeve të jashtme të Albcontrol SHA, në zonën apo zonat e ndryshme të sigurisë ose në pjesët kritike të këtyre zonave të cilat nuk janë në fokusin e punës së tyre. Për sa më lart, hartimi i specifikimeve teknike për këtë sistem është mbështetur në përcaktimet ligjore që rregullojnë aspektet e sigurisë dhe parrezikshmërisë për institucionet e rëndësisë së vecantë, pjesë e infrastrukturës kritike.*

*Përmes shkresës nr. 445/6, datë 14.12.2021, subjekti i audituar sqaron gjithashtu mbi domosdoshmërinë e përcaktimit të kriterit se operatori ekonomik duhet të ketë kryer punime të ngjashme dhe arsyeton pse është kërkuar ky kriter.*

*Në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit se zërat "PC Klienti" dhe "Software Klienti" nuk janë realizuar, subjekti i audituar ka paraqitur observacionin se dorëzimi i këtyre mallrave vërtetohet me relacionin nr. 281/9, datë 08.07.2019 të nënshkruar nga grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës. Gjithashtu subjekti i audituar sqaron se ky investim që është bërë hyrje si sistem, në situacionin nr.2 përfundimtar, datë 05.07.2019, konfirmuar me nënshkrim nga anëtarët e grupit të punës konfirmon lëvrimin e mallrave PC Klienti dhe Software Klienti. Sqarohet se me procesverbalin e dorëzimit të mallit dhe me fletëhyrjen nr.51, datë 05.07.2019 dhe procesverbalin e grupit të punës datë 05.07.2019 malli është bërë hyrje në magazine. Subjekti i audituar por edhe operatori ekonomik përmes shkresës nr.445/6, datë 14.12.2021 kanë paraqitur në observacion prova dokumentare dhe foto (Procesverbal i dates 05/07/2019, fletëhyrje e sistemit, foto të PC Klienti të instaluar në postin e sigurisë, foto të software të sistemit të aksesit të aksesuar nga PC Klienti e instaluar në postin e sigurisë, screenshot të logeve të sistemit të akses kontrollit) që provojnë dorëzimin dhe instalimin e këtij zëri. Ky dokumentacion i është vënë në dispozicion për here të pare grupit të auditimit përmes shkresës nr. 445/6, datë 14.12.2021.*

*Përmes shkresës nr. 445/6, datë 14.12.2021, subjekti i audituar ka praqitur observacionet e përcjella nga operatori ekonomik R. shpk në të cilat sqarohet se objekti i kontratës lidhet me instalimin dhe konfigurimin e sistemit Access Control dhe detyrat e kontraktuesit përfshijnë aktivitete konfigurimi, instalimi, implementimi etj. që në mënyrë aktive targetojnë sistemin*

*Access Control dhe jo ndonjë sistem tjetër të instaluar në Albcontrol. Gjithashtu operatori ekonomik pretendon se gjatë zbatimit të kontratës nuk ka pasur akses dhe as leje për modifikimin e sistemit Rostering. Gjithashtu operatori ekonomik pretendon se sistemi Access Control është i konfiguruar plotësisht për integrimin e me Rostering System. Pra, operatori ekonomik pretendon se i ka përmbushur të gjithë detyrimet kontraktuale që kanë lindur nga kontrata në fjalë.*

***Qëndrim i grupit të auditimit***:

Grupi i auditimit i qëndron konstatimit pasi grupi i auditimit në asnjë moment nuk është shprehur se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender nuk duhet të plotësojnë Standardet ISO dhe të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale. Grupit të auditimit ka shprehur qartë ato kritere të cilët në opinionin e grupit të auditimit janë konsideruar të tepërta për këtë procedurë prokurimi dhe rrjedhimisht nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Grupi i auditimt i qëndron opinionit të tij, pasi grupi i auditmit në asnjë paragraf nuk është shprehur për mos-domosdoshmërinë e kërkesës së dokumentimit të kryerjes së punimeve të mëparshme të ngjashme. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me ngushtimin e spektrit vetëm në shërbimet e aviacionit civil.

Observacioni mbi dorëzimin e produkteve ñSoftware Klientiò dhe ñPC Klientiò konsiderohet sqarues nga grupi i auditimit dhe dokumentacioni i dërguar nga subjekti i audituar dokumenton realizimin dhe dorëzimin e zërave ñPC Klientiò dhe ñSoftware Klientiò. Nisur nga sa më sipër pretendimi dhe observacioni i subjektit të audituar merret parasysh. Dokumentacioni vërtetues i është vënë në dispozicion për here të pare grupit të auditimit përmes shkresës nr. 445/6, datë 14.12.2021.

Në lidhje me realizimin e pjesshëm të zërit të kontratës që lidhet me integrimin e sistemit të Accesss Control me Rostering System, grupi i auditimit i qëndron opinionit të tij duke pasur parasysh se ndërmjet subjektit të audituar Albcontrol SHA dhe operatorit ekonomik është lidhur një kontratë bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës përkatës. Në këto specifikime grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka përcaktuar se operatori ekonomik që do të implementojë sistemin Access Control duhet të bëjë dhe integrimin e Rostering System. Me firmosjen e kësaj kontrate, operatori ekonomik ka marrë përsipër edhe integrimin me Rostering System, punim i cili nuk është realizuar. Përsa i përket observacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, lidhur me shkaqet apo arsyet e mos realizimit të këtij punimi, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që dokumenton ndonjë komunikim midis kontraktorit dhe autoritetit kontraktues lidhur me vështirësitë apo problematikat teknike që mund të lidhen me realizimin e këtij punimi, apo me nivelin e aksesit dhe të drejtën për të ndërvepruar me sistemet ekzistues të Albcontrol sha, pavarësisht se edhe nëse do të kishte një dokumentacion të tillë, nuk do të ishtë një arsyetim që mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale.

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në procedurën e prokurimit ***"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019,*** *dhe mos realzim i detyrimeve kontraktuale me pasojë dëmtimin e fondeve publike.* |
| **Situata:** | 1. Në specifikime teknike është përcaktuar një zë i veçantë, ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, zë i cili është përcaktuar tre herë, konkretisht në pikën A.10, B.8, C.6 sipas ambienteve ku është kërkuar të instalohet sistemi i akses control-it.<br>Shërbimi i instalimit dhe trajnimit është një proces që kryhet në të njëjtën mënyrë dhe nuk ka specifika të veçanta sipas ambienteve |

| | |
|---|---|
| | fizike të shoqërisë dhe në opinionin e grupit të auditimit janë shërbime të cilët duhet të parashikoheshin një herë dhe nuk duhej të përsëriteshin sipas ambienteve të shoqërisë.<br>2. Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon :<br>*"Kontrata të ngjashme në një vlerë sa 40 % të vleres se fondit limit që prokurohet ne fushen e sigurise ne aviacionin civil, të realizura gjatë tre viteve të fundit financiare. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe vërtetime të cilësisë së kryerjes së shërbimit. Kur sherbimi i se njejtes natyre eshte realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara."*<br>Përcaktimi i këtij kriteri në opinionin e grupit të auditimit konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil, por janë sisteme që funksiojnë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.<br>òNë Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 3 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon :<br>*"Operatori ekonomik, duhet te jete ne zoterim te çertifikates* ***ISO 14001:2015*** *mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit". Çertifikata qe do te paraqitet kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Ne rastet e bashkimit te operatoreve te gjithe anetaret e bashkimit duhet te jene ne zoterim te kesaj certifikate ose ekuivalente me to."*<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik, duhet te jete ne zoterim te certifikates PAS 99:2012 per Sistemin e Integruar te Menaxhimit. Ne rastet e bashkimit te operatoreve te gjithe anetaret e bashkimit duhet te jene ne zoterim te kesaj certifikate ose ekuivalente me to."*<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 7 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik ofertues duhet te jete ne zoterim te certifikates per sistemin e menaxhimit te energjise ISO 50001:2011. Çertifikata qe do te paraqitet kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Ne rastet e bashkimit te operatoreve te gjithe anetaret e bashkimit duhet te jene ne zoterim te kesaj certifikate ose ekuivalente me to."*<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 8 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik ofertues duhet te jete ne zoterim te certifikates per sistemin e menaxhimit te pegjegjshmerise sociale* |

| | |
|---|---|
| | *SA 8000:2014 Çertifikata qe do te paraqitet kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Ne rastet e bashkimit te operatoreve te gjithe anetaret e bashkimit duhet te jene ne zoterim te kesaj certifikate ose ekuivalente me to."*<br>Në opinionin e grupit të auditimit, pavarësisht se për të gjithë certifikatat e sipërpërmendura është përdorur termi ósose ekuivalente me toô, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e objektit të procedurës.<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 9 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: *"Operatori ekonomik, duhet te kete te punesuar ne stafin e tij minimumi 30 persona mesatarisht per periudhen Janar 2018 - Janar 2019, te vertetuar me listepagesat sipas formularit E-sig025a."*<br>Ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi dhe konsiderohet një kërkesë e tepërt për aq kohë sa afati i lëvrimit është përcaktuar të jetë 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe operatorët ekonomikë mund ta realizojnë këtë procedurë me sukses edhe me një numër më të ulët punonjësish.<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 11 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar stafin e meposhtem:*<br>*1. Inxhinier Ndertimi*<br>*2. Inxhinier Mekanik*<br>*3. Inxhinier Mjedisi*<br>*4. Inxhinier Elektrik*<br>*Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise dhe në* ***<u>Licencën e Shoqërisë si Drejtues Teknik.</u>*** *Për secilin prej pjestarëve të stafit teknik ofertuesi duhet të paraqesë diplomë, kontrate pune si dhe CV përkatëse."*<br>Autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar asnjë argumentim për këtë kriter të hartuar. Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa e 1 (Një) Inxhinier Ndërtimi dhe 1 (Një) Inxhinier Mjedisi është e tepërt pasi nuk lidhen me realizimin e objektit të kësaj procedure prokurimi.<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 14 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te Ligjit nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht të paraqitet kontratë pune dhe certifikata perkatese. (në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik ky kriter duhet plotësuar nga të gjithë operatorët)."*<br>Ky kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor nuk lidhet me asnjë pjesë të realizimit të objektit të kësaj procedure prokurimi dhe për |

| | |
|---|---|
| | këtë arsye nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në tender.<br>Në Pikën 2.3 të Shtojcës 9 të DST ñKriteret e Veçanta të Kualifikimitò, nënpika 15 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon : *"Operatori, duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e vetë punonjësit e kualifikuar si:[1 teknik ndertimi ; 1 saldator ; 1 hidraulik ; 1 elektricist ; 1 Elektromekanik] Për secilin duhet te paraqiten:*<br>• *Kontrata e punes dhe dëshmi kualifikimi*ò<br>Kërkesa e 1 teknik ndërtimi, 1 saldator dhe 1 hidraulik në kriteret e kualifikimit të kësaj procedure nuk lidhet me realizimin e objektit të kësaj procedure prokurimi dhe rrjedhimisht nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë për këtë procedurë prokurimi. Përcaktimet e kritereve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë në përputhje të plotë me pikën ñcò të Nenit ñ2ò të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.<br>3. Nga auditimi në SPE është konstatuar se operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertë ka mungesë në dokumentacioni, konkretisht në kriterin e kërkuar ó3 punonjës ñInxhinier Elektronikòô, dhe kjo mangësi në dokumentacion nuk është marrë parasysh nga KVO, çdka nuk është në përputhje me përcaktimin në Pikën 3 të Nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, në të cilën citohet se : *"Pas mbylljes së seancës publike, KVO verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, KVO kërkon sqarime nga ofertuesit, të 42 cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal."*<br>4. Autoriteti kontraktor është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës nr. 51805185 të datës 05.07.2019 në vlerën 17,775,590 lekë pa TVSH ose 21,330,708 lekë me TVSH për furnizimet dhe shërbimet e kryera të përcaktuara në Situacionin nr. 2 të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 281/8, datë 05.07.2019.<br>Situacioni nr.2 është siguluar nga anëtarët e grupit të punës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës i ngritur me Urdhrin nr. 281/5, datë 06.03.2019, grup i cili ka hartuar relacionin nr. 281/9, Datë 08.07.2019. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në pikën ñIntegrimi me Rostering Systemò të Situacionit nr. 2 është përcaktuar si vijon : ñSistemi është konfiguruar në mënyrë që të prodhojë një raport ditor me hyrjen e parë, daljen e fundit dhe kohëzgjatjen e periudhës së punës për çdo punonjës të Albcontrol, i cili u transmetohet burimeve njerëzore në formën e e-mailit. Të gjitha instalimet e reja janë përfshirë në këtë raport dhe tashmë përfshijnë godinën e Administratës dhe ambientet e Meteorologjisë dhe AROò.<br>Në opinionin e grupit të auditimit metoda e ndjekur si më sipër cituar nuk konsiderohet si integrim i sistemit të akses control me Rostering System pasi integrimi konsiston në komunikimin e sistemeve automatikisht pa ndëhyrje manuale të përdoruesve për transmetimin e të dhënave, si rezultat zëri óIntegrim me SW |

| | |
|---|---|
| | ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemô, me vlerë 4,668,900 lekë pa TVSH ose **5,602,680 lekë me TVSH** konsiderohet i realizuar pjesërisht. |
| **Kriteri:** | 1) Dokumentet Standarde të Tenderit;<br>2) Pika c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar;<br>3) Pika 3 të Nenit 66 të VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 ñPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò;<br>4) Neni 36 i Udhëzimit Nr. 30, Datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò |
| **Ndikimi/Efekti:** | 1. Risk për rritje të paargumentuar të fondit limit të procedur procedurës.<br>2. Përcaktim i kritereve të veçanta që nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë.<br>3. Mos realizim i shërbimeve komform kontratës duke shkaktuar dëmtim të buxhetit të shoqërisë. |
| **Shkaku:** | Mos analizim i saktë i nevojave dhe kërkesave të shoqërisë. Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masat organizative përkatëse nga ana e shoqërisë.<br>2. Albcontrol SHA të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në lidhje me sisteme të teknologjisë të përcaktojë në Njësinë e Prokurimit të paktën një specialist të fushës dhe të mos përcaktojë kritere që nuk lidhen me objektin e shërbimit apo mallit që prokurohet.<br>3. Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e grupi pune i cili të analizojë situatën e realizimit të pjesshëm të zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim & trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò dhe të hartojë një raport ku të përcaktohet vlera financiare përsa i përket ñIntegrimit me Rostering Systemò.<br>Të merren masa që vlera financiare e mos realizimit të integrimit me Rostering System që do të nxirret nga ky analizim të arkëtohet menjëherë pranë shoqërisë Albcontrol nga ana e OE óR.ô sh.p.k. |

***7.24. Prokurimi me objekt "<u>Blerje E-Brifing System</u>", viti 2018;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 1179, datë 24.08.2019, e Z. S.R., me detyrë Drejtor i Divizionit Operacional për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje Brifing Systemò nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së

prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.
Është konstatuar se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 1779/1, datë 24.08.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me nenin 23, pika 3, shkronja c, dhe nenin 23, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ku përcaktohet se: *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*
*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*
*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*
*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*[3]*.*
*4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.*
Në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit është kërkuar që OE të paraqesë vërtetim nga organi i Administratës Tatimore të xhiros mesatare të viteve 2015,2016 dhe 2017 e cila të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Operatori Ekonomik ñA.E. D.ò sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin e xhiros të lëshuar nga organi i Administratës Tatimore, por ky vërtetim është lëshuar me objekt një procedurë prokurimi që nuk lidhet me shoqërinë Albcontrol SHA por me një procedurë prokurimi të një shoqërie tjetër.
Grupi i auditimit ka konstatuar se në kriteret e veçanta gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit është parashikuar që operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 27001:2005, ndërkohë që OE i shpallur fitues ka paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar certifikatë ISO 27001:2013. Gjithsesi, në opinionin e grupit të auditimit, ky ñdevijimò është i pranueshëm duke marrë parasysh faktin se standardi ISO 27001:2013 është një standard i sigurisë së informacionit dhe përcaktohet si një version i përditësuar dhe i zgjeruar i standardit ISO 27001:2005.
Në kriteret e veçanta të kualifikimit nga autoriteti kontraktor është kërkuar vërtetimi i eksperiencave të mëparshme në fushën e sistemeve të informacionit që lidhen me fushën e

[3] Shtuar me ligjin 131/2012ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar

aviacionit civil. Bazuar në këtë kriter nga KVO, ndër të tjera është argumentuar skualifikimi i operatorit ekonomik me ofertën më të ulët duke argumentuar konkretisht si vijon :

➢ Operatori Ekonomik ñI. T. Al.ò sh.p.k. kishte këto mangësi :

1. Nuk plotësonte tek Kapaciteti teknik 2.3. pikën 1, në të cilën kërkohej :
   *"Përvojë e suksesshme në kryerjen e kontratave të ngjashme në fushën e Aviacionit Civil të realizuara gjatë tre viteve të fundit, në vlerën sa 40% e fondit limit të kësaj procedure. Dëshmitë për kryerjen e furnizimeve dhe instalimeve të mëparshme të jepen nëpërmjet kontratave të lidhura dhe të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse, ose përmes realizimit të kontratës të lëshuara nga autoritetet kontraktore përfituese ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e mallit të furnizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar më sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në të treja kontratat e paraqitura, njëra është kontratë shërbimi, e cila nuk ka lidhje me tipin e procedurës, i cili është instalim sistemi, pra mall. Ndërsa dy të tjerat nuk përputhen me këtë kriter për kualifikim, pra nuk ka eksperiencë në fushën e Aviacionit Civil. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me specifikimet teknike, ku ky product duhet dhe është për këtë fushë

Në dokumentacionin e paraqitur nga OE ñA.E. D.ò sh.p.k, i cili është shpallur fitues rezulton se nga katër kontratat e paraqitura, dy prej tyre janë kontrata shërbimi, konkretisht kontrata nr. 1182/3 me objekt ñRehabilitimi teknik i infrastrukturës mbështetëse të Remont Siteò, datë 15.09.2015 dhe kontrata nr. 852/4, datë 06.06.2017 me objekt ñMirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi për sistemin e monitorimit në distancë në Malin e Krujësò. Pra, konstatohet se OE i shpallur fitues, ka pasur mangësi të ngjashme në dokumentacion me OE i cili ka paraqitur OE më të ulët dhe është skualifikuar nga KVO.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupi i auditimit konstaton se një anëtar i KVO i caktuar me urdhrin nr. 1899/2, datë 29.09.2018, konkretisht Z. S.R., ka kryer edhe funksionin e anëtarit të grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, caktuar me urdhrin nr. 1779/1, datë 24.08.2018, çôka bie në kundërshtim me Nenin 58 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar në të cilin citohet se: ñ*KVO emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës".*

*Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri ianëtarëve duhet të jetë tek*'.

Në kontratën nr. 1899/5, datë 01.11.2018 është parashikuar paradhënia e vlerës 30% të vlerës së kontratës që në momentin e lidhjes së kontratës. Ky parashikim është i pabazuar ligjërisht pasi ai nuk parashikohet në asnjë ligjore apo rregullatore.

Për sistemin e prokuruar nga Albcontrol SHA është parashikuar në kontratë shërbimi i mirëmbajtjes dhe mbështetjes për sistemin ñBrifing Systemò për një periudhë 1-vjeçare, gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 në të cilën citohet se:

*2. Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement - SLA).*

*Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet institucionit publik dhe ofruesit të shërbimit të TIK-ut dhe hartohet sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit. Institucionet:*

*a) të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.*
*b) të cilat kanë sisteme ekzistuese, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.*
*c) Duhet, për çdo procedurë prokurimi mbi investimet për sisteme ose shërbime të teknologjisë së informacionit, këtë marrëveshje t'ia bashkëlidhin si aneks, kontratës administrative të lidhur ndërmjet palëve.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion është konstatuar se procesverbali i dotëzimit të sistemit nr. 1899/8 i datës 31.01.2019 nga ana e autoritetit kontraktor, Albcontrol SHA, është firmosur vetëm nga dy anëtar i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr.1899/7, datë 01.11.2018 për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës, konkretisht nga Z. S.M., dhe Z. S. R..
Gjatë auditimit është konstatuar se procesverbali i datës 28.01.2018, për instalimin e sitemit E-Brifing është firmosur vetëm nga dy anëtarë të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr.1899/7, datë 01.11.2018 për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës, konkretisht nga Z. S. M., dhe Z. S.R.. Procesverbali i datës 28.01.2019 për marrjen në dorëzim të mallit është firmosur vetëm nga dy anëtarë të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1899/7, datë 01.11.2018 për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës, konkretisht nga Z. S.M., dhe Z. S. R.. Gjithashtu, raporti ñRaport për Situacion nr.1 i datës 28.01.2018 është firmosur vetëm nga dy anëtarë të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr.1899/7, datë 01.11.2018 për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës, konkretisht nga Z. S. M., dhe Z. S. R.. Veprimet e sipërpërmendura nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô, i ndryshuar kur përcaktohet se : *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*

### *7.25. Prokurimi me objekt "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 1834, datë 29.08.2018, e Z. M.E., me detyrë Drejtor i Divizionit Teknik për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt óBlerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)ô nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA për realizimin e këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi.
Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 1834/1, datë 29.08.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me Nenin 23, pika 3, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ku përcaktohet se: *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*
*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*
*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*[4]*.*
Kontraktori ñI. S.ò sh.p.k. ka nënkontraktuar OE ñS. I.C.T. S.ò sh.p.k. për realizimin e një prej zërave të kontratës, vlera monetare e të cilit zë rreth 28.35% të vlerës totale të ofertës, Për këtë nën-kontraktim, OE fitues ka paraqitur deklarimin për këtë nënkontraktim përpara lidhjes së kontratës si dhe ka paraqitur një kopje të noterizuar të kontratës së lidhur midis dy operatorëve për kryerjen e këtij shërbimi. Autoriteti kontraktor nuk është pajisur dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion i cili vërteton kapacitetin teknik të nënkontraktorit për realizimin e shërbimit sipas kontratës së lidhur, në kundërshtim me pikën 5, neni 75 të VKM 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô, i ndryshuar ku përcaktohet se: *"Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. KVO vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.*
Është konstatuar se në rastet e problematikave gjatë punës së përditshme apo shërbimeve të ndryshme periodike që ka kryer OE gjatë përiudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit CMS (prodhuar nga IBM) është përdorur metoda e ofrimit të shërbimit në distancë duke përdorur metodën VPN (Virtual Private Network) nëpërmjet të cilës specialistët e OE janë lidhur me sistemin CMS i cili është i konfiguruar dhe funksionon dhe në rrjetin kompjuterik të Albcontrol SHA për të kryer shërbimet përkatëse. Në kontratë parashikohet që kjo metodë e ofrimit të shërbimit të kryhet vetëm pasi është dakordësuar ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit për çdo rast të përdorimit të kësaj metode, gjë e cila nuk ka ndodhur në asnjë rast të ofrimit të shërbimit, çôka përmban risk të lartë për cënim të sigurisë së sistemit informatik CMS dhe rrjetit kompjuterik të Albcontol SHA.
Nga auditimi i zbatimit të kontratës është konstatuar se OE nuk ka paraqitur një plan vjetor të aprovuar për mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe për kontrollet e logeve të sistemeve që disponojnë të tilla sikurse parashikohet në kontratën nr. 1872/4, datë 23.10.2018 ku citohet si vijon: *"Kompania ka për detyrë monitorimin e vazhdueshëm të sistemeve dhe në mënyrë specifike të propozojë një plan vjetor të aprovuar për mënyrën e ofrimit të këtyre shërbimeve dhe për kontrollet e logeve të sistemeve që disponojnë të tilla, si dhe një plan tremujor për përditësime dhe ndryshime nëse do të shfaqet e nevojshme gjatë mirëmbajtjes së platformës".*
Grupi i auditimi ka konstatuar se në raportin ñMbi verifikimin/kontroll i statusit të sistemit CMSô, System Healthcheck, të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë autoritetit kontraktor më datë 23.11.2018, cilësohen si problematika të dala gjatë kontrollit si më poshtë vijon :

- *U vu re që në objekt server cms2 kishte një numër shumë të lartë alarmesh active nga pajisja 192.168.254.251 ASA-305011 rreth 500k alarme. Alerti që doli si rezultat ishte "ALERT :event count (alerts.status) is high : 550611". Për pasojë objekt serveri nuk arrinte që të procesonte alarme të reja nga cms1. Kjo situatë njihet si alarm flood. Për zgjidhjen e problemit u bë ndërhyrja manuale në databazën e object server tek tabela alerts.status duke bërë fshirje manuale të alerteve të mësipërme.*

[4] Shtuar me ligjin 131/2012ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar

- *Nga cms6 morëm alertin JVM memory usage is 1,993 Mbof capacity 2,048 MB: 97%. Po analizohet problematika për mundësinë e rritjes së JVM Memory allocation tek cms6.*
- *Duhet të realizohet upgrade i infrastrukturës VMware.*
- *Nga storage qendror Storwize V5000 kemi një alert për një bug që afekton platformën. Do të punohet për upgrade e firmëare të storage në një moment të përshtatshëm.*

Është konstatuar se në zbatim të kontratës nr. 1872/5, datë 23.10.2018, nga ana e operatorit ekonomik, përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit CMS (prodhuar nga IBM) janë marrë masa korrigjuese vetëm për pikën 1 dhe 3 të dedektuar si problematikë, pra ka realizuar zgjidhjen e alertit ñALERT: event count (alerts.status) is high : 550611 dhe upgrade të infrastrukturës VMWare, dokumentuar në raportin ñMbi verifikimin/kontroll i statusit të sistemit CMSò, System Healthcheck të datës 23.11.2018 , ndërkohë nuk ka asnjë dokumentim për marrjen e masave korrigjuese, përgjatë gjithë periudhës së afatit të zbatimit të kontratës, për pikëm 2 dhe 4 të konstatuar si problematika në raportin ñMbi verifikimin/kontroll i statusit të sistemit CMSò, System Healthcheck të datës 23.11.2018.

Sipas Akt-Dorëzimit nr. 1872/6 të datës 23.11.2018 rezulton se më datë 23.11.2018 pranë autoritetit kontraktor, janë dorëzuar elektronikisht materialet si më poshtë vijon :

| Nr. | Produkti | PN | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Production Support Coverage VMware vSphere 6 Standard for 1 processor for 1 year | VS6-STD-P-SSS-C | 4 |
| 2 | Upgrade : VMware vCenter Server 6 Foundation to vCenter Server 6 Standard | VCS6-FND-STD-UG-C | 1 |
| 3 | Production Support/Subscription Vmware vCenter Server 6 Standard for vSphere 6 (Per Instance) for 1 year | VS6-STD-P-SSS-C | 1 |
| 4 | Red Hat Enterprise Linux Server FOR VIRTUAL DATACENTERS STD 1Y | RH0002 | 1 |
| 5 | IBM Netcool Operations Insight Operations Management PA Managed Client Devices | E0J97LL | 40 |
| 6 | IBM Netcool Operations Insight Operations Management 10 Managed Client Devices | E0J9BLL | 182 |
| 7 | IBM SW Netcool Operations Insight Operations Management Managed Virtual Netëork Device | E0J9DLL | 200 |
| 8 | IBM Netcool Operations Insight PA Connection | E0J9DLL | 1 |
| 9 | IBM Netcool Operations Insight Netëork Management PA Managed Virtual Network Device | E0JS9LL | 100 |
| 10 | IBM SmartCloud Application Performance Management Entry Managed Virtual Server | E0DYDLL | 10 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 11 | IBM SystemX 3650 M5 | 06GEXKR | 1 |
| 12 | IBM SystemX 3650 M5 | 06DAKHK | 1 |
| 13 | IBM SystemX 3550 M4 | 06DHKNB | 1 |
| 14 | IBM Storwize V5000 | 7876052 | 1 |
| 15 | IBM SAN 24B-5 | 10490MË | 1 |
| 16 | IBM SAN 24B-5 | 10490RT | 1 |

Nga verifikimi i kryer rezulton se zërat e përmendur në tabelën e mësipërme kanë qenë aktive për periudhën 01.11.2018-30.10.2019, pra me afat 1-vjeçar. Duke qenë se në kontratën nr. 1872/4, datë 23.10.2018 parashikohet që licencat duhet të kenë afat vlefshmërie 1 vit, mallrat e paraqitur në tabelën e mësipërme, të dorëzuara pranë Albcontrol SHA në datë 23.11.2018 duhet të kishin vlefshmëri për Albcontrol SHA deri më datën 22.11.2019. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion dokumentacioni i cili vërteton domosdoshmërinë për rinovim të suportit më datë 01.11.2018 vetëm për zërat 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 në tabelën e mësipërme, por gjithësesi kjo domosdoshmëri nuk është dokumentuar në përputhje me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar.

***7.26. Prokurimi me objekt "<u>Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)</u>", viti 2018;***

Gjatë auditimit të kësaj procedure grupi i auditimit konstatoi se kërkesa nr. 1833, datë 29.08.2018, e Z. S.R., me detyrë Drejtor i Divizionit Operacional për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)ò nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA për realizimin e këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 1833/1, datë 29.08.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me nenin 23, pika 3, shkronja c, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ku përcaktohet se: *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj*[5]*.*

Kontraktori ñI. S.ò sh.p.k. ka nënkontraktuar OE ñI.ò sh.p.k. për realizimin e një prej zërave të kontratës, vlera monetare e të cilit zë rreth 33.36% të vlerës totale të ofertës. Për këtë nën-kontraktim, OE fitues ka paraqitur deklarimin për këtë nënkontraktim përpara lidhjes së kontratës si dhe ka paraqitur një kopje të noterizuar të kontratës së lidhur midis dy operatorëve për kryerjen e këtij shërbimi. Autoriteti kontraktor nuk është pajisur dhe nuk i

[5] Shtuar me ligjin 131/2012ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, të ndryshuar

është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion i cili vërteton kapacitetin teknik të nënkontraktorit për realizimin e shërbimit sipas kontratës së lidhur, në kundërshtim me pikën 5, neni 75 të VKM 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar ku përcaktohet se : *"Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. KVO vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.*

Është konstatuar se OE nuk ka përcaktuar një person përgjegjës për ofrimin e shërbimit në kohë reale sikurse parashikohet në kontratën nr. 1873/5, datë 23.10.2018 ku citohet se: *'Për organizimin e suportit dhe menaxhimin e kërkesave, thirrjeve, incidenteve dhe problemeve që do të parashtrohen nga Albcontrol SHA, Kompania Ofruese e Shërbimit duhet të vendosë në dispozicion të Albcontrol SHA shërbimin e Service Desk duke asenjuar një përgjegjës të dedikuar për kontratën e shërbimit".*

Në rastet e problematikave gjatë punës së përditshme apo shërbimeve të ndryshme periodike që ka kryer OE gjatë përiudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit Help Desk (prodhuar nga IBM) është përdorur metoda e ofrimit të shërbimit në distancë duke përdorur teknologjinë VPN (Virtual Private Network) nëpërmjet të cilës specialistët e operatorit ekonomik janë lidhur me sistemin Help Desk i cili është i konfiguruar dhe funksionon dhe në rrjetin kompjuterik të Albcontrol SHA për të kryer shërbimet përkatëse. Në kontratë parashikohet që kjo metodë e ofrimit të shërbimit të kryhet vetëm pasi është dakordësuar ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit për çdo rast të përdorimit të saj duke marrë për çdo rast aprovimin e të dy palëve, gjë e cila nuk ka ndodhur në asnjë rast të ofrimit të shërbimit, çôka përmban risk të lartë për cënim të sigurisë së sistemit informatik Help Desk dhe rrjetit kompjuterik të Albcontol SHA.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës është konstatuar se OE nuk ka paraqitur një plan vjetor të aprovuar për mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe për kontrollet e logeve të sistemeve që disponojnë të tilla sikurse parashikohet në kontratën nr. 1873/5, datë 23.10.2018 ku citohet se: *'Kompania duhet të kryejë monitorimin e vazhdueshëm të platformës Helpdesk dhe të propozojë si më poshtë:*

a. *Një plan vjetor të aprovuar për mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe për kontrollet e logeve të sistemeve që disponojnë të tilla'.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se mallrat janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor më datë 23.11.2018 sipas Akt-Dorëzimit të datës 23.11.2018. Ky Akt-Dorëzimi nga ana e autoritetit kontraktor, Albcontrol SHA, është firmosur vetëm nga një anëtar i grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1873/6, datë 23.10.2018 për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës, konkretisht nga Z. S. M., çôka nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô, i ndryshuar kur përcaktohet se : *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.*

Sipas këtij Akt-Dorëzimi, rezulton se më datë 23.11.2018 pranë AK janë dorëzuar elektronikisht materialet si më poshtë vijon :

| Nr. | Produkti | PN | Sasia | Nr. | Produkti | PN | Sasia |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Production Support | VS6-STD- | 5 | IBM SW, | E0CV6LL | 6 | 5 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Coverage VMëare vSphere 6 Standard for 1 processor for 1 year | P-SSS-C | | Control Desk Everyplace Concurrent User | | | |
| 2 | RH00004 Red Hat Enterprise Linux Server, Standard (Physical or Virtual Nodes) | RH0004 | 6 | IBM SW, Maximo Asset Management Scheduler Authorized User | E07QSLL | 1 | 6 |
| 3 | IBM SW, Control Desk Concurrent User | E0CVLLL | 7 | IBM SystemX 3650 M5 | J305DTA | 1 | 7 |
| 4 | IBM SW, Control Desk Concurrent User | E0CVLLL | 8 | IBM SystemX 3650 M5 | 06EZVNË | 1 | 8 |

Nga verifikimi i kryer rezulton se zërat e përmendur në tabelën e mësipërme kanë qenë aktive për periudhën 01.11.2018-30.10.2019, pra me afat 1-vjeçar. Duke qenë se në kontratën nr. 1873/5, datë 23.10.2018 parashikohet që licencat duhet të kenë afat vlefshmërie 1 vit, mallrat e paraqitur në tabelën e mësipërme, të dorëzuara pranë Albcontrol SHA më datë 23.11.2018 duhet të kishin vlefshmëri për Albcontrol SHA deri më datën 22.11.2019.
Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion dokumentacioni i cili vërteton domosdoshmërinë për rinovim të suportit më datë 01.11.2018 vetëm për zërat 3,4,5 dhe 6 në tabelën e mësipërme, por gjithsesi kjo domosdoshmëri nuk është dokumentuar në përputhje me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 ôPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô, i ndryshuar.

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Mosargumentim i kërkesave për fillimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, për 9 procedura prokurimi, përkatësisht:<br>1. *"Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*<br>2. *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*<br>3. *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*<br>4. *"Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*<br>5. *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*<br>6. *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*<br>7. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>8. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>9. *"E-Brifing System", viti 2018;*<br>kërkesat për fillimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol SHA për realizimin e këtyre prokurimeve, si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës, në të cilin të jetë parashikuar kryerja e këtyre investimeve |

| | |
|---|---|
| | / shpenzimeve, për nevojat e shoqërisë. |
| **Situata:** | Për të gjitha procedurat e prokurimit të sipërpëmendura të kryera nga Albcontrol SHA, kërkesat për fillimin e këtyre procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha, për realizimin e këtyre prokurimeve, nga çdo Divizion/Drejtori që inicion procesin si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin të jetë është parashikuar kryerja e këtyre investimeve/shpenzimeve,në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Drejtoritë dhe Divizionet e shoqërisë për mosplotësim të dokumentacionit të nevojshëm për inicimin e procedurave të prokurimit. |
| **Kriteri:** | 1) Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar 'Për Prokurimin Publik'.<br>2) VKM 914 datë 29.12.2014 ôPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô,<br>3) Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 ôPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mosevidentim i saktë i nevojave për investime dhe shpenzime të Albcontrol SHA sipas planeve ekonomike të saj, krahasuar me mosargumentimin e kërkesave në dosjet e prokurimit të Divizioneve /Drejtorive të shoqërisë. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur Legjislacionit të Prokurimit Publik |
| **Rëndësia**: | E mesme |
| **Rekomandime**: | Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, tôi iniciojë këto procedura duke evidentuar kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë , arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Parregullsi në procesin e përllogaritjes së fondit limit për 9 procedura prokurimi, përkatësisht:<br>1. *"Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*<br>2. *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*<br>3. *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*<br>4. *"Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*<br>5. *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*<br>6. *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*<br>7. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>8. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;* |

| | |
|---|---|
| | *9. "E-Brifing System", viti 2018;* |
| **Situata:** | Procesverbalet e përllogaritjes së fondit limit të grupeve të punës të ngritur për përllogaritjen e fondit limit të procedurave nuk kanë të bashkëlidhur shkresat dërguar operatorëve ekonomikë (ose e-mail zyrtar) për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokolli hyrës në Albcontrol SHA. veprime të cilët nuk janë në përputhje me Pikën 4 të Nenit 48 të Ligjit Nr. 9643, Datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri. |
| **Kriteri:** | 1) Pika 4 e Nenit 48 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò.<br>2) Rregullore e Brendshme e funksionimit dhe organizimit të Shoqërisë Albcontrol. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mosevidentim dhe mosdokumentim i saktës i ofertave të operatorëve ekonomikë të cilat merren për bazë për përllogaritjen e fondit limit për procedurat e prokurimit. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur Legjislacionit të Prokurimit Publik. |
| **Rëndësia**: | E lartë. |
| **Rekomandime**: | Albcontrol SHA të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit në rastet kur do të përdoret metoda e llogaritjes së fondit limit përmes studimit të tregut, të marrë parasysh dhe të vlerësojë vetë ato oferta të operatorëve ekonomikë administrimi shkresor i të cilave në shoqëri është i mirëdokumentuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. |

| | |
|---|---|
| ►**Titulli i Gjetjes:** | Paradhënie e pargumentuar nga Autoriteti Kontraktor në 3 procedura prokurimi, përkatësisht në kontratat e lidhura të procedurave:<br>**1.** ñ*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*<br>**2.** ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*<br>**3.** ñ*Blerje Brifing System", viti 2018;* |
| **Situata:** | Nga auditimi i procedurave të prokurimit të sipërpërmendura, është konstatuar se Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontrata duke përcaktuar detyrimin e AK për ti paguar operatorit fitues 30 të vlerës së kontratës, në kundërshtim me LPP, i ndryshuar, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit dhe hartuesit e kontratave të shoqërisë me operatorët fitues të procedurave të prokurimit. |
| **Kriteri:** | DST/Kushtet e veçanta të kontratës përkatëse ku përcaktohet se nëse nuk është specifikuar pagesa paraprake, kontraktori nuk do të marrë një të tillë dhe në kundërshtim me nenet 59 e 60 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ñPër prokurimin publikò i ndryshuar |
| **Ndikimi:**<br>**Shkaku:** | Përfitimi pa të drejtë i parapagesës së 30 % të vlerës së kontratës.<br>Veprimet në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe DST. |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandimi:** | Nga ana e shoqërisë në procedurat e prokurimit që do kryejë në të ardhmen në rastet kur analizohet se është e nevojshme parapagesa e operatorit fitues me vlerë 30% të kontratës, të pasqyrohet qartë nevoja e kryerjes së këtij veprimi dhe gjithashtu të shkruhet dhe në hartimin e DST/kushtet e veçanta të kontratës. |
| **Pretendimi i subjektit:** | Përmes observacioneve subjekti i audituar pretendon se parapagesa për kontraktorët të vlerës 30% të kontratës që në momentin e lidhjes së kontratës nuk përbën shkelje ligjore dhe është në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti pretendon se paradhënia nuk është kriter kualifikimi gjatë vlerësimit, për pasojë nuk mund të jetë pjesë e DST-ve para shpalljes së fituesit. |
| **Qëndrimi i grupit të auditimit:** | Grupi i auditimit i qëndron opinionit se për aq kohë sa nga ana e shoqërisë nuk është përcaktuar që në DST nevoja e kryerjes së këtij veprimi dhe vendosja e detyrimit të AK për ti parapaguar operatorit fitues paradhënie pa shkaqe të argumentuara ky përcaktim nuk është I bazuar në ligj por bie në kundërshtim me nenet 59 e 60 të ligjit nr. 9643 ñPër prokurimin publikò i ndryshuar. Sipas llogjikës së subjektit rezulton që shoqëria selekton cilat kontrata duhet të kenë paradhënie ose jo dhe Dokumentet Standarte të Tenderit janë thjesht ñformaleò, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në projektraportin e auditimit. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Mos respektim i legjislacionit mbi prokurimin public në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të parashikuara në Nenin 23 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, në 7 procedura prokurimi, përkatësisht në procedurat:<br>**1.** ñ*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*<br>**2.** *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019 VOIP;*<br>**3.** ñ*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*<br>**4.** ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*<br>**5.** ñ*Blerje Brifing System", viti 2018;*<br>**6.** ñ*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>**7.** ñ*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;* |
| **Situata:** | Procesverbalet përkatës të grupeve të punës për pëcaktimin e specifikimeve teknike nuk kanë të paraqitur asnjë diagramë rrjeti, model lidhjeje të pajisjeve ekzistuese apo informacion të përgjithshëm të sistemeve ekzistuese me qëllim njohjen e |

| | |
|---|---|
| | operatorëve ekonomikë me të gjitha kushtet dhe rrethanat me rëndësi për hartimin e ofertës. |
| **Kriteri:** | 1) Neni 23, Pika 4, shkronja c, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Risk i lartë për mos-nxitje të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit si dhe risk për mos-kuptim të kërkesave të autoritetit kontraktor nga ana e operatorëve ekonomikë. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur Legjislacionit të Prokurimit Publik. |
| **Rëndësia**: | E lartë. |
| **Rekomandime**: | Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, të argumentojë dhe të përshkruajë në mënyrë të qartë të gjithë situatën aktuale të sistemeve dhe ambienteve teknologjike në të cilët do të kryhen shërbimet apo implementohen produktet duke paraqitur të dhëna të përgjithshme (nr. Pajisjesh, mënyra e lidhjes në rrjet, llojet e infrastrukturës/topologjisë mbi të cilat janu ngritur platformat) me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke pasur në konsiderat që informacioni i publikuar të mos-përmbajë të dhëna teknike konfidenciale, publikimi i të cilave mund të përbëjë risk për cënimin e sigurisë së informacionit. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Nga auditimi u konstatua se për 2 procedura prokurimit përkatësisht:<br>1. ñ*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*<br>2. *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019 VOIP;* nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit. |
| **Situata:** | Në DST është kërkuar nga operatorët ekonomikë të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në procedure që të jenë të pajisur me autorizim të prodhuesit të sistemeve të IT por nuk është pëcaktuar se cili është prodhuesi i këtyre sistemeve që ka në përdorim Albcontrol SHA. |
| **Kriteri:** | Neni 61, Pika 2, e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Risk i lartë për mos-nxitje të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit si dhe risk për mos-kuptim të kërkesave të autoritetit kontraktor nga ana e operatorëve ekonomikë. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur Legjislacionit të Prokurimit |

| | |
|---|---|
| | Publik. |
| **Rëndësia**: | E lartë. |
| **Rekomandime**: | Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, për të cilat Njësia e Prokurimit konsideron se duhet të kërkojë në DST që operatorët ekonomikë të jenë të autorizuar nga prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve, të përcaktojë dhe të bëjë të njohur për operatorët ekonomikë se cili është prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Nga auditimi u konstatua se për 3 procedura prokurimit përkatësisht :<br>1. ñ*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*<br>2. *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*<br>3. *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*<br>nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me përllogaritjen e fondit limit. |
| **Situata:** | Operatoret ekonomike ofertat e të cilëve janë marrë per bazë për studimin e tregut me qëllim përllogaritjen e fondit limit, nuk kanë në objektin e tyre të veprimtarisë objektin për të cilin po zhvillohet procedura, për të tre procedurat e sipërpërmendura, çka mbart risk për mos-llogaritje të saktë të fondit limit të procedurës. |
| **Kriteri:** | Neni 59 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Risk i lartë për përllogaritje të pasaktë të vlerës limit për kryerjen e shërbimeve/blerjen e mallrave. |
| **Shkaku:** | Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur Legjislacionit të Prokurimit Publik. |
| **Rëndësia:** | E lartë. |
| **Rekomandime:** | Nga Administratori i shoqërisë të nxirren përgjegjësitë për këtë rast dhe të merren masa nga që mos të përsëritet ky fenomen, nga grupet e përllogaritjeve të fondit limit për procedurat e prokurimit në të ardhmen. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Nga auditimit u konstatua se për 2 procedura prokurimit përkatësisht :<br>***1.*** *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>***2.*** *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*<br>nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me nënkontraktimin. |
| **Situata:** | ***Për procedurën "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018 :***<br>Kontraktori ñI. S.ò sh.p.k. ka nënkontraktuar OE ñI.ò sh.p.k. për |

| | |
|---|---|
| | realizimin e një prej zërave të kontratës, vlera monetare e të cilit zë rreth 33.36 % të vlerës totale të ofertës. Për këtë nën-kontraktim, operatori ekonomik fitues ka paraqitur deklarimin për këtë nënkontraktim përpara lidhjes së kontratës si dhe ka paraqitur një kopje të noterizuar të kontratës së lidhur midis dy operatorëve për kryerjen e këtij shërbimi. Autoriteti kontraktor nuk është pajisur dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion i cili vërteton kapacitetin teknik të nënkontraktorit për realizimin e shërbimit sipas kontratës së lidhur.<br>***Për procedurën "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018", viti 2018:***<br>Kontraktori ñI. S.ò sh.p.k. ka nënkontraktuar OE ñS. ICT S.ò sh.p.k. për realizimin e një prej zërave të kontratës, vlera monetare e të cilit zë rreth 28.35% të vlerës totale të ofertës, Për këtë nën-kontraktim, OE fitues ka paraqitur deklarimin për këtë nënkontraktim përpara lidhjes së kontratës si dhe ka paraqitur një kopje të noterizuar të kontratës së lidhur midis dy operatorëve për kryerjen e këtij shërbimi. Autoriteti kontraktor nuk është pajisur dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion i cili vërteton kapacitetin teknik të nënkontraktorit për realizimin e shërbimit sipas kontratës së lidhur. |
| **Kriteri:** | - Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.<br>- VKM 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô; Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 óPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikô |
| **Ndikimi/Efekti**: | Risk i lartë për mos realizim të shërbimit në përputhje me termat e kontratës si pasojë e mosparaqitjes së dokumentacionit përkatës vërtetues për kapacitetin teknik të operatorit ekonomik të nënkontraktuar. |
| **Shkaku:** | Analizim jo i plotë i domosdoshmërisë dhe rëndësisë së zërave të nënkontraktuar në realizimin e plotë të kontratës së lidhur. |
| **Rëndësia**: | E lartë |
| **Rekomandime**: | Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit në të cilat operatori ekonomik fitues i tenderit lidh marrëveshje nënkontraktimi, pavarësisht nëse operatori i nënkontraktuar ka pasur eksperienca të mëparshme në procedurat e zhvilluara nga Albcontrol SHA, të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumentacionin e kërkuar në tender për operatorin ekonomik të nënkontraktuar njësoj sikurse për operatorin ekonomik të kontraktuar. |

| | |
|---|---|
| **►Titulli i Gjetjes:** | Nga auditimit u konstatua se gjatë zbatimit të 2 kontratave të lidhura përkatësisht :<br>1. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1873/5, datë 23.10.2018);*<br>2. *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1872/4, datë 23.10.2018);*<br>është përdorur metoda VPN (Virtual Private Network) për ofrimin e shërbimit të mbështetjes teknike për Albcontrol sha. nga operatorët |

| | |
|---|---|
| | ekonomikë, pa dokumentuar arsyen dhe domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj metode, dakordësimin midis autoritetit kontraktor dhe kontraktuesit si dhe të dhëna të tjera teknike në lidhje me këtë shërbim. |
| **Situata:** | ***Për procedurën "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018 :***<br>Në rastet e problematikave gjatë punës së përditshme apo shërbimeve të ndryshme periodike që ka kryer operatori ekonomik gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit Help Desk (prodhuar nga IBM) është përdorur metoda e ofrimit të shërbimit në distancë duke përdorur teknologjinë VPN (Virtual Private Network) nëpërmjet të cilës specialistët e operatorit ekonomik janë lidhur me sistemin Help Desk i cili është i konfiguruar dhe funksionon në rrjetin kompjuterik të Albcontrol SHA, për të kryer shërbimet përkatëse. Në kontratë parashikohet që kjo metodë e ofrimit të shërbimit të kryhet vetëm pasi është dakordësuar ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit për çdo rast të përdorimit të saj duke marrë për çdo rast aprovimin e të dy palëve, gjë e cila nuk ka ndodhur në asnjë rast të ofrimit të shërbimit.<br>***Për procedurën "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018", viti 2018 :***<br>Në rastet e problematikave gjatë punës së përditshme apo shërbimeve të ndryshme periodike që ka kryer operatori ekonomik gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit CMS (prodhuar nga IBM) është përdorur metoda e ofrimit të shërbimit në distancë duke përdorur metodën VPN (Virtual Private Network) nëpërmjet të cilës specialistët e operatorit ekonomik janë lidhur me sistemin CMS i cili është i konfiguruar dhe funksionon në rrjetin kompjuterik të Albcontrol sha, për të kryer shërbimet përkatëse. Në kontratë parashikohet që kjo metodë e ofrimit të shërbimit të kryhet vetëm pasi është dakordësuar ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit për çdo rast të përdorimit të kësaj metode, gjë e cila nuk ka ndodhur në asnjë rast të ofrimit të shërbimit. |
| **Kriteri:** | 1) Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar 'Për Prokurimin Publik'.<br>2) VKM 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.<br>3) Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò.<br>4) VKM 710 datë 21.08.2013 óPër krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimitô, i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Risk i lartë për problematika të mundshme në lidhje me sigurinë e informacionit në sistemet teknologjike të Albcontrol sha. |
| **Shkaku:** | Vlerësim jo i duhur i rëndësisë së sigurisë së informacionit në lidhje me sistemet teknologjike. |
| **Rëndësia**: | E lartë |
| **Rekomandime**: | Albcontrol të marrë masa që në të gjithë rastet, kur nga kontraktorët me të cilët lidhen kontrata me objekt sistemet e informacionit të të gjithë niveleve ofrohet shërbimi i suportit përmes metodës VPN, të dokumentojë të gjithë procedurën e kryer për cdo rast të ofrimit të |

| | |
|---|---|
| | shërbimit, duke nisur nga dakordësimi për përdorimin e VPN për cdo rast deri në dokumentimin e zgjidhjes së dhënë në lidhje me problematikën e raportuar apo shërbimin e kryer. |

►**<u>Titulli i gjetjes</u>:** Në **15** raste u konstatuan problematika mbi pagesat paraprake, respektivisht për kontratat:

**Situata:**

**Nga auditimi i DST, konkretisht shtojcën mbi hartimin e Kushteteve të veçanta dhe të përgjithshme, parashikimi mbi pagesat paraprake si dhe kontratave për punë publike, u konstatuan problematikat si vijon:**

**1.** Në zbatim të procedurës së prokurimit me nr. 2317 për objektin ñRehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò është lidhur kontrata e shërbimit me nr. ..... prot, datë 27.12.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Znj. B.B.. dhe OE ñA. I. Gj. Co.ò SHPK me licencë ..... dhe NIPT ....., përfaqësuar nga Z. A.A.. Vlera e kontratës është 37,294,821 lekë pa TVSH ose 44,753,785.2 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë së difekteve është përcaktuar 12 muaj nga data e marrjes së përkohshme në dorëzm të punimeve të objekt ñRehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò.

Pagesa do të kruhet në formën e poshtëshënuar:

Kontraktori do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 70 % të vlerës totale të kontratës. Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me punimet për rehabilitimin e Kullës së Kontigjencës; sipas projektit. Afati i dhënies së kësaj pagese do të jetë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Vlera e parapagimit do të zbritet nga situacionet pjesore apo të plota që do të paraqesi Kontraktori për punimet që do të kryejë. Pagesa për punën e kryer do të bëhet brenda 30 ditësh nga momenti i dorëzimit të situacionit pjesor të punimeve të miratuar nga Drejtori i Punimeve, duke zbritur garancinë e difekteve.

*<u>Problematikë e konstatuar nga auditimi:</u>*

Në kontratën me nr. 2317/4 prot, datë 27.12.2017 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Znj. B.B.. dhe OE ñA. I. Gj. Co.ò SHPK, është përcaktuar se vlera 37,294,821 lekë pa TVSH ose 44,753,785.2 lekë me TVSH do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 70 % të vlerës totale të kontratës. Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me punimet për rehabilitimin e Kullës së Kontigjencës; sipas projektit. Afati i dhënies së kësaj pagese do të jetë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Bazuar në dokumentacionin e likuidimit si; Formular urdhër transferte datë 27.12.2017; faturë tatimore nr. 117, datë 27.12.2017 me seri 51770495 nga Albcontrol SHA, është realizuar paradhënie në shumën 31,327,649 lekë (për 70 % të vlerës së kontratës).

Vlera e parapagimit do të zbritet nga situacionet pjesore apo të plota që do të paraqesi Kontraktori për punimet që do të kryejë. Pagesa për punën e kryer do të bëhet brenda 30 ditësh nga momenti i dorëzimit të situacionit pjesor të punimeve të miratuar nga Drejtori i Punimeve, duke zbritur garancinë e difekteve.

*Sa më sipër, në gjykimin e grupit të auditimit, përcaktimi në kontratën me Nr. ... Prot, datë 27.12.2017 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe OE "A. I. Gj. Co." SHPK, mbi pagesën paraprake në masën 70 % është në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) të miratuara më DST dhe konkretisht me Shtojcën 17 (Kushtet e Veçanta - Punët Procedura e hapur) neni 10 (Pagesat Paraprake). Pra, në DST nuk është premtuar/përcaktuar një pagesë paraprak nga Autoriteti Kontraktor.*

**2.** Në zbatim të procedurës së prokurimit me nr. REF-19403-04-24-2019 për objektin ñShpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjesë ndërrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)ò është lidhur kontrata e shërbimit me nr. ..... prot, datë 10.06.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Z. M.K. dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñ4. A. M.ò SHPK, përfaqësuar nga z. A.M.. Vera e kontratës është 29,248,926

lekë pa TVSH, ose 35,098,711.20 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Titullari i AK, me urdhrin e brendshëm nr. 948/5, datë 10.06.2019 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës me përbërje Z. J.M. Kryetar, z. D.N. dhe z. E. C. anëtarë, për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës nr. ..... datë 10.06.2019, për prokurimin me objekt: ñShpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjese nderrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)ò. Grupi i punës përbëhet nga Z. J.M. Kryetar, z. D.N. dhe z. E.C. anëtarë.
*Në gjykimin e grupit të auditimit, përcaktimi në kontratën me nr. ....prot, datë 10.06.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe OE "4. A. M." SHPK, mbi pagesën paraprake në masën 30 % është në kundërshtim me DST të miratuara dhe konkretisht me Shtojcën 17 (Kushtet e Veçanta - Punët Procedura e hapur) neni 9 (Pagesat Paraprake). Pra, në DST nuk është premtuar/përcaktuar një pagesë paraprak nga Autoriteti Kontraktor.*
**3.** Në zbatim të procedurës së prokurimit me nr. REF-85935-09-17-2018 për objektin ñStudim ñKukës obstacle surveyòò është lidhur kontrata e shërbimit me nr. .....prot, datë 12.11.2018 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Znj. B.B. dhe BPOE ñA. C.ò SHPK & ñE.N.A.V.ò S.P.A, përfaqësuar nga ñA. C.ò SHPK, sipas prokurës nr. 2092 rep, datë 12.10.2018, të dorëzuar në ofertën e paraqitur me përfaqësues ligjor znj. V. T.. Vlera e kontratës është 23,180,500 lekë pa TVSH ose 27,816,600 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë së difekteve është përcaktuar 12 muaj nga data e marrjes së përkohshme në dorëzm e shërbimeve të kontratës me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò.
- Në marrëveshjen e bashkëpunimi (Për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomik) midis OE ñA. C.ò SHPK dhe ñE.N.A.V ñ S.P.A me NIPT ..... me përfaqësues ligjor znj. V.T. është vendosur se Shoqëria ñA. C.ò SHPK do të kryejë 30 % të vlerës së ofertës ekonomike dhe OE ñE.N.A.V.ò SPA do të realizojë 70% të vlerës së ofruar.
- Në nenin 4 të kontratës me nr. .... prot, datë 12.11.2018 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari znj. B.B. dhe BPOE ñA. C.ò SHPK & ñE.N.A.V.ò SPA, përfaqësuar nga OE ñA. Co.ò SHPK, është përcaktuar që vlera prej 23,180,500 lekë pa TVSH do të paguhet nga Autoriteti Kontraktor në formën e poshtëshënuar:
Kontraktori do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 30 % të vlerës totale të kontratës, Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me shërbimin e ribërjes së hartës së lartësive minimale të survejimit. Afati i dhënies së kësaj pagese do të jetë në momentin e nënshkrimit të kontratës. .....Pagesa do të kryhet brenda 30 ditësh nga momenti i dorëzimit të shërbimit objekt prokurimi, marrjes në dorëzim dhe hartimit të procesverbalit për marrjen në dorëzim nga grupi i punës për ekzekutimin e kontratës, i cili do të ngrihet me urdhër të nrendshëm nga Drejtoresha e Përgjithshme e AK.
*Sa më sipër, në gjykimin e grupit të auditimit, përcaktimi në nenin 4 të kontratës me Nr. .... Prot, datë 12.11.2018 ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe BPOE "A. C." SHPK & "E.N.A.V." SPA, mbi pagesën paraprake në masën 30% është në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) të miratuara më DST dhe konkretisht me Shtojcën 19 (Kushtet e Veçanta - Punët Procedura e hapur) neni 9 (Pagesat Paraprake). Pra, në DST nuk është premtuar/përcaktuar një pagesë paraprak nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu konstatohet se nga AK "Albcontrol SHA" nuk është plotësuar "Shtojca 19" (Kushtet e veçanta).*
**4.** Në zbatim të procedurës së prokurimit me nr. REF-93468-11-09-2018 për objektin ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò është lidhur kontrata e shërbimit me nr. ..... prot, datë 27.12.2018 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga titullari Znj.B.B.. dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr. En 2ò SHPK, përfaqësuar nga ñRr.U.A nr. 2ò SHA me licencë NZ..... dhe NIPT....., përfaqësuar nga Z. K.H. Vlera e kontratës është 38,756,659 lekë pa TVSH ose 46,507,990.8 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 muaj, nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë së difekteve është përcaktuar 12 muaj nga data e marrjes së përkohshme në dorëzm të punimeve të objekt

ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò. BOE  përfaqësohet nga OE ñRr.U.A nr. 2 E.ò SHA bazuar në prokurën e posaçme me datë 17.12.2018, me nr. 882 rep dhe nr. 373/1 kol.
- Me datë 17.12.2018 me nr. 881 rep dhe nr. 372/1 kol, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomik) midis OE ñTr. En.ò SHPK me përfaqësues ligjor z. I.T. dhe OE ñRr.U.A nr. 2ò SHA me përfaqësues ligjor z. K.H. me objekt krijimin e bashkimit të përkohshëm të OE për objektin ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò. Shoqëria ñRr.U.A nr. 2ò SHA do të kryejë 50.144% të vlerës së ofertës ekonomike dhe OE ñTr. En. 2ò SHPK do të realizojë 49,856% të vlerës së ofruar.
- Për objektin ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò është lidhur akt-marrëveshje me nr. .... Prot, datë 03.04.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA, të përfaqësuar nga Titullari Z. M.K.  dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr. En. 2ò SHPK, përfaqësuar nga ñRr.U.A nr. 2ò SHA me licencë NZ..... dhe NIPT ....., përfaqësuar nga Z. K.H., me objekt shtyrjen e afatit të përcaktuar në nenin 6 ñVendodhja dhe ekzekutimiò të kontratës nr. ...., datë 27.12.2018 deri më datë 14.06.2019.
Likuidimi i vlerës së kontratës prej 46,507,990.8 lekë me TVSH do të paguhet nga Autoriteti Kontraktor në formën e poshtëshënuar:
Kontraktori do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 20 % të vlerës totale të kontratës, Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me punimet për rehabilitim të Qendrës së Kontigjencës ACC; sipas projektit. Afati dhënies së kësaj pagese do të jetë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Vlera e parapagimit do të zbritet nga situacionet pjesore apo të plota që do të paraqes  Kontraktori për punimet që do të kryejë. *Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Juristi  z. E.N. në cilësinë e konceptuesit të kontratës.*
**Kriteri:** Për sa më sipër, është në kundërshtim me Dokumentet Standarde të Tenderit.
**Ndikimi/Efekti:** Për sa konstatuar, ka shkaktuar ulje të konkurrencës nga operatorët ekonomik.
**Shkaku:** Mos zbatimi i DST, duke ngarkuar me *përgjegjësi: Juristi  z.* ***E.N.*** *në cilësinë e konceptuesit të kontratës.*
**Rëndësia:** E mesme
**<u>Rekomandime</u>:** Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, duhet të analizohen rastet mbi paradhënien e operatorit ekonomik fitues, në vlerën nga 20 % deri në 70 % të vlerës së kontratës, sepse këto veprime bien ndesh me kriterin e vendosur në DST nga Autoriteti Kontraktor, ndërkohë kur AK kërkon që OE fitues, duhet të ketë bilancet e tre viteve të fundit jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, për të cilën presupozohet se ai ka të gjitha mundësitë dhe merr përsipër kryerjen e shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Në rast se parashikohet një faliment i mundshëm i operatorit ekonomik fitues, atëherë shuma e paguar do të përbënte një dëm të konsiderueshëm ekonomik për shoqërinë e Albcontrol SHA.

**8. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit:**
(Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit; Vlerësimi i Menaxhimit të riskut; Vlerësimi i Aktivitetit të Kontrollit; Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi).
Në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.*2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në shoqërinë Albcontrol SHA.
*Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe raportimin e veprimtarisë së shoqërisë Albcontrol SHA, për realizimin e objektivave.*
Strukturat përgjegjëse të shoqërisë Albcontrol SHA në përgjithësi kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

**Nga auditimi rezultoi se:**
- *Neni 16 "Numri, emërimi, përbërja dhe kriteret", Seksioni II "Këshilli Mbikëqyrës", i Statutit të Shoqërisë Aksionare Albcontrol citon "Këshilli Mbikëqyrës është organ kolegjial i përbërë nga 6 anëtarë, nga të cilët 2 anëtarë propozohen nga Ministria e Financës, 2 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe 2 të tjerë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*
**Për sa më sipër rezulton se Statuti është i papërditësur dhe njeh si organ propozues për antarë, një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017.**
-Shoqëria Albcontrol SHA përgjatë periudhë objekt auditimi 01.09.2018-31.03.2021, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9 datë 26.11.2018 ñPër miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë ñAlbcontrol sh.aò.
Nga përmbajtja e së cilës rezulton se ekzistojnë strukturat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe përgjithësisht garantohet përgjegjshmëria menaxheriale në bazë të strukturës organizative.
Miratimi i politikave menaxheriale, rregullave dhe procedurave të zbatueshme të nivelit të lartë janë pjesë përbërëse të rregullores së brendshme dhe në harmoni me dispozitat ligjore.
-Shoqëria ka hartuar dhe miratuar misionin, strategjinë ku janë përcaktuar objektivat strategjikë si dhe programet afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë financiare të cilat përfshijnë dhe planet konkrete të veprimit dhe zhvillimit. Këto plane përmbajnë hapat që duhen ndjekur në zbatimin e tyre, afatet përkatëse kohore të realizimit, fushat prioritare si dhe projektet, por pa përcaktuar personat përgjegjës dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme, përfshirë menaxhimin e riskut në linjë me hartimin e programit ekonomik.
-Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur që në vitin 2018 me urdhërin nr.12 nga Drejtori i Përgjithshëm,në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, neni 27, në të cilin është përcaktuar dhe roli i këtij grupi.
Me urdhërat nr.817, datë 15.11.2013 dhe nr.300, datë 21.03.2018, janë bërë ndryshime në urdhrin e brendshëm nr. 21.03.2013, ndryshime në togfjalësh në lidhje me emërtimin e sektorëve/drejtorive, jo në përbërje të grupit të menaxhimit strategjik. Konstatohet se disa prej anëtarëve të grupit të menaxhimit strategjik nuk janë më pjesë e strukturës aktuale të Albcontrol SHA. Për sa më sipër ky urdhër nuk është përditësuar.
-Nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masa për hartimin e rregullave specifike dhe proçedurave, për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, sistemin e evidentimit, monitorimit, kontrollit dhe informimit të cilat janë përfshirë në Rregulloren ñPër menaxhimin e aktiveve në Albcontrol SHA miratuar me urdhër nr. 889, prot. 1782, datë 31.12.2013 në zbatim të pikës 5 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27/12/2011 ò*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò dhe nenit 5 e 8 të ligjit nr. 10 296, date 08/07/2010 ò*Për menaxhimin financiar e kontrollin*ò.

-Me urdhër nr. 515, prot. të datës 18.07.2014 janë miratuar procedurat antikorrupsion në të cilat janë përshkruar mënyrat e denoncimit dhe regjistrimit të praktikave korruptive, shqyrtimi i denoncimeve si dhe procesi i hetimit administrativ, për zbatimin e të cilave janë ngarkuar të gjitha strukturat e Albcontrol SHA.
-Me vendimin nr.14, datë 27.10.2015, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2016-2020 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë Albcontrol SHA për vitin 2016.
-Me vendimin nr.15, datë 23.12.2016, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2017-2019 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë ñAlbcontrolò Sh.a për vitin 2017.
-Me vendimin nr.15, datë 02.11.2017, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol Sh.a është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2018-2020 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë ñAlbcontrolò Sh.a për vitin 2018.
-Me vendimin nr.11, datë 26.11.2018, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol Sh.a është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2019-2021 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë ñAlbcontrolò Sh.a për vitin 2019.
-Me vendimin nr.28, datë 19.12.2019, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol Sh.a është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2020-2022 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë për vitin 2020.
- Me vendimin nr.9, datë 21.12.2020, nga Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol Sh.a është miratuar programi strategjik i auditimit për periudhën 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimit të brendshëm të shoqërisë për vitin 2021.

**Vlerësimi i efektivitetit të komponentëve të kontrollit të brendshëm bëhet në drejtim të hartimit të kontrolleve të brendshme, implementimit të tyre dhe në fund funksionimit.**
Për sa më sipër, komponentët e kontrollit të brendshëm në shoqërinë Albcontrol SHA, rezultojnë si më poshtë:

**Në lidhje me mjedisin e kontrollit**
-Janë përcaktuar prioritetet në secilën fushë, ku shtrin veprimtarinë Albcontrol SHA, të cilat janë dhënë të kanalizuara sipas sektorëve.
-Për Albcontrol SHA, nëpunësi autorizues është Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe ekzekutimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e menaxhuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndetshëm financiar dhe transparencës.
-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Shefe e Sektorit të Kontabilitetit në Drejtorinë Ekonomike.
-Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në këtë njësi veprohet në bazë të detyrave që nënkuptojnë pozicionet sipas strukturës organike dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave.
-Ekzistojnë politikat për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe janë miratuar përshkrimet individuale të detyrave të cilat evidentojnë ngarkesën konkrete të punës si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.
*Shoqëria ka hartuar kodin e saj të etikës, të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.4, datë 30.06.2015 dhe elemente të etikës janë përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 9 , datë 26.11.2018 .*
-Shoqëria ka hartuar edhe një manual për burimet njerëzore, të miratuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm nr.111, datë 02.02.2015.
-Janë përcaktuar kriteret për rekrutimin e stafit dhe përshkrimet për çdo pozicion pune.

**Në lidhje me menaxhimin e riskut:**
-Albcontrol Sh.a ka hartuar dhe miratuar strategji të menaxhimit të riskut në datën 22.01.2016 me nr.174 prot. dhe që ka hyr në fuqi në datën 17.02.2016. E fundit është përditësuar në datën 06.08.2021 me nr. prot 1275.
**-Drejtori i Divizionit Administrativ është përcaktuar si Koordinator Risku, bashkë me detyrat e tij me urdhërin nr. 817 prot. 1681, datë 15.11.2013, urdhër ky i papërditësuar me ndryshimet.**
-Janë bërë analizat e menaxhimit janar-dhjetor 2019 dhe janar-dhjetor 2020, përkatësisht me shkresat nr.1197 prot., datë 26.06.2020 dhe nr.1081 prot datë 16.07.2021.
**Në lidhje me aktivitetet e kontrollit:**
-Proceset e punës janë të bazuara në strukturën e re organizative, përshkrim të proceseve të punës për çdo sektor dhe informacion mbi planin financiar dhe buxhetin dhe kuadrin rregullator ligjor respektiv sipas ligjit bazë mbi të cilin funksionon çdo strukturë.
-Angazhimi aktiv i strukturave të kontrollit të brendshëm është kryer në mënyrë që të bëhet projektimi i një programi ekonomik të mirë-studiuar dhe analizuar në mënyrë sa më të detajuar, duke mundësuar kështu edhe përcaktimin e detyrave dhe hapave që duhen ndjekur gjatë zbatimit të tij për secilën strukturë.
**Në lidhje me informacionin dhe komunikimin:**
Ka udhëzime të shkruara në lidhje me mënyrën e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara brenda shoqërisë të cilat janë të përfshira në rregulloren e brendshme.
-Albcontrol SHA i ka kushtuar rëndësi zhvillimit të sistemeve të Teknologjisë dhe Informacionit (TI) me qëllim përmirësimin e aktiviteteve të kontrollit. Sistemi TI siguron dhe lehtëson transmetimin e informacionit për monitorimin e progresit dhe arritjen e objektivave të njësisë në tërësi dhe strukturave të veçanta të saj në këtë fushë.
**Në lidhje me monitorimin**
-Titullari i institucionit merr raport ditor, javor, mujor , 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor dhe vjetor.
- Organet drejtuese të shoqërisë monitorojnë dhe analizojnë realizimin ose shkaqet e mosrealizimit të objektivave.
Pas auditimit dhe dokumentimit të gjithë veprimtarisë së Shoqërisë Albcontrol SHA, konstatohet se sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në përgjithësi është implementuar dhe zbatuar nga shoqëria në përputhje me kuadrin ligjor, por kërkohet vëmendje e shtuar në lidhje me sa trajtuar në këtë material.

**9. Mbi vlerësimin e veprimtarisë të Njësisë së Auditit të Brendshëm.**

Nga auditimi mbi krijimin dhe funksionimin e NjAB rezultoi si vijon:

ʒ **Titulli i Gjetjes:** Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

**Situata:** Në këndvështrim të tre auditimeve të fundit të këtij sistemi konkludojmë se, ekzistenca e detyrimeve të prapambetura që nga viti 2018 është evidente dhe ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të tyre për shkak të mungesës së fondeve por edhe të mungesës së dokumentacionit mbështetës të tyre dhe mos zhvillimit të procedurave ligjore të plota në disa prej tyre .

Megjithëse këto mangësi, këto detyrime mbeten si të tilla dhe Drejtoria ekonomike dhe Menaxhimit Financiar/Sektori i financës dhe buxhetit, duhet të marrë masat për analizimin dhe likuidimin e atyre detyrimeve (nga më e vjetra tek më e reja) të cilat kanë dokumentacionin mbështetës dhe janë kryer me procedurë të drejtë ligjore, nëpërmjet një plani konkret të përvitshëm.

*Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimet vjetore për vitet objekt auditimi, rezulton se NJAB pavarësisht se ka planifikuar auditimin e disa drejtorive me risk të lartë siç është Drejtoria e Financës apo Drejtoria e Prokurimeve, në secilin rast, pavarësisht planifikimit vjetor, angazhimi është kryer mjaftueshëm, pasi janë audituar çështje me risk të ulët deri në të mesëm.*

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, òManuali i Auditimit të Brendshëm (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt ج raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si projekt ï raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual.

Disa nga subjektet e audituara, kanë pranuar rekomandimet e lëna dhe kanë paraqitur një <u>Plan Veprimi të pjesshëm</u> për zbatimin e rekomandimit, veprime që nuk përmbushin tërësisht ligjin 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, ò*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*ò), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Vend të veçantë në program zë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

-Mangësi e konstatuar në dosjet e auditimit, rezulton mungesa e planifikimit të detajuar të angazhimit, veprim ky në kundërshtim me Kapitullin IV, pika 4.1.1 ñPlanifikimi i një angazhimi auditimiò, i cili parashikon sipas *Standardit 2200 – Planifikimi i angazhimit se "Audituesit e brendshëm duhet të zhvillojnë dhe të dokumentojnë një plan për secilin angazhim, duke përfshirë objektivat, fushën, kohën, dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit*, si dhe *Standardin 2210 – Çështje të planifikimit.*

NjAB ka bërë mjaftueshëm punë mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duke bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

*Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:*

1. Organizimi i NJAB, shoqëria Albcontrol SHA, është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò.
2. Është miratuar Karta e Auditit, janë hartuar planet strategjike, planifikimet vjetore, si dhe raportimet vjetore të aktivitetit të njësisë, dërguar në DHAB brenda afateve dhe standardeve ligjore të përcaktuara Manualin e Auditimit të Brendshëm.
3. Angazhimi i kryer nga NJAB për auditimet e ushtruara në përgjithësi është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò dhe të kapitullit VI ñEvidentimi dhe dokumentimi i punës audituesò të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr.100, datë 25.10.2016.
4. Disa nga subjektet e audituara, kanë pranuar rekomandimet e lëna dhe kanë paraqitur një Plan Veprimi të pjesshëm për zbatimin e rekomandimit, veprime që nuk përmbushin tërësisht ligjin 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.
5. Nga Njësia e AB për periudhën e auditimit 2018 ï 2020 janë zbatuar 7 auditime nga 15 auditime të planifikuara, ose në masën 46.66 %.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015 ñPër auditin e brendshëm në sektorin publikò, neni 10 germa (a), (c); nenin 4, pika 12; neni 11, pika 2, shkronja (b), (c), (ç).
VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò, neni 6 germa (a). Urdhrin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave.
**Ndikimi/Efekti:** Sistem funksional i kontrollit të brendshëm, duke mos dhënë siguri titullarit për aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucionit.
**Shkaku:** Mosnjohje e ligjit nr. 114/2015 ñPër auditin e brendshëm në sektorin publik. Mosnjohje e Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të MF mbi Manualin e AB.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandime:** - Titullari i AK dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.
- Subjektet e audituara të pranojnë rekomandimet e lëna dhe të paraqesin një Plan Veprimi të Detajuar dhe të plotë për zbatimin e rekomandimeve.
- NJAB në Shoqërinë Albcontrol SHA, jo vetëm të realizojë numrin e planifikuar të auditimeve vjetore, por, të planifikojë një numër më të madh të auditimeve të prokurimeve publike me vlerë mbi 800,000 lekë , si dhe në Drejtorinë e financës, referuar nivelit të riskut dhe materialitetit.
- Titullari i Albcontroll, të marrë masa për të emëruar në NJAB punonjës të certifikuar në AB në fushën e financë kontabilitet.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJAB: Znj. E.P. dhe Znj. F.D..

**10. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.**

Gjatë procesit të auditimit në subjektin Albcontrol SHA sipas programit të auditimit nr. 445/1, datë 12.05.2021, i ndryshuar, me nr. 445/2 prot., datë 30.06.2021, i ndryshuar me nr. 445/3 prot., datë 29.07.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.05.2021 deri më datë 30.09.2021, nuk u konstatuan problematika specifike për tû trajtuar në kntë Raport Përfundimtar Auditimi.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se sipas pikës 3, nenit 7 ñKarakteristika të përgjithshme të aksioneveò, kreut II ñAksionet dhe Kapitaliò të statutit të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë nr. 25, datë 01.11.2013, aksionari i vetëm i shoqërisë Albcontrol SHA vazhdon të figurojë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
Ndërkohë që aktualisht aksionari i vetëm i shoqërisë është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila me Urdhrin nr. 148, datë 21.11.2017, ka miratuar edhe zmadhimin e kapitalit themeltar. Konstatohet gjithashtu se, sipas nenit 16 ñNumri, emërimi, përbërja dhe kriteretò, Seksioni II ñKëshilli Mbikëqyrësò, i Statutit të Shoqërisë Aksionare anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës propozohen si në vijim: *2 anëtarë nga Ministria e Financës, 2 nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe 2 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes.*
Për sa më sipër rezulton se shoqëria e zhvillon veprimtarinë e vet mbështetur në një Statut të pa përditësuar dhe njeh si organ propozues të antarëve të Këshillit Mbikëqyrës, një Ministri që nuk ekziston më, pas ristrukturimit të bërë në vitin 2017, konkretisht *Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,* kjo jo në përputhje me pikën 2 ñAsambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: ndryshime të statutitò, nenin 135 të Ligjit nr. 9901,datë 14.08.2008, i ndryshuar dhe shkronjën b, pikën 2 të Nenit 13 ñTë drejtat dhe detyrimetò të Seksionit i ñAsambleja e përgjithshmeò e Statutit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1. Rekomandimi</u>:** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA të marrin masa duke i drejtuar kërkesë Asamblesë së Aksionarit, me qëllim ndryshimin e emërtimit të aksionarit dhe përditësimin e Statutit.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albcontrol SHA për periudhën objekt auditimi, konstatohet se për propozimet dhe vendimmarrjet e ndryshimeve në Programin e Zhvillimit Ekonomik nuk janë relatuar me detaje arsyet mbi këto ndryshime.
Materialet argumentuese relatuese mbi këto vendimmarrje i janë vënë në dispozicion këtij organi vetëm një ditë përpara miratimit duke mos marrë kohë të mjaftueshme për njohjen dhe vlerësimin e tyre dhe si rrjedhojë këto ndryshime janë miratuar brenda ditës, jo në përputhje me nenin 21 , pika 4, Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"* sipas të cilit Raportet dhe materialet e përgatitura për tû paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, sipas rendit të ditës të miratuar, u dorëzohen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nga drejtuesit e shoqërisë deri në 10 ditë para mbledhjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>2.1. Rekomandimi</u>:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, të marrë masa që të relatojë dhe të argumentojë në procesverbalet dhe mbledhjet e tij, çdo vendimmarrje sipas afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator të funksionimit të shoqërisë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA ka marrë vendimin nr. 2 datë 25.02.2021 ñ*Për një ndryshim në programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë "Albcontrol*ò SHA të vitit 2021.
Nga relacioni bashkëlidhur këtij vendimi argumentohet se shtohet nënzëri ñAsistencë ligjore për çështjen e ngrirjes së llogarive bankare në Eurocontrolò në vlerën 12,500,000 lekë, vlerë e cila programohet të mbulohet nga zbritja e zërit ñamortizimò, në kuadër të lëshimit të një urdhër ekzekutimi nga shërbimi përmbarimor Belg me objekt ñBllokimin/ngrirjen e llogarive të

Shqipërisë në Eurocontrol.
Pasi pala shqiptare si palë e paditur ka humbur çështjen, pala paditëse i është drejtuar gjykatës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata dhe si rrjedhojë është lëshuar një urdhër ekzekutimi nga Shërbimi përmbarimor belg për bllokimin e llogarive të Albcontrol. Për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës belge është angazhuar Eurocontrol, Avokatura e Shtetit dhe një studio ligjore belge e kontraktuar nga Albcontrol për asistencë ligjore.
Konstatohet se vendimi nr. 2, datë 25.02.2021 i Këshillit Mbikëqyrës për kontraktimin e studios ligjore belge është jo në përputhje me pikën 1, nenin 9 ñZyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtarò të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 ñPër avokaturën e shtetitò sipas të cilit, përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, kryhen nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albcontrol SHA, në lidhje me mbrojtjen për kundërshtimin e vendimit të gjykatës belge dhe angazhimin në këtë proces të një studio ligjore nga ana e Albcontrol SHA, të sigurohet koordinimi i mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit duke garantuar eficencën maksimale në strategjinë e mbrojtjes, si dhe në interesin më të mirë të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të saj.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e shoqërisë dhe shpërblimeve të përfituara, u konstatua se pavarësisht faktit se mund të mos kenë marr pjesë në mbledhje ose kanë marr pjesë në një numër të kufizuar mbledhjesh vjetore, pagesat e tyre vlerësohen mujore, kjo e mbështetur nga neni 24 ñShpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrësò i Statutit i cili parashikon se ñanëtarët përfitojnë shpërblim mujor për pjesëmarrje në Këshillin Mbikëqyrës i cili jepet sipas akteve ligjore në fuqiò dhe pika 7 e VKM nr. 570, datë 3.10.2018 ñPër këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetëroreò e cila parashikon se ñShpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është mujor dhe jepet nga mbledhja e parë e Këshillit. Efektet përballohen nga vetë shoqëria anonimeò.
Për sa më sipër edhe pse pjesëmarrja në mbledhje nuk është mujore dhe sipas Statutit Këshilli Mbikëqyrës bënë të paktën 4 Mbledhje në vit, shpërblimi është caktuar që të jetë mujor. Për periudhën objekt auditimi shpërblimet për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretares rezultojnë në vlerën 6,245,140 lekë bruto ose 5,308,369 lekë neto, pas mbajtjes së tatimit në burim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. Rekomandimi:** Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të merren masa për propozimin e rishikimit të VKM nr. 570 datë 3.10.2018 me qëllim shpërblimin e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhje.

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi:** Në 2 (dy) raste nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të pasqyrës së asteve të Albcontrol SHA në tenderin me objekt: ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò me nr. Reference të prokurimit: REF-xxò dhe tenderit me objekt: ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHA)ò me nr. Reference të prokurimit: REF-YY, u kostatua se:
**-** Në zbatim të procedurave për prokurimin ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò viti 2019, grupi i punës me shkresën nr. 1106/2, datë 21.05.2019, i përbërë nga: D.Z., H.P. dhe T.F. ka mbajtur proces ï verbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,150,365,227 lekë, ku në këtë pasqyrë janë përfshirë programe/Pajisje informatike në shumën 71,280,236 lekë. Këto pajisje informatike/programe

informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqyruara në mënyrë të pa argumentuar dhe grupuar më saktë në asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga rreziqet e mundshme.
- Në zbatim të procedurave për prokurimin ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò viti 2018, grupi i punës, me shkresën nr. 660/2, datë 02.05.2018, i përbërë nga: D.Z., H.P. dhe T.F. ka mbajtur procesverbal për përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe hartimin e pasqyrës së aseteve të shoqërisë në shumën 5,218,035,800 lekë, ku në këtë pasqyrë janë përfshirë, përfshirë programe/pajisje informatike në shumën 146,914,175 lekë. Këto pajisje informatike/programe informatike, në gjykimin e audituesit mund të konsiderohen të pasqryruara në mënyrë të pa argumentuara dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga rreziqet e mundshme. Për sa më sipër trajtuar, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar, Kreu II, pika 2, shkronja ñaò; me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 28. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>5.1. Rekomandimi</u>:** Nga administratori i shoqërisë Albcontrol SHA si dhe nga Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkurruese të merren masa që në zhvillimin e prokurimeve me natyrë të njëjtë në përllogaritjen e fondit limit të kontratave të ngjashme me objekt ñSigurimi i Pasurisë së Albcontrol SHAò të bazohen në inventarin e saktë të aseteve të shoqërisë, duke argumentuar dhe grupuar më saktë asetet e shoqërisë me emërtimin pajisje dhe jo zëra të cilat paraqiten me veprime ñBlerjeò ñFurnizimò apo ñInstalimeò për tôu siguruar nga 11 rreziqet. Disa zëra që nuk i përkasin këtij grupimi të adresohen me emërtim të ri të zërit dhe në grupin e duhur teknikisht.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi mbi zhvillimin e prokurimit me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò me nr. Reference të prokurimit: REF-14539-03-20-2019, me fond limit 83,261,772 lekë pa TVSH, fituar nga BOE fitues ñRr.U.A. nr. 2ò SHA dhe ñCUò SHPK, me vlerë të kontratës së sipërmarrjes 79,098,683 lekë pa TVSH, u konstatua se në hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivit të punimeve, Autoriteti Kontraktor i është referuar markës/prodhuesit për zërat:
- zëri (An) F.V. Pajisje e brendshme kasetë AUXA54GALH, marka GENERAL FUJITSU, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw <u>në sasinë 12 copë.</u>
- *zëri i pajisjes, pompë e jashtme VRF V III "*GENERAL FUJITSU*" për "*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90). Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*".*
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 23, pika 5, të LPP, me nenin 59, të VKM nr. 914, datë datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuarò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>6.1. Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, si dhe Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i të Dhënave Konkurruese, në rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekte/kontrata me natyrë të ngjashme, duhet të evidentojnë kritere të veçanta dhe të kryejnë një argumentim të thelluar teknik dhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre, kritere të cilat nuk mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së Operatorëve Ekonomik, ofertues të mundshëm të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi mbi zhvillimin e prokurimit me objekt ñStudim Kukës obstacle surveyò me nr. Reference të prokurimit: REF-xy, me fond limit 40,000,000 lekë pa

TVSH, fituar nga BOE ñA. Co.ò SHPK dhe òE. N. A. V.ò SPA, me vlerë të kontratës së sipërmarrjes 23,180,500 lekë pa TVSH, u konstatua se në procedurën e mësipërme morën pjesë 4 OE, konkretisht: BPOE ñA. Co.ò SHPK dhe ñE. N. A. V.ò SPA me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH; BPOE ñB-V En.ò SHPK & ñIn. Y. S.ò SA me çmim oferte 19,800,000 lekë pa TVSH; OE ñCo. & Ma. Al.ò SHPK me çmim oferte 36,800,000 lekë pa TVSH dhe OE òL & Coò SHPK me çmim oferte 39,000,000 lekë pa TVSH.
Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga ofertuesit pjesëmarrës në tender, KVO ka kualifikuar BPOE ñA. Co.ò SHPK & ñE. N. A. V.ò SPA dhe BPOE ñCo. & Ma. Al.ò SHPK si dhe ka sôkualifikuar BPOE ñB-V En.ò SHPK & ñIn. Y. Se.ò SA dhe BPOE ñL. & Coò SHPK.
Fitues nga KVO është shpallur BPOE ñA. Co.ò SHPK dhe ñE. V. A. N.ò S.P.A. me çmim oferte 23,180,500 lekë pa TVSH, si BOE i cili plotëson të gjitha kushtet e DST dhe me një diferencë me FL në vlerën 16,819,500 lekë. AK ñAlbcontrolò SHA, me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi OE ñB-V. En.ò SHPK me shkresën me nr. 108 prot., datë 22.10.2018 (Protokolluar në Albcontrol SHA me nr. prot. 2135, datë 22.10.2018) për procedurën me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò, ka urdhëruar Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO me urdhrin e brendshëm nr. 1916/5 datë 23.10.2018, të pezullojë vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në kthimin e përgjigjes së ankesës.
Në vijim, titullari i AK Albcontrol SHA, me shkresën me nr. 2135/1 prot., datë 24.10.2018 me objekt: Kthim përgjigje, informon OE ñB-V. En.ò SHPK, se ankesa nuk merret parasysh nga Autoriteti Kontraktor ñAlbcontrolò SHA duke argumentuar pretendimet e operatorit ofertues ankimues.
Konstatohet se nga Titullari i Albcontrol SHA nuk është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Komisioni i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, kreu ñXò ñShqyrtimi i ankesaveò, neni 78 ñAnkesat në autoritetin kontraktorò pika 6 (a) dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK ñAlbcontrolò SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 82-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1. Rekomandim:** Titullari i Autoriteti Kontraktor, për rastin konkret si dhe në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit, duhet të eliminojë praktikat e kthimit të përgjigjes mbi pretendimet e ngritura nga vetë titullari, por të ngrejë Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, rezulton se, sistemi i NjAB në Albcontrol SHA për periudhën e audituar 2018 ï 31.03.2021 ka funksionuar në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò por ka ende nevojë për përmirësime me qëllim përdorimin sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, adresimin e risqeve dhe auditimin e sektorëve me risk të lartë në veprimtarinë ekonomike dhe financiare në Albcontrol SHA, për të dhënë garanci të mjaftueshme që objektivat e njësisë audituese do të arrihen duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë. Është miratuar Karta e Auditit, janë hartuar planet strategjike, planifikimet vjetore, si dhe raportimet vjetore të aktivitetit të njësisë, dërguar në DHAB brenda afateve dhe standardeve ligjore të përcaktuara Manualin e Auditimit të Brendshëm. Por gjithsesi, nga NjAB janë realizuar 7 auditime nga 15 auditime të planifikuara ose në masën 46.66 %. Disa nga subjektet e audituara, kanë pranuar rekomandimet e lëna dhe kanë paraqitur një Plan Veprimi të pjesshëm për zbatimin e rekomandimit, veprime që nuk përmbushin tërësisht

ligjin 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për forcimin e procesit të auditimit të brendshëm duke planifikuar auditime në sektorë me risk të lartë dhe të rrisë numrin e auditimeve në Kompaninë Albcontrol SHA.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit, në 9 raste rezultuan parregullsi mbi fillimin/inicimin e procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor, për periudhën 01.09.2018- 30.09.2020, jo në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 12, pika 2, germa a) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, tô iniciojë këto procedura duke evidentuar në kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë, duke bërë një përshkrim të shkurtër/relacion, bashkëlidhur kërkesës për fillimin e procedurave.

***Në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit u konstatua se, në **5** raste, përllogaritja e fondit limit, është kryer jo në përputhje me kërkesat e nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar dhe nenit 26 e 28 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, për Prokurimin Publik, i ndryshuar, për të cilët kërkohet minimumi 3 operatorë ekonomik, për të marrë një mesatare mbi çmimet e tregut. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i shoqërisë të merren masa për zhvillimin e prokurimeve me natyrë të njëjtë që përllogaritja e fondit limit të bëhet në mënyrë të saktë, që në rast të zgjedhjes së alternativës me tre OE në përllogaritjen e fondit limit, duhen përzgjedhur ata operatorë ekonomik që kanë për objekt fushën e prokurimit dhe fenomene të ngjashme mos përsëritet në të ardhmen, në Procedurat e Prokurimit Publik.

**-** Për procedurën me objekt: ñShërbime për kontrollin mjekësorò, nga grupi i punës në përllogaritjen e fondit limit dhe grupi i punës që ka hartuar specifikimet teknike, në procedurat e ardhshme të përcaktojnë qartë shërbimet e planifikuara, shoqëruar me numrin e saktë të shërbimeve, duke argumentuar në mënyrë transparente dhe çmimin e shërbimeve që planifikohen të kryhen, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në grafikun e Dokumenteve Standarde të Tenderit.

***Në vijimësi***

**11. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi mbi hartimin e specifikimeve teknike u konstatua se, në 9 raste hartimi i tyre është bërë jo në përputhje me kërkesat e nenit 23, pika 3, shkronja b) dhe pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar dhe jo sipas kërkesave të nenit 61, pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i shoqërisë Albcontrol SHA, të merren masa, që në zhvillimin e Procedurave të Prokurimit Publik, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, për çdo kriter të kërkuar në DST, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, me qëllim të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

***Në vazhdimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi paraqitjen e dokumenteve të tenderit nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në **3** raste u konstatuan parregullsi mbi verifikimin dhe vërtetësinë e dokumenteve të tenderit, respektivisht në Procedurën e Prokurimit me objekt: "Kontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indra 2019", "Shpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREX 2019", "Blerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbajte VSC-INDRA, GAREX 2020". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, të analizohen rastet dhe të merren masa që për procedurat e shqyrtuara respektive, si dhe në procedurat e tjera në vijim, të vërtetohet dhe dokumentohet vërtetësia e dokumenteve, që janë kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) që janë autorizime/letra e prodhuesit, për pajisjet navigacionale, prodhuar nga Indra apo Garex duke kontaktuar me prodhuesin që ka lëshuar dokumentin, siç është përshkruar në pikën përkatëse.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratave për punë publike/mallra/shërbime, në **15** raste u konstatuan problematika mbi pagesat paraprake, respektivisht për kontratat si vijon:

**-** Kontratë për punë publike ñRehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò me nr. 2317/4 prot., datë 27.12.2017 lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñA. I. Gj. Co.ò SHPK me vlerë 44,753,785.2 lekë me TVSH ku, nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **70 %** të vlerës totale të kontratës. Kjo pagesë do të jepet për krijimin e kushteve që kanë të bëjnë me punimet për rehabilitimin e Kullës së Kontigjencës.

**-** Kontratë me objekt ñShpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjesë ndërrimi e sistemeve të instaluara ne ACC/APP/TWR /ADMINISTRATE)ò me nr. 948/4 prot., datë 10.06.2019 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA, dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñ4. A. M.ò SHPK, me vlerë 35,098,711.20 lekë me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

**-** Kontratë me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò me nr. 1916/7 prot., datë 12.11.2018 lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe BPOE ñA. Co.ò SHPK & ñE. N. A. V.ò S.P.A, me vlerë 27,816,600 lekë me TVSH, do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30 %** të vlerës së ofertës ekonomike.

**-** Kontratë me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò me nr. 2255/5 prot., datë 27.12.2018 lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr En 2ò SHPK, në vlerën 46,507,990.8 lekë me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **20%** të vlerës totale të kontratës.

**-** Kontratë me objekt ñTrajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Anglezeôò me nr.2185/4 prot., datë 13.11.2019, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñCo. & Me. Al.òSHPK në vlerën 53,904,000 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

**-** Kontratë me objekt ñTrajnim refresh të emergjencave ATCOò me nr.351/5 prot., datë 15.03.2019, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe BOE ñCo. & M.Al. E.P.N. Alò, në vlerën 79,999,200 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

**-** Kontratë me objekt ñShpenzime për kontrollin mjekësorò me nr. 2278/4, datë 24.12.2019, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñA. H.ò SHA, në vlerën 49,200,000 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

**-** Kontratë me objekt ñShpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeò me kontratë nr. 373/4, datë 20.03.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE

ñR. & T.ò SHPK, në vlerën 25,356,072 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt ñKontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indraò me kontrata nr.374/4, datë 20.03.2019, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñR. & T.ò SHPK, në vlerën 10,999,980 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt ñShpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREXò 2019 me kontratë nr. 577/4, datë 09.04.2019, lidhur ndërmjet Albcontrol SHA dhe OE ñR. & T.ò SHPK, në vlerën 41,988,960 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **40%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbatje VSC-INDRA, GAREXôò 2020 me kontratë nr. 459/6, datë 19.05.2019, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñR. & T.ò SHPK, në vlerën 66,146,400 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.
- Kontratë me objekt ñMasterplani i Navigimit Ajror për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorësò me kontratë nr. 459/6, datë 19.05.2020, lidhur ndërmjet ñAlbcontrolò SHA dhe OE ñR. & T.ò SHPK, në vlerën 66,146,400 me TVSH, ku nga AK është përcaktuar se do të paguhet nga ñI Siguruariò do të marrë një pagesë paraprake në masën prej **30%** të vlerës totale të kontratës.

Grupi i auditimit mendon se përcaktimi i pagesës paraprake është bërë jo në përputhje me: DST të miratuara nga AK dhe konkretisht me shtojcat mbi ñKushtet e veçantaò si dhe ñPagesat paraprakeò por edhe në kundërshtim me kërkesat e nenit **60**, pika **1** të ligjit **nr. 9643,** datë **20.11.2006** ñ*Për prokurimin publik*ò i ndryshuar.

Paradhënie e pargumentuar nga Autoriteti Kontraktor në 3 procedura prokurimi, përkatësisht në kontratat e lidhura të procedurave:
- Kontratë me objekt ñ*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- Kontratë me objekt ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*
- Kontratë me objekt ñ*Blerje Brifing System", viti 2018;*

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi.** Drejtori i Përgjithshëm i Albcontrol SHA, për rastet konkrete dhe gjatë zhvillimit të prokurimeve me natyrë të njëjtë tôi kërkojë NjP dhe Juristit që të analizohen rastet mbi paradhënien e operatorit ekonomik fitues, në vlerën nga 20 % deri në 70 % të vlerës së kontratës, dhe këto veprime të parashikohen që në fazën fillestare të hartimit të DST me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në garën e zhvillimit të prokurimeve.

***Në vazhdimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK mbi zbatmin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm u konstatua se; për 4 masa organizative të mbetura në proces zbatimi nga Albcontrol SH: **1** masë është zbatuar pjesërisht, **2** masa janë zbatuar plotësisht, **1** masë është në proces. **1** (një) masë për shpërblim dëmi në vlerën **33,435,330 lekë** është në proces; **1** (një) masë në vlerën **1,512,840 lekë** për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike rezulton në proces zbatimi. Nga ñAlbcontrolò SHA rezulton se 1 (një) masë disiplinore nuk është zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos realizimin e masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të

pazbatuara, në proces dhe të zbatuara pjesërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme rekomandimeve të cilat janë në procese gjyqësore.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve të prokurimeve në **9** raste u konstatua, mos argumentim nga Autoriteti Kontraktor Albcontrol SHA, i kërkesave nga strukturat përkatëse për fillimin e procedurave të prokurimit si dhe në procesin e përllogaritjes së fondit limit, përkatësisht për prokurimet:

- *"Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*
- *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*
- *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza II", viti 2019;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"E-Brifing System", viti 2018;*

kërkesat për fillimin e procedurave të prokurimit nga AK nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së ñAlbcontrolò SHA për realizimin e këtyre prokurimeve, si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës, në të cilin të jetë parashikuar kryerja e këtyre investimeve / shpenzimeve, për nevojat e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>15.1 Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit të:

- Tô iniciojë këto procedura duke evidentuar në kërkesat nga Divizionet/Drejtoritë e shoqërisë, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime të shoqërisë.
- Përdoret metoda e llogaritjes së fondit limit përmes studimit të tregut, të marrë parasysh dhe të vlerësojë vetë ato oferta të operatorëve ekonomikë administrimi shkresor i të cilave në shoqëri është i mirë dokumentuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit u konstatua mos respektim i LPP në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, përkatësisht për prokurimet:

- ñ*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019;*
- ñ*Blerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWL", viti 2019;*
- ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019;*
- ñ*Blerje Brifing System", viti 2018;*
- ñ*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- ñ*Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018; (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>16.1 Rekomandimi</u>:** Albcontrol sha. të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të

teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, të argumentojë dhe të përshkruajë në mënyrë të qartë të gjithë situatën aktuale të sistemeve dhe ambienteve teknologjike në të cilët do të kryhen shërbimet apo implementohen produktet duke paraqitur të dhëna të përgjithshme (nr. Pajisjesh, mënyra e lidhjes në rrjet, llojet e infrastrukturës/topologjisë mbi të cilat janë ngritur platformat) me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke pasur në konsideratë që informacioni i publikuar të mos-përmbajë të dhëna teknike konfidenciale, publikimi i të cilave mund të përbëjë risk për cenimin e sigurisë së informacionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin e DST në **2** raste të zhvillimit të procedurës së prokurimit përkatësisht për prokurimet me objekt:
1. ñShpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosteritò, viti 2018, u konstatua se kërkesa nr. 289, datë 01.02.2018, e Z. S. R., me detyrë Drejtor i Divizionit Operacional për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së Albcontrol sha. për realizimin e këtij prokurimi, dhe gjithashtu nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës. Veprim ky në kundërshtim me LPP në lidhje me hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit.
- ñMirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit ITò, viti 2019 VOIP, u *konstatua se, n*ë DST është kërkuar nga operatorët ekonomikë të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në procedure që të jenë të pajisur me autorizim të prodhuesit të sistemeve të IT por nuk është pëcaktuar se cili është prodhuesi i këtyre sistemeve që ka në përdorim Albcontrol. Ky veprim dhe mosveprim është në kundërshtim me nenin 61, pika 2, e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 127-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>17.1 Rekomandimi</u>:** Albcontrol SHA, të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit që kanë objekt ofrimin e shërbimeve apo blerjen e mallrave që lidhen me sisteme aktuale të teknologjisë së informacionit që posedon shoqëria, për të cilat Njësia e Prokurimit konsideron se duhet të kërkojë në DST që operatorët ekonomikë të jenë të autorizuar nga prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve, të përcaktojë dhe të bëjë të njohur për operatorët ekonomikë se cili është prodhuesi përkatës i këtyre sistemeve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për 3 procedura prokurimit përkatësisht :
- ñ*Shpenzime mirëmbajtjes teknike CRS/PRS e Rosterit", viti 2018;*
- *"Kontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrol", viti 2019;*
- *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019;*

nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me përllogaritjen e fondit limit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 167-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>18.1 Rekomandimi</u>:** Nga Administratori i shoqërisë të nxirren përgjegjësitë për këto raste dhe të merren masa që mos të përsëritet ky fenomen, nga grupet e përllogaritjeve të fondit limit për procedurat e prokurimit në të ardhmen.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit ñKontratë konsulence për hartimin e kostos me Eurocontrolò, viti 2019, në Urdhrin e Prokurimit nr. 500, datë 21.02.2019, NjP ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë óKërkesë me

Propozimô me qëllim nxitjen për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim të arsyes së përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar njoftimi për ftesë për propozim, gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 4 të Nenit 39 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò.

- Nga auditimi i likuidimit dhe zbatimit të kontratës është konstatuar se AK është faturuar nga kontraktuesi me anë të faturës 42590535 të datës 16/12/2019 në vlerën 973,920 lekë me TVSH për shërbimet (Pjesëmarrje në mbledhjen e Nëntorit të Komitetit të Zgjeruar të C.R.C.O. për miratimin e kostos të shërbimit ñEn-routeò për vitin 2020; Pjesëmarrje në takime konsulence në lidhje me koston e terminalit e miratimin e saj për vitin 2020; Përgatitje e raportit përkatës; Shpenzime të tjera lidhur me shërbimet e mësipërme) ku pagesa e faturës së sipërpërmendur është konfirmuar përmes procesverbalit nr. 500/10, Datë 17.12.2019, të dy prej anëtarëve të grupit të punës për ndjekjen e ekzekutimit të kontratës ngritur me urdhrin nr. 500/5, datë 29.03.2019 konkretisht znj. R. D. dhe znj. H.P., ndërkohë që procesverbali nuk është sigluar nga anëtari tjetër i grupit të punës së sipërpërmendur, znj. D. Z.. Ky veprim nuk është në përputhje me Pikën 54 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 134-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>19.1 Rekomandimi</u>:** Albcontrol SHA në rastet e procedurave të prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duke përdorur llojin e procedurës ñKërkesë pë propozimò, në çdo rast të dokumentojë arsyen e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që do të ftojë për të paraqitur propozimet për procedurën përkatëse si dhe pavarësisht eksperiencave të mëparshme të suksesshme me operatorë ekonomikë të caktuar, të ndjekë me përpikmëri të gjithë hapat dhe veprimet që përcakton legjislacioni për prokurimin publik.

- Albcontrol SHA të marrë masa që në rastet e pamundësisë së arsyeshme së anëtarëve të grupeve të punës për prezencë në momentin e marrjes në dorëzim të shërbimeve apo mallrave të kryejë zëvendësimin e anëtarit i cili nuk mund të jetë prezent.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**20. Gjetje nga auditimi:** Parregullsi në procedurën e prokurimit *"*Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit ITò, viti 2019; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 168-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>20.1 Rekomandimi</u>:** Albcontrol SHA të marrë masa që në të ardhmen të dokumentojë përmes procesverbaleve përkatës dorëzimin e shërbimeve apo mallrave.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës ñ*Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019*, u konstatua se kërkesa nr.228, datë 25.01.2019, për inicimin e realizimit të procedurës së prokurimit nuk përmban asnjë argumentim të nevojës së ñAlbcontrolò SHA, për realizimin e këtij prokurimi, dhe nuk përmban një përshkrim të shkurtër të shërbimeve që prokurohen, por kjo kërkesë përbëhet nga një fjali e vetme në të cilën nuk përshkruhet asgjë tjetër përveç drejtimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit. Në këtë kërkesë nuk përshkruhet shërbimi që do të prokurohet por përcaktohet vetëm emërtimi i procedurës.

-Kriteri për punimet e ngjashme konsiderohet i paargumentuar pasi sistemi i akses control dhe sistemi i evakuimit në raste alarmi nuk lidhen me aviacionin civil, por janë sisteme që funksionojë në mënyrë universale dhe kanë të njëjtët parime dhe standarde pune pavarësisht fushës ku aplikohen.

- Kriteret për zoterim të çertifikates **ISO 14001:2015** mbi ñSistemet e menaxhimit te ambjentitò, të certifikates PAS 99:2012 për Sistemin e Integruar të Menaxhimit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zoterim të kësaj certifikate ose ekuivalente me toò, të certifikates për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001:2011. Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jete e vlefshme në kohen e zhvillimit te tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtarët e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate ose ekuivalente me toò, të certifikates për sistemin e menaxhimit të përgjegjshmërisë sociale SA 8000:2014 Çertifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohen e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të operatoreve të gjithë anëtaret e bashkimit duhet të jenë në zotërim të kësaj certifikate. Ose ekuivalente me toò në opinionin e grupit të auditimit, përcaktimi i tyre si kriter për kualifikimin e operatorëve ekonomikë nuk nxit operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe konsiderohen si kritere që nuk lidhen me realizimin e objektit të procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-188 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës sipas objektit të prokurimit për të hartuar një raport për domosdoshmërinë e çdo kriteri të veçantë të përcaktuar në këtë procedurë. Në varësi të rezultateve të raportit të hartuar nga specialistët e fushës, sipas përgjegjësive përkatëse të merren masa administrative përkatëse nga ana e shoqërisë.

***Menjëherë***

**21.2 Rekomandimi:** Albcontrol SHA të marrë masa që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në lidhje me sisteme të teknologjisë të përcaktojë në Njësinë e Prokurimit të paktën një specialist të fushës dhe të mos përcaktojë kritere që nuk lidhen me objektin e shërbimit apo mallit që prokurohet.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**22. Gjetje nga auditimi:** Për 2 procedura prokurimit përkatësisht :

- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*
- *"Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018;*

nuk është respektuar legjislacioni i prokurimit publik në lidhje me nënkontraktimin, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar, neni 61 dhe VKM 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 75.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 178-183 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1 Rekomandimi:** Albcontrol SHA të marrë masa që në të gjithë procedurat e prokurimit në të cilat operatori ekonomik fitues i tenderit lidh marrëveshje nënkontraktimi, pavarësisht nëse operatori i nënkontraktuar ka pasur eksperienca të mëparshme në procedurat e zhvilluara nga Albcontrol, të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumentacionin e kërkuar në tender për operatorin ekonomik të nënkontraktuar njësoj sikurse për operatorin ekonomik të kontraktuar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen teknik të zbatimit, në **2** kontratave të lidhura përkatësisht :

*1. "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1873/5, datë 23.10.2018);*

*2. "Blerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)", viti 2018 (Kontrata 1872/4, datë 23.10.2018);*

është përdorur metoda VPN (Virtual Private Network) për ofrimin e shërbimit të mbështetjes teknike për Albcontrol SHA, nga operatorët ekonomikë, pa dokumentuar arsyen dhe domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj metode, dakordësimin midis autoritetit kontraktor dhe kontraktuesit si dhe të dhëna të tjera teknike në lidhje me këtë shërbim, në mos-përputhje me detyrimet kontraktuale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 68-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1 Rekomandimi:** Albcontrol të marrë masa që në të gjithë rastet, kur nga kontraktorët me të cilët lidhen kontrata me objekt sistemet e informacionit të të gjithë niveleve ofrohet shërbimi i suportit përmes metodës VPN, të dokumentojë të gjithë procedurën e kryer për çdo rast të ofrimit të shërbimit, duke nisur nga dakordësimi për përdorimin e VPN për çdo rast deri në dokumentimin e zgjidhjes së dhënë në lidhje me problematikën e raportuar apo shërbimin e kryer.

***Në vijimësi***

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, lidhur me ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, janë marrë ose një ditë para, ose brenda të njëjtës ditë, me atë kur është miratuar relacioni përkatës i Drejtorit të Përgjithshëm që i propozonte.

Referuar materialeve të vëna në dispozicion nga subjekti, konstatohet se miratimet e ndryshimeve me *Vendimet nr. 19 dhe nr. 22 e Këshillit Mbikëqyrës*, janë marrë brenda të njëjtës ditë me relacionet përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm, për ndryshimin e programit të zhvillimit ekonomik. Veç të tjerash, propozimet e përfshira në relacionet shpjeguese kanë qenë në të dyja rastet të shumta dhe koha brenda të cilës janë marrë vendimet nga Këshilli Mbikëqyrës, ka qenë e pamjaftueshme për anëtarët e tij, për të marrë informacion, për të bërë vlerësime dhe për të marrë vendime të kujdesshme në interes të aktivitetit të shoqërisë, duke anashkaluar parimin e përgjithshëm mbi ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, në shoqëritë tregtare të cilat menaxhohen nga një sistem administrimi me dy nivele, ku ndarja e funksioneve, ai i hartimit të politikave, i ushtruar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ai i zbatimit të politikave, i ushtruar nga Drejtori i Përgjithshëm, mbetet detyrim i cili duhet respektuar në thelb.

Konstatohet se, relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm japin një përshkrim të shkurtër të propozimeve, pa një analizë të hollësishme mbi domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, në shtesa apo pakësimi të zërave të shpenzimeve, ndërsa nga procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës rezulton mospjesëmarrje e përfaqësuesve të Divizioneve që kanë lidhje me çështjet, objekt propozimi për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të cilët do të duhej të prezantonin materialin për pjesën teknike, e po kështu dhe mungesa e nënshkrimeve në relacionet propozuesve për ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò i ndryshuar, neni 163, neni 164, neni 166, të Statutit të shoqërisë ñAlbcontrolò SHA, nenit 21 dhe me Rregulloren e Brendshme të ñAlbcontrolò SHA, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 26.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Kreu IV ñFunksionimi i shoqërisëò, nenet 21, 37, 38, 39 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 43-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1 Rekomandimi**: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij për miratimin e propozimeve të ndryshimeve të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, vetëm pasi të jetë paraqitur nga shoqëria i gjithë dokumentacioni shpjegues për nevojën e këtyre ndryshimeve, duke marrë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar dhe njohur relacionet e paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm e duke shmangur vendimmarrjen e përshpejtuar.

Titullari i Albcontrol SHA dhe departamentet e shoqërisë të marrin masa të hartojnë dhe administrojnë propozimet për ndryshimet e mundshme të ardhmen të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, shoqëruar me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

***Në vijimësi***

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 ñKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò, nenet 21-33, të Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Albcontrol SHA), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim ***shpërblimin e dëmit në vlerën* 5,602,680 *lekë pa TVSH***, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Mos realizim i detyrimeve kontraktuale me pasojë dëmtimin e fondeve publike në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** për procedurën e prokurimit *"Instalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me "Rostering System" – Faza III", viti 2019.* Nisur nga konstatimet e kryera në terren nga grupi i auditimit është konstatuar se në zbatim të kontratës së lidhur për procedurën e sipërpërmendur, nuk është realizuar njëra nga komponentët e zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, konkretisht komponentja óintegrimi i sistemit të akses control me Rostering Systemò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 152-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandimi</u>:** Administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të marrë masa për ngritjen e grupi pune të përbërë nga specialistë të fushës, i cili të analizojë situatën e realizimit të pjesshëm të zërit ñIntegrim me SW ekzistues të menaxhimit të akses control, instalim&trajnim, përfshirë AS Build, Integrimi me Rostering Systemò, zë i cili është faturuar në vlerën **5,602,680 lekë me TVSH** dhe të hartojë një raport ku të përcaktohet vlera financiare përsa i përket ñIntegrimit me Rostering Systemò. Të merren masa që vlera financiare e mos realizimit të integrimit me Rostering System që do të nxirret nga ky raport të arkëtohet pranë shoqërisë nga ana e OE óR.ô SHPK.

***Brenda datës 30.03.2022***

## C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò Albcontrol SHA, fituar nga BOE fitues ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñCuò SHPK, me vlerë 94,918,419.60 lekë me TVSH, u konstatua realizimi i zërit të punëve ñ*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90)"* jo në përputhje me specifikimet teknike për treguesit: *Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*ò.

Pra, vendosja e pompës së nxehtësisë (Chiller) VRF nga sipërmarrësi i punimeve BOE ñRr.U.A nr. 2 ñSHA & ñCuò SHPK me tregues më të ulët sesa treguesit e përcaktuar në Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, ka shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **5,354,194 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:

- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.

- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 13).
- Shtojcën 18 (Kushtet e përgjithshme të kontratës), Neni 13 ñKontraktori që Kryen Punimetò, pika 13.1 ku citohet se: ñ Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderitò të kontratës me nr. 732/45 prot., datë 21.05.2019. Pika 13.3 ku citon se: ñKodet dhe standardet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standardeve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktorò, Neni 14 (Materialet dhe pajisjet) të kontratës nr. 732/4 prot., datë 21.05.2019. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 77-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>1.1. Rekomandim:</u>** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve ñ*F.V Pompë e jashtme VRF V III. Marka General Fujitsu: Modeli: AJH414LALBH (162+162+90); Ngarkesë ftohëse 128 Kw, ngarkesë ngrohëse 131.5 Kw*ò apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Efiçiencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò Albcontrol SHA, fituar nga BOE òRr.U.A nr. 2ò SHA & òTr. En.ò SHPK, me vlerë vlerë 46,507,991 lekë me TVSH, u konstatua realizimi i zërit të punëve ñ*F.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumlin. Modeli: WSAN-XEE 702*ò jo në përputhje me specifikimet teknike:

Pra, vendosja e pompës së nxehtësisë (Chiller) nga sipërmarrësi i punimeve BOE òRr.U.A nr. 2ò SHA & òTr. En.ò SHPK me tregues më të ulët sesa treguesit e përcaktuar në Specifikimet Teknike të pranuara dhe nënshkruara nga sipërmarrësi i punimeve në DST, ka shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën **4,680,214 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me:

- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (Shtojca 5) e DST.
- Projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike (Shtojca 12).
- Shtojca 17 (Kushtet e përgjithshme të kontratës), Neni 13 ñKontraktori që Kryen Punimetò, pika 13.1 ku citohet se: ñ Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentet e tenderitò; Neni 14 ñMaterialet dhe pajisjetò të kontratës të kontratës me nr. 2255/5 prot., datë 27.12.2018.

të kontratës nr. 2255/5 prot., datë 27.12.2018. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2 (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 77-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>2.1. Rekomandim:</u>** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të zërit të punëve ñF.V Pompë nxehtësie (Chiller), kapaciteti termik në ftohje 183 KW, kapaciteti termik në ngrohje 212 kw. Përfshirë pompën qarkulluese dhe akumulim. Modeli: WSAN-XEE

702ò apo të çdo lloj pajisje të preventivuar jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Kontratës sipërmarrëse dy palëshe. Të eliminohen praktikat e realizimit të zërave të punëve të ndërtimit ku mund të konsiderohen devijime të vogla dhe për rastin konkret dhe në vijimësi, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kërkojnë ndryshimin e specifikimeve teknike nëse në treg nuk gjenden pajisje siç janë ofertuar në preventivin fitues dhe të merrnin miratimin e investitorit, duke bërë edhe negocimin e çmimit të zërit të ri të punës, duke mundësuar përdorimin e buxhetit të shoqërisë Albcontrol SHA, sipas 3-E me Eficencë, Efektivitet, Ekonomicitet.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñShtesë kontrate, për, Rehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò Albcontrol SHA, me vlerë 4,742,340 lekë me TVSH, fituar nga OE ñA. I. G. C. ò SHPK si dhe kontratës për punë publike me objekt ñRehabilitimi i Kullës së Kontigjencësò Albcontrol SHA, me vlerë 44,753,785 lekë me TVSH, fituar nga OE ñA. I. G. C. ò SHPK rezultuan zëra punime, respektivisht: ñ*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*ò, ñ*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*ò, ñ*Llamarinë D=2 mm, galvanizuar për fasadën*ò të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën **2,373,260 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2611/4 prot., datë 31.12.2018 dhe kontratës me nr. 2317/4 prot., datë 27.12.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe OE ñA.I.G.C.ò SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 74-75 të Raporit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandimi</u>:** Albcontrol SHA, të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve: ñ*Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm*ò dhe ñ*Veshje fasade me Alekubond, përfshi strukturën*ò të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: ñShpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeò me REF-xsss, me fond limit 22,416,560 lekë pa TVSH, me fitues operatori ekonomik ñR. & T.ò SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 21,130,060 lekë pa TVSH, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, hartuar nga AK me procesverbalin e datës 08.02.2019, me pasojë shpalljen fitues në paligjshmëri të prokurimit në vlerën **21,130,060 lekë pa TVSH.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>4.1. Rekomandim</u>:** Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë shpalljen fitues në paligjshmëri të prokurimit në vlerën **21,130,060 lekë pa TVSH**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi në fushën e prokurimit, si pasojë e së cilës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si dhe përbën kusht për sõkualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt Trajnim refresh të emergjencave ATCO me REF-sdsss, me fond limit 66,666,666 lekë pa TVSH, me fitues operatorin ekonomik BPOE ñCo. & M. Al. E.P.N. Al.ò SHPK me vlerë të ofertës ekonomike **66,666,666** lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO-ja nuk ka kërkuar sqarime për operatorin ekonomik Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò

me çmimin e ofertës: 54,800,000 lekë pa TVSH, për arsye se është sõkualifikuar nga KVO-ja sepse nuk ka dorëzuar bilancet për vitin 2015, 2016, 2017 e cila pretendon se në bilancet e dorëzuara nga kjo kompani ato nuk i përkasin kompanisë Global AS Danmark IVS, por i përkasin kompanisë ñGl. ATS LI., në (England Walel) dhe se këto dy shoqëri nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën, ndërkohë OE pretendon se kjo është e njëjta kompani me **50%** aksione në bashkëpronësi, duke dhënë edhe mundësi verifikimi për këtë rast, përshkruar në formularin e ankesës nr. 640 prot., datë 06.03.2019**.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 89-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandim:** Titullari i Albcontrol SHA, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për sõkualifikimin e ofertës ekonomike për të cilën nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik konkurrues, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë ñA. Co.ò shpk dhe ñGl. ATS D.IVSò, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 66,666,666 lekë pa tvsh. Të konsiderojë faktin se shqyrtimi i ofertave, duhet të udhëhiqet në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve dhe barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, duke respektuar kërkesat e nenit 2, dhe nenit nenit 53, pika 1 dhe 4 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar.

- Në procedurat e së njëjtës natyrë, në rast se do të ketë pretendime apo sqarime mbi ofertat e paraqitura apo dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik konkurrues, nëse ekzistojnë të tilla, nga KVO-ja të kërkohen sqarime shtesë për të bërë një krahasim sa më të drejtë të tyre në fazën e shqyrtimit të ofertave dhe ti kthehet një përgjigje operatorit ekonomik të sõkualifikuar duke argumentuar arsyet e sõkualifikimit të tij.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit IT", viti 2019, për zërin* õSuport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçareò u konstatua se, në ST të hartuara nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 441/1, datë 15.02.2019, në pikën 5. ñKërkesat teknikeò ndër të tjera janë kërkuar dy komponentë kryesore, rinovimi i suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve si dhe shërbime të mirëmbajtjes së pajisjeve nga ana e OE. Ky specifikim përbën mbivendosje të shërbimeve që janë kërkuar nisur nga fakti se rinovimi i suportit të prodhuesit nënkupton, ndërhyrjen e prodhuesit të pajisjeve dhe të sistemeve për marrjen e masave korrigjuese ose ndërrimin e pajisjeve në raste të problematikave madhore që mund të shfaqen gjatë përdorimit të pajisjeve. Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të ñAlbcontrol SHAò, Pika 1 d) përcaktohet se: Sektori i Shërbimeve Teknike ka për detyrë *"Të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe OpManager (Sistemi i monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik)"*. Në Nenin 35 ñDrejtoria e ITò të Rregullores së Brendshme të Albcontrol sha, Pika 2 përcaktohet se Sektori i Asistencës Informatike ka për detyrë: (Të sigurojë mbikëqyrje konstante të rrjetit të brendshëm kompjuterik në ñAlbcontrolò SHA, të sigurojë mbikëqyrje konstante të datacenter-it që i përket Drejtorisë IT; të sigurojë mbështetje teknike për printerat dhe PC-të e ñAlbcontrolò SHA; të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të Ticketing System (Sistem i kërkesës për mbështetje teknike nëpërmjet biletave elektronike) dhe të gjitha sistemeve të monitorimit të funksionimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik; Të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit lidhur me informacionin që qarkullon, ruhet dhe aksesohet; të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit të e - mail dhe vazhdimësinë e shërbimit të internet-it; Të sigurojë shërbimin back - up (kopje rezervë) me qëllim përdorimin e tij në rast defektesh). Pra, për mirëfunksionimin e sistemeve të sigurisë, shërbimeve të rrjetit, sistemit Wireless, sistemit të Telekonferencës, sistemeve të menaxhimit të rrjetit dhe sistemeve të telefonisë, Albcontrol SHA, ka prokuruar në këtë procedurë prokurimi

rinovimin e suportit të prodhuesit të pajisjeve dhe sistemeve çõka nënkupton sigurimin nga prodhuesi për marrjen e masave korrigjuese në raste të problematikave ose avarive që mund të shfaqen. Gjithashtu në strukturën organizative funksionon një drejtori e cila në bazë të rregullores së brendshme të Albcontrol ka për detyrë sigurimin dhe mbikëqyrjen e mirëfunksionimit të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të monitorimit të rrjetit të brendshëm. Në këtë procedurë, shoqëria ñAlbcontrolò SHA ka kryer investim *pa eficiencë* për zërin õSuport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçareû, në vlerën 4,233,360 lekë pa TVSH.
Grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, i ngritur me Urdhrin 591/5, datë 17.04.2019 nuk ka mbajtur procesverbal për verifikimin e realizimit të zërit ñSuport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, Wireless, telefonat IP, Telekonferencë, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetitò për një periudhë 1-vjeçare nga momenti i lidhjes së kontratës, në kundërshtim me pikën 47, Kapitulli 3 i Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Grupi i punës i sipërpërmendur ka firmosur raportet mujore të shërbimit të mirëmbajtjes të dorëzuar nga operatori ekonomik, por nuk ka konfirmuar kryerjen e shërbimeve me anë të ndonjë procesverbali, çõka bie në kundërshtim me nenin 37 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, Albcontrol SHA, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të realizimit të prokurimit të paargumentuar të një shërbimi i cili i mbivendoset detyrave që rregullorja e brendshme e Albcontrol përcakton se duhet të kryhen nga strukturat e brendshme të shoqërisë si dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa eficiencë, për procedurat e prokurimit që lidhen me sisteme të IT.

***Menjëherë***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019 u konstatua se, n*ga ana e kontraktuesit nuk është dorëzuar pranë AK kodi burim i sistemit në format elektronik dhe në format shkresor sikurse përcaktohet në pikën 9. ñTë Drejtat e Kodit të Aplikacionitò, të ST të hartuara përmes procesverbalit nr. 1182/2, datë 02.09.2019 të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 1182/1, datë 22.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm. Pavarësisht se sistemi është hostuar në infrastrukturën fizike të Albcontrol SHA dhe menaxhimi dhe administrimi i tij kryhet nga ana e Albcontrol SHA, nga ana e OE në përputhje me kontratën nr. 2076/4, datë 16.12.2019 duhet të ishte dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, kodi burim i sistemit në format shkresor dhe elektronik. Sistemi i Intranet të Albcontrol SHA nuk është përdorur në asnjë rast për nevoja të shoqërisë apo për mbështetjen e proceseve të punës së shoqërisë. Nga gjurmët e auditimit të veprimeve të kryera në sistemin Intranet të Albcontrol SHA konstatohet se, që nga momenti i implementimit të sistemit, pra data 16.01.2020 deri më datë 27.09.2021 në sistem janë kryer vetëm veprime në formën e testimeve nga kontraktori ose nga punonjës së strukturave IT të ñAlbcontrolò SHA, gjithsej 21 veprime. Sa më sipër trajtuar kemi të bëjmë me shpenzim të fondeve *pa efektivitet* në vlerën ***1,333,100 lekë pa TVSH*** në procedurën e prokurimit *"Sistem INTRANET të ALBCONTROL SHA", viti 2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 149-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë Albcontrol SHA të marrë masa për analizimin e situatës aktuale, të nevojës së institucionit për këtë sistem dhe nxjerrjen e rezultateve për të konstatuar përgjegjësitë përkatëse dhe arsyet e mos-përdorimit të sistemit Intranet të Albcontrol. Në rast se nga analizimi i situatës rezulton se sistemi INTRANET është i dobishëm për shoqërinë të merren masa për të organizuar punën e divizioneve përkatës me qëllim shfrytëzimin e sistemit me kapacitet të plotë për nevojat e shoqërisë.

***Menjëherë***

**8. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò Albcontrol SHA, fituar nga BOE fitues ñRr.U.A nr. 2 ñSHA & ñCuò SHPK, me vlerë 94,918,419.60 lekë me TVSH, rezultuan zëra punime, konkretisht: *"Shtrim dysheme me Rezinë EPOXY Autoniveluese 3-5 mm (Rezistente ndaj kalimit të mjeteve të magazinës)", "F.V Porte metalike dekorative rrëshqitëse", "Pajisje të brendshme kasetë AUXA54GALH, marka General Fujitsu, ngarkesë ftohëse 14 kw, ngarkesë ngrohëse 16 kw"* të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën **2,401,029 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.732/4 prot., datë 21.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ñAlbcontrolò SHA dhe BOE fitues ñRr.U.A nr. 2 ñSHA & ñCuò SHPK. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 76-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

***Menjëherë***

**9. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò Albcontrol SHA, fituar nga BOE òRr.U.A nr. 2 ñSHA & òTr. En.ò SHPK, me vlerë vlerë 46,507,991 lekë me TVSH, rezultuan në objekt zëra të punimeve, respektivisht : ñF.V bolier 80 litër, ujë të ngrohtëò dhe zëri ñShtresë termoizoluese me lesh guriò, të paargumentuar qartësisht dhe në përputhje me SP në vlerën në vlerën **923,494 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2255/5 prot., datë 27.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Albcontrol SHA dhe BOE ñRr.U.A nr. 2ò SHA & ñTr. En.ò SHPK. (Më hollësisht *trajtuar në pikën 7 faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Nga Albcontrol SHA, të merren masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punime të cilat të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet dhe arsyet e mos pasqyrimit me saktësi në librezën e masave.

**Menjëherë**

## D. MASAT DISIPLINORE.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò; nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 ñKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò, nenet 21-33, të Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ñPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/2 dhe neni 15; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2, *për*:
- Shkeljet e konstatua për mos eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet të fondeve publike kryesisht në prokurimet publike.

- Shkeljet e konstatua për mos realizimin e disa zërave të ndërtimit gjatë zbatimit të kontratave për punë publike si dhe kontratat e shërbimit.
- Shkeljet e konstatua për mos realizimin e disa zërave në përputhshmëri me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës së lidhur.
- Mbi ndryshimet e përshpejtuara të programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë, në mungesë dokumentacionit justifikues mbi nevojën e ndryshimeve të pa shoqëruara me relacione të hollësishme teknike dhe financiare.

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; germat (b, c, ç) e nenit 58 ñLlojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 ñKodi i punës në Republikën e Shqipërisëò; shkronja (b) e nenit 9 ñMasa disiplinore ò, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i **rekomandojmë titullarit të shoqërisë "Albcontrol" SHA** që të kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

# VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT.

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

**a. Akt konstatime:**

1. Akt Konstatimi nr.1, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñSigurimi i riskut nga të tretët dhe aksidentet ajroreò mbajtur në Albcontrol SHA.
2. Akt Konstatimi nr.2, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñTrajnim KTA të rinj (Rating ACS/TWR) dhe gjuhën Anglezeò mbajtur në Albcontrol SHA.
3. Akt Konstatimi nr.3, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñTrajnim refresh të emergjencave ATCOò mbajtur në Albcontrol SHA.
4. Akt Konstatimi nr.4, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime për kontrollin mjeksorò mbajtur në Albcontrol SHA.
5. Akt Konstatimi nr.5, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pajisje elektronikeò mbajtur në Albcontrol SHA.
6. Akt Konstatimi nr.6, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime mirëmbajtje, blerje pjesë ndërrimi, si dhe zgjerimi i rrjetit për fibrën optikeò mbajtur në Albcontrol SHA.
7. Akt Konstatimi nr.7, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñKontratë mirëmbajtje e pajisjes së navigimit DME-Indraò mbajtur në Albcontrol SHA.
8. Akt Konstatimi nr.8, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime mirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi VSC-INDRA, GAREXò mbajtur në Albcontrol SHA.
9. Akt Konstatimi nr.9, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi dhe kontratë mirëmbajtje ò mbajtur në Albcontrol SHA.
10. Akt Konstatimi nr.10, datë 30.09.2021 ñPër Auditimin e shërbimeve të kryera nga shoqëria dhe zbatimin e sistemit të taksave mbi korridoret ajrore referuar dispozitave ligjore në fuqi, për periudhën 01.09.2018-31.03.2021ò mbajtur në Albcontrol SHA.
11. Akt Konstatimi nr.11, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñShpenzime mirëmbajtje teknike CRS/PRS e Rosteritò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
12. Akt Konstatimi nr.12, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñKontratë konsulentë për hartimin e kostos me Eurocontrol mirëmbajtje teknike CRS/PRS e Rosteritò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
13. Akt Konstatimi nr.13, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñMirëmbajtje dhe blerje pjesë ndërrimi, mbështetje teknike, rinovim licencash, për sistemin VOIP, Cisco, Wireless, Telekonferencë, si dhe shërbim mirëmbajtje e rrjetit ITò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
14. Akt Konstatimi nr.14, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi, si dhe shpenzime për mirëmbajtje e përmirësimi i rrjetit network MWLò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
15. Akt Konstatimi nr.15, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñSistem Intranet të Albcontrol SHAò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
16. Akt Konstatimi nr.16, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñInstalimi Akses Control System në ACC/TWR dhe integrimi me ñRostering Systemò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
17. Akt Konstatimi nr.17, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje Brifing Systemò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
18. Akt Konstatimi nr.18, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin CMS (prodhuar nga IBM)ò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.

19. Akt Konstatimi nr.19, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñBlerje pjesë ndërrimi dhe mirëmbajtje për sistemin Help Desk (prodhuar nga IBM)ò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
20. Akt Konstatimi nr.20, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt ñSigurimi i Pasurisë Albcontrol SHAò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
21. Akt Konstatimi nr.21, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñShtesë kontrate, për Rehabilitimin i Kullës së Kontigjencësò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
22. Akt Konstatimi nr.22, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñShpenzime mirëmbajtja dhe blerje pjesë ndërrimi e sistemeve të instaluara në ACC/APP/TWR/ADMINISTRATËò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
23. Akt Konstatimi nr.23, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñInvestime për infrastrukturën e Divizionit Teknikò, viti 2019 mbajtur në Albcontrol SHA.
24. Akt Konstatimi nr.24, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñSigurimi i pasurisë së Albcontrol SHAò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
25. Akt Konstatimi nr.25, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñRehabilitimi i Qendrës së Kontigjencës ACCò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
26. Akt Konstatimi nr.26, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñStudim ñKukës obstacle surveyò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
27. Akt Konstatimi nr.27, datë 30.09.2021 mbi ñOrganizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brenfshëmò, mbajtur në Albcontrol SHA.
28. Akt Konstatimi nr.28, datë 30.09.2021 mbi ñMbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò, mbajtur në Albcontrol SHA.
29. Akt Konstatimi nr.29, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimi i punimeve me objekt ñShtesë kontrate, për Rehabilitimin i Kullës së Kontigjencësò, viti 2018 mbajtur në Albcontrol SHA.
30. Akt Konstatimi nr.30, datë 30.09.2021 mbi ñMbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyreò, mbajtur në Albcontrol SHA.
31. Akt Konstatimi nr.31, datë 30.09.2021 mbi ñMbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tijò, mbajtur në Albcontrol SHA.
32. Akt Konstatimi nr.32, datë 30.09.2021 mbi ñMbi përputhshmërinë ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeliò, mbajtur në Albcontrol SHA.

**b. Akt verifikime:**

1. Akt verifikim nr. 1, datë 30.09.2021 mbi ñZbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëmò mbajtur në Albcontrol SHA.
2. Akt verifikim nr. 2, datë 30.09.2021 mbi zbatimin e procedurave ligjore për prokurimin me objekt ñShpenzime për policinë privateò mbajtur në Albcontrol SHA.

**Shënim:** Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet tâu bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht tâu jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Përfundimtar.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**